

KONFISKIMI I DOBISË PASURORE TË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE

SEVDALI ZEJNULLAHU

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës

Shkollës doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të doktoratës në
SHKENCA JURIDIKE, me profil E DREJTË PUBLIKE, për marrjen e
gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor Prof. Dr. Bashkim Zahiti (LL.M)

Numri i fjalëve: 97.439

Tiranë, 2019

DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time, deklaroj se ky punim i disertacionit me titull “ Konfiskimi i dobisë pasurore të përfitur me vepër penale” është shkruar prej meje, nuk është prezentuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi
Sevdali Zejnullahu

Tiranë, 2019

Falenderim

Të cilin dua ta nis me Universitetin European të Tiranës që më dha mundësinë për të qenë pjesë e programit doktorat.

Falenderim i sinqertë shkon për udhëheqësin shkencor, Prof. Dr. Bashkim Zahiti (LL.M) që dëshmoi dashamirësinë dhe mirëkuptimin për të kapërcyer në kohë dhe shpejt vështirësitë e hasura në çdo shkallë të punimit të këtij disertacioni. Diskutimet me të, sugjerimet, këshillat dhe udhëzimet e dhëna në vazhdimësi kanë ndikuar në rritjen time profesionale në fushën e drejtimit juridiko – penal e më gjerë dhe, padyshim, më kanë ndihmuar drejt paraqitjes sa më të mirë të këtij punimi.

Një falenderim i veçantë shkon për kolegët e mi, e sidomos ata avokatë, me të cilët ecim çdo ditë në fushën e bukur por sfiduese të drejtësisë. Diskutimet me ta më kanë nxitur t'i përkushtohem kësaj fushe akoma më shumë dhe më shërbyen si një guidë e pazëvendësueshme për të qenë koherent dhe efektiv në këtë sipërmarrje akademike.

Mirënjohja e fundit, por mjaft e rëndësishme shkon për familjen time, e cila ka qenë mbështetja më e madhe dhe e pakursyer në hapat e mi të karrierës. Pa dashurinë e tyre të çdo dite dhe mirëkuptimin për mungesat e mia në kohën që duhet të kaloja me ta, nuk do mund të mbërrija deri këtu. Ata me durim më inkurajuan dhe më mbështetën përgjatë gjithë kësaj kohe.

Falenderim për këdo bashkëudhëtar tjetër të këtij punimi, pavarësisht nga koha e përkushtimit, që më ka ndihmuar të përsos më mirë fjalën dhe argumentin dhe e ka plotësuar këtë temë si shenjë miqësie dhe kontributi për më të mirën.

Ky punim i dedikohet fëmijëve të mi, jo si falje për kohën e munguar, por si mesazh i qartë se rruga e dijes, në të cilën duhet të ecin, është e gjatë dhe plot djersë.

Abstrakt

Çështja e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale gjendet në fokusin e interesimit të opinionit profesional dhe shkencor vendor e global. Interesimi për të është ngritja e vetëdijes për rritjen e vazhdueshme të kriminalitetit dhe për efektet e saja me theks të posaçëm përfitimet financiare.

Në kuadër të strukturës së dizertacionit të doktoraturës, vë hipotezën kryesore (pyetjen kërkimore) dhe disa pyetje ndihmëse të cilat me përpunimin e strukturës ekzistuese ligjore në Republikën e Kosovës, të standardeve ndërkombëtare dhe të paraqitjes komparative të legjislacionit ndërkombëtar do të vërtetojnë si vijon:

1) Nevojën e avancimit të masave për luftimin e krimit me ngritjen e nivelit të vetëdijes të të gjitha agjencive të zbatimit të ligjit të cilët marrin pjesë në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, me veprim të koordinuar, kontroll efektiv dhe edukim sistematik, për çka në rend të parë duhet intensifikuar përpjekjet e vazhdueshme për parandalimin e këtyre dukurive negative në të gjitha nivelet.

2) Forcimi i drejtpërdrejtë i agjencive të zbatimit të ligjit për parandalim, edukimit dhe të përpunimit analitik të informacioneve të pranura për transaksionet e parave të gatshme, në veçanti të transaksioneve me karakter dyshimi.

3) Dallimet dhe ngjashmëritë e sistemeve për luftimin e kriminalitetit dhe me theks të posaçëm konfiskimin e dobisë pasurore në disa vende të Bashkimit Evropian, në tërësi bëjnë me dije se aktivitetet kriminale dhe të financimit të terrorizmit tejkalojnë kufijtë nacional dhe synohet drejtë gjetjes së zgjidhjeve në nivelin ndërkombëtar.

Hipotezat e theksuara shkojnë në favor të faktit se globalizimi i krimit kërkon globalizimin e normave juridike dhe në veçanti, harmonizimin dhe koordinimin e veprimit në nivelin ndërkombëtar por edhe në nivelin nacional.

Nga arsyeja e theksuar me të drejtë pritet se ligjet, aktet juridike dhe marrëveshjet të cilët më hollësisht përpunojnë materien e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, do të hapin mundësi të reja të veprimit konkret në praktikën gjyqësore të Republikës së Kosovës. Përderisa, instituti i konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale bazohet në parimin se askush nuk duhet të ketë përfitime nga kriminaliteti, në të kundërtën atë dobi, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë, shteti do ta konfiskoj dhe dënoj veprimin e kundërligjshëm.

Abstract

The issue of confiscation of the material benefit of criminal offenses lies in the focus of interest of local and global scientific and professional opinion. Its interest is raising awareness about the continued growth of criminality and its effects with a special emphasis on financial benefits.

Within the structure of the doctoral dissertation, I have highlighted the main hypothesis (research question) and some auxiliary questions which by elaborating the existing legal structure in the Republic of Kosovo, international standards and comparative presentation of international legislation will prove as follows:

- 1) The need to advance crime prevention measures by raising the level of awareness of all law enforcement agencies participating in the fight against organized crime and terrorist financing through coordinated action, effective control and systematic education, for which, first of all, prevention at all levels should be strengthened.
- 2) Direct strengthening of law enforcement agencies for prevention, education and analytical processing of accepted information on cash transactions, especially of suspicious transactions.
- 3) Differences and similarities of systems to fight criminality and with particular emphasis on the confiscation of property benefits in some European Union countries generally suggest that criminal and terrorist financing activities exceed national boundaries and it is aimed for solutions at the international level. The highlighted hypotheses go in favor of the fact that globalization of crime requires the globalization of legal norms and, in particular, the harmonization and coordination of action at the international level but also at the national level. From the right reason it is expected that laws, legal acts and agreements that elaborate on the matter of confiscation of the material benefit of criminal offenses and organized crime will open new opportunities for concrete action in judicial practice in Republic of Kosova.

Therefore, the institute of the confiscation of material benefit acquired by criminal offense is based on the principle that no one should have benefits from criminality, on the contrary that benefit, in order to protect the society; the state will confiscate and punish the unlawful act.

Shkurtesat e përdorura

AAPSK	Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
BE	Bashkimin European.
DHKEK	Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit.
EULEX	Misioni i Bashkimit European mbi Sundimin e Ligjit në Kosovë.
FBI	Byroja Federale e Hetimeve.
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar mbi Shpëlarjen e Parave.
GRECO	Komiteti i Këshillit të Europës për të luftuar korrupsionin.
KB	Kombet e Bashkuara.
KE	Këshilli i Europës.
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale i Kosovës
KPRSH	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
KPPRSH	Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
LPKDPK	Ligji për procedurën e konfiskimit të dobisë pasurore të realizuar me vepër penale dhe kundërvajtje i Kroacisë.
MONEYVAL	Komiteti i përzgjedhur i ekspertëve i Këshillit të Europës mbi Vlerësimin e Masave Kundër Shpëlarjes së Parave.
ML	Money Laundering/Shpëlarja e parave
NjIF-K	Njësinë Financiare të Inteligjencës e Republikës së Kosovës.
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara.
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë.
PBB	Produkti i brendshëm bruto
PEP	Personat e ekspozuar politik.
RTG	Raporti i parave të gatshme.
QFI	Qendra Financiare e Inteligjencës.
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
SIPK	Sistemi informativ i Policisë së Kosovës.
SOCA	Agjencia për vepra të rënda penale.
TF	Terrorism Financing/ Financimi i terrorizmit.
UNODC	Sekretariati i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin.
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë.
VKM	Vendime të këshillit të ministrave.

LISTA E TABELAVE

- Tabela 1. Klasifikimi i moshës së popullsisë mostër.
- Tabela 2. Njohuritë e respondentëve rreth institutit të konfiskimit të pasurisë të përfituar me vepër penale.
- Tabela 3. Opinionet rreth efektivitetit të parandalimit të kriminalitetit në të ardhmën nëpërmjet konfiskimit të pasurisë së paligjshme të tyre
- Tabela 4. Njohuritë rreth aktiviteteve kriminale në Republikën e Kosovës
- Tabela 5. Opinionet rreth agjencive të zbatimit të ligjit në lidhje me konfiskimin e pasurive të paligjshme
- Tabela 6. Mendimet e respondentëve lidhur me kategoritë më të rrezikuara të subjekteve nga format e sofistikuara të krimeve
- Tabela 7. Mendimet e respondentëve lidhur me aftësinë e agjencioneve të zbatimit të ligjit në trajtimin e kërcnimeve nga kryesit e veprave penale
- Tabela 8. Opinionet për efikasitetin e masave të deritanishme të agjencioneve të zbatimit të ligjit në konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale
- Tabela 9. Informacionet për rastet e proceduara lidhur me konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale

Përmbajtja

Deklarata e autorësisë.....	II
Falenderim.....	III
Abstrakt.....	IV
Abstract.....	V
Shkurtesat e përdorura.....	VI
Lista e tabelave.....	VII
KAPITULLI I.....	1
1.HYRJE.....	1
1.1. Qëllimi i punimit	4
1.2. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore.....	5
1.3. Metodologjia.....	7
1.4. Avantazhet (përparësitë) dhe kufizimet e studimit të konfiskimit të dobisë pasurore...8	
1.5. Struktura e punimit.....	9
KAPITULLI II.....	11
VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME KONFISKIMIN E DOBISË PASURORE TË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE.....	11
2.1. Natyra juridike të institutit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.....	12
2.2. Përcaktimi i përmbajtjes së nocionit dobi pasurore e përfituar me vepër penale in abstracto.....	14
2.3. Format themelore dhe konfiskimi i kundërvlerës.....	16
KAPITULLI III.....	18
DISPOZITAT LIGJORE NDËRKOMBËTARE – KONVENTAT DHE DIREKTIVAT ME TË CILAT RREGULLOHET MATERJA E KONFISKIMIT TË DOBISË PASURORE TË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE.....	18
3.1Aktet juridike të karakterit ndërkombëtar lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.....	22
3.1.1. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër qarkullimit të kundërligjshëm të mjeteve narkotike dhe substancave psikotropike (Konventa e Vjenës) në vitin 1988	23
3.1.2. Konventa e Këshillit të Europës e vitit 1990 “Mbi pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të rrjedhura nga krimet”, e njohur si Konventa e Strasburgut...25	
3.1.3. Konventa Ndërkombëtare për luftimin e financimit të terrorizmit, e miratuar më 9 dhjetor 1999 në New York.....	26

3.1.4. Konventa penalo-juridike e Këshillit të Europës për korrupsionin, e miratuar më 27 janar 1999 në Strasburg.....	26
3.1.5. Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar transnacional (Konventa e Palermo-s) e vitit 2000 dhe protokollet plotësuese.....	28
3.1.6. Konventa e OKB-së kundër korrupsionit (Konventa e New York-ut) e vitit 2003..	30
3.1.7. Konventa e KE-së “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”... ..	31
3.2Aktet juridike të Bashkimit European lidhur me konfiskimin e pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme	32
3.2.1.Vendimi kornizues për pastrimin e parave, identifikimin, përcjelljen, ngrirjen, konfiskimin e mjeteve dhe të hyrave nga vepra penale (2001/500/JHA).....	33
3.2.2.Vendimi Kornizues për zbatimin e urdhërave për ngrirje të pasurisë ose të dëshmive (2003/577/JHA).....	33
3.2.3.Vendimi Kornizues për vendosjen e dispozitave minimale për elementët thelbësorë të veprave penale dhe të dënimeve në fushën e trafikimit të paligjshëm të mjeteve narkotike (2004/757/JHA).....	34
3.2.4.Vendimi Kornizues për konfiskimin e përhershëm të të hyrave, mjeteve dhe pasurive të ndërlidhura me kriminalitetin (2003/212/JHA)....	34
3.2.5.Vendimi kornizues për zbatimin e parimit të pranimit reciprok të urdhërimit për konfiskim të përhershëm (2006/783/JHA).....	35
3.2.6.Direktiva për ngrirjen dhe konfiskimin e përhershëm të të hyrave të fituara me vepra penale në Bashkimin European 25 shkurt 2014 (EP-PE_TC1-COD (2012)0036)...	36
3.2.7. Urdhëri European i Hetimeve.. ..	39
KAPITULLI IV.....	43
ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE, TË RËNDËSISHME NË FUSHËN E KONFISKIMIT TË PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË TË KUNDËRLIGJSHME.....	43
4.1. Organizatat ndërkombëtare në luftën kundër shpëlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe zgjerimit të armëve të shkatërrimit në masë - FATF	43
4.2. Komiteti i ekspertëve të Këshillit të Europës për evolucionin e masave në luftën kundër larjes së parave dhe financimin e terrorizmit – MONEYVAL.....	46
4.3. Grupi i shteteve për luftën kundër korrupsionit (GRECO).....	46
4.4. Rrjeti integrativ ndërkombëtar për kthimin e mjeteve – CARIN.....	47
4.5. Rrjeti i njësive financiarë informues – EGMONT GROUP.....	47

KAPITULLI V.....	49
PARAQITJA KRAHASIMORE E DISA SISTEMEVE TË KONFISKIMIT TË DOBISË PASURORE TË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE NËPËR BOTË.....	49
5.1. Nevoja e respektimit të parimeve themelore të drejtësisë në procesin e konfiskimit të dobisë pasurore.....	49
5.2. Qëllimi dhe rëndësia e konfiskimit të dobisë pasurore.....	50
5.3.Kroacia... ..	55
5.3.1. Ligji për procedurën e konfiskimit të dobisë pasurore të realizuar me vepër penale dhe kundërvajtje i Kroacisë... ..	56
5.3.2. Veprimi i gjykatës sipas legjislacionit kroat.....	58
5.3.3. Sigurimi i konfiskimit të dobisë pasurore.....	60
5.3.4. Mbrojtja e drejtave të personit të tretë	62
5.3.5. Përmbarimi.....	62
5.3.6. Veprimi me pasurinë e konfiskuar përkohësisht dhe me pasurinë e konfiskuar	62
5.3.7. Pranimi dhe përmbarimi i vendimeve të huaja	63
5.3.8. Rastet e veçanta të konfiskimit	64
5.4. Sllovenia	65
5.4.1. Ligji për Procedurën Penale.....	66
5.4.2. Ligji për Procedurën Tatimore	67
5.4.3. Ligji për Shërbimin Tatimor.....	69
5.4.4. Dekreti për veprimin me sendet, pasurinë dhe letrat me vlerë të konfiskuara	70
5.4.5. Ruajtja, shitja dhe shkatërrimi i sendeve.....	71
5.4.6. Administrimi me depozitat gjyqësore dhe mjetet monetare... ..	74
5.5. Bosnja dhe Hercegovina	77
5.5.1. Ligji Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës.....	79
5.5.2. Konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale dhe pasojat juridike të dënimit.....	79
5.5.3. Mbrojtja e të dëmtuarit	80
5.5.4. Ligji i Procedurës Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës.....	80
5.5.5. Urdhëri për bankën ose personin tjetër juridik	81
5.5.6. Konfiskimi i përkohshëm i pasurisë me qëllim sigurimin e saj.....	82
5.5.7. Konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.....	83
5.5.8. Barra e kundërt e të provuarit të prejardhjes së pasurisë.....	84

5.5.9. Zbatimi i vendimeve të huaja penale të konfiskimit nga Bosnje-Hercegovina.....	85
5.6. Serbia.....	87
5.6.1. Ligji për konfiskimin e pasurisë së dalë nga vepra penale.....	88
5.6.2. Organet kompetente.....	89
5.7. Italia.....	92
5.7.1. Ligji Nr. 575.....	93
5.7.2. Ndryshimi legjislativ i 1982: Ligji Rognoni - La Torre.....	94
5.7.3. Sekuestrimi i kapitaleve mafioze - Maxi procesi i Cosa Nostra-s.....	94
5.7.4. Peticioni Libera dhe Ligji 109/1996....	95
5.7.5. Policia Financiare.....	96
5.8. Sllovakia.....	100
5.8.1 Ligji 335/2005 për dëshmimin e burimeve të pasurisë	101
5.9. Irlanda....	107
5.9.1 Veprimi i gjykatës në fushën e konfiskimit.....	107
5.10. Anglia.....	110
5.10.1 Agjencisë për Vepra të Rënda Penale (SOCA).....	111
5.11. Franca.....	112
5.11.1 Ngrirja dhe konfiskimi i aseteve.....	114
5.11.2. Agjencia e administrimit të aseteve.....	115
5.11.3. Si funksionon AGRASC.....	116
5.11.4. Identifikimi i aseteve	118
5.12. Shqipëria.....	119
5.12.1. Ligjet e veçanta që e rregullojnë fushën e konfiskimit të pasurisë të përfituar në...123	123
mënyrë të kundërligjshme.....	123
5.12.2. Agjencitë e zbatimit të ligjit që prekin fushën e konfiskimit të pasurisë.....	125
5.12.3. Ndryshimet legjilative që prekin fushën e konfiskimit të pasurisë të përfituar në	
mënyrë të kundërligjshme.....	127
5.12.4 Roli i Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara.....	129
5.12.5. Raportet dhe statistikat e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara	
dhe Konfiskuara.....	131
KAPITULLI VI.....	137
RREGULLIMI LIGJOR I KONFISKIMIT TË DOBISË PASURORE TË PËRFITUAR	
ME VEPËR PENALE NË KOSOVË.....	137
6.1. Vështrime të përgjithshme.....	137

6.2. Natyra juridike e konfiskimit të dobisë pasurore	139
6.3. Konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale në legjislacionin e Republikës së Kosovës.....	143
6.3.1. Konfiskimi i dobisë pasurore sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.....	144
6.3.1.2. Mbrojtja e të dëmtuarit.....	149
6.3.1.3. Pasojat juridike të dënimit... ..	149
6.4. Konfiskimi i zgjeruar të dobisë pasurore	151
6.4.1. Nocioni i konfiskimit të zgjeruar.....	153
6.4.2. Zgjidhjet në legjislacionin krahasues.. ..	155
6.5. Konfiskimi i zgjeruar i dobisë pasurore sipas Legjislacionit Kosovar... ..	157
6.5.1. Pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit... ..	158
6.5.2. Kushtet e veçanta për disa raste të konfiskimit.....	160
6.6. Procedura e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale sipas Kodit të Procedurës Penale....	163
6.6.1. Konfiskimi i përkohshëm (sequestrimi).....	163
6.6.2. Urdhërkontrolli, koha dhe vendi i kontrollit.....	164
6.6.3. Sekuestrimi i përkohshëm i sendeve.....	166
6.6.4. Konfiskimi i përhershëm i sendeve të konfiskuara përkohësisht.....	170
6.6.5. Ngrirja e përkohshme e aseteve dhe urdhri ndalues... ..	172
6.6.6. Procedura e konfiskimit të përkohshëm dhe masat e përkohshme për sigurimin e Pasurisë.....	176
6.6.6.1. Konfiskimi i përkohshëm....	176
6.6.7. Procedurat e konfiskimit të dobisë pasurore pas ngritjes së aktakuzës. Përfshirja në aktakuzë e pasurisë që është objekt i konfiskimit....	185
6.7. Agjencionet e zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore.....	197
6.7.1. Evidenca për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar.....	198
6.7.2. Shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi ndërkombëtar i agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.....	198
6.7.3. Roli i agjencisë në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.....	199
6.7.4. Roli ekzekutues i Agjencisë... ..	200
6.7.5. Administrimi me pasurinë e sekuestruar.....	200
6.7.6. Vlerësimi i vlerës monetare të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar.....	201

6.7.7. Shkatërrimi i detyrueshëm i pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe kthimi i saj.....	202
6.7.8. Shitja e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.....	202
6.7.9. Analiza e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave për konfiskim të pasurisë..	202
KAPITULLI VII.....	208
7. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT, PYETËSORËT DHE ANALIZA.....	208
7.1. Formulimi i pyetësorit kërkimor..	209
7.2. Konsideratat etike në mbledhjen e të dhënave.....	209
7.3. Procesi i marrjes së mostrave....	210
7.4. Metodat e përdorura në anketat kërkimore.....	211
7.5. Mostra e respondentëve... ..	212
7.6. Organizimi i të dhënave dhe analizat.....	212
7.7. Cilësia e të dhënave të grumbulluara.....	213
7.8. Rezultatet nga anketa.....	214
7.8.1. Demografia e popullsisë mostër.....	214
7.8.2. Njohuritë e respondentëve rreth institutit të konfiskimit të pasurisë të përfituar me vepër penale... ..	215
7.8.3. Opinionet rreth efektivitetit të parandalimit të kriminalitetit në të ardhmën nëpërmjet konfiskimit të pasurisë së paligjshme të tyre.	216
7.8.4. Njohuritë rreth aktiviteteve kriminale në Republikën e Kosovës.....	217
7.8.5. Opinionet rreth agjencive të zbatimit të ligjit në lidhje me konfiskimin e pasurive të paligjshme.....	218
7.8.6. Mendimet e respondentëve lidhur me kategoritë më të rrezikuara të subjekteve nga format e sofistikuara të krimeve.....	219
7.8.8. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për arsyejet e operimit të grupeve të ndryshme kriminale në Kosovë që ndërlidhen me shpëlarjen e parave, trafikimin me qenie njerëzore, prostitucionin, trafikimin me narkotik etj.....	221
7.8.9. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për efikasitetin dhe mundësitë e institucioneve të zbatimit të ligjit në Kosovë që të garantojnë siguri me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit	221
7.8.10. Njohuritë për zbatimin e konfiskimit të pasurisë së paligjshme.....	222
7.8.11. Opinionet për efikasitetin e masave të deritanishme të agjencioneve të zbatimit të ligjit në konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.....	222

7.8.12. Informacionet për rastet e proceduara lidhur me konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.....	223
7.8.13. Gadishmëria e qytetarëve për mbikëqyrjen nga institucionet në sistemin e tyre bankarë.....	224
7.8.14. Vlerësimi i shkallës së koordinimit në mes të organeve të zbatimit të ligjit	225
7.8.15. Pritjet në të ardhmen lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore.....	225
7.9. Përfundimet e anketës.....	225
7.9.1. Kufizimet.....	227
SHTOJCË.....	228
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	234
L I T E R A T U R A.....	239

KAPITULLI I

1. HYRJE

Çështja e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale gjendet në vatrën e interesit të opinionit profesional dhe shkencor vendor, rajonal dhe botëror. Një interes i përgjithshëm dhe i shtuar mbështetet në rritjen e vetëdijes profesionale dhe publike, në kushtet kur kriminaliteti dhe efektet financiare që prodhon, njohin rritje të vazhdueshme. Kapitali i fituar nga veprat penale dhe i rikthyer për të financuar vepra të tjera penale po rritet dukshëm dhe në mënyrë shqetësuese në nivel global. Sjellja kriminale njihet zhvillim të mëtijshëm dhe nëpërmjet financimeve, që nuk janë gjë tjetër veçse pastrim parash dhe korrupsion, përmes të cilave kontrollojnë edhe vendimarrjet ekonomike dhe politike të shteteve. Në kushte të tilla, metodat tradicionale të politikës së luftimit të kriminalitetit bazuar në mekanizmat e drejtësisë penale kanë rezultuar të pamjaftueshme. Për këtë arsye janë bërë përpjekje për të hyrë në gjurmë, në mënyrë që të konfiskohen të hyrat e fituara me aktivitete kriminale. Në këto përpjekje është përfshirë dhe Kosova, e cila gjatë dekadës së fundit ka lëvizur në dy drejtime: 1. në luftën kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe 2. në luftën e vazhdueshme të zbulimit, kontrollit dhe koncentrimit të pasurisë në duart e elementëve të lidhur me krimin e organizuar. Përpjekja, e cila do mbështetje të pakushtëzuar, ka rezultuar shpesh në vështirësi konsekuente mes të cilave, përpjekja për të përcaktuar barrën e provës në lidhje me prejardhjen e pasurisë, rezulton ndër më sfidaeset.

Në dekadat e fundit, problemi i kriminalitetit të organizuar me qëllim përfitimin e dobisë pasurore me anë të veprës penale është prezent gjithnjë e më shumë si në shkallë kombëtare ashtu dhe në atë ndërkombëtare. Rritja e kriminalitetit është e favorizuar në njërin anë nga globalizimi i tregut, përmes qarkullimit të lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, ndërsa nga ana tjetër, teknologjitë moderne dhe sistemi i sofistikuar i pagesës hapin mundësi të reja dhe modifikojnë mënyrat klasike të fitimit të dobisë pasurore me vepër penale.

Në esencë, fitimi i dobisë pasurore me vepër penale paraqet një ndër problemet më sfidaese për organet e drejtësisë pasi që është shumë e vështirë zbulimi i rrjeteve kriminale, gjë e cila e bën shumë të vështirë suksesin përfundimtar. Kriminelët mund të jenë të suksesshëm vetëm nëse dobia pasurore e përfituar me vepër penale do të shfrytëzohej në

mënyrë që burimi i vërtetë i saj të fshihet. Me përfundimin e ciklit të fitimit të dobisë pasurore me vepër penale aktiviteti kriminal fiton konfirmimin se është i pagueshëm dhe, kështu, mundet përsëri të fillojë ose të vazhdojë investime të reja me fitimet e dobive pasurore me anë të veprës penale, investime që shkojnë edhe në fusha të ashtëquajtura “të ligjshme”.

Në rrafshin ndërkombëtar, përkatësisht në aktet juridike ndërkombëtare, kuptimi i shprehjes “dobi pasurore” përmendet për herë të parë vetëm para 30 viteve, e madje në kuptim të ngushtë. Kështu, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër qarkullimit të paligjshëm të mjeteve narkotike dhe substancave psikotropike e vitit 1988 konsiderohet si marrëveshja e parë ndërkombëtare lidhur me këtë lëndë por, duhet pohuar, se ajo e ndërlidh në mënyrë primare dobinë pasurore me nocionin e drogës.

Konventa vijuese e Këshillit të Europës, e vitit 1990 për pastrimin, gjurmimin, konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin e të hyrave të fituara me vepër penale (dhe për financimin e terrorizmit), si dhe konventat e tjera që kanë lidhje me krimin e organizuar dhe terrorizmin rezultuan përpjekje serioze e këtyre organizmave me qëllim:

- zvogëlimin e plagëve nacionale, rajonale dhe ndërkombëtare të krijuara nga krimi;
- luftën kundër kriminalitetit të lidhur me fitimin e dobisë pasurore të krijuar me vepër penale; dhe
- luftën kundër financimit të terrorizmit dhe krimit në përgjithësi.

Pas ngjarjeve të tmerrshme terroriste të 11 shtatorit të vitit 2001 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vetëdija ndërkombëtare e popujve ndaj krimit të organizuar dhe terrorizmit u rrit me shpejtësi. Po kaq vëmendje mori lufta ndaj krimit të organizuar dhe veprave të krijuara nga paratë e krimit, vëmendje që ndryshoi projeksionet e politikave qeveritare në botë, me theks të veçantë në luftën ndaj financimit të terrorizmit dhe realizimit të akteve terroriste. Në pararojë të këtyre masave të reja u vendos legjislacioni ndërkombëtar, ndryshimet e të cilit synuan intensifikimin e masave për identifikimin e veprave dhe autorëve të tyre në fushën e krimit të organizuar. Ky fokus pati për qëllim forcimin e bashkëpunimit mes të gjitha organeve kompetente që operojnë në këto fusha, përparimin e instrumentalizimit juridik ndërkombëtar dhe natyrisht, përpjekjen pa kompromis të organeve vepruese të fushës, me qëllim harmonizimin e të gjitha masave relevante të luftimit të terrorizmit dhe financimit të tij.

Këtu, rëndësi të veçantë kanë edhe direktivat e Bashkimit Europian, të cilat kërkojnë ndalimin e fitimit të dobisë pasurore me vepër penale dhe pastrimin e parave, duke detyruar sektorin financiar dhe jo financiar në identifikimin e krijuesve dhe shfrytëzuesve

të pasurive të fituara me veprë penale, ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave, njoftimin e organeve kompetente për fitimin e pasurisë me anë të veprës penale, si dhe ndërmarjen e masave tjera preventive. Në këtë fushë një rëndësi të veçantë ka Direktiva 2005/60/EC, e cila, sistemin e përgjithshëm të bazuar në rregulla e zëvendëson me sistemin e ri të analizës së thellë të lidhjes së veprave penale të kryera dhe rrezikut të mundshëm të veprave të reja kriminale, të financuara me paratë e fituara nga veprat penale.

Konfiskimi i aseteve të fituara nëpërmjet kryerjes së veprave penale është vegël e shkëlqyer për sanksionimin e kriminelëve dhe njëkohësisht për kompensim nga shteti të dëmeve të krijuara nga veprimtaritë kriminale. Në çdo krim ekziston një palë e dëmtuar ose viktimë që mund të jetë/jenë individë ose subjektet juridike. Prandaj, shoqëria si tërësi ka interes të madh në konfiskimin e aseteve të fituara në mënyrë të kundërligjshme nga kriminelë të dyshuar apo të dënuar, në mënyrë që të kompensojë dëmet e shkaktuara nga veprimtaria e tyre.

Kjo situatë e mbështetur nga teoria dhe e theksuar parreshtur nga praktika, është një çështje që duhet të gjej vend edhe në Republikën e Kosovës, e cila aspiron hyrjen në Bashkimin Europian. Për të ndihmuar luftën kundër kriminalitetit vendor dhe veprave të tjera penale që rrezikojnë njerëzimin, Kosova duhet të bëjë më shumë në pjesën që i takon duke u nisur së pari nga përpjekja për të harmonizuar legjislacionin e Republikës së Kosovës me normat ndërkombëtare dhe njëherësh, zbatimin efektiv të tyre në praktikë. Këtu na duhet të pranojmë se legjislacioni i ri penal i Republikës së Kosovës ka tentuar dukshëm të jetë i harmonizuar me standardet ndërkombëtare, e në rend të parë, me Direktivën 2005/60/EC dhe me legjislacionin tjetër europian, megjithatë zbatimi praktik i këtyre ligjeve len shumë për të dëshiruar. Këtë e thonë edhe të gjitha raportet ndërkombëtare.

Me qëllim ndriçimin e problematikës së theksuar, e cila është tejet e rëndësishme në luftën kundër kriminalitetit, në këtë tezë do të përpiqem të shqyrtoj çështjet të rëndësishme, që lidhen me problematikën e konfiskimit të dobisë pasurore të dalë nga vepra penale.

1.1. Qëllimi i punimit

Çështja e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale është preokupim i të gjitha shteteve veç e veç por edhe i organizatave kryesore ndërkombëtare në botë siç janë mekanizmat e OKB-së dhe BE-së.

Konfiskimi i pasurisë të përfituar në mënyrë të kundërligjshme, është një institut juridik sa kompleks po aq edhe i rëndësishëm për hulumtim dhe studim. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe aktualitetin e temës, ky punim doktoral si objekt kryesor ka analizimin e dispozitave dhe të instrumenteve ndërkombëtare, por edhe të dispozitave ligjore kombëtare që i referohen konfiskimit të pasurisë të përfituar me vepër penale, krejt kjo, për të sjellë një punim solid dhe me rekomandime të dobishme të cilat mund të nxisin organin ligjdhënës në rishikimin, plotësimin dhe ndryshimin e legjislacionit me të cilin rregullohet çështja e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.

Nga sa u tha më lartë, qëllimi i këtij punimi doktoral shkon në dy drejtime:

Së pari, të shtjelloj konceptin e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale në përgjithësi dhe fazat nëpër të cilat kalon ky proces që nga sekuestrimi, konfiskimi dhe administrimi i saj, në veçanti në aspektin e akteve juridike ndërkombëtare dhe të legjislacionit kombëtar;

Së dyti, të shqyrtoj shkallën e zbatimit në praktikë të legjislacionit për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale me theks të veçantë në Kosovë, si dhe identifikimi i problemeve me të cilat ballafaqohen organet e zbatimit të ligjit.

1.2. Hipoteza dhe pyetjet kërkimore

Hipoteza e parë: Në Kosovë nuk aplikohet në masë të duhur dënimi plotësues-Konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, dhe një gjë e tillë është pasojë, së pari e dështimit të ligjvënësit për të qenë i saktë lidhur me procedurën për shqiptimin e dënimit plotësues (konfiskimi i pasurisë së fituar me vepër penale) dhe së dyti niveli i ulët profesional dhe i neglizhencës së gjyqësorit.

Hipoteza e dytë: Republika e Kosovës ka nevojë për ndryshim të legjislacionit aktual, në mënyrë që të krijohen kushtet për zbatimin më efektiv të konfiskimit të pasurisë së paligjshme në praktikën gjyqësore.

Andaj pashmangshëm na del edhe **pyetja kryesore kërkimore**, e cila mund të përmblihet me sa vijon:

- Cila është shkalla e rregullimit me legjislacion i fushës së konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale në Kosovë dhe a janë të nevojshme ndryshimet ligjore, të cilat prekin fushën e konfiskimit të pasurisë të përfituar në mënyrë të kundërligjshme?

Për të dhënë përgjigje në pyetjen kryesore të këtij punimi doktoral, është e domosdoshme të specifikohen edhe disa pyetje ndihmëse për zbërthimin e pyetjes kryesore, të cilat mund të përmblihen si vijon:

- Si zbatohen konkretisht secila dispozitë ligjore nga organet kompetente të zbatimit të ligjit në Kosovë dhe cilat janë problemet për tu përshtatur me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira të konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale?
- Me legjislacionin aktual, cili është niveli i konfiskimit të pasurisë të fituar në mënyrë të kundërligjshme?
- Cilat janë kompetencat dhe përgjegjësitë e secilit prej organeve proceduese në hetimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër

penale, përfshirë edhe administrimin e kësaj pasurie nga ana e Agjencisë kompetente?

- Si qëndron çështja e bashkëpunimit ndër institucional në Kosovë në fushën e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale?
- A ka Kosova pengesa në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në këtë fushë për shkak të statusit të saj politik?
- Cilat janë problemet e identifikimit të pasurive të përfituara në mënyrë të kundërligjshme?
- A është dhe si është e rregulluar çështja e konfiskimit civil të pasurisë dhe sa është e gatshme Kosova për këtë institut të ri?

1.3. Metodologjia

Metodat e shfrytëzuara dhe teknikat e punës që janë aplikuar në këtë punim janë: metoda juridike, metoda historike, metoda e krahasimit, metoda statistikore, metoda e anketës dhe e intervistës, analizës dhe metoda e studimit të rasteve individuale.

1) *Metoda juridike*

Nëpërmjet kësaj metode janë përshkruar dhe shpjeguar normat juridike që adresojnë çështjen e konfiskimit ashtu si janë të rregulluara në të drejtën pozitive, në konventat ndërkombëtare dhe në marrëveshjet ndërkombëtare.

2) *Metoda historike*

Përmes të cilës procesi vjen ashtu si ka ecur nëpër faza të ndryshme, çka na ka ndihmuar të njohim dhe kuptojmë nivelin e zhvillimit të nismave të shteteve të ndryshme deri te nismat rajonale e globale për konfiskimin e aseteve kriminale.

3) *Metoda krahasimore*

E cila, nëpërmjet çelësit krahasimor na ka ndihmuar të evidentojmë dhe të kuptojmë veçoritë, diferencat dhe të përbashkëtat mes legjislacioneve penale, përpjekjeve dhe arritjeve të shteteve të ndryshme sa i përket konfiskimit të dobisë pasurore.

Në studimin e kësaj problematike kemi shfrytëzuar edhe metoda të tjera si ato statistikore, anketën dhe intervistën e bartësve institucional, por njëherësh kemi analizuar të gjitha raportet e punës të agjencive të zbatimit të ligjit në Kosovë, raportin e progresit nga Bashkimi Europian dhe raportet vjetore të Departamentit Amerikan të Shtetit. Mungesa e të dhënave të plota për shumicën e formave të konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar përmes aktiviteteve kriminale ka imponuar nevojën që hulumtimi të mbështetet edhe në metodën e mostrës.

Problematikë më vete është edhe paplotësia, për shkak të vetë temës, e informacioneve në faqet zyrtare të agjencive të ligjit, të cilat ndonëse tentojnë të jenë sa më pranë transparencës, mbeten ende të rezervuara në publikimet e vendimeve përfundimtare lidhur me sekuestrimet dhe konfiskimet.

Përtej vështirësive duhet pranuar se korniza ligjore që rregullon këtë lëndë po pasurohet përherë e më tepër dhe ajo synon: *nga njëra anë* të përsos legjislacionin duke iu përqasur veprimeve të krimit dhe, *nga ana tjetër*, të krijojë një rrjet ndërkombëtar bashkëpunimi duke përafruar legjislacionet dhe duke krijuar hapësira efikase ndërkufitare bashkëpunimi.

Por, a kanë qenë hapat e deritanishëm të suksesshëm? Kësaj pyetje do t'i përgjigjemi duke u bazuar në studimin tonë, i cili ka për qëllim të shqyrtojë rolin dhe efikasitetin e

instrumenteve juridike që janë përdorur në luftën kundër kriminalitetit, në shërbim të një rajoni të sigurt dhe të jetueshëm për të gjithë, pa vakume midis qendrës dhe periferisë, vendeve të zhvilluara dhe atyre të pazhvilluara, vendeve që janë të sigurta dhe eksportojnë siguri dhe atyre që eksplorojnë akoma rrugën e tyre drejt sigurisë.

Për përgatitjen e këtij punimi doktorature, literatura e shfrytëzuar është e gjerë sa i takon territorit dhe përfshin literaturë të gjerë shkencore dhe publike të botuar në Kosovë, Shqipëri, në rajonin e Ballkanit, Europë, SHBA etj.

1.4. Avantazhet (përparësitë) dhe kufizimet e studimit të konfiskimit të dobisë pasurore

Është me rëndësi të theksohet fakti, se studimi i konfiskimit të dobisë pasurore, ndërsa paraqet interes, ka njëherësh avantazhet dhe sfidat e veta. Avantazhi i parë ka të bëjë me faktin se kjo tematikë, e cila është mjaft aktuale, trajtohet për herë të parë në këtë nivel (punim doktrate); së dyti, fenomeni në fjalë ka trende rritjeje dhe shtrirjeje kudo në botë e kësisoj, edhe në Kosovë dhe në rajon; së treti, ky aspekt paraqet interes për studim, në veçanti për shkak të shkallës së lartë të rrezikshmërisë që paraqet për shoqërinë veprimtaria kriminale.

Sfida e këtij studimi i referohet kryesisht mungesës së literaturës bazike me objekt studimin e konfiskimit të dobisë pasurore të përfutur përmes aktiviteteve kriminale, sidomos asaj në gjuhën shqipe. Sfida e dytë i referohet mungesës së të dhënave statistikore, bazuar në faktin se pothuajse të gjitha lëndët që kanë të bëjnë me konfiskimin janë në procedim e sipër dhe/ose, edhe kur ato janë përfunduar, ato nuk gjenden lehtësisht, madje as në kërkimin elektronik (si e cekëm më lart), për shkak të përmbajtjes së lëndës. Rezulton se në faqet zyrtare të agjencive të kontrollit dhe administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, mungojnë të dhënat mbi vendimet gjyqësore të sekuestrimit, konfiskimit dhe revokimit të këtyre masave, duke bërë që informacioni më i madh të vilet nga media, e cila më rezultoi bashkëpunëtori më i mirë në këtë sipërmarrje doktorale.

1.5. Struktura e punimit

Nga sa më sipër dhe në pajtim me tezat e theksuara më lartë, kemi përcaktuar që sistemimi dhe struktura përmbajtësore e punimit të ketë shtatë kapituj me radhitjen si vijon: pjesa hyrëse, kryesore, shqyrtimet përfundimtare dhe rekomandimet në formën e rezymësë dhe në fund, bashkëlidhur me të gjitha këto, do të jetë edhe literatura e shfrytëzuar.

Kapitulli i parë paraqet hyrjen si një përmbledhje e qëllimit dhe arsyes së studimit të çështjes së konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, e cila pason me pyetjen kërkimore dhe hipotezën e punimit doktorat, si dhe pyetjet tjera ndihmëse për arritjen e rezultateve dhe përfundimeve. Ky kapitull gjithashtu përmban edhe metodologjin kërkimore të përdorur në punim, përparësitë dhe sfidat e studimit të konfiskimit të pasurisë të përfituar në mënyrë të kundërligjshme si dhe vetë strukturën e punimit.

Kapitulli i dytë paraqet një vështrim paraprak teorik në funksion të riafirmimit të konceptit themelor për luftën ndaj krimit të organizuar dhe nocionit të dobisë pasurore të përfituar me anë të veprës penale. Kjo pjesë i referohet edhe analizës pozitiv-juridike të konfiskimit të dobisë pasurore si një masë klasike penalo-juridike në sistemin tonë juridik, me theks të veçantë në karakteristikat e saj, në procedurat për veprat penale të kriminalitetit të organizuar dhe në autorizimet e veçanta të organeve kompetente. Këtu do të paraqiten disa çështje pasurore, mënyrat e konfiskimit të tyre, roli i gjykatës dhe i prokurorit shtetëror, konfiskimi nga personat e tretë, marrëdhënia ndaj kërkesës pasuroro-juridike, mundësitë e konfiskimit “të zgjeruar” të dobisë pasurore dhe reduktimi i standardit provues, ndërhyrja apo ndarja e barrës së të provuarit.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nocionit të konfiskimit të dobisë pasurore, shqyrtimeve hyrëse empirike në rregullimin e natyrës juridike të institutit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, përcaktimit të përmbajtjes së nocionit dobi pasurore dhe natyrës juridike të konfiskimit të dobisë pasurore, formave themelore dhe konfiskimit të kundërvlerës.

Kapitulli i tretë i punimit trajtohen dispozitat ndërkombëtare (legjislacioni primar dhe sekondar, përkatësisht konventat, rregulloret, direktivat, vendimet, dhe instrumentet tjera) me të cilat rregullohet materia e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale. Kryesisht janë paraqitur ato konventa dhe akte të tjera ndërkombëtare të cilat në kuadër të luftës së kriminalitetit në përgjithësi, orientojn edhe në kontrollin e transaksioneve të dyshimta, vërtetimin e prejardhjes së pasurisë, barrës së provës dhe

konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, nëpërmjet inkorporimit të tyre në legjislacionet nacionale.

Kapitulli i katërt i punimit i paraqet organizatat ndërkombtare dhe rajonale të rëndësishme në fushën e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale. Këtu përfshihen ato organizata të cilat kanë për qëllim, rritjen e efikasitetit të përpjekjeve të shteteve të ndryshme, në identifikimin dhe kapjen e kryerësve të veprave penale si dhe konfiskimin e dobisë pasurore të tyre të përfituar në mënyrë të kundërligjshme, qoftë nëpërmjet bashkëpunimit ndërinstitucional apo edhe të shkëmbimit të përvojave të mira drejt luftimit të kriminalitetit në përgjithësi.

Kapitulli i pestë i punimit i referohet zgjidhjeve komperativo-juridike për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale të disa sistemeve në rajon, Evropë dhe më gjerë, me një vështrim më të thelluar në Republikën e Shqipërisë. Shtetet e Europës rezultojnë me zgjidhje të ndryshme legjislative sa i takon konfiskimit të pasurisë së përfituar nga kryerja e veprës penale, ku sfida në vete, paraqitet konfiskimi i zgjeruar i pasurisë të përfituar në mënyrë të kundërligjshme dhe barra e të provuarit.

Kapitulli i gjashtë i kësaj teze doktorale trajton sistemin e konfiskimit të dobisë pasurore të dalë nga vepra penale sipas legjislacionit të Kosovës. Kjo pjesë do të përmbajë jo vetëm sqarime të dispozitave relevante lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore të dalë nga vepra penale, por edhe qasjen kritike të këtyre teksteve, si vështirime teorike të nevojshme, me qëllim nxjerrjen e propozimeve të dobishme për zbatimin e dispozitave ligjore. Kjo pjesë do të përmbajë gjithashtu praktikën gjyqësore vendore relevante por edhe të rajonit e më gjerë, nga fusha e konfiskimit të dobisë pasurore të dalë nga vepra penale, si dhe praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kapitulli i shtatë paraqet metodologjin e procesit të hulumtimit dhe analizës për të përshkruar dhe përcaktuar nivelin e ndërgjegjësimit të publikut në luftimin dhe parandalimin e çështjeve në lidhje me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale dhe veprimet e autoriteteve. Si qëllim kryesor i hulumtimit në këtë kapitull është për të paraqitur, të dhënat e mbledhura në lidhje me tezën kërkimore dhe rezultatet që burojnë nga hulumtimi.

Në fund janë dhënë përfundime dhe rekomandime konkrete dhe specifike të cilat do ti shërbejnë teorisë juridike dhe praktikës gjyqësore, si dhe institucioneve tjera që merren me këtë fushë.

KAPITULLI II

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME KONFISKIMIN E DOBISË PASURORE TË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE

Sikurse edhe shtetet tjera të cilat e kanë të rregulluar me ligje çështjen e Konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale edhe Republika e Kosovës, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së saj në vitin 2008, me nxjerrjen e legjislacionit material dhe procedural në fushën penale dhe të legjislacionit tjetër në luftën kundër krimit të organizuar, ka bërë natyrisht një hap të rëndësishëm ndaj konceptit të ri të vështimit edhe të problemit të konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.

Sistemi ligjor i Kosovës ofron dispozita që i'u mundësojnë prokurorëve dhe gjyqtarëve që pas vendimit gjyqësor, të konfiskojnë pasuritë e fituara përmes aktiviteteve të kundërligjshme. Këto pasuri përfshijnë "...të gjitha të hollat, gjësendet me vlerë dhe përfitimet e tjera materiale të fituara përmes kryerjes së veprës penale..."¹ dhe që duhet ti konfiskohen kryerësit të veprës penale. Në rastet kur konfiskimi nuk është i mundur, personi i dënuar duhet të urdhërohet që të paguajë shumën e të hollave në barasvlerë me të mirat materiale të fituara. Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale në Kosovë përmbajnë kapituj të veçantë, të cilët përkufizojnë çka, kush, kur, dhe si mund të konfiskohet pasuria². Prokurorët dhe gjyqtarët janë të obliguar të hetojnë, sekuestrojnë apo konfiskojnë pasuritë në bazë të Kapitullit 7 të Kodit Penal të Kosovës. Më tej, gjykata nuk kufizohet në konfiskimin vetëm të sendeve që janë në posedim të kryerësit, por mund të konfiskojnë të mira materiale³, të cilat i janë transferuar pa kompensim çfarëdo pale tjetër.

Lidhur me nocionin e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, së pari duhen bërë me dije disa fakte, ku për analizimin e këtij instituti, para së gjithash është e nevojshme të definohet *a)* nocioni dhe *b)* momenti për zbatimin e tij. Kjo për shkak të tendencave të reja në disa sisteme penalo - juridike, të cilat vendosin parimet e barrës së të provuarit të tërthortë për shkak të pamundësisë së luftës efektive ndaj krimit të organizuar dhe pasojave të tij gjithnjë në rritje. Nga ana tjetër, është fakt i gjithënjohur, se qëllimi kryesor i formimit dhe veprimit të çdo grupi të organizuar kriminal është përfitimi, që matet në raport me rrezikun e veprimeve penale që ndërthuren në mënyrë zinxhirore në

¹Kodi Penal të Kosovës, Neni 97.

²Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 115.

³Po aty.

kryerjen e veprimtarive kriminale. Për këto arsye, instituti i konfiskimit të pasurisë së fituar me vepër penale bazohet në parimin se askush nuk duhet të ketë dobi nga kriminaliteti, çka nënkupton se shteti, me qëllim mbrojtjen e shoqërisë, duhet ta konfiskoj pasurinë e përfituar në mënyrë të kundërligjshme dhe kryesit e veprave penale ti dënoj. Qëllimi i kësaj mase është i karakterit preventiv dhe dënues, por ka njëherësh karakter mbrojtës për interesat e palës së dëmtuar. Veçanërisht është thelbësor për qëllimin e aplikimit më të madh që ky institut ka ndaj pasurisë së përfituar nëpërmjet kryerjes së veprave penale si korrupsioni, krimi i organizuar, pastrimi i parave dhe çdo lloj tjetër të kriminalitetit ekonomik, me ç'rast në mënyrë paralele zhvillohen hetimet financiare të integruara me qëllim identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e çdo dobie pasurore të përfituar në mënyrë jo legale. Në shtetet e Evropës ekzistojnë zgjidhje të ndryshme ligjore të përcaktimit, konfiskimit dhe administrimit të pasurisë që rrjedh nga vepra penale, që është edhe tema bosht e këtij punimi doktoral.

Teoria juridike e definon në mënyrë të ndryshme konfiskimin e dobisë pasurore të dalë nga vepra penale, si masë sigurimi, si masë e veçantë ose si masë e sanksioneve penalo-juridike. Sot, pranohet me të madhe se bëhet fjalë për një institut juridik të përzier penalo - civil *sui generis*, qëllimi i të cilit është rivendosja e gjendjes së prishur nga kryerja e veprës penale dhe ndalimi i begatimit të paligjshëm nëpërmjet veprimtarive kriminale.

2.1. Natyra juridike të institutit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale

Rendet juridike bashkëkohore janë të ballafaquara me rritjen e kriminalitetit të drejtuar në fitimin e dobisë pasurore. Zbatimi i institutit të konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale i kontribuohet vendosjes së gjendjes juridike që ka qenë para kryerjes së veprës penale. Zbatimi i këtij instituti dobëson forcën motorike të aktiviteteve të mëtejshme kriminale dhe kryerësve potencial ju bën me dije, se nuk do të mund të mbajnë dobinë pasurore të krijuar nga vepra penale, çka do të thotë se kryerja e veprës penale “nuk paguhet”. Është kjo arsyeja që konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, logjikisht, imponohet si mjet efektiv i luftimit të krimit të drejtuar në përfitimin e dobisë pasurore.

Instituti i konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, në sisteme të ndryshme juridike, mund të ketë natyrë të ndryshme juridike. Kështu, në disa vende,

konfiskimi i dobisë pasurore paraqet sanksion të caktuar penalo-juridik⁴, pasojë të veçantë të aktgjykimit⁵, ose është i rregulluar si masë e veçantë që mundëson realizimin e parimit, se askush nuk guxon të mbajë dobinë pasurore të fituar me veprë penale⁶. Për shembull, Kodi i ri Penal Francez nga viti 1992 (*Code penal*, 1992⁷) parashikon institutin e konfiskimit trinom, i cili mund të jetë dënimi, masa e sigurimit ose riparimi⁸. Kodi Penal Italian (*Code penal*)⁹, në dispozitën e nenit 240 parashikon konfiskimin (*confisca*) si masën reale të sigurimit brenda sistemit të sanksioneve penalo-juridike, edhe pse në mes të autorëve italianë natyra e saj *sui generis* nuk është kontestuese¹⁰.

Kodi Penal (*Strafgesetzbuch*) Gjerman¹¹ konfiskimin e dobisë pasurore e ka rregulluar në dispozitën 73 si masë të veçantë penalo-juridike, zbatimi i të cilës nuk kushtëzohet me ekzistencën e fajit të autorit të veprës penale, por vetëm me supozimin se me veprën penale të vërtetuar është përfituar dobia materiale¹². Ngjashëm me të është edhe Kodi Penal (*Strafgesetzbuch*) Austriak¹³.

Për të gjitha sistemet e sipërpërmendura penalo-juridike është karakteristikë, se konfiskimi i dobisë pasurore paraqet institut penalo-juridik, kështu, supozimi bazik i zbatimit të tij është gjithmonë vërtetimi i kryerjes së veprës penale¹⁴, ndërsa supozimet e tjera do të varen

⁴ Dënimin, masën e sigurisë ose sanksionin e veçantë penalo juridik. V. KOS, D., Problematika oduzimanja imovinske koristi, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu, vol. 5, nr. 2/1998., f. 753-754.

⁵ “pasojat juridike të aktgjykimit nuk janë sanksione penalo juridike, por masa të veçanta penalo juridike të cilat sipas fuqisë ligjore si pasoja të gjykimit për veprën penale, prekin personin e dënuar në atë mënyrë se kufizojnë të drejtat e caktuara të tij ose i vënë ndalesa të caktuara”. Bacic, Franio, Krivichno pravo – opsti deo, Informator, Zagreb, 1995, f. 427.

⁶ Pavišić, Berislav, Osnovni krivični zakon Republike Hrvatske (bilješke, literatura, sudska praksa, prilog), MUP RH, Zagreb, 1993, fq. 126; Derenčinović, Davor., Pravna priroda instituta oduzimanja imovinske koristi i njegovo značenje u prevenciji organiziranog kriminala, Policija i sigurnost, Zagreb, godina 8. (1999), broj 3-4, fq. 161-162.

⁷ Code Pénal, <http://lexinter.net/ENGLISH/penal code.htm>

⁸ Levasseur, George; Chavanne, Albert; Montreuil, Jean; Boulloc, Bernard, Droit pénal general et procédure pénale, Sirey editions, 1999., fq. 356-358.

⁹ Codice penale, Regio decreto 19 ottobre 1930., n. 1938, testo in vigore dal: 1.1.1999; <http://dbase.ipzs.it/cgi-free/db2www/notai/arti.mac/input?swpag=12E>

¹⁰ Alessandri, Alberto, Confisca nel diritto penale, Digesto delle Discipline Penalistiche III, UTET, Torino, 1998. fq. 46.

¹¹ Strafgesetzbuch (StGB), <http://www.gesetze.2me.net/stgb/stgb0112.htm>

¹² Jeschek, H. Hans; Weigend, Thomas, Lehrbuch des Strafrechts, Allgemeiner Teil, Duncker & Humblot, Berlin, 1996., fq. 790.

¹³ § 20, § 20a., § 20b. i § 20c. Strafgesetzbuch (StGB), Bundesgesetz vom 23. Jänner 1974 über die mit gerichtlicher Strafe bedrohten Handlungen, BGBl 1974/60 idF BGBl I 134/2002, http://www.sbg.ac.at/ssk/docs/stgb/stgb_index.htm

¹⁴ Në disa sisteme juridike, për shembull angleze dhe amerikane, përpos konfiskimit penalo-juridik të dobisë pasurore, është paraparë edhe konfiskimi civilo-juridik i pasurisë së kundërligjshme, i cili zbatohet jashtë procedurës penale dhe pavarësisht nga aktgjykimi, fajësia dhe fakti se a është vërtetuar kryerja e veprës penale. Më gjerësisht sh. ALBRECHT, HJ., Post-Adjudication Dispositions in Comparative Perspective, në:

nga natyra juridike e konfiskimit të dobisë pasurore, të cilën e përcakton çdo legjislacion i vetëm.

2.2. Përcaktimi i përmbajtjes së nocionit dobi pasurore e përfituar me vepër penale in abstracto

Kodi Penal i Republikës së Kosovës definon ç'është dobia pasurore e përfituar me vepër penale. Në nenin 120, paragrafi 34, Kodi Penal i Republikës së Kosovës thekson, se: "... dobi pasurore është çdo pasuri e fituar drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga vepra penale"¹⁵. Pasuria, e cila fitohet tërthorazi nga vepra penale përfshin pasurinë në të cilën është konvertuar, transformuar apo përzier çfarëdo pasurie drejtpërdrejtë e përfituar nga vepra penale si dhe të ardhurat, kapitali apo dobitë e tjera ekonomike të përfituara ose të realizuara për pasurinë e tillë në çfarëdo kohe që prej kryerjes së veprës penale.

Dobia pasurore e përfituar me anë të veprës penale mund të definohet si dobi e pastër, përkatësisht tepricë e pasurisë së përfituar me vepër penale ose për shkak të veprës penale. Me këtë rast, dobia pasurore mund të përbëhet nga paratë, letrat me vlerë ose sendet në tërësi apo pjesërisht¹⁶. Dobinë pasurore të përfituar me vepër penale mund ta definojmë edhe si çdo lloj pasurie, e cila përbëhet nga sendet ose të drejtat, të cilat mund të jenë të luajtshme ose të paluajtshme, përfshirë edhe aktet juridike dhe/apo dokumente, të cilat dëshmojnë titullin ose të drejtën për atë pasuri¹⁷.

Dobia pasurore e përfituar me vepër penale mund të nënkuptojë gjithashtu pasuritë që dalin ose janë përfituar drejtpërdrejt ose indirekt me kryerjen e veprës penale, prapasurinë e çdo lloji, pa marrë parasysh nëse ajo është materiale apo jomateriale, e luajtshme apo e paluajtshme, ose bëhet fjalë për dokumente juridike që dëshmojnë pronësinë apo ndonjë të drejtë mbi pasurinë e tillë.¹⁸

Tonry, Michael.; Frase, R. S. (ur.), *Sentencing and Sanctions in Eastern Countries*, Oxford University Press, 2001., str. 319. V. i PONFORTI, M. D., *Forfeiture*, u: *Digesto delle Discipline Penalistiche*, V, UTET, Torino, 1994., f. 270.

¹⁵ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 120.

¹⁶ Kaznenog zakona Republike Hrvatske, Čl. 82. st. 2, Nar. Nov. br. 110/1997, 27/1998, 129/2000, 51/2001.

¹⁷ Konvencija o pranju, traganju, privremenom oduzimanju i oduzimanju prihoda stečenoga kaznenim djelom, Čl. 1. t. a), od 8. Studenoga 1990., koju je Republika Hrvatska ratificirala Zakonom o potvrđivanju Konvencije o pranju, traganju, privremenom oduzimanju i oduzimanju prihoda stečenoga kaznenim djelom od 29. Rujna 1997, Nar. Nov. MU br. 14/1997.

¹⁸ Konvencija Ujedinjenih naroda protiv transnacionalnog organiziranog kriminaliteta, Neni. 2. t. d) i e), od 15. studenog 2000., koju je Republika Hrvatska ratificirala Zakonom o potvrđivanju Konvencije Ujedinjenih naroda protiv transnacionalnog organiziranog kriminaliteta, Protokola za sprječavanje, suzbijanje i kažnjavanje krijumčarenja ljudi, posebice žena i djece te

Me këtë rast, posaçërisht vlen të theksohet, se dobisë pasurore të përfituar me vepër penale mund ta përbëjnë edhe sendet, por ato sende që esencialisht dallohen nga mjetet me të cilat është kryer vepra penale dhe nga prodhimet, përkatësisht sendet e realizuara me kryerjen e veprave penale¹⁹.

Edhe pse definicionet e theksuara të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale në parim ofrojnë një bazë të mirë juridike për përcaktimin e dobisë pasurore, në shumicën e veprave të ndryshme penale, përcaktimi i kësaj dobie paraqet vështirësi. Në të vërtetë, format e dobisë pasurore mund të ndryshohen me ndërmarrjen e disponimit me atë dobi, zakonisht me transaksione financiare, çka vështirëson identifikimin e dobisë pasurore dhe prejardhjen e saj.

Lidhur me problematikën e definimit të kuptimit të dobisë pasurore të fituar me anë të veprës penale marrë në përgjithësi (*in abstracto*), pranojmë se nuk ekziston një qëndrim i caktuar dhe i gjithëpranuar por, konstatohet se në teorinë penalo-juridike janë rrënjësuar dy teori kryesore: teoria e **parimit neto** dhe teoria e **parimit bruto**. Teoritë e përmendura dallohen nga njëra tjetra nga përgjigjet që japin rreth pyetjes thelbësore e cila ka edhe akcent moral: a duhet t'i pranohen autorit të veprës penale shpenzimet e mbartura për shkak të kryerjes së veprës penale në mënyrë që ti zbriten nga të hyrat e përfituara pasurore para se t'i konfiskohet pasuria?²⁰ Përgjigjia pohuese për këtë pyetje thelbësore imponon

Protokola protiv krijumčarenja migranata kopnom, morem i zrakom, kojima se dopunjuje Konvencija Ujedinjenih naroda protiv transnacionalnoga organiziranog kriminaliteta od 7. Studenog 2002, Nar. Nov. MU br. 14/2002.

¹⁹Në të vërtetë, në mes sendit të realizuar me kryerjen (*producta sceleris*), të përdorura në kryerjen ose të destinuar për kryerjen e veprës penale (*instrumenta sceleris*), në një anë, dhe dobisë pasurore të cilën kryesi “nxjerrë” nga vepra penale, ekzistojnë dallime thelbësore. Kështu, sendet që janë përdorur në kryerjen ose të destinuara për kryerjen e veprës penale janë pikërisht mjetet në të holla ose veglat e kryerjes së veprës penale dhe që, në shikim të parë dallohen nga dobia pasurore, përkatësisht nga të hyrat e përfituara me vepër penale. Dallimi në mes të sendeve të realizuara me vepër penale dhe dobisë pasurore të fituar me vepër penale ndoshta nuk është e dukshme, por sipas përfundimit logjik me siguri se mund të kuptohet. Për dallim prej dobisë pasurore e cila paraqet të hyra të përfituar me vepër penale, sendet e realizuar me kryerjen e veprës penale janë pikërisht prodhime të veprës penale, të cilat pa kryerjen e asaj veprë nuk kishin mundësi të realizoheshin. Dallimin e cekur e shprehin më së miri këto shembuj tipik të prodhimit të veprës penale dhe shembujt e dobisë pasurore nga vepra penale. Kështu shembull tipik i prodhimit të veprës penale është falsifikimi i parasë, i cili pa kryerjen e veprës penale të falsifikimit të parasë nuk do të realizohej. Në anën tjetër, shembulli tipik i dobisë pasurore nga vepra penale paraqet paraja e vjedhur, i cila nuk është realizuar me kryerjen e veprës penale, por ka ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës penale, ndërsa për autorin e veprës paraqet të hyrë nga kryerja e veprës penale. Podolsky, Johan.; Brenner, Tobias, Veith, Vermögensabschöpfung im Strafverfahren, Richard Boorberg Verlag, 2003, f. 83.

²⁰ Me këtë problematikë më së shumti janë marrë teoreticienët e të drejtës penale në Gjermani, sepse atje deri në vitin 1992 është qëndruar në zbatimin e parimit neto, që pastaj të miratohet parimi bruto.

V. i Wallschläger, Rene, Die strafrechtlichen Verfallsvorschriften, Eine rechtssystematische, verfassungrechtliche und kriminalpolitische Analyse, Der Andere Verlag, 2002, fq. 18.

pyetjen vijuese: a duhet autorit të veprës penale t'i njihen të gjitha shpenzimet apo vetëm shpenzime të caktuara, ndryshe, cilat shpenzime i duhen pranuar? Arsyet, të cilat flasin në favor të parimit bruto duhen kërkuar në përpjekjen për të evituar dyshimet, por edhe vështirësitë që dalin në rastet kur duhen përcaktuar se cilat shpenzime duhen ndarë nga të hyrat e përgjithshme nga vepra penale dhe sido të përcaktohen shumë e atyre shpenzimeve. Përveç kësaj, me aplikimin e parimit bruto realizohet një veprim më i fortë specialo-preventiv dhe gjeneralo-preventiv i masës, në kuptim të porosisë se krimi nuk shpaguhet.

Arsyeja kryesore për kundërshtimin e aplikimit të parimit bruto në legjislacionet që konfiskimin e dobisë pasurore të përfutur me vepër penale nuk e rregullojnë si sanksion penalo-juridik, por si masë penalo-juridike që zbatohet pavarësisht nga faji i autorit, është se me këto masa, sipas efektit të tyre, përcaktohet masa e dënimit për autorin e veprës penale. Në të vërtetë, me zbatimin e teorisë së parimit bruto, autori i veprës së supozuar penale duhet “të paguaj më tepër se sa ka fituar”, çka padyshim na orienton në karakterin punitiv të konfiskimit të dobisë pasurore. Me këtë hapet çështja e respektimit të parimit të fajësisë në të drejtën penale materiale, përkatësisht çështja e respektimit të supozimit të pafajësisë së pandehurit në të drejtën penale procedurale²¹. Përfundimisht, vjen në pyetje edhe vetë natyra juridike e masës së konfiskimit të dobisë pasurore dhe njëherësh imponohet nevoja e rishqyrtimit të gjithë regjimit të zbatimit të saj.

Duhet konkluduar se, zbatimi i parimit bruto gjatë përcaktimit të dobisë pasurore të përfutur me vepër penale do të jetë i mundursi në legjislacionet që konfiskimin e dobisë pasurore e rregullojnë si sanksionin penalo-juridik, ashtu dhe në legjislacionet që konfiskimin e dobisë pasurore e rregullojnë si masë të veçantë penalo-juridike me të cilën nuk realizohet qëllimi i dënimit, as qëllimi i zbatimit të sanksionit penalo-juridik, por parimi i drejtësisë në të drejtën penale.

2.3. Format themelore dhe konfiskimi i kundërvlerës

Kodi Penal i Republikës së Kosovës konfiskimin e dobisë pasurore e rregullon si masë të veçantë penalo-juridike, me të cilën realizohet parimi se askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të përfutur me anë të veprës penale (neni 96 paragrafi 1 i Kodit Penal). Parimi i theksuar është pasojë e parimit më të lartë të drejtësisë sipas së cilës, askush nuk mund të

²¹Weigend, Thomas, General report: The criminal justice systems facing the challenge of organized crime, *Revue internationale de droit pénal*, Vol. 68. Br. 3-4, 1997., fq. 538.

mbajë asgjë, e kësisoj, as dobinë pasurore të krijuar nga vepra penale.²² Kodi Penal ka parashikuar dy forma themelore të konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale: konfiskimin e dobisë pasurore nga kryerësi i veprës penale (neni 97 paragrafi 1 i Kodit Penal) dhe konfiskimin e dobisë pasurore nga personi i tretë (neni 97 paragrafi 2 i Kodit Penal). Kështu, dobia pasurore e përfituar me vepër penale do të konfiskohet çdonjërit që ka përfituar këtë dobi, qoftë autor i veprës penale, pjesëmarrës i veprës penale, por edhe person i tretë²³. Dobia pasurore do t'i konfiskohet edhe personit të tretë, i cili gjendet i tillë “sipas cilësdo bazë juridike”, çka do të thotë, se konfiskimi ndaj tij do të ndodhë pa marrë parasysh faktin se ai ka vepruar si *bonafide*, në kuptimin se nuk e ka ditur, nuk ka mundur të dijë dhe as ka qenë i detyruar të dijë se vlerat janë përfituar me vepër penale. Zgjidhje të tilla ligjore mundësojnë vendosjen e gjendjes në kushtet që ka qenë para kryerjes së veprës penale me të cilën është realizuar dobia pasurore, gjendje që kërkohet nga parimet e fiksuara në nenin 96 paragrafi 1 dhe nenin 97 të Kodit Penal²⁴.

Përveç dy formave themelore të lartëtheksuara, ligjdhënësi ka parashikuar edhe konfiskimin e kundërvlerës (neni 97 paragrafi 1 i Kodit Penal), si një formë e veçantë e konfiskimit të dobisë pasurore për rastet kur “vërtetohet pamundësia e konfiskimit të dobisë pasurore e përbërë nga paraja, letrat me vlerë ose sende në tërësi apo pjesërisht”. Në këto kushte, gjykata është e “obliguar që autorin e veprës penale ta detyrojë të paguaj kundërvlerën përkatëse në shumën e të hollave”. Në këtë rast, procedura e gjykatës në vlerësimin e kundërvlerës është me rëndësi thelbësore dhe këtu, merr rëndësi përzgjedhja e kriterëve me të cilat gjykata do bëjë vlerësimin. Por ligjvënësi nuk ka parashikuar asnjë dispozitë lidhur me këto kriterë, çka detyron praktikën gjyqësore të ndërtojë vetë sistemin e kriterëve që do ta ndihmojnë në vlerësimin e provave dhe vlerësimin e kundërvlerës. Kuptohet, se sistemi i theksuar i kriterëve, do të duhet të jetë në përputhje me parimin neto të përcaktimit të dobisë pasurore, të lehtësojë përcaktimin e konfiskimit të kundërvlerës në rastet konkrete dhe ajo çka është me shumë rëndësi, të unifikoj praktikën gjyqësore.

²²Horvatić, Željko, dhe Novoselec, Petar, Kazneno pravo, Ministarstvo unutarnjih poslova Republike Hrvatske, Policijska akademija, Zagreb, 2001, fq. 474.

²³ Kështu nuk është thelbësore nëse dobia pasurore paraqet veçori të veprës penale ose se me kryerjen e veprës penale a është krijuar gjendja e cila ka mundur fitimin e dobisë pasurore, por është thelbësore të vërtetohet se ajo dobi krijohet me kryerjen ose lidhur me kryerjen e cilësdo vepër penale.

²⁴Mirëpo, dispozitat e nenit 82 paragrafi 1 dhe 3 të Kodit Penal duhet të harmonizohen me detyrimet ndërkombëtare, pikë së pari me jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strastburg, sipas së cilës konfiskimi i dobisë pasurore duhet të jetë i mundur vetëm nga personi i tretë, i cili nuk ka vepruar si *bonafide* me rastin e bartjes së asaj pasurie, që është në pajtim me parimin e drejtësisë.

Shih rasti *Phillips Kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 5 Korrik 2001, No 41087/98, <http://hudoc.echr.coe.int/hudoc/>

KAPITULLI III

DISPOZITAT LIGJORE NDËRKOMBËTARE – KONVENTAT DHE DIREKTIVAT ME TË CILAT RREGULLOHET MATERJA E KONFISKIMIT TË DOBISË PASURORE TË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE

Krimi i organizuar është një nga fenomenet më negative në shoqëri dhe pasojat e tij mbi jetën e njerëzve, shoqërinë dhe sigurinë, janë shumë të rënda. Për këtë arsye lufta kundër tij po bëhet çdo ditë e më tepër prioritet i çdo politike kombëtare dhe ndërkombëtare duke imponuar nevojën për vizion, përcaktim të qartë objektivash, burime të nevojshme dhe, natyrisht aftësi për ta trajtuar këtë fenomen. Shtetet, të shqetësuara për ekzistencën e këtij fenomeni dhe të gjendura para shtimit dhe perfeksionimit të metodave të krimit, hulumtuan dhe filluan të sillnin metoda dhe modele të reja në këtë luftë, një nga të cilat ishte edhe sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë të përfituar me vepra penale. Teoritë moderne e konsiderojnë konfiskimin si një mjet të vjetër dhe të lashtë kundër një fenomeni të “ri dhe modern”, që drejtohet kundrejt dobisë pasurore të përfituar me anë të veprave penale që prodhon aktiviteti kriminal, pavarësisht formave me të cilat ai shfaqet, duke pasur si qëllim luftën jo vetëm kundër autorëve të këtyre veprave, por edhe kundër veprimtarisë kriminale të tyre.

Krimi nuk njihet kufij, nuk ndalet në kohë dhe në hapësirë dhe sofistikohet përditë duke u përhapur në mënyrë kapilare në organizimin tonë shoqëror e politik. Nën ndikimin e fuqishëm të faktorëve të ndryshëm lokal, rajonal dhe global janë zhvilluar dhe përsosur forma të krimit rajonal e ndërkombëtar të trafikimit të drogës, trafikimit të qenieve njerëzore dhe armëve, krimit kibernetik, vjedhjes së sendeve me vlerë dhe veprave të artit, pastrimit të parave etj. Për nga organizimi, krimi shfaqet gjithmonë e më i ndërlikuar dhe më dinamik duke përbërë një kërcënim serioz për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare dhe duke sjellë pasojat të dëmshme për shëndetin dhe sigurinë publike, institucionet demokratike dhe stabilitetin ekonomik.²⁵ Është pikërisht kjo arsyeja që lufta ndaj tij është bërë temë e shqyrtimeve në planin ndërkombëtar, ku përpjekjet shkojnë për gjetjen e metodave dhe masave efikase në luftën kundër krimit dhe pasojave të ardhura prej tij.

²⁵Transnational Organized Crime: A Growing Threat to National and International Security retrieved from <http://m.whitehouse.gov/administration/eop/nsc/transnational-crime/threat>.

Në dekadën e fundit të shekullit XX dhe fillim shekullin e XXI, nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal, lufta synon parandalimin e veprimeve kriminale, karakteristike e të cilave është përfitimi i kundërligjshëm i dobisë pasurore, e karakterizuar nga domosdoshmëria e luftës kundër formave të reja të kriminalitetit me konfiskimin e pasurisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme. Legjislacionet penale i vijnë në ndihmë kësaj lufte dhe disa vende janë shtyrë që të sjellin ligje specifike në lidhje me këtë fenomen, përfshirë edhe mundësinë e të kërkuarit që shkelësi të demonstrojë origjinën e fitimeve të dyshuara si kriminale. Italia ka zhvilluar mekanizma të avancuar për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Vendet fqinje me Kosovën si Shqipëria, Serbia dhe Kroacia kanë adoptuar ligje të veçanta në mënyrë që t'i ndihmojnë prokurorët në konfiskimin e aseteve.

Legjislacioni Penal Italian, ndoshta dhe për shkak të zhvillimit, strukturës dhe dinamikës së krimit të organizuar në vend ka qenë në pararojë të këtyre zhvillimeve juridike. Rruga që shteti italian ka bërë për të perfeksionuar mënyrën e sulmit ndaj pasurive mafioze është e gjatë dhe e mbushur me sakrifica, dhunë dhe vonesa, por edhe e pasur me rezultate në kohë rekord. Një rrugë që ka disa etapa të ndryshme, duke filluar në vitet 60, deri në legjislacionin e viteve 90; duke kaluar nga ligji i famshëm i vitit 1982 Rognoni - La Torre, për të arritur në ditët e sotme tek krijimi i Agjencisë Kombëtare të Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar ndaj krimit të organizuar (ANBSC) dhe të ligjit që rregullon veprimtarinë e saj²⁶. I tillë është dhe ligji shqiptar Nr.10192 “Për parandalimin dhe goditjen e Krimit të Organizuar”, i cili sanksionon procedimin parandalues kundër krimit të organizuar. Qëllimi i tij është ”Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar nëpërmjet zbulimit, identifikimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, si dhe përcaktimi i mënyrës së përdorimit të këtyre pasurive”²⁷. Në thelb të këtij ligji është sekuestrimi dhe konfiskimi i dobive pasurore që rrjedhin nga krimi i organizuar, trafikimet, aktet terroriste, etj., dhe njëherësh, ai drejtohet si ndaj autorëve të veprave penale ashtu dhe të afërmve të tyre, të cilët fshehin këto produkte. Ky ligj sanksionon masa me karakter pasuror dhe masa me karakter të përkohshëm si pezullimin e përkohshëm të aktivitetit, sekuestrimin, sekuestrimin paraprak, përkatësisht të përkohshëm dhe si masën me karakter përfundimtar, konfiskimin²⁸. Por

²⁶<http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/law-ways/tancredi/cap1.htm>

²⁷ Ligji Shqiptar Nr. 10 192, për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, neni 2.

²⁸Po aty.

duhet pranuar se përtej kuadrit ligjor, suksesi në luftën kundër krimit të organizuar është i mundur kur gjykata, prokuroria, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe përmbaruesi gjyqësor shtetëror, apo përmbaruesit privat (varësisht nga mënyra e rregullimit të secilit shtet), bashkëpunojnë ngushtësisht për ekzekutimin e vendimeve të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të paligjshme²⁹. Ky bashkëpunim nuk është i lehtë dhe vakumet ligjore, përkatësisht zbrastësitë juridike që shoqërojnë proceset i bëjnë ato akoma më të vështira. Sa më sipër dhe lidhur me ligjin shqiptar antimafia, një prokuror i Task-Forcës shqiptare, i cili ka folur për BIRN (*rrjeti european i gazetarëve hulumtuese*), ka thënë në kushtet e anonimitetit se ligji “Antimafia” e ka bërë komode punën e prokurorisë në hetimet pasurore, por jo punën e administratorëve të AAPSK, (*Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara*). Ai shpjegon se vendimet gjyqësore për sekuestrimin e kompanive i dërgohen AAPSK, ndërsa kjo e fundit përballet me një sërë peripecish ligjore për të kryer një administrim të vërtetë mbi to. “Problemi është se shumë administratorë bllokojnë shkresat dhe letrat në QKR (*Qendra Kombëtare e Regjistrimit*) apo hipotekë, por nuk ndërhyjnë në bordin e administrimit të kompanisë,” - thotë prokurori, i cili pohoi se “...ajo që duhet bërë është ndërhyrja në bordin e kompanisë dhe jo vetëm në letra”³⁰.

Lufta ndaj krimit të organizuar është e vështirë dhe ajo kërkon shkallë të lartë të bashkëpunimit dhe të koordinimit ndërkombëtar në luftimin e këtyre dukurive negative, ndërsa e reflektuar në nivelin nacional kërkon inkorporimin e akteve juridike ndërkombëtare nga kjo fushë në sistemin e brendshëm juridik dhe participimin aktiv në punën e organizatave që kanë përgjegjësinë ligjore dhe shtetërore të bartin dhe zhvillojnë këtë luftë. Lidhur me këtë, në nivelin ndërkombëtar dhe rajonal janë nxjerrë akte juridike të karakterit të përgjithshëm, disa nga të cilat i ka ratifikuar edhe Republika e Kosovës, duke i përfshirë disa prej Konventave dhe instrumenteve juridike ndërkombëtare si pjesë e Kushtetutës, të cilat zbatohen drejtpërdrejtë, ndërsa të tjerat, nga aspekti i të drejtës dhe rendit juridik, nuk ka pasë mundësi të ratifikohen për shkak se Kosova nuk është pjesë e Këshillit të Evropës dhe BE-së, por që institucionet e Kosovës edhe në këtë situatë nuk kanë qëndruar duarkryq pasi që kanë hartuar ligje të shumta, me të cilat e gjithë përmbajtja e konventave dhe instrumenteve më të rëndësishme juridike ndërkombëtare janë shëndrruar në ligje. Të gjitha këto veprime të ndërmarra janë të rëndësishme për shkak të nevojës së zbatimit të tyre praktik, por dhe si kritere standardizuese për anëtarësimin e

²⁹Alberto Pilo “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive të paligjshme”, Gazeta “Shqip”, 28.Maj 2016

³⁰<https://www.reporter.al/të-dënuarit-e-krimit-të-organizuar-vjelin-frytet-e-bizneseve-të-sekuestruara/>

vendit në Bashkimin Europian.

Për shkak të rëndësisë së madhe të procedurës së konfiskimit të pasurisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme në shkatërrimin dhe luftën kundër formave të rënda të kriminalitetit, në veçanti të kriminalitetit të organizuar dhe të korrupsionit, në këtë temë do të epet një pasqyrë e akteve juridike më themelore të karakterit ndërkombëtar dhe rajonal, së bashku me këndvështrimin për format specifike formale dhe joformale të organizimit, qëllimi i të cilave është avancimi i bashkëpunimit, shkëmbimi i informacioneve dhe unifikimi i veprimit të përbashkëta në planin ndërkombëtar në luftën kundër kriminalitetit dhe, në këtë kuadër, edhe në konfiskimin e pasurisë, përkatësisht të dobisë pasurore të krijuar me anë të veprës penale. Modeli kroat mbështetet në procedurën penale për konfiskimin e aseteve pasi të jetë shpallur verdikti mbi fajësinë. Konfiskimet e përkohshme lejohen, por për një kohë të kufizuar. Kroacia ka avancuar Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale duke kaluar ligje që kanë të bëjnë me Zyrën e Prokurorisë Speciale që ka për detyrë të luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar³¹.

Ajo gjithashtu mundëson bartjen e përgjegjësisë së ofrimit të dëshmive tek i dyshuari në rastet e veçanta që drejtohen nga zyra e USKOK për korrupsion dhe krim i organizuar. Kjo qasje është shfrytëzuar për të siguruar ndjekje efikase të rasteve penale. Në mënyrë që të konfiskojë dhe të garantojë sekuestrimin e pasurisë së rrjedhur nga pasuria e fituar në mënyrë të kundërligjshme në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar, është kaluar një ligj i veçantë mbi konfiskimin apo sekuestrimin³². Edhe Maqedonia ka amenduar Kodin e saj Penal duke zgjeruar grupin e njerëzve prej të cilëve autoritetet shtetërore mund të konfiskojnë asetet e fituara me anë të aktiviteteve të kundërligjshme. Gjatë vitit 2008, Serbia ka miratuar Ligjin mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e fitimit nga krimi, duke qartësuar procedurat për sekuestrimin dhe konfiskimin, pasi prokurorët të kenë ofruar dëshmi për dyshimet e tyre në lidhje me mospërputhjet mes pasurisë së një personi dhe të ardhurave të tij. Edhe Kosova ka legjislacion të veçantë për kompetencat e zgjeruara të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar me aktivitete kriminale, e gjithashtu ajo e ka miratuar edhe ligjin mbi krijimin e agjencisë përgjegjëse për menaxhimin e këtyre aseteve. Kodi Penal dhe ai i Procedurës Penale gjithashtu adresojnë këtë çështje, megjithatë zbatimi duhet intensifikuar përpjekjet për zbatimin më të madh të tyre në

³¹Ligji mbi zyrën për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

http://narodnenovine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2009_07_76_1834.html

³²Ligji mbi procedurën për konfiskimin e fitimit nga aktivitetet kriminale, NN145/10, i kaluar me 24.12.2010.

praktikë nga ana gjykatave, prokurorive dhe organeve tjera të zbatimit të ligjit, të cilat duhet të jetë në nivel shumë më të lartë nga sa janë tani. Vlenë të theksohet se në Kosovë fusha e konfiskimit të pasurisë siç u tha rregullohet me Kodin Penal, i cili përmban dispozita materiale juridike, Kodin e Procedurës Penale, i cili përmban dispozitat procedurale, Ligjin për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit të pasurisë, i cili përmban dispozita materiale juridike dhe procedurale juridike, si dhe ligji për administrimin e pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar, i cili përmbanë dispozita administrative. Siç shihet Kosova ka mjaftë të avancuar legjislacionin falë edhe prezencës ndërkombëtare në Kosovë, të cilët kanë dhënë një kontribut të madh në krijimin e legjislacionit në harmoni me aktet më të rëndësishme juridike të BE-së, si dhe Konventat dhe instrumentet juridike të kombeve të bashkuara. Në këtë kontekst, Prokurorët e Kosovës e arsyetojnë mungesën e zbatimit të ligjit të aplikueshëm³³ me mungesën e kapaciteteve të mjaftueshme kadrovike për hetimin, gjetjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.

3.1 Aktet juridike të karakterit ndërkombëtar lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale

Bashkësia ndërkombëtare nëpërmjet një varg konventash, deklaratash, konkluzionesh ose rekomandimesh, ka shprehur qëndrimin e përgjithshëm, se lufta efikase kundër kriminalitetit të organizuar dhe transnacional, lufta kundër korrupsionit, shpëlarjes së parave dhe terrorizmit nuk mund të zhvillohet pa mekanizmin ligjor adekuat, i cili mundëson kontrollin e transaksioneve të dyshimta, vërtetimin e prejardhjes së pasurisë, barrës së provës, konfiskimit efikas të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, si dhe administrimin e pasurisë së konfiskuar me qëllim ruajtjen e vlerës së saj dhe kthimin e saj në një të mirë publike³⁴.

Koncepti “*para e zezë*” ka filluar të përdoret me skandalin “Watergate 1973”, ndërsa si vepër penale pastrimi i parave ka tërhequr vëmendjen në vitet 70’-80’ ku veprimtaria kriminale, kryesisht ajo e lidhur me trafikimin e drogës nisi të njihte një zhvillim kërcënues për shtetet. Gjenerimi i fitimeve të mëdha nga ky aktivitet kriminal dhe rritja e përmasave

³³Intervista me Prokuroren e Kosovës Znj. Drita Hajdari, Zyra Koordinuese e Prokurorisë Shtetërore Kundër Korrupsionit, prill 2011.

³⁴Albana Isufi, Prishtinë. Seminari “Pastrimi i parave përbën kërcënim global” datë 21.09.2004. I disponueshëm në internet <http://www.evropaelire.org/content/Article/1020095>. html. Cituar Paul Byron, përfaqësues i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara Amerikës.

të abuzimit me drogën, nxitën qeveritë perëndimore për të vepruar, nga njëra anë nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit dhe përsosjes së metodave të hetimit për zbulimin e mekanizmave dhe mjeteve me të cilat kriminelët fshehin të ardhurat e fituara me vepra kriminale dhe, nga ana tjetër, duke krijuar legjislacionin e nevojshëm për konfiskimin e të ardhurave të paligjshme.

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) e përkufizon pastrimin e parave si “... një gamë të gjerë të aktiviteteve dhe proceseve me qëllim errësimin e burimit të të hollave të fituara në mënyrë të paligjshme dhe për të krijuar pamjen se ato e kanë origjinën nga një burim legjitim”³⁵. Kësisoj, puna për evidentimin e parave të krijuara me vepër penale, sekuestrimi dhe konfiskimi i tyre rezulton një ndërrmarje institucionale mjaft sfiduese. Kjo shihet më së miri edhe nga fakti se pasuria e përfituar në mënyra të ndryshme të kundërligjshme është prezente në të gjitha shtetet, qoftë ajo e përfituar me veprat më të rënda penale, e gjithashtu edhe ajo e cila është përfituar në format tjera të kundërligjshme siç janë evazioni fiskal dhe format tjera të ekonomisë joformale.

3.1.1. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër qarkullimit të kundërligjshëm të mjeteve narkotike dhe substancave psikotropike (Konventa e Vjenës) në vitin 1988

Nga burimet e para të së drejtës ndërkombëtare, e cila thekson rëndësinë dhe nevojën e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme është *Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër qarkullimit të kundërligjshëm të mjeteve narkotike dhe substancave psikotropike (Konventa e Vjenës e viti 1988)*. Por duhet theksuar se kjo Konventë e lidh konceptin e parave të pista vetëm me veprimtarinë kriminale të trafikut të drogës dhe jo me veprimtaritë e tjera kriminale. Nisur nga fakti se qarkullimi i paligjshëm i mjeteve narkotike sjell dobi të mëdha financiare dhe pasuri që organizatave transnacionale kriminale u mundëson të hyjnë në strukturat e pushtetit çka rrënon ekonominë legjitime, rrezikon stabilitetin, sigurinë dhe sovranitetin e shteteve. Konventa, teksa përkufizoi pastrimin e parave si: (i) shkëmbim ose transferim i pasurive duke ditur se këto pasuri kanë rrjedhur nga veprimtari të kundërligjshme qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të pasurive ose me qëllimin e dhënies së ndihmës ndonjë personi që është

³⁵The International Organization of Securities Commissions (IOSCO) as “a wide range of activities and processes intended to obscure the source of illegally obtained money and to create the appearance that it has originated from a legitimate source.” IOSCO Technical Committee, 1992, Report on Money Laundering, October, No. 25.

përfshirë në kryerjen e një apo disa veprimtarive të kundërligjshme, për t'iu shmangur pasojave ligjore të veprimeve të tij; (ii) fshehjen ose mbulimin e natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, sistemimit, lëvizjes, të të drejtave në lidhje me pasurinë ose pronësinë e pasurisë, duke ditur se një pasuri e tillë ka rrjedhur nga një veprimtari e kundërligjshme³⁶. Këtu theksi duhet të bie në rëndësinë e luftës kundër këtij aktiviteti kriminal dhe të kërkohej me ngulm konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, përkatësisht të të hyrave të realizuara me këto veprimtari kriminale.

Konventa sanksionoi për shtetet nënshkruese detyrimin të miratojnë masat e nevojshme që, krahas konfiskimit të mjeteve narkotike, substancave psikotropike, materialeve, të pajisjes dhe të mjeteve të tjera të shfrytëzuara ose të destinuara për kryerjen e veprimit të dënueshëm, të mundësohet konfiskimi i të hyrave³⁷, të cilat dalin nga deliktet e përcaktuara me Konventën ose pronave³⁸ vlera e të cilave i përgjigjet dobisë së tillë. Gjithashtu, Konventa obligon shtetet nënshkruese për miratimin e masave të nevojshme që organeve kompetente t'iu mundësohet *identifikimi, zbulimi, ngrirja ose konfiskimi* i dobisë, pronës, mjeteve ose sendeve me qëllim konfiskimin përfundimtar të tyre³⁹.

Konventa ka mbajtur parasysh edhe faktin, se të hyrat e fituara me kryerjen e veprave penale shpesh përzihen me pasuritë e tjera të ligjshme të autorit ose të personave të tjerë, duke fshehur kështu prejardhjen e paligjshme të pasurisë dhe duke vështirësuar zbulimin dhe konfiskimin e saj. Kjo Konventë parashikon obligimin e konfiskimit edhe të *dobisë së tillë*⁴⁰. Nga aspekti i konfiskimit të pasurisë së paligjshme, të fituar nga prodhimi dhe qarkullimi jo i ligjshëm i mjeteve narkotike dhe të substancave psikotropike, merr vlerë sidomos zgjidhja që parashikon detyrimin e konfiskimit të të hyrave që dalin nga⁴¹: *dobia e fituar me anë të veprës penale, pronës në të cilën dobia është shndërruar dhe pronësisë me të cilën është përzier pasuria*. Në të vërtetë, po në këtë Konventë, shteteve nënshkruese u rekomandohet shqyrtimi i aplikimit të *ngarkesës së kundërt të të provuarit*⁴² lidhur me ligjshmërinë e dobisë ose të pronës tjetër, e cila i nënshtrohet konfiskimit në atë masë sa nuk cenon dhe shkel parimet e drejtësisë dhe natyrën juridike të së drejtës vendore.

³⁶Konventa e Kombeve të Bashkuara “Kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope” Vjenë - Dhjetor 1988, neni 3/b.

³⁷ Në kuptim të kësaj Konvente me të hyra nënkuptohet çdo pronësi e fituar drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë me kryerjen e veprës së dënueshme penale të paraparë nga Konventa.

³⁸ Me pronë nënkuptohet pasuria e cilitdo lloji, e luajtshme ose e paluajtshme, materiale ose jo materiale, dokumentet juridike ose mjetet të cilat dëshmojnë për të drejtën e pronës në pasuri apo aktiva e ndërmarrjeve.

³⁹ Neni 5 paragrafi 2 i Konventës.

⁴⁰ Neni 5 paragrafi 6 i Konventës.

⁴¹ Neni 5 paragrafi 6 pika c) e Konventës.

⁴² Neni 6 paragrafi 7 i Konventës.

3.1.2. Konventa e Këshillit të Europës e vitit 1990 “Mbi pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të rrjedhura nga krimet”, e njohur si Konventa e Strasburgut

Kjo Konventë vjen pas asaj të Kombeve të Bashkuara në 1988 dhe synon të plotësojë më mirë konceptin e “*Pastrimit të parave*” edhe me vepra të tjera penale, pa përjashtuar veprat penale të përcaktuara nga Konventa e Kombeve të Bashkuara. Konventa e Strasburgut i qaset problematikës së luftës kundër veprave penale në mënyrë konkrete dhe thekson nevojën e domosdoshme për gjetjen e metodave bashkëkohore dhe efikase në luftën kundër kriminalitetit si dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar. Konfiskimin e të hyrave të përfituara me vepër penale, Konventa e Strasburgut e identifikon si një nga metodat efikase në luftën kundër veprave të rënda penale, sikurse kërkon nga shtetet nënshkruese të bashkëpunojnë në fushën e konfiskimit të të hyrave të përfituara me vepër penale. Për palët nënshkruese parashikohet aprovimi i masave ligjore dhe i masave të tjera në bazë të të cilave mund të ekzekutohet konfiskimi i *mjeteve*⁴³ dhe të *hyrave të paligjshme*⁴⁴, ose i *pasurisë*⁴⁵ dhe vlerës që i përgjigjet të hyrave të tilla të paligjshme. Konfiskimi konsiderohet si *dënim* ose *masë* të cilën e cakton gjykata pas zbatimit të procedurës gjyqësore për një ose më shumë vepra penale, pasoja e të cilave është konfiskimi përfundimtar i pasurisë. Ngjashëm, sikurse Konventa e Vjenës e vitit 1988, kjo Konventë thekson rëndësinë e miratimit të masave legislative dhe masave tjera për të mundësuar *identifikimin* dhe *hyrjen në gjurmë të pasurisë*, e cila i nënshtrohet konfiskimit, dhe pengimin e të gjitha formave të tregëtimit, bartjes ose të disponimit me pasurinë si e tillë⁴⁶.

⁴³ Me mjete Konventa nënkupton çdo objekt të shfrytëzuar ose të destinuar për shfrytëzimin në çfarëdo mënyre, në tërësi ose pjesërisht, gjatë kryerjes së një ose më shumë veprave penale.

⁴⁴ Si të hyra të paligjshme kjo Konventë shënon cilëndo dobi pasurore të përfituar me vepër penale, ndërsa mund të përbëhet nga cilado lloj i pasurisë në pajtim me definicionin e saj.

⁴⁵ Pasuria shënon cilëndo lloj pasurie, pa marrë parasysh nëse përbëhet në sendet ose të drejtat, qofshin të luajtshme ose të paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet të cilat provojnë të drejtën në pasurinë e tillë.

⁴⁶ Neni 3 i Konventës

3.1.3. Konventa Ndërkombëtare për luftimin e financimit të terrorizmit, e miratuar më 9 dhjetor 1999 në New York

Kjo Konventë, konstaton se përfaqësimi dhe zhvillimi i terrorizmit ndërkombëtar varet nga mjetet financiare që terroristët mund të marrin dhe për këtë arsye, argumenton nevojën urgjente në forcimin e bashkëpunimit mes shteteve dhe miratimin e masave efektive për pengimin e financimit të terrorizmit. Konventa parashikon edhe konfiskimin e pasurisë në lidhje me financimin e terrorizmit. Në të vërtetë, me këtë Konventë parashikohet inkriminimi idetyrueshëm i financimit të terrorizmit, me të cilin për herë të parë promovohet qasja e re e kundërshtimit të terrorizmit në planin global me rrënimin e levës së forcës së organizatave terroriste⁴⁷.

Shtetet nënshkruese obligohen që të miratojnë masat përkatëse ligjore, në pajtim me parimet ligjore vendore për *identifikimin, zbulimin, ngrirjen ose për sekuestrimin e mjeteve eventuale*⁴⁸, të cilat shfrytëzohen ose janë caktuar me qëllim kryerjen e veprave penale të përcaktuara nga Konventa si dhe mjetet e fituara me kryerjen e veprave të tilla penale.

3.1.4. Konventa penalo-juridike e Këshillit të Europës për korrupsionin, e miratuar më 27 janar 1999 në Strasburg

Për shtetet anëtare, kjo Konventë, parashikon miratimin e legjislacionit specifik dhe marrjen e masave të tjera me të cilat mundësohet kryerja e konfiskimit ose, në mënyrë tjetër, konfiskimin e mjeteve apo të dobive të përfituara me anë të kryerjes së veprave penale të vendosura në pajtim me këtë Konventë, ose të pasurisë në vlerën që i përgjigjet dobisë së fituar nga kryerja e veprave penale⁴⁹. Konventa thekson rëndësinë e aplikimit të teknikave të veçanta të hulumtimit dhe masave ligjore që iu mundëson gjykatave dhe organeve tjera kompetente qasjen në evidencat bankare dhe financiare si dhe konfiskimin e tyre. Në pajtim me këtë Konventë “sekreti bankar” nuk paraqet pengesë për ndërmarrjen e masave të nevojshme për konfiskimin e pasurisë ose të të hyrave.

⁴⁷ Govedarica, Milimir, Oduzimanje imovinske koristi i uasaglasenost sa medjunarodnim standardima. Pravo i Pravda, casopis za pravnu teoriju i praksu Udruzenja sudija u Federaciji Bosne i Hercegovine, godina XI, broj 1, Sarajevo, 2011, fq. 466.

⁴⁸ Në kuptim të kësaj Konvente me mjete nënkuptohen mjetet e çdo lloji, qoftë materiale ose jomateriale, të luajtshme ose të paluajtshme, pa marrë parasysh se si janë fituar, dokumentet juridike ose instrumentet në çfarëdo formë, përfshirë ato elektornike dhe digjitale, me të cilat provohet pronësia ose interesi në raport me ato mjete, duke përfshirë por jo duke u kufizuar, në kreditë bankare, çëçet për udhëtime, aksionet, letrat me vlerë, obligacionet, kambialet dhe akreditivet.

⁴⁹ Neni 19 paragrafi 3 i Konventës.

Kjo u përsos më tej sidomos nga mundësia e artë që dha programi SWIFT, (*Shoqata për Telekomunikacionin Ndërbankar Financiar*), një kompani me bazë në Belgjikë, e krijuar për të siguruar rrjetin përmes të cilit kryhen transaksionet financiare. Aktualisht, më shumë se 9.000 kompani bankare dhe financiare nga 209 vende të botës kryejnë transaksione nëpërmjet këtij rrjeti dhe rreth 80% e transaksioneve në mbarë botën përfitojnë nga kjo bazë logjistike. Në kuadër të bashkëpunimit transnacional, me këtë mekanizëm evropian punon tashmë edhe SHBA, e cila përfiton nga informacionet që merr prej saj në kuadër të luftës kundër terrorizmit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë në gjendje të përdorin informacionin bankar evropian në mënyrë të larmishme. Shtetet e Bashkuara mund të kenë të dhëna specifike financiare nga autoritetet sipas kërkesave të bëra në kuadër të programit për Trajtimin e Financimit të Terrorizmit (*TFTP*). Programi u fillua më 23 shtator 2001, në kontekstin e sulmeve të 11 shtatorit, nëpërmjet nënshkrimit nga Presidenti Bush të Urdhrit Ekzekutiv 13224, i cili delegoi Departamentin e Thesarit të SHBA, e në veçanti në rast emergjencash të mëdha, të marrë, përmes thirrjeve administrative, grupet e të dhënave nga rrjetet përmes të cilave bëhen transaksionet financiare, përfshirë Shoqatën për Telekomunikacionin Ndërbankar Financiar (*SWIFT*). Por fakti që SHBA-të kanë akses në informacionin e mbajtur nga SWIFT nuk u bë publike deri më 23 qershor 2006, kur u paraqitën tre artikuj në The New York Times, The Wall Street Journal dhe The Los Angeles Times. Reagimi i BE-së ishte intensiv, rregullatori belg i mbrojtjes së të dhënave (*Autoriteti i Mbrojtjes së të Dhënave të Belgjikës*) dhe Parlamenti European nxorrën rezoluta ku i bënë thirrje SWIFT-it të vepronte në përputhje me rregulloret e BE-së, veçanërisht kur transaksionet ndodhën në Europë. Megjithatë, nga strukturat qendrore të Bashkimit European janë shfaqur dy pozicione: nga njëra anë Komisioni European dhe Këshilli ishin mjaft të lejuara në lidhje me aksesin e SHBA-së në informatat e Bankës Europiane dhe, nga ana tjetër, Parlamenti European, i cili ndonëse tregoi entuziazëm të madh në lidhje me këtë çështje kërkoi rregullim në mënyrë strikte të këtij bashkëpunimi, në përputhje me parimet e BE. Pas bisedimeve mbi këtë temë u gjet edhe mekanizmi i luftës kundër financimit të aktiviteteve terroriste.

Në qershor 2007, SWIFT vendosi me miratimin e Bordit të Drejtorëve të ndryshojë infrastrukturën e mesazheve duke krijuar dy qendra operative në Europë, që duhet të kenë funksionin e mesazheve dhe ruajtjes së informacionit të transaksioneve intra-europiane. Arkitektura e re e distribuuar u bë funksionale në fund të vitit 2009. Rrjeti i komunikacionit u nda në dy blloqe: Zona Europiane, për vendet në këtë zonë dhe Zona Transatlantike për të trajtuar operacionet e kryera në SHBA. Shtete të tjera u caktuan

automatikusht në Zonën Transatlantike, por ato mund, megjithatë, sipas kërkesës, të ndahen në Zonën Europiane⁵⁰. Kjo arkitekturë e re e shpërndarë bëri të mundur mbajtjen e informacionit mbi transfertat bankare brenda-europiane vetëm në serverët e vendosur në Europë dhe lehtësoi komunikimin mes shteteve edhe në këtë fushë, në kuadër të luftës kundër terrorizmit dhe finacimit të tij me paratë e dala nga kryerja e veprave penale.

3.1.5. Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar transnacional (Konventa e Palermo-s) e vitit 2000 dhe protokollet plotësuese

Kjo Konventë u nënshkrua nga 184 vende anëtare të OKB-së, të cilat obligoheshin që, në sistemet e tyre të brendshme penale, të përcaktonin katër vepra penale të dallueshme: - pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal - pastrimi i parave - korrupsioni dhe pengimi i drejtësisë⁵¹. Siç shihet kriminelët ordiner ndërmarrin të gjitha veprimet antiligjore me qëllim të pengimit të drejtësisë, gjë e cila është sfidë jo vetëm për sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe shtetet e regjionit të Ballkanit, por edhe për shtetet më të zhvilluara diku më shumë e diku më pak, por nga kjo dukuri negative nuk janë imune asnjë vend i botës.

Konventa, teksa promovon vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me qëllim parandalimin dhe luftën efikase ndaj krimit të organizuar transnacional bën njëherësh me dije rëndësinë e sigurimit të nivelit më lartë të standardizimit ose të koordinimit të qasjes së politikës shtetërore, të legjislacionit, të punës së administratës dhe organeve ligjzbatuese lidhur me problemin e luftës kundër kriminalitetit transnacional, me qëllim arritjen e efikasitetit të lartë dhe rritjen e përpjekjeve globale për kontrollin e saj. Rëndësia e kësaj Konvente shtohet teksa në kontekstin e luftës kundër kriminalitetit të organizuar parashikon⁵², se shtetet nënshkruese duhet të miratojnë masat e domosdoshme legjislative për të siguruar konfiskimin⁵³ e dobisë nga veprat penale⁵⁴ të parashikuara me këtë

⁵⁰<http://www.arduph.ro/domenii/diu-si-terorismul/u-s-access-to-eu-banking-information-for-the-prevention-of-terrorism-accommodations-between-the-u-s-and-eu/>

⁵¹Konventa e OKB kundër krimit të Organizuar, Palermo 2000.

⁵² Dispozitat më të rëndësishme të Konventës që i përkasin “konfiskimit” janë të përmbajtura në nenin 12 të saj.

⁵³ Me këtë nocion Konventa përfshin konfiskimin ku është e zbatueshme, përkatësisht privimi i përhershëm i drejtave të pronësisë mbi pasurinë sipas urdhërit të gjykatës ose të organit tjetër kompetent.

⁵⁴ Konventa me këtë nocion shënon pasurinë, e cila ka dalë ose është realizuar në mënyrë direkte apo indirekte, me kryerjen e veprës penale.

Konventë ose të pasurisë,⁵⁵ që i përgjigjet vlerës së kësaj dobie si dhe të pasurisë, pajisjes ose të instrumenteve të tjera të shfrytëzuara ose të destinuara për kryerjen e veprave penale nga kjo Konventë. Shtetet nënshkruese u angazhuan të miratojnë masat e domosdoshme me qëllim mundësimin e identifikimit, gjurmimit, ngrirjes ose sekuestrimit⁵⁶ të dobisë së përfituar nga kriminaliteti siç janë: mjetet dhe pasuria. Në qoftë se dobia e fituar me kryerjen e veprave penale është transformuar ose shndërruar pjesërisht ose në tërësi në ndonjë pasuri tjetër, pasuria e tillë i nënshtrohet masave nga ky nen, në vend të dobisë së theksuar⁵⁷, nëse është përzier me pasurinë e përfituar në mënyrë legjitime. Pasuria e tillë, duke mos prishur çfarëdo autorizimi të ndërlidhur me ngrirjen ose sekuestrimin, do t'i nënshtrohet konfiskimit deri në vlerën e vlerësuar të mjeteve të përziera me kriminalitetin. Gjithashtu, sipas kësaj Konvente, e hyra ose beneficionet e tjera të dala nga dobia kriminale, nga pasuria në të cilën ajo dobi është transformuar ose është shndërruar, ose pasuria me të cilën ajo dobi është përzier, i nënshtrohen gjithashtu masave të konfiskimit, në të njëjtën mënyrë dhe shkallë si vetë dobia nga kriminaliteti. Dispozita të rëndësishme të kësaj Konvente kërkojnë nga 184 shtetet nënshkruese që të shqyrtojnë mundësinë e aplikimit të barrës së bartur të të provuarit në mënyrë që autori i veprës penale të dëshmojë ligjshmërinë e prejardhjes së dobisë në fjalë, e supozuar si e përfituar nga kriminaliteti ose dobinë e pasurisë tjetër, e cila i nënshtrohet konfiskimit, por përherë në një masë e cila është konform me parimet e ligjeve vendore, karakterin e procedurës gjyqësore dhe të procedurave tjera⁵⁸.

⁵⁵ Në kuptim të kësaj Konvente me pasuri nënkuptohen sendet e çdo lloji, qoftë materiale ose jomateriale, të luajtshme ose të paluajtshme, të vlerësueshme ose jo të vlerësueshme, si dhe dokumentet juridike ose instrumentet me të cilat dëshmohet e drejta, ose interesi në raport me sendet e tilla.

⁵⁶ “Ngrirja ose sekuestrimi” shënon ndalesën e përkohshme të bartjes, shndërrimit, disponimit ose të tjetërsimit të pasurisë, apo ruatja e përkohshme ose kontrolli i pasurisë në bazë të urdhërit që e lëshon gjykata apo organi tjetër kompetent.

⁵⁷ Duke u nisur nga teksti i kësaj dispozite në gjuhën angleze e cila gjendet në nenin 12 paragrafi 3 i Konventës: “*such property shall be liable to the measures referred in this article*” e cila në përkthim të vrazhdë do të thotë: “*pasuria e tillë do të jetë përgjegjëse masave të përcaktuara në këtë nen*” ekziston qëndrimi se këtu gjendet baza për konfiskimin civilo-juridik, përkatësisht procedura e konfiskimit e orientuar kundër të mirave që janë objekt i konfiskimit e jo kundër personit të caktuar, në të cilën të mirat (pasuria) shpallen fajtor, nga e cila më tej del se procedura përkatëse penale kundër ndonjë personi që t'i shqiptohet masa e konfiskimit të pasurisë as që është e nevojshme.

⁵⁸ Neni 12 paragrafi 7 i Konventës

3.1.6. Konventa e OKB-së kundër korrupsionit (Konventa e New York-ut) e vitit 2003

Kjo Konventë paraqet marrëveshje globale, qëllimet e të cilës janë: a) nxitja dhe forcimi i masave për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit më me efikasitet dhe efektivitet; b) nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe asistencës teknike në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, duke përfshirë rimarrjen e pasurisë; c) nxitja e integritetit, përgjegjësisë dhe administrimi i rregullt i çështjeve publike dhe pasurisë publike⁵⁹.

Kthimi i pasurisë është parim themelor në këtë Konventë dhe, në këtë aspekt, Konventa parashikon detyrimin e vendeve nënshkruese për t'i ofruar njëra tjetrës ndihmë dhe bashkëpunim në masën më të madhe të mundshme⁶⁰. Sikurse edhe konventat paraprake, kjo Konventë definon në mënyrë të njëjtë nocionet themelore “pasuri”, “sekestrim” dhe “konfiskim”. Vlera e veçantë e saj qëndron në zbatimin e detyrueshëm nga ana e vendeve nënshkruese, e masave të nevojshme që mundësojnë identifikimin, gjurmimin, ngrirjen ose sekestrimin me qëllim konfiskimin e mjeteve të përfituara nga kryerja e veprës penale ose pasurinë, vlera e të cilave i përgjigjet vlerës së atyre mjeteve. Kjo Konventë parashikon konfiskimin e mjeteve që janë transformuar ose zëvendësuar në pasuri tjetër pjesërisht ose tërësisht, si dhe konfiskimin e mjeteve të fituara në mënyrë të paligjshme por të përziera me pasurinë e ligjshme deri në vlerën e mjeteve të përfituara me kryerjen e veprave penale⁶¹. Në të vërtetë, rëndësinë e veçantë të saj e gjejmë në dispozitat e nenit 31 paragrafi 8, me të cilin shtetet kontraktuese “...mund të shqyrtojnë mundësinë e kërimit që, autori i veprës penale të tregojë origjinën e këtyre fitimeve të prezumuara nga krimi, ose vlerën e çdo pasurie tjetër që i nënshtrohet konfiskimit, në masën që një kërkesë e tillë të jetë në përputhje me principet themelore të ligjit të tyre të brendshëm dhe me natyrën e procedurave gjyqësore dhe të tjera”⁶². Kjo do të thotë që parasheh mundësinë e kalimit të barrës së të provuarit të personi ndaj të cilit mund të paraqitet kërkesa për sekestrim dhe konfiskim të pasurisë e cila dyshohet se është përfituar në mënyrë të kundërligjshme.

⁵⁹ <http://www.hidaa.gov.al/Konventa/Konventa%20e%20OKB%20%20kunder%20Korrupsionit.pdf> , neni 1.

⁶⁰ Po aty, neni 51.

⁶¹ Po aty, neni 31 paragrafi 4 dhe 5.

⁶² Po aty, neni 31, paragrafi.

3.1.7. Konventae KE-së “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”

Konventën “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit” Këshilli i Europës e ka miratuar më 16 maj 2015 në Varshavë, duke patur parasysh qëndrimin, se lufta kundër formave të krimit të organizuar dhe terrorizmit, i cili gjithnjë e më shumë po bëhet problem ndërkombëtar, kërkon përdorimin e metodave bashkëkohore frytëdhënëse në planin ndërkombëtar; dhe duke besuar, se një nga ato metoda është privimi i autorit të veprës penale nga dobia që rrjedh nga kriminaliteti dhe nga instrumentet për përfitimin e asaj dobie.

Sipas kësaj Konvente⁶³, secili vend nënshkrues duhet të miratojë masa legislative dhe masa të tjera të nevojshme, të cilat mundësojnë *konfiskimin*⁶⁴ e *dobisë*⁶⁵ që del nga kriminaliteti, përkatësisht që nga kryerësi i veprës së rëndë penale ose veprave penale siç janë definuar me ligjin shtetëror. Njëherësh autori i veprës penale duhet që të dëshmoj prejardhjen e dobisë pasurore ende të pavërtetuar ose të pasurisë tjetër që i nënshtrohet konfiskimit, në masën në të cilën kërkesa e tillë është në pajtim me parimet e ligjeve vendore. Konventa thekson rëndësinë e masave gjurmuese, të masave të përkohshme dhe miratimin e kornizës legislative që mundëson identifikimin, gjetjen, ngrirjen dhe konfiskimin urgjent të pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit⁶⁶. Gjithashtu, vendet nënshkruese janë të obliguara të miratojnë masa legislative që mundësojnë të kryhet *ngrirja, sekuestrimi*⁶⁷ dhe konfiskimi i pasurisë në të cilën janë përzier mjetet në tërësi ose pjesërisht me atë pasuri, deri në vlerën e përcaktuar të mjeteve të përziera; të hyrave ose të mirave të tjera që rrjedhin nga dobitë, nga pasuria në të cilën janë fituar mjetet me veprimet kriminale dhe janë transformuar ose janë shndërruar, ose nga pasuria me të cilat janë përzier mjetet e kriminalitetit, deri në vlerën e mjeteve të përziera në mënyrë dhe në masë të njëjtë sikurse edhe mjetet e krimit.

⁶³ Po aty, neni 3 paragrafi 1.

⁶⁴ Me konfiskim nënkuptohet dënimi ose masa të cilën e shqipton gjykata pas zhvillimit të procedurës lidhur me veprën kriminale, ndërsa rezultati është konfiskimi i përhershëm i pasurisë.

⁶⁵ Dobia shënon çdo dobi ekonomike të përfituar nga veprimi kriminal në mënyrë direkte ose indirekte. Dobia mund të përfshijë cilëndo lloj pasurie, përkatësisht çdo lloj pasurie, qoftë materiale ose jomateriale, të luajtshme ose të paluajtshme si dhe dokumentet juridike ose instrumentet të cilat dëshmojnë pronësinë mbi pasurinë apo interesin në atë pasuri.

⁶⁶ Konventae KE-së “Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit, neni 4.

⁶⁷ Ngrirja dhe sekuestrimi nënkupton ndalimin e përkohshëm të transferit, shkatërrimit, disponimit ose të transferimit të pasurisë ose veprimet e përkohshme e ruajtjes ose e kontrollit mbi pasurinë sipas urdhërit të lëshuar nga gjykata apo organi tjetër kompetent.

3.2 Aktet juridike të Bashkimit European lidhur me konfiskimin e pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme

Një varg i akteve juridike të Bashkimit European, në kuadër të shqyrtimit të problematikës së luftimit të kriminalitetit të organizuar, terrorizmit dhe veprave të tjera penale të rënda, përkatësisht të definimit të kornizës juridike për luftën efikase të këtyre formave të kriminalitetit, trajtojnë edhe problematikën e konfiskimit të të hyrave dhe të dobive të përfituara me anë të kryerjes së veprave penale. Qëllimi i përbashkët i gjithë instrumentave juridike është unifikimi i mjeteve, metodave dhe procedurave në luftën kundër kriminalitetit të organizuar në legjislacionet nacionale të shteteve nënshkruese. Në këtë qëllim, ashtu si vendet e tjera, u përfshi edhe Shqipëria dhe ligjet e saj Nr. 9284/2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” dhe Ligji Nr. 10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të cilat i shërbyen përmirësimit të kornizës juridike në këtë fushë. Të dy ligjet, pavarësisht përparimit, nuk japin përcaktimin e nocioneve të sekuestros, ngrirjes, bllokimit, konfiskimit, produktit etj., duke e drejtuar interpretimin tek Kushtetuta, e cila në nenin 116, deklaron se marrëveshjet e ratifikuara nga Kuvendi (*Shqipëria e ka ratifikuar Konventën e Varshavës, në të cilën ka një përcaktim të qartë të këtyre koncepteve*), janë drejtpërdrejt të zbatueshme në të drejtën e brendshme⁶⁸.

Pavarësisht nga përparimi, duhet pranuar se momentalisht korniza juridike e Bashkimit European në fushën e ngrirjes dhe konfiskimit të të hyrave nga krimi bazohet në vendimet e Këshillit të BE-së, i cili ka nevojë të jetë më fleksibil për të siguruar efikasitet dhe rezultatet e pritshme (*Council Framework Decisions*)⁶⁹.

⁶⁸http://www1.fint.gov.al/images/Ligji_nr._10192_datë_03_12_2009_Për_parandalimin_dhe_goditjen_e_krim_të_organizuar.pdf dhe <http://www.fint.gov.al/doc/9284.pdf>

⁶⁹ Vendimet kornizuese të Këshillit të BE-së janë definuar si akte me të cilat përafërohen dispozitat interne të shteteve anëtare, dhe të cilat janë të detyrueshme për shtet në pikëpamje të rezultati që me atë realizohet, por i lënë lirinë në përzgjedhjen e formës dhe metodave. Edhe pse të definuar mjaft ngjashëm me direktivat nga shtylla e parë, mundësia që aktet kornizuese të kenë efekte direkte shprehimisht është përjashtuar me nenin 34 të Kontratës së BE-së

3.2.1. Vendimi kornizues për pastrimin e parave, identifikimin, përcjelljen, ngrirjen, konfiskimin e mjeteve dhe të hyrave nga vepra penale (2001/500/JHA)⁷⁰

Ky vendim obligon shtetet anëtare në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm që, nëpërmjet masave ligjore, të sigurojnë procedurat për konfiskimin e të hyrave të fituara me kriminalitet, përkatësisht “konfiskimin e vlerësuar”⁷¹. Në bazë të këtij vendimi kornizues mund të konfiskohet edhe pasuria e ligjshme e vlerës përkatëse nëse nuk mund të konfiskohet dobia e paligjshme⁷², si në procedurën që zhvillohet para organeve vendore ashtu edhe në procedurën sipas kërkesës së vendit tjetër. Në kuptim të këtij Vendimi Kornizues rëndësia e shprehjeve “pasuria”, “të hyrat” dhe “konfiskimi” kanë të njëjtin kuptim sikurse në Konventën e Këshillit të Europës për pastrimin e parave, hulumtimin, konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin e të hyrave të përfituara me vepër penale (Konventa e Strasburgut nga viti 1990).

3.2.2. Vendimi Kornizues për zbatimin e urdhëresave për ngrirje të pasurisë ose të dëshmive (2003/577/JHA)⁷³

Ky vendim ka si qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurës sipas të cilave, shtetet anëtare do të bëjnë “njohjen” dhe zbatimin në territorin e vet të urdhëresave për ngrirje, të paraqitura nga ana e organeve gjyqësore të shtetit tjetër anëtar. Me të vendoset procedura e shpejtë dhe efikase e zbatimit reciprok të urdhërave për ngrirje të pasurisë ose provave, së bashku me kushtet rigoroze për refuzimin e zbatimit të urdhërave. Sipas këtij Vendimi Kornizues, urdhër - ngrirja mendohet për cilëndo masë të ndërmarrë nga ana e organit kompetent gjyqësor të shtetit nxjerrës, me qëllim pengimin e përkohshëm të shkatërrimit, transformimit, lëvizjes, bartjes ose disponimit me pasurinë, e cila mund të jetë objekt konfiskimi, përkatësisht i sekuestrimit ose konfiskimit të përhershëm. Vera Jourova, komisionerja europiane për drejtësinë, këmbëngulte se legjislacionet e përafruara do të ndihmojnë në luftën kundër kriminalitetit. Ajo kërkonte të punohet në këtë drejtim dhe shpjegonte se: “Në të ardhmen, të gjitha vendet anëtare të BE-së do të njohin konfiskimin e

⁷⁰Gazeta zyrtare e Bashkësisë Europiane, numër L 182/2001. E qasshme në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:1:2001:182:0001:0002:EN:PDF>.

⁷¹Me këtë term nënkuptohet konfiskimi i përcaktuar në shumën monetare që i përgjigjet vlerës së dobisë së përfutur në mënyrë të kundërligjshme me kryerjen e veprës penale.

⁷²Govedarica, Milimir, Oduzimanje imovine stecene izvrsenjem krivicnog dela preventivni – represivni aspect, Visoka skola unutrašnjih poslova, Banja Luka, 2013. Godina, str. 43.

⁷³Gazeta zyrtare e Bashkësisë Europiane, numër L 196/2003 dhe L 374/2006.

Me qasje në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2003:196:0045:0055:EN:PDF> dhe

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2006:374:0020:0020:EN:PDF>.

pasurive të terroristëve ose ngrirjen e llogarive në çdo vend të BE”. Kur një gjykatës ngrin një llogari në çdo shtet anëtar, ai duhet të jetë efektiv në të gjithë BE-në, të paktën brenda 48 orëve, shprehet ajo, duke shtuar se ky proces tani merr disa javë. “Vuajtjet duhet të mbyllen”- thoshte Jourova në paraqitjet e saj, teksa e vënte theksin dhe në nevojën që konfiskimi duhet të veprojë shpejt edhe në llogaritë e mbajtura nga familjet dhe bashkëshortët e terroristëve⁷⁴. Kjo nënkupton që për një luftë të sukseshme kundër kriminalitetit transnacional, nevojitet një bashkëpunim i gjerë dhe i mirëfilltë në mes të shteteve të BE-së, si në aspektin e përafrimit të rregullimit ligjor ashtu edhe të zbatimit të tyre.

3.2.3. Vendimi Kornizues për vendosjen e dispozitave minimale për elementët thelbësorë të veprave penale dhe të dënimeve në fushën e trafikimit të paligjshëm të mjete narkotike (2004/757/JHA)⁷⁵

Ky Vendim, në mes të tjerash, parashikon që shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa të domosdoshme për të mundësuar konfiskimin e substancave të paligjshme, të sendeve që janë përdorur ose kanë qenë të destinuara të përdoren për kryerjen e veprës penale dhe të hyrave nga vepra penale apo konfiskimi i pasurisë në vlerën e substancave të paligjshme, mjeti me të cilin është kryer vepra penale ose të të hyrave nga vepra penale.

3.2.4. Vendimi Kornizues për konfiskimin e përhershëm të të hyrave, mjeteve dhe pasurive të ndërlidhura me kriminalitetin (2003/212/JHA)⁷⁶

Ky vendim zëvendësoi vendimin lidhur me konfiskimin e përhershëm të të hyrave, mjeteve dhe pasurisë së ndërlidhur me kriminalitetin. Baza e pikënisjes për nxjerrjen e tij gjendet në konkluzionin se lufta kundër kriminalitetit të organizuar transkufitar duhet të jetë e fokusuar në hulumtimin, ngrirjen, në konfiskimin e përhershëm dhe të përkohshëm të të hyrave, përkatësisht të dobisë nga vepra penale, duke marrë parasysh se motivi themelor i kryerjes së këtyre veprave penale është përfitimi i dobisë pasurore. Me këtë Vendim Kornizues, si standard minimal për shtetet anëtare kërkohet miratimi i masave të domosdoshme me të cilat mundësohet konfiskimi i përhershëm, në tërësi ose pjesërisht, i pasurisë që i takon personit të dënuar për format e rënda përgjatë kryerjes së veprave

⁷⁴ <http://www.dw.com/en/european-commission-tackles-terrorism-financing/a-36869137>

⁷⁵ Gazeta zyrtare e Bashkësisë Europiane, numër: 335/2004. Qasja në:
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2004:335:0008:0011:EN:PDF>.

⁷⁶ Gazeta zyrtare e Bashkësisë Europiane, numër: 68/2005. Qasja në:
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2005:068:0049:0051:EN:PDF>.

penale⁷⁷, përkatësisht të pasurisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme. Konfiskimi i pasurisë së përfituar në mënyrë të paligjshme, përkatësisht të ashtuquajturës “konfiskimi i zgjeruar” është parashikuar në mënyrë alternative nëpërmjet tre modeleve⁷⁸.

Së pari, kur gjykata nacionale, në bazë të fakteve konkrete, është e bindur plotësisht se pasuria është me prejardhje nga aktivitetet e ngjashme kriminale të personit të dënuar në periudhën para aktgjykimit për veprën penale, e cila konsiderohet e arsyeshme duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret;

Së dyti, kur vërtetohet se vlera e pasurisë nuk është në përpjestim me të hyrat e ligjshme të personit të dënuar, dhe;

Së treti, kur gjykata nacionale, në bazë të fakteve konkrete, është plotësisht e bindur se pasuria ka dalë nga aktiviteti kriminal i personit të dënuar.

Për të tre modelet është karakteristikë se duhet të ekzistojë supozimi i bazuar se, pasuria e personit rrjedh nga kryerja e veprës penale. Kështu, gjykata duhet të jetë plotësisht e bindur në prejardhjen kriminale të pasurisë së caktuar dhe supozimi për prejardhjen kriminale të pasurisë së caktuar duhet të jetë i bazuar në fakte që duhet të jenë treguese, ndërsa arsyetohet me peshën e manifestimit të formave të kriminalitetit të organizuar dhe terrorizmit. Pavarësisht këtyre, personit të dënuar duhet ti jepet mundësia e përgënjeshtërimit të supozimit të përmendur, përkatësisht mundësia e të provuarit të prejardhjes së ligjshme të pasurisë së tij⁷⁹.

3.2.5. Vendimi kornizues për zbatimin e parimit të pranimit reciprok të urdhërit për konfiskim të përhershëm (2006/783/JHA)⁸⁰

Me këtë Vendim parashikohet pranimi reciprok i urdhërit të konfiskimit, përkatësisht konfiskimi i përhershëm i pasurisë së dalë nga veprat penale, zbatimi i urdhërave, arsyet për refuzimin e ekzekutimit, mjetet juridike në procedurën e pranimit dhe ekzekutimit të urdhërave, disponimi me pasurinë e konfiskuar etj.

⁷⁷ Sipas nenit 3 të këtij vendimi kornizues penale kjo i përket veprave penale të cilat janë kryer në kuadër të organizatës kriminale, e definuar në Aksionin e Përbashkët për përcaktimit të veprës penale të pjesëmarrjes në organizatën kriminale (98/733/JHA) dhe të Vendimit kornizues të Këshillit të BE-së për luftën kundër terrorizmit (2002/475/JHA).

⁷⁸ Neni 3 paragrafi 2 i Vendimit kornizues.

⁷⁹ Ivcevic – Karas E: Utvrđivanje imovinske koristi stecene kaznenim djelom primjenom bruto ili neto načela s obzirom na pravnu prirodu mjere (prosirenog) oduzimanja imovinske koristi, Hrvatski ljetopis bza kazneno pravo i praksu, Zagreb, vol. 17, broj 1/2010, str. 201. I 202. Qasur në: <https://www.pravo.unizg.hr/hljcpp>

⁸⁰ Gazeta zyrtare e Bashkësisë Europiane, numër: L 328/2006.

Me qasje në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriSery/LexUriSery.do?uri=OJ:L:2006:328:0059:0078:EN:PDF>

Vendimi i Këshillit të BE-së i shërben bashkëpunimin reciprok në mes shteteve anëtare lidhur me ofrimin e shërbimeve në fushën e gjurmimit dhe identifikimit të të hyrave dhe të pasurisë tjetër të lidhur me veprën penale (2007/845/JHA)⁸¹.

Ky Vendim parashikon vendosjen e shërbimeve të veçanta (*Asset Recovery Offices*) dhe të specializuara për gjurmimin dhe identifikimin e të hyrave të fituara me vepër penale dhe të pasurisë tjetër, e cila ka dalë nga vepra penale dhe që gjithashtu mund të jetë objekt i ngrirjes, i konfiskimit të përkohshëm ose të përhershëm sipas vendimit të gjykatësit. Njëherësh ky vendim përcakton edhe kornizën juridike për vendosjen e bashkëpunimit reciprok, shkëmbimin dhe mbrojtjen e të dhënave si dhe shkëmbimin e praktikave më të mira.

3.2.6. Direktiva për ngrirjen dhe konfiskimin e përhershëm të të hyrave të fituara me vepër penale në Bashkimin European 25 shkurt 2014 (EP-PE_TC1-COD (2012)0036)⁸²

Nismat më të mira në kuadër të institucioneve të Bashkimit European flasin për interesimin në rritje dhe rëndësinë e problemit të konfiskimit të pasurisë së paligjshme, në funksion të luftës efikase kundër kriminalitetit. Kjo direktivë detyron shtetet të cilave i'u drejtohet, obligimin për zbatim, por ajo i lë shteteve nacionale zgjedhjen e formës dhe metodës së zbatimit.

Direktiva kërkon nga shtetet anëtare marrjen e masave që mundësojnë konfiskimin e përhershëm të sendeve të cilat janë përdorur ose kanë qenë të destinuara të përdoren për kryerjen e veprës penale dhe të hyrave të përfituara me kryerjen e veprës penale, sikurse kërkon njëherësh konfiskimin e përhershëm të pasurisë në vlerën që i përgjigjet lartësisë së përfutur të dobisë pasurore⁸³. Direktiva thekson rëndësinë e “konfiskimit të zgjeruar” të pasurisë⁸⁴. Kjo nënkupton mundësinë e konfiskimit të pasurisë që nuk paraqet të hyrë direkte nga vepra penale konkrete për të cilën gjykohet pronari, por të pasurisë për të cilën gjykata, në bazë të fakteve specifike përcakton probabilitetin më të madh se është fituar

⁸¹ Gazeta zyrtare e Bashkësisë Evropiane, numër: L 332/2007.

Me qasje në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriSery/LexUriServy.do?uri=OJ:L:2007:332:0103:0105:EN:PDF>.

⁸² Propozimi i Direktivës i është paraqitur Parlamentit Evropian nga ana e Komisionit Evropian më datën 12.03.2012 ndërsa leximi i parë është bërë më 25 shkurt 2014 kur edhe është miratuar.

Qasja në:

<http://www.europarl.europa.eu/oeil/popups/ficheprocedure.do?lang=en&reference=2012/0036%28COD%29>

⁸³ Direktiva për ngrirjen dhe konfiskimin e përhershëm të të hyrave të fituara me vepër penale në Bashkësinë Evropiane 25 shkurt 2014 (EP-PE_TC1-COD (2012)0036), neni 3 i Direktivës.

⁸⁴ Po aty, neni 4.

nga aktiviteti kriminal i llojit ose i peshës së ngjashme se sa nga aktivitetet e tjera. Konfiskimi i zgjeruar i pasurisë përjashtohet në rastet kur “aktiviteti kriminal i ngjashëm” nuk është parashikuar si veprë penale sipas dispozitave penale nacionale dhe, kur “aktivitetet e ngjashme kriminale” kanë qenë objekt i një gjykimi penal që në fund ka rezultuar me lirimin e personave nga përgjegjësia, ose në rastet e tjera në të cilat është i zbatueshëm parimi *ne bis in idem*.

Gjithashtu, Direktiva përpunon edhe konfiskimin e pasurisë pa aktgjykim penal (*Non conviction based confiscation – NCB confiscation*)⁸⁵. Konfiskimi pa aktgjykim penal vendoset me qëllim zgjidhjen e rasteve në të cilat ndjekja penale lidhur me veprën penale konkrete nuk mund të realizohet dhe me qëllimin që, vendeve anëtare t’u lihet mundësia e rregullimit të kësaj procedure para gjykatave penale, civile ose administrative. Konfiskimi pa aktgjykim penal është i zbatueshëm në situatat kur aktgjykimi penal nuk mund të nxirret sepse i akuzuari ka vdekur, është i sëmurë ose kur, për shkak të arratisjes së tij apo të sëmundjes së përhershme, gjykimi nuk mund të zhvillohet në afatin e arsyeshëm, çka rrezikon edhe paraqitjen e parashkrimit. Autorët e veprave penale shpeshherë e bartin pasurinë e fituar me kryerjen e veprës penale – pasurinë e fituar në mënyrë të paligjshme, me qëllim fshehjen e prejardhjes së saj dhe shmangien nga hetimi në vende të tjera, të ndryshme nga vendi ku është kryer vepra penale dhe ku gjendet dhe burimi i krijimit të asaj pasurie. Në këto kushte, bashkëpunimi mes shteteve për pranimin reciprok të urdhërave të sekuestrimit dhe konfiskimit bëhet i domosdoshëm. Propozimi i Direktivës rregullon standardet minimale me të cilat kryhet harmonizimi në këtë fushë. Qëllimi i këtyre instrumenteve është të lejojë ngrirjen ose konfiskimin e pasurisë kriminale në vendin A, në një kohë që kriminelin i dyshuar po ndiqet penalisht në vendin B. Vendimi Kornizë lejon një autoritet gjyqësor në një vend të BE-së t’i dërgojë urdhër për të ngrirë ose konfiskuar pronën drejtpërdrejt autoritetit gjyqësor të një vendi tjetër të BE ku do të njihet dhe ekzekutohet pa asnjë formalitet të mëtejshëm⁸⁶.

Direktiva parashikon konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme, përkatësisht të të hyrave të fituara me kryerjen e veprave penale, të cilat janë bartur në personin e tretë me çmim më të ulët se vlera e saj e vërtetë e tregut, ndonëse bartësi i pasurisë pretendon se pasuria është fituar në mënyrë të ligjshme. Direktiva parashikon gjithashtu që konfiskimi i pasurisë në personat e tretë të shoqërohet edhe me konfiskimin e pasurisë së ligjshme të kryerësit të veprës penale, të cilën autori i veprës penale e ka bartur për të shmangur

⁸⁵ Po aty, neni 5.

⁸⁶ http://ec.europa.eu/justice/criminal/recognition-decision/confiscation/index_en.htm

konfiskimin e asaj pasurie si pasuri e zëvendësueshme në lartësinë e dobisë pasurore të përfituar.

Në të gjithë BE-në, është bërë gjithnjë e më e rëndësishme që Shteti të jetë në gjendje të ngrijë dhe konfiskojë pronën në lidhje me kryerjen e një veprë penale dhe kështu t'i privojë kriminelët e pasurive të tyre të fituara nëpërmjet kriminalitetit. Për shkak të natyrës gjithnjë e më shumë ndërkufitare të veprimtarisë kriminale, veçanërisht të terrorizmit dhe krimit të organizuar, kërkohet një bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet autoriteteve gjyqësore kombëtare të BE-së për të pasur veprim efektiv të legjislacionit⁸⁷.

Në këtë kuadër, në vitin 2014, BE-ja ra dakord për një Direktivë që përcaktonte rregulla minimale për ngrirjen dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi, çka synon t'u lehtësojë autoriteteve kombëtare të konfiskojnë dhe rimarrin pasuritë kriminale brenda juridiksionit të tyre. Direktiva e propozuar do të zëvendësojë dy Vendime Kornizë të BE-së, të miratuara në vitin 2003 dhe 2006, e para që parashikon ekzekutimin e urdhrave për ngrirjen e pronës ose provave, e dyta për njohjen reciproke të urdhrave të konfiskimit⁸⁸. Komisioni parashikon që Rregullorja e propozuar do të përmirësoj përmbarimin ndërkufitar nëpërmjet:

- krijimit të një kornize gjithëpërfshirëse që mbulon ngrirjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit në bazë të rregullave të drejtpërdrejta të zbatueshme (zvogëlimi i rrezikut nga zbatimi i pasaktë ose i vonuar nga Shtetet Anëtare);
- udhëzimit për njohjen reciproke të të gjitha llojeve të urdhrave të ngrirjes dhe konfiskimit, të mbuluara nga Direktiva e vitit 2014 si dhe urdhrat e tjerë të konfiskimit të bazuara në padi, të lëshuara si pjesë e procedurës penale;
- vendosjes së afateve të qarta për njohjen dhe ekzekutimin e urdhrave të ngrirjes dhe konfiskimit të lëshuara nga një shtet tjetër anëtar;
- thjeshtësimit të procedurës së njohjes së ndërsjelltë duke vendosur një formular standard për urdhrat e ngrirjes dhe një certifikatë standarde për urdhrat e konfiskimit;
- përmirësimit të komunikimit ndërmjet autoriteteve kombëtare përgjegjëse për lëshimin dhe ekzekutimin e urdhrave të ngrirjes dhe konfiskimit; dhe
- duke i dhënë prioritet të drejtës së viktimës së krimit për kompensim dhe kthim.

⁸⁷http://ec.europa.eu/justice/criminal/recognition-decision/confiscation/index_en.htm

⁸⁸<http://publications.parliament.uk/pa/cm201617/cmselect/cmeuleg/71-xxviii/7105.htm>

Rregullorja e propozuar është një masë penale e BE-së dhe ka hyrë në fuqi për Shtetet Anëtare gjashtë muaj pas miratimit formal dhe hyrjes në fuqi të saj.

Direktiva është një masë penale e BE-së që përfshin gjithashtu konfiskimin e bazuar në jo-dënim dhe krijon një kuadër për njohjen reciproke dhe zbatimin e urdhrave të ngrirjes dhe konfiskimit në të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

3.2.7. Urdhëri European i Hetimeve

Urdhëri European i Hetimeve (EIO)⁸⁹ është një instrument ligjor i BE - së që synon përshtetimin e asistencës së ofruar nga një vend në tjetrin në hetimet penale. Urdhëri EIO, obligon të gjitha shtetet anëtare të Bedhe, dhe bazohet në njohjen reciproke të vendimeve penale. Kjo do të thotë se çdo vend i BE-së është i detyruar të njohë dhe zbatojë kërkesën e vendit tjetër, ashtu siç do të bënte me një vendim që vjen nga autoritetet e veta.

EIO pritet të jetë një hap më tej në luftën kundër krimit të organizuar duke siguruar një dakordim të veprimeve penale të institucioneve të ligjit në shtetet anëtare të BE - së dhe pritet të sjellë përfitimet e mëposhtme:

- ai prezanton një instrument gjithëpërfshirës me një fushë të gjerë;
- përcakton afate të rrepta për mbledhjen e dëshmive të kërkuara;
- kufizon arsyet për refuzimin e kërkesave të tilla;
- redukton dokumentet për këto kërkesa;
- mbron të drejtat themelore të mbrojtjes.

Në veçanti, ai lejon:

- transferimin e përkohshëm të personave në paraburgim për të mbledhur prova;
- kontrollin në llogaritë bankare dhe operacionet financiare të personave të dyshuar ose të akuzuar;
- hetimet e fshehta dhe ndërprerje të telekomunikimeve;
- masat për ruajtjen e provave.

"Urdhëri European i Hetimeve" hyri në fuqi më 22 maj 2017 dhe ai konsiderohet si një instrument ligjor që do të ndihmojë autoritetet për të luftuar krimin dhe terrorizmin. Urdhëri thjeshtëson punën kur kërkohen dëshmi të vendosura në një vend tjetër të BE-së. Për shembull, nëse autoritetet gjyqësore franceze ndjekin terroristë të fshehur në Belgjikë,

⁸⁹<http://www.app.college.police.uk/appcontent/investigations/europeaninvestigations/european-investigation-order/>

ata mund të kërkojnë nga homologët belgë të marrin në pyetje dëshmitarët ose për të kryer kërkime në shtëpi në emër të tyre. Ky mjet pritet të lehtësoj dhe shpejtojë hetimet kriminale ndërkufitare. Vera Jourova, Komisionere për Drejtësinë, Konsumatorët dhe Barazinë Gjinore në Komisionin Europian thotë se: "Kriminelët dhe terroristët nuk njohin kufij. Pajisja e autoriteteve gjyqësore me Urdhrin Europian të Hetimeve do t'i ndihmoj ata të bashkëpunojnë në mënyrë efektive për të luftuar krimin e organizuar, terrorizmin, trafikun e drogës dhe korrupsionin. Ajo do t'u japë autoriteteve gjyqësore qasje të shpejtë në evidencë kudo në vendet e BE-së. I bëj thirrje të gjithë Shteteve Anëtare ta zbatojnë atë sa më shpejt që të jetë e mundur për të përmirësuar luftën tonë të përbashkët kundër krimit dhe terrorizmit". Më tej Jurkova, duke nxitur gjetjen e zgjidhjeve të shpejta mes Shteteve Anëtare për të lehtësuar mbledhjen dhe shkëmbimin e dëshmive shprehet se: "Është koha për të modernizuar plotësisht mjetet në dispozicion të autoriteteve gjyqësore për të kryer hetimet"⁹⁰.

Urdhëri Europian i Hetimit bazohet në njohjen reciproke të vendimeve penale, që do të thotë se çdo vend i BE është i detyruar të njohë dhe zbatojë kërkesën e vendit tjetër, ashtu siç do të bënte me një vendim që vjen nga autoritetet e veta.

Urdhri Europian i Hetimit do të sjellë përparësitë e mëposhtme:

- Krijon një instrument të vetëm gjithëpërfshirës me një hapësirë të madhe;
- Zëvendëson kuadrin ligjor të fragmentuar ekzistues për marrjen e provave. Ai do të mbulojë të gjithë procesin e mbledhjes së provave, nga ngrirja dhe ruajtja e provave në transferimin e provave ekzistuese, për shtetin anëtar pjesëmarrës;
- Përcakton afate të rrepta për mbledhjen e dëshmive të kërkuara;
- Redukton dokumentet duke paraqitur një formë të vetme standarde të përkthyer në gjuhën e shtetit anëtar;
- Ndihmon autoritetet të kërkojnë ndihmë kur kërkojnë dëshmi;
- Mbron të drejtat themelore të njeriut dhe
- Udhëzon autoritetet lëshuese të vlerësojnë domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masës hetimore të kërkuar.

Shtetet anëtare kanë afat deri në 30 ditë për të vendosur nëse ata pranojnë një kërkesë. Nëse pranohet, shtetet duhet të respektojnë afatin 90 ditor për të kryer masat hetimore të kërkuara. Çdo vonesë do të raportohet në vendin e BE që lëshon urdhrin për hetim.

⁹⁰Po aty.

Parashihet që, EIO duhet të lëshohet ose të vërtetohet nga një autoritet gjyqësor në përputhje me të drejtat e mbrojtjes dhe me procedurat penale kombëtare. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë mjete juridike ekuivalente me ato që janë në dispozicion në një rast të ngjashëm të brendshëm dhe të sigurojnë që personat në fjalë janë informuar mirë për këto mundësi.

EIO vë në fokus të interesit të tij edhe komunikimet digjitale duke theksuar se, instrumentet tradicionale të hetimit nuk përshtaten gjithmonë me botën digjitale ku jetojmë. Autoritetet gjyqësore kanë nevojë për një qasje të re në dëshmitë që gjenden të vendosura në një tjetër vend.

Komisioni European gjendet i përfshirë dhe është duke punuar fort për të gjetur zgjidhje dhe për të pajisur autoritetet gjyqësore me mjete hetimore moderne, në funksion të lehtësimit të qasjes së tyre edhe në dëshmitë elektronike.

Pas miratimit të Urdhërit European të Hetimit, Komisioni European, shteteve anëtare i'u la kohë deri në 22 maj 2017 për ta implementuar atë në legjislacionet kombëtare, duke iu deklaruar atyre se Komisioni European do të analizojë në vijim gjendjen e zbatimit të këtij Urdhëri.⁹¹

Direktiva bazohet në parimin e njohjes reciproke të vendimeve gjyqësore kur duhet dëshmia, e marrë sipas procedurës penale. Kjo direktivë zbatohet për të gjitha vendet e BE-së përveç Danimarkës dhe Irlandës, të cilat nuk marrin pjesë. Mbretëria e Bashkuar vendosi të marrë pjesë në Direktivën e propozuar, e cila zëvendëson legjislacionin ekzistues të përbashkët të BE-së dhe skemat e asistencës për mbledhjen e provave, sidomos ato të Konventës 2000 për Ndihmën e Ligjshme të BE-së dhe Vendimin Kornizë 2003/577 / JHA mbi ngrirjen e provave.

Ajo u inicua në 21 maj 2010, nga shtatë shtete anëtare të BE (Austri, Belgjikë, Bullgari, Estoni, Slloveni, Spanjë dhe Suedi), të cilat paraqitën një nismë për një Urdhër të Hetimeve Europiane⁹².

Siç shihet nga kjo që u tha më lartë, BE-ja ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të unifikimit të legjislacionit dhe njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja gjyqësore. Ndërsa nëse marrim shtetet tjera që nuk janë pjesë e BE-së, si psh. Kosova, e cila gjindet në pozitë më të pavolitshme në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë kur dihet se nuk arriti viteve të fundit të bëhet pjesë e mekanizmave ndërkombëtarë siç është interpoli.

⁹¹ Po aty.

⁹² www.europa.eu/rapid/press-release_IP-17-1388_en.pdf

Edhe shtetet tjera fqinjë të cilat akoma nuk janë pjesë e BE-së nuk mund të jenë palë në zbatimin e këtyre akteve juridike të BE-së, megjithatë janë në pozicion më të mirë sesa Kosova pasi që të gjitha janë anëtare të OKB-së dhe janë të antarësuara edhe në interpol dhe e kanë më të lehtë luftën kundër të gjitha formave të kriminalitetit. Kur bëhet fjalë për krimin e të gjitha formave, përfshirë edhe identifikimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore që është rezultat i veprës penale, BE-ja e cila tenton që në gjirin e saj të ketë edhe shtetet e Ballkanit Perëndimorë do duhej të gjente mundësinë ligjore që bashkëpunimi në këtë fushë të jetë i njëjtë, ngjashëm me të gjitha shtetet anëtare, pasi që secila prej shteteve aspironte për tu bërë pjesë e BE-së kanë me miliona qytetarë të tyre me leje qëndrimi nëpër shtetet e ndryshme të BE-së dhe kjo do të ishte interes i gjithanshëm në funksion të luftës së kriminalitetit të të gjitha formave. Me këtë do të humbisnin vetëm kriminelët pasi që nuk do kishin asnjë hapsirë për fshehjen e pasurisë së tyre.

KAPITULLI IV

ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE RAJONALE, TË RËNDËSISHME NË FUSHËN E KONFISKIMIT TË PASURISË SË FITUAR NË MËNYRË TË KUNDËRLIGJSHME

4.1. Organizatat ndërkombëtare në luftën kundër shpëlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe zgjerimit të armëve të shkatërrimit në masë - FATF

Në vitet 1980 e më pas, prodhimi dhe qarkullimi i kundërligjshëm i substancave narkotike u bë një nga problemet më të mëdha në të gjithë botën dhe përfshiu vëmendjen dhe interesimin lidhur me to. Përpjekjet për kriminalizimin e veprave penale lidhur me prodhimin, përdorimin dhe tregëtimin e lëndëve narkotike mbushën burgjet dhe në jo pak raste, krijuan probleme dhe me traktatet e të drejtave të njeriut. Njëherësh ato treguan se lufta ndaj këtyre veprave penale rezultoi joefektive dhe shpesh herë e parcelizuar. Në këto kushte, shtetet vendosën të ndryshojnë politikën e luftës ndaj këtij fenomeni.

Me qëllim zhvillimin dhe forcimin e veprimeve në fushën e luftimit dhe shkatërrimit të prodhimit dhe qarkullimit të kundërligjshëm të mjeteve narkotike, përkatësisht të forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë, në Samitin e vendeve të G7, mbajtur në Paris në vitin 1989, me iniciativën e këtyre shteteve u vendos krijimi i *Organizatës Ndërkombëtare për luftën kundër larjes së parave, financimit të terrorizmit dhe zgjerimit të armëve të shkatërrimit në masë - FATF*⁹³. Taks Forca e Veprimit Financiar (**Financial Action Task Force –FATF**) është një organizatë që zhvillon politika për të luftuar pastrimin e parave dhe, në vitin 2001, qëllimi i saj u zgjerua për të vepruar edhe në fushën e financimit të terrorizmit⁹⁴.

FATF-a, në të vërtetë, është kreator i politikës, e cila punon në krijimin e vullnetit politik për reformën e legjislacionit dhe kornizës rregullative në fushën e luftës ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivelin nacional. Themelimi i kësaj organizate ndërkombëtare, u bazua më së shumti në dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër qarkullimit të paligjshëm të mjeteve narkotike dhe substancave psikotropike dhe, në realitet, ka marrë formën e një lloj policie financiare ndërkombëtare.

⁹³Më shumë në: www.fatf-gafi.org.

⁹⁴Po aty.

Që nga krijimi i saj FATF, u përpoq të punonte me shpejtësi për të ndihmuar kauzën për të cilën u krijua dhe rezultoi se vetëm një vit pas krijimit, në Prill të vitit 1990, ajo paraqiti një raport, i cili përmbante njëherësh 40 (dyzetë) rekomandime, qëllimi i të cilave ishte të ofronin një plan gjithpërfshirës të veprimit të nevojshëm në luftën kundër larjes së parave. Zgjerimi i fushës së aktivitetit të FATF në vitin 2001 përfshiu luftën kundër financimit të terrorizmit dhe për këtë FATF lëshoi edhe (8) tetë rekomandime të veçanta për çështjen e financimit të terrorizmit. Në 2003 FATF rikualifikoi standartet e saj në luftën kundër larjes së parave. Në Tetor 2004 FATF shpalli (9) nëntë rekomandime të veçanta, të cilat erdhën si standard shtesë të kontraktuara në luftën për larjen e parave dhe financimin e terrorizmit. Në shkurt të vitit 2012, FATF ka kryer revizionin fundamental të standardeve të veta të shpallura në rekomandimet e rievidentuara të FATF-s⁹⁵. Ky revizion është bërë me qëllim forcimin e garancisë globale dhe mbrojtjen e integritetit të sistemit financiar duke u ofruar qeverive instrumente të fuqishme për ndërmarrjen e masave, me të cilat organeve kompetente u mundësohet ngrirja dhe konfiskimi i përhershëm, pa prejudikuar të drejtat e personave të tretë të ndërgjegjshëm, dhe atë të: pasurisë “së larë”; të të hyrave nga larja e parave dhe të mjeteve të shfrytëzuara për kryerjen e veprave penale; të pasurisë e cila paraqet të hyrë nga aktiviteti terrorist, përkatësisht të destinuara ose të përdorura për financimin e aktiviteteve terroriste si dhe të pasurisë, vlera e të cilës i përgjigjet lartësisë së të hyrave të realizuara me larjen e parave ose të financimit të terrorizmit.

Rekomandimet e FATF dhe udhëzuesit e saj rikonsiderohen çdo vit dhe ndihmojnë vendet për të identifikuar, vlerësuar dhe kuptuar se pastrimi i parave (ML) dhe financimi i terrorizmit (TF) i rrezikon ato të jenë të ekspozuara ndaj goditjes së krimit. FATF kërkon që vendet të kuptojnë siç duhet rreziqet, në mënyrë që të jenë në gjendje të zbatojnë masat kundër pastrimit të parave dhe masat kundër financimit të terrorizmit.

⁹⁵International standards on combating money laundering and financing of terrorism & proliferation, The FATF Recommendation. Qasja në: www.fatf-gafi.org. Ky revision është e destinuar për forcimin e garancisë globale dhe të mbrojtjes së mëtejshme të integritetit të sistemit financiar duke u ofruar qeverive mjete të fuqishme për ndërmarrjen e masave kundër krimit financiar. Sipas rekomandimit 4 të FATF-s vendet duhet të miratojnë masat e tilla me të cilat organeve kompetente u mundëson ngrirjen dhe konfiskimin e përhershëm të pasurisë, pa prejudikim të drejtave të palës së tretë të ndërgjegjshme dhe atë: pasuritë “e lara”; të hyrat nga larja e parave dhe mjetet e shfrytëzuara për kryerjen e veprës penale, pasuria e cila paraqet të hyrë nga aktiviteti terroristik, përkatësisht të destinuara ose ka qenë përdor për financimin e aktiviteteve terroriste, dhe të pasurisë vlera e të cilës i përgjigjet lartësisë të hyrave të realizuara me larjen e parave ose financimin e terrorizmit.

Kjo qasje, si qasje e bazuar në rrezik, është thelbësore për zbatimin efektiv të standardeve të FATF⁹⁶ - këshillon FATF dhe zbatohet gjithashtu edhe për institucionet financiare, bizneset dhe profesione financiare jo të përcaktuara.

FATF deklaron se shumë vende kanë zgjedhur të publikojnë informacion në lidhje me rreziqet ML / TF në sistemin e tyre financiar në formën e vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Publikimi i një vlerësimi të tillë të rrezikut nuk është një kërkesë e detyrueshme e Standardeve të FATF- pohon FATF⁹⁷, megjithatë, ndarja e këtij informacioni do të ndihmojë në rritjen e kuptueshmërisë globale të rrezikut të ML / TF dhe mund të ndihmojë vendet të identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë se ku ndodhen dobësitë e tyre.

Një nga rekomandimet e FATF është edhe konfiskimi i pasurisë pa aktgjykim penal (*NCB confiscation*) dhe krijimi i kornizës juridike për aplikimin e masave efikase që mundësojnë hulumtimin, identifikimin, ngrirjen, konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin e përhershëm të të hyrave, përkatësisht të pasurisë.

FATF rekomandon gjithashtu që vendet duhet të sigurojnë, në mënyrë konstruktive dhe efikase, pa vonesa të pajustificuara, gamën më të gjerë të bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me pastrimin e parave, veprave penale të origjinës dhe financimin e terrorizmit. Vendet mund ta bëjnë këtë qoftë në mënyrë spontane qoftë me kërkesë, por bashkëpunimi duhet të jetë i bazuar përherë në ligj.

Vendet duhet të autorizojnë autoritetet e tyre kompetente për të përdorur mjetet më efikase për të bashkëpunuar. Nëse një autoriteti kompetent i nevojitet marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe ose marrëveshje të tilla si një Memorandum Mirëkuptimi, ato duhen negociuar dhe nënshkruar në mënyrën e duhur dhe me një numër të shumtë të homologëve të huaj.

Autoritetet kompetente duhet të përdorin kanale të qarta apo mekanizma për transmetimin efektiv dhe zbatimin e kërkesave për informacion ose llojet e tjera të ndihmës. Autoritetet kompetente duhet të kenë procese të qarta dhe efikase për vendosjen e prioriteteve dhe ekzekutimin në kohë të kërkesave, si dhe për ruajtjen e informacionit të marrë⁹⁸.

⁹⁶<http://www.fatf-gafi.org/publications/methodsandtrends/documents/ml-tf-risks.html>

⁹⁷ Po aty

⁹⁸ Po aty

4.2. Komiteti i ekspertëve të Këshillit të Europës për evolucionin e masave në luftën kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit – MONEYVAL

Kjo Organizatë është themeluar në vitin 1997 dhe ajo grumbullon ekspertët të cilët, në shtetet anëtare, vlerësojnë harmonizimin me të gjitha standardet ndërkombëtare në funksion të luftës kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit në fushën e praktikës juridike, të sistemit financiar dhe të punëve të brendshme, nëpërmjet procesit të evolucionit reciprok të anëtarëve të barabartë. Qëllimi i kësaj organizate është që të gjitha shtetet anëtare të kenë sisteme të efektshme në luftën kundër larjes së parave dhe financimit të terrorizmit dhe, këto sisteme, të jenë të harmonizuara me standardet relevante në atë fushë. Në aktivitetin e saj MONEYVAL -i nxit fuqishëm vendet anëtare në zbatimin e parimeve dhe rekomandimeve të FATF, në veçanti në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën kundër shpërlarjes së parave, financimit të terrorizmit dhe mbrojtjes së sistemeve fiskale. Në veçanti, MONEYVAL vlerëson se anëtarët e saj ju përmbahen standardeve të bazuara në një platformë, bazën e të cilës e përbëjnë rekomandimet e FATF, Konventa e Vjenës si dhe direktivat përkatëse të Unionit Europian për luftimin e përdorimit të sistemit financiar për larjen e parave - Konventa e Strasburgut.

4.3. Grupi i shteteve për luftën kundër korrupsionit (GRECO)

Këshilli i Europës ka zhvilluar një mori instrumentesh juridike, të cilat merren me kriminalitetin, korrupsionin në sektorin publik dhe privat, përgjegjësinë dhe kompensimin e dëmit të shkaktuar me korrupsion, mbajtja e nëpunësve publik dhe financimi i partive politike etj. Këto instrumente janë të orientuara në përmirësimin e kapaciteteve të shtetit për luftën kundër korrupsionit në nivelin vendor dhe ndërkombëtar. Përcjellja e respektimit të atyre standardeve i është besuar *Grupit të shteteve për luftën kundër korrupsionit, GRECO*⁹⁹. Një nga segmentet e punës të këtij grupi punues ka të bëjë edhe me konfiskimin, përkatësisht me konfiskimin e përhershëm të të hyrave të fituara me kryerjen e veprave penale, kryerjen e evoluimit të sistemeve të shteteve dhe nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve për realizimin dhe avancimin e kornizës juridike me këtë fushë. GRECO ka 49 anëtarë të përhershëm, 48 prej të cilëve janë shtete europiane dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shqipëria, Kroacia dhe Serbia janë pjesë e anëtarëve të përhershëm në GRECO, i cili ka gjithashtu edhe anëtarë vëzhgues.

⁹⁹ Më tepër për këtë: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/default_en.asp

4.4. Rrjeti integrativ ndërkombëtar për kthimin e mjeteve – CARIN¹⁰⁰

Krijimi zyrtar i CARIN u zhvillua gjatë Kongresit të krijimit të CARIN në Hagë, 22-23 Shtator 2004. Kjo organizatë është rrjet joformal që i është dedikuar analizës dhe përmirësimit të bashkëpunimit në të gjitha aspektet e zgjidhjes së të hyrave të përfituara nga kriminaliteti. Konkretisht, CARIN ka për qëllim rritjen e efikasitetit të përpjekjeve të vendeve anëtare në identifikimin dhe kapjen e kryerësve të veprave penale si dhe konfiskimin e dobisë pasurore të tyre të përfituar në mënyrë të kundërligjshme, nëpërmjet bashkëpunimit ndër institucional dhe shkëmbimit të informacioneve. Ky rrjet joformal paraqet një nga “instrumentet” kryesore të agjencive për zbatimin e ligjit në përcaktimin e mjeteve financiare të grupeve të organizuara kriminale. Në këtë kuadër janë duke u bërë përpjekje për të vendosur rrjetin e kontakteve mes shteteve anëtare, të përcakohet synimi në konfiskimin e të hyrave nga të gjitha veprat penale si dhe të promovohet shkëmbimi i informacioneve dhe praktikës më të mirë.

CARIN aktualisht ka 54 anëtarë të regjistruar, përfshirë 28 shtete anëtare të BE-së dhe 9 (nëntë) organizata ndërkombëtare. Ajo është e lidhur gjithashtu me pesë rrjete të tjera rajonale të rimëkëmbjes së aseteve ndërmjet agjencive (CARIN-s) në të gjithë globin¹⁰¹.

4.5. Rrjeti i njësive financiaro informuese – EGMONT GROUP¹⁰²

Duke dalluar përparësitë e veçanta për zhvillimin e rrjetit të njësive financiaro informative (FOJ) të vitit 1995, FOJ-i është takuar *Egmont Arenberg Palace* në Bruksel dhe ka vendosur që të themelojë grupin joformal për përparimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, i njohur si *Rrjeti i njësive financiaro informuese –EGMONT GROUP*, i njësive financiaro informative (FOJ). FOJ takohen rregullisht dhe zbulojnë mënyra të bashkëpunimit, në veçanti në fushën e shkëmbimit të informacioneve, trajnimit dhe shkëmbimit të njohurive. Qëllimi i *EGMONT GROUP-it* është ofrimi i mundësisë për FOJ-in anëmbanë botës për përmirësimin e bashkëpunimit në luftën kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit si dhe nxitja e implemtimit të programeve vendore në këtë fushë. Kjo

¹⁰⁰Camdem Assets Recovery Inter-Agency Network. Emërtimin e ka fituar sipas emërimit të lokacionit (Camden Court Hotel Dublin) në kryeqytetin e Irlandës ku në tetor të vitit 2002 është mbajtur konferenca dhe është inicuar inisiativa për themelimin e CARIN. Më tepër për themelimin, anëtarësinë, qëllimet dhe punën të shihet në publikimin:

The History, Statement of Intent, Membership and Functioning of CARIN, European Police Office, Hague, 2012, e marr nga: <https://www.europol.europa.eu/sites/default/files/publications/carin-manual.pdf>. Data 09.05.2013.

¹⁰¹ <http://carin-network.org/>

¹⁰² Më tepër për shih: <http://www.egmontgroup.org>

mbështetje përfshin: zgjerimin dhe sistematizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në shkëmbimin reciprok të informacioneve; sigurimin e efikasitetit të nëpunësve të FOJ-it; nxitjen më të mirë dhe të sigurtë të komunikimeve mes FOJ-it nëpërmjet zbatimit të teknologjive specifike, nxitjen e koordinimit të ngritur mes pjesëve operative të FOJ-it si dhe promovimi i autonomisë operative të FOJ-it.

Në planin ndërkombëtar synohet bashkëpunimi mes shteteve në luftën kundër korrupsionit dhe formave të kriminalitetit të rëndë, duke vendosur theksin në konfiskimin e pasurisë dhe të hyrave që e kanë prejardhjen nga veprat penale. *EGMONT GROUP* shprehet i bindur se sulmi në pasurinë e kriminelëve bëhet mjeti më efikas për luftimin e grupeve kriminale dhe, nëpërmjet privimit nga pasuria e krijuar në mënyrë të kundërligjshme, shkatërrohet struktura e tyre ekonomike. Në këtë mënyrë veprimtaria kriminale privon kriminelët nga burimi i rëndësishëm i financimit, që është njëherësh edhe burimi i forcës së tyre. Përveç formave “klasike” të konfiskimit të pasurisë së krijuar me veprë penale siç është: konfiskimi i sendeve që janë përdorur ose kanë qenë të destinuara për kryerjen e veprës penale ose janë krijuar me kryerjen e veprës penale dhe të konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me kryerjen e veprës penale, *EGMONT GROUP* promovon edhe “mekanizma” të rinjë me të cilët arrihet efikasiteti në luftën kundër kriminalitetit. Pa marrë parasysh se aktet e caktuara juridike ose organizatat relevante merren vetëm me problematikën e tregëtisë së mjeteve narkotike, terrorizmin, trafikimin e qenieve njerëzore, korrupsionin, kriminalitetin e organizuar etj., e përbashkëta e tyre është se theksojnë konfiskimin e pasurisë, përkatësisht të të hyrave me prejardhje nga veprat penale, si një nga mënyrat e domosdoshme dhe efikase në luftën kundër kriminalitetit.

KAPITULLI V

PARAQITJA KRAHASIMORE E DISA SISTEMEVE TË KONFISKIMIT TË DOBISË PASURORE TË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE NËPËR BOTË

5.1. Nevoja e respektimit të parimeve themelore të drejtësisë në procesin e konfiskimit të dobisë pasurore

Konfiskimi i pasurisë me prejardhje nga vepra penale ka në themel parimin se askush nuk duhet të ketë fitim nga kriminaliteti, por qëllimi i konfiskimit nuk është vetëm preventiv dhe dënues, por zbaton njëherësh parimet themelore të drejtësisë për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kështu, Ben Ruddell, një avokat në Ilinoes, SHBA, shprehet se: "Nëse do të ndëshkojmë njerëzit për përfshirje të supozuar në një krim, duhet të jemi shumë të sigurtë se ka pasur një krim dhe ata janë të lidhur me të"¹⁰³. Realiteti flet se në fushën e sekuestrimit dhe të konfiskimit një sërë faktesh dhe rrethanash kundërshtojnë njëri tjetrin. Teksa nevoja për të luftuar kriminalitetin kërkon të punohet për pengimin e rihyrjes në treg të parave të ardhura nga veprimet kriminale, nevoja për respektimin e të drejtave themelore dhe gjykimin e drejtë potencon një hetim dhe vendimmarrje të kujdesshme për të mos krijuar kosto shtesë të paargumentuara dhe impakte sociale të panevojshme.

Në vitin 2010 Kara Bland, nga distrikti i Kolumbisë - SHBA, kishte ende targa të përkohshme në makinën e saj, kur policia e kapi për një krim që ajo nuk e kishte kryer. Ajo ia kishte dhënë hua babait të vajzës së saj makinën, në të cilin ai mori edhe një person që kishte marihuanë. Krahas hetimit, ajo u përball edhe me sekuestron e makinës së saj, çka e detyroi që për gjashtë javë, Bland të marrë vajzën e saj 6-vjeçare nga shkolla me një autobus në qytetin e Çikagos. Të afërmit e ndihmuan atë të administronte detyrat e saj si nënë para se një gjyqtar t'ia lëshonte makinën. U desh një total prej nëntë muajsh për të rifituar zyrtarisht pronësinë dhe kjo i kushtoi asaj edhe një tarifë prej 1'000 \$. "Ata qëllimisht përpiqen ta bëjnë këtë proces të vështirë dhe konfuz në mënyrë që njerëzit të marrin fund", - tha ajo në fund të procesit¹⁰⁴.

Kjo do të thotë se Bland, ishte viktimë e një praktike kontestuese që lejon zbatimin e ligjit për të kapur automjete, para të gatshme dhe prona të tjera që mendohet se janë të lidhura

¹⁰³<http://chicago.suntimes.com/news/illinois-property-confiscation-laws/>, qasur me datë 11.05.2015.

¹⁰⁴<http://chicago.suntimes.com/news/illinois-property-confiscation-laws/>

me një krim, por rasti Bland, si i shumë të tjerëve, konfirmon se përtej ligjit, gjendja e të pafajshmëve në procese të tilla prodhon kosto të panevojshme dhe rraskapitëse për njerëzit e zakonshëm.

Gjendja e të pafajshmëve, prona e të cilëve është konfiskuar ka ushqyer një stuhi të ndryshimeve ligjore në të gjithë Distriktin e Kolumbisë, të cilat kërkojnë të kufizojnë kompetencat policore. Që nga viti 2014, 19 shtete në amerikë, kanë ndryshuar disa aspekte të ligjeve të tyre të konfiskimit. Dymbëdhjetë shtete tani kërkojnë një dënim penal për të konfiskuar zyrtarisht pasuritë në shumicën apo në të gjitha rastet dhe nëntë të tjerë, duke përfshirë Illinois, po konsiderojnë miratimin e standardeve të tilla¹⁰⁵.

Europa është po kaq e kujdesshme në procese të tilla sekuestrimi dhe konfiskimi, dhe dokumente të ndryshme deklarojnë nevojën e respektimit të Deklaratës Universale për të Drejtat Njeriut (1948) dhe dispozitat e Kartës Europiane për të Drejtat Njerëzore (1950).

Këtu shihet se çështja e konfiskimit të pasurisë duhet trajtuar me shumë kujdes pasi që e drejta në pronë është e garantuar me Konventat ndërkombëtare dhe me kushtetutat e të gjitha shteteve të botës. Në veçanti duhet kushtuar kujdes dhe vëmendje çështjes së konfiskimit të pasurisë pa vendim gjyqësor që vërteton kryerje të ndonjë vepre penale.

5.2. Qëllimi dhe rëndësia e konfiskimit të dobisë pasurore

Respektimi i parimeve themelore të drejtësisë në një proces të konfiskimit të dobisë pasurore nuk e ul aspak vlerën e procesit të konfiskimit, i cili bazohet në parimin tjetër të drejtësisë se askush nuk duhet të ketë fitim nga kriminaliteti. Për këtë qëllim dhe për të bërë të mundur konfiskimin e pasurive të fituara nga vepra penale, hetimet duhet të fokusohen në pasurinë që pretendohet se rrjedh nga vepra penale, qoftë kjo vepër korruptive, krim i organizuar, larje parash apo lloje të tjera të kriminalitetit. Qëllimi i këtij fokusi hetimi është identifikimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së përfituar nga vepra penale, si një pjesë e rëndësishme e strategjisë në luftën kundër kriminalitetit.

Siç e kemi parë deri tani koncepti i konfiskimit të pasurisë, si rrjedhojë e lidhjes së tij me veprimtari të ndryshme kriminale, nuk është një koncept i ri. Atë e gjejmë në qytetërimet e hershme si një nevojë e qartë e individëve për t'u hakmarrë. Që nga viti 1970, kur dispozitat e para ligjore të konfiskimit penal në historinë e SHBA-së u miratuan në Kongres, është forcuar gjithnjë e më tepër bindja, se për t'i bërë ballë sfidës që paraqesin

¹⁰⁵Po aty

ndaj shtetit grupet kriminale, duhet të çrrënjohet struktura organizative e tyre¹⁰⁶. Mjeti më efektiv për këtë është, nga njëra anë ndërprerja e mundësive për të pastruar paratë e krimit dhe moslejimi i futjes së tyre në treg si para e “ligjshme” dhe nga ana tjetër, moslejimi i mundësive për rifinancimin e veprimtarive kriminale. Në vitin 1984 Shtetet e Bashkuara të Amerikës miratuan Ligjin e Përgjithshëm mbi Kontrollin e Krimeve, ku u forcuan dispozitat ligjore të konfiskimit, “...si një mjet i agjencive të zbatimit të ligjit në luftën kundër dy krimeve më të rënda që ballafaqohet vendi, krimit të organizuar dhe trafikut të drogës”¹⁰⁷.

Çdo ditë e më tepër dispozitat ligjore që rregullojnë fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit përmirësohen duke synuar të jenë të zbatueshme dhe të harmonizuara me ligjet e tjera që rregullojnë jetesën në shtetin e së drejtës. Barry Vitou, partner dhe kreu i krimit global të korporatave në Mazonet Pinsent, thotë se reformat në këtë fushë janë gjithmonë të mirëpritura. Por, shprehet ai më tej, "Mendoj se ligji duhet të qartësohet dhe forcohet. Është e sigurt të thuhet se regjimi ligjor duhet të thjeshtësohet dhe të bëhet më i fuqishëm”¹⁰⁸.

Instituti juridik i konfiskimit ka efekte të shumta mes të cilave evidentojmë efektin preventiv, sepse përfitimi ekonomik është shkak i shumicës së veprave penale; pengimi i infiltrimit të të hyrave të paligjshme në ekonominë legale; eliminimi i instrumenteve për kryerjen e veprave të reja penale në të ardhmen, fokusi në drejtimin e organizatave kriminale; mbështetja e sundimit të së drejtës/ligjit dhe zbatimi i parimit moral se askush nuk duhet të ketë dobi nga krimi”¹⁰⁹.

“Një nga motivet kryesore të kriminalitetit të rëndë dhe të organizuar është fitimi i dobisë financiare. Grupet e organizuara kriminale e investojnë dobinë e paligjshme në aktivitete të paligjshme ose shfrytëzojnë larjen e parave për legalizimin e tij dhe infiltrimin, me qëllim fitimin e ndikimit ekonomik në shoqëri. Konfiskimi i pasurisë me prejardhje nga vepra penale po identifikohet gjithnjë e më shumë si mjet efikas në luftën kundër kriminalitetit të

¹⁰⁶ Mecalla, Naim, “Aspekte juridike dhe kriminologjike të pastrimit të parave”, Punim doktore, Tiranë, 2017, f.3. Qasur në: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/06/DISERTACIONI-Naim-Mecalla-Aspekte-juridiko-penale-dhe-kriminologjike-te-pastrimit-te-parave.pdf>.

¹⁰⁷ Ligji i Përgjithshëm mbi Kontrollin e Krimeve i vitit 1984. Bot. L.98- 473. 98 Stat. 1837. Ribotuar në 1984 Kodi Penal i ShBA. Cong.And. New 3182 – 3374 (1985).

¹⁰⁸ e qasshme në: <https://www.ft.com/content/0f3c4ba4-54b0-11e6-9664-e0bdc13c3bef>

¹⁰⁹ Golobinek, Robert 2006 Financial Investigations and Confiscation od Proceeds from Crime, *Council of Europe*, fq. 9., Burimi- faqja e internetit e Këshillit të Europës: www.coe.int/

organizuar, sepse një anëtar i burgosur ose dhe vetë udhëheqësi i organizatës kriminale nuk i ndalon aktivitetet kriminale, pasi ata mund të zëvendësohen thjesht me një tjetër”¹¹⁰.

“Teoria juridike e definon në mënyra të ndryshme konfiskimin e dobisë së dalë nga vepra penale, si masë sigurie, si masë të veçantë ose si masë të sanksioneve penalo-juridike. Mirëpo, sot, zakonisht konsiderohet se bëhet fjalë për institut të përzier penalo-civil *siu generis*, qëllimi i të cilit është vendosja e gjendjeve të rrënuara me kryerjen e veprës penale dhe ndalimi i pasurimit të paligjshëm nga veprimtaritë kriminale”¹¹¹.

Globalizimi i kriminalitetit të organizuar paraqet kërcënim për shoqëritë anembanë botës. Është kjo arsyeja që bashkësia ndërkombëtare kujdesin e saj e ka orientuar në çështjen e konfiksimit të pasurisë së dalë nga vepra penale dhe, nëpërmjet instrumenteve të ndryshme ligjore, ka vendosur standarde minimale për punën efikase dhe bashkëpunimin në këtë fushë”¹¹². Më poshtë do të sjellim vetëm disa prej tyre, ato të konsideruara më të rëndësishmet.

Dispozitat e Kombeve të Bashkuara:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër trafikimit të paligjshëm të mjeteve narkotike dhe sendeve psikotrope (1988);
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar transnacional dhe protokollet e saj (2000);
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit (2004);
- Dispozitat e Këshillit të Europës për larjen, zbulimin, konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin e dobisë së fituar me veprime kriminale (1990);
- Konventa e Këshillit të Europës për larjen e parave, zbulimin, konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin e dobisë së fituar me veprime kriminale dhe financimi i terrorizmit (2005).

Dispozitat e Bashkimit Europian:

- Vendimi Kornizues për përmbarimin e urdhërit për ngrirjen e pasurisë ose të provave në Bashkësinë Europiane;
- Vendimi Kornizues për zbatimin e parimeve të pranimit reciprok të urdhërave për konfiskimin (2005).

¹¹⁰Po aty.

¹¹¹ Derenčinović, Davor, (1999). Pravna priroda instituta oduzimanja imovinske koristi i njegovo značenje u prevenciji organiziranog kriminala. *Policija i sigurnost*, 8(3-4), str. 169.

¹¹²Golobinek, Robert 2006, Financial Investigations and Confiscation of Proceeds from Crime, *Council of Europe*, fq. 7.

Në përgjithësi, në zbatimin e masave të konfiskimit të dobisë pasurore të dalë nga vepra penale shpesh kombinohen elemente të së drejtës penale, të së drejtës procedurale penale ose të së drejtës civile dhe administrative, me të cilat krijohen mundësi mjaft të mira për luftimin e formave të ndryshme të korrupsionit, si një element i rëndësishëm që mban në këmbë veprimtaritë kriminale. Kjo materie në parim, rregullohet me normat e legjislacionit penal dhe në shumicën e shteteve, ky institut zbatohet gjatë zhvillimit të procedurës penale. Prandaj themi, se themel i konfiskimit të dobisë pasurore është çdo vendim gjyqësor me të cilin përcaktohet se është kryer vepra penale. Në anën tjetër, ekzistojnë edhe legjislacione të tjera, brenda të cilave mund të zhvillohet procedura civilo-juridike me të cilën përcaktohet ekzistenca e paligjshme e dobisë së fituar pasurore, por nën kushtin që në lëndën e njëjtë, në mënyrë paralele, të ecë edhe procedura penale mbi të cilën nxirret vendimi përfundimtar për konfiskimin. Në pikëpamje të zgjidhjeve të tilla legjislative është paraqitur edhe nevoja për instrumente plotësuese hulumtuese, qëllimi i të cilave ishte përcaktimi i vërtetë i rrethanave të tilla. Kështu, është lajmëruar edhe nocioni i hetimit financiar, i cili zhvillohet njëkohësisht me hetimin në procedurën penale dhe ka për qëllim, grumbullimin e të gjitha të dhënave relevante financiare, të të dhënave të tjera të ndërlydhura dhe informacioneve, që bëjnë me dije natyrën dhe prejardhjen e pasurisë për të cilën dyshohet se është përfituar në mënyrë të paligjshme. Në të vërtetë, me këtë nocion nënkuptohet grumbullimi, kontrolli, kompletimi, përpunimi dhe analiza e të dhënave financiare dhe/apo të ndërlydhura me qëllim aplikimin e ligjit¹¹³. Zbatimi i hetimit financiar është imperativ tek veprat e ndërlydhura penale të kriminalitetit ekonomik, të veprave penale korruptive dhe krimit të organizuar. Në të vërtetë, pa zbatimin e hetimit financiar, në ato procedura nuk ka mundësi të vërtetohet dobia e fituar pasurore dhe kështu, nuk ka mundësi të kryhet as konfiskimi efektiv i pasurive të përftuara nga veprat penale¹¹⁴. Është evidente se zhvillimi ekonomik global ndikohet nga veprat kriminale të çdo lloji. Kështu, sipas indeksit global të terrorizmit konstatohet se ndikimi i ekonomisë botërore nga terrorizmi arriti në 98.6 miliardë dollarë në vitin 2015 dhe ky ndikim është rreth njëmbëdhjetëfishi i 15 viteve të fundit¹¹⁵.

Në këto kushte, hetimi financiar merr një rol të rëndësishëm në hetimin e përgjithshëm të veprimeve kriminale dhe duhet pranuar se, në esencë, zgjidhje të tilla ligjore u mundësojnë

¹¹³Van Duyne, C. P., Pheijffer, M., Kuijl, G. H., Van Dijk, A. & Bakker, J.C.M. G. (2001). *Financial investigation of crime (A tool of the integral law enforcement approach)*, The Hague: Koninklijke Vermande

¹¹⁴Novosel, Dragan, (2007). Financijske istrage i prognoza pocinitelja gospodarskog kriminaliteta. *Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu*, 14(2), str. 782. <https://www.pravo.unizg.hr/hljkkp>

¹¹⁵ Global-terrorisim-Index-2016

organeve gjyqësore të konfiskojnë pasurinë për të cilën dyshohet se është me prejardhje nga aktiviteti kriminal. Konfiskimi i pasurisë urdhërohet edhe pse nuk ekziston aktgjykimi penal i nxjerrë më herët, ose dëshmia për aktivitetin kriminal në raport me personin, pasuria e të cilit konfiskohet si e fituar në mënyrë të paligjshme. Në anën tjetër, në procedura të tilla, ligji ka zhvendosur barrën e provës nga organi i akuzës tek individi që është mbajtës i pronës së kontestuar, duke e detyruar këtë të fundit që, nëse do të mbajë pronën e kontestuar, sipas principit të mundësive të balancimit (*pasi objektivisht duhen marrë parasysh të hyrat e tij për të parë nëse mund të arrijë në posedimin e asaj pasurie*), duhet të dëshmoj prejardhjen e saj të ligjshme”¹¹⁶.

Masën e konfiskimit të dobisë pasurore e shfrytëzon kategoria e të drejtës penale dhe, për konfiskimin e saj, vendoset në procedurën penale. Në anën tjetër, për vetë konfiskimin e dobisë pasurore (*pas nxjerrjes së vendimit për konfiskim në procedurën penale*) janë relevante dispozitat e të drejtës përmbartimore¹¹⁷.

Prandaj, në këtë kuptim, kemi të bëjmë me konfiskimin e dobisë pasurore të përfiturar në mënyrë të paligjshme, të cilën duhet ta përmbajnë dispozitat relevante dhe kapacitetet institucionale që mundësojnë zbulimin (*identifikimin*) efikas, konfiskimin e përkohshëm, administrimin dhe, në fund, konfiskimin e përhershëm, me garancinë e plotë të mbrojtjes së të drejtave njerëzore dhe të lirive themelore (*në veçanti të drejtave në pasuri dhe në gjykim të drejtë*).

Në veçanti është me rëndësi çështja e administrimit të pasurisë së dalë nga kryerja e veprës penale dhe që konfiskohet, me qëllim ruajtjen e vlerës së asaj pasurie, si në rastin e konfiskimit të përkohshëm (sekuestrimit) ashtu dhe në rastin e konfiskimit të përhershëm. Për këtë arsye, shtetet kanë vendosur *parimin e administrimit të nikoqirit të mirë* (*Kroacia, Sllovenia*) dhe, në dispozitat e tyre, kanë parashikuar mundësinë që pasuria e konfiskuar të shfrytëzohet në funksion të interesave publike.

Kur flitet për konfiskimin e pasurisë së përfiturar nga vepra penale, duhet theksuar ekzistenca e institutit të të provuarit të barrës së kundërt, përkatësisht kalimin e barrës së provës tek personi i akuzuar. Ky institut gjendet në legjislacionin e disa shteteve si p.sh Italia, Britania e Madhe, Irlanda, Polonia, Latvia, Greqia, Belgjika, Danimarka, Austria

¹¹⁶Alldrige, Peter, (2003). *Money Laundering Law- Forfeiture, Confiscation, Civil Recovery, Criminal Laundering and Taxation of the Proceeds of Crime*. Hart Publishing Oxford&Portland, Oregon, fq. 225.

¹¹⁷Derenčinović, Davor, (1999). *Pravna priroda instituta oduzimanja imovinske koristi i njegovo značenje u prevenciji organiziranog kriminala. Policija i sigurnost*, 8(3-4), str. 162.

etj., të cilat dispozitën për barrën e provës e lidhin tek i akuzuari për vepra të rënda penale si shpëlarja e parave, kontrabanda e drogës, terrorizmi, tregëtia e armëve etj.

Shtetet e Europës rezultojnë me zgjidhje të ndryshme legislative sa i takon konfiskimit të pasurisë së përfitur nga kryerja e veprës penale. Disa prej tyre si Kroacia, Sllovenia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Italia, Sllovakia, Irlanda, Anglia dhe Shqipëria do të trajtohen në këtë punim.

5.3. Kroacia

Kroacia në fund të vitit 2010 ka nxjerr aktin ligjor më kufizues lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore të paligjshme, me miratimin e Ligjit për procedurën e konfiskimit të dobisë pasurore të realizuar me vepër penale dhe me kundërvajtje¹¹⁸, me të cilin, përveç të tjerash, është parashikuar edhe administrimi i pasurisë së konfiskuar përkohësisht dhe përherë. Në të njëjtën kohë është miratuar edhe Ligji për administrimin e pasurisë shtetërore¹¹⁹, me të cilin është definuar themelimi i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë Shtetërore, kompetencat e saj, principet e punës, mënyra e drejtimit etj. Ky ligj përcakton fushën e zbatimit dhe përkufizon se me nocion pasuri shtetërore, veç të tjerave, nënkuptohet edhe pasuria të cilën Agjencia e administron në bazë të dispozitave të veçanta, që përfshijnë edhe pasurinë e konfiskuar, të fituar me vepër penale dhe me kundërvajtje. Në vazhdim, do të sjellim në vëmendje pjesët më të rëndësishme të dy ligjeve të sipërmendura, së bashku me nenin 21 të Ligjit që rregullon organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Luftës Kundër Korrupsionit dhe të Krimit të Organizuar, dispozitat e të cilave vlejnë për procedurën e konfiskimit të dobisë pasurore të realizuar me vepër penale dhe kundërvajtje.

¹¹⁸Zakon o postupku oduzimanja imovinske koristi ostvarene krivičnim djelom i prekršajem, Narodne novine br.: 145, od 24.12.2010. godine; izvor – internetska stranica Narodnih novina Republike Hrvatske: <http://narodne-novine.nn.hr/>

¹¹⁹Po aty.

5.3.1. Ligji për procedurën e konfiskimit të dobisë pasurore të realizuar me vepër penale dhe kundërvajtje i Kroacisë

Me këtë Ligj rregullohet procedura e përcaktimit, sigurimit të konfiskimit të dobisë pasurore të realizuar me vepër penale dhe përmbarimi¹²⁰ i vendimit për konfiskimin e saj, veprimet me pasurinë e konfiskuar dhe pasurinë, për shkak të së cilës është caktuar masa e përkohshme e konfiskimit, realizimi i të drejtave të personit të dëmtuar me veprën penale dhe mbrojtja e të drejtave të personit të tretë¹²¹. Sipas këtij Ligji, veprohet në bazë të propozimit të prokurorit¹²². Në qoftë se përcaktimi i lartësisë së dobisë pasurore të realizuar me vepër penale është i lidhur me vështirësi joproporcionale ose me zvarritjen evidente të procedurës, gjykata, lartësinë e asaj dobie mund ta përcaktojë sipas bindjes së lirë¹²³. Dispozitat e këtij Ligji zbatohen në mënyrë të përshtatshme (*mutadis mutandis*) edhe në procedurën e kundërvajtjes, nëse nuk është parashikuar ndryshe me këtë Ligj.

Një nga risitë e rëndësishme të këtij Ligji është fakti se lejon që procedura mund të zhvillohet para, gjatë dhe pas përfundimit të procedurës penale. Gjykata vepron sipas rregullave të procedurës penale, nëse nuk përcaktohet ndryshe nga ky Ligj¹²⁴.

Është me shumë rëndësi të theksohet se procedura nuk ndërpritet edhe në rastin e vdekjes së të pandehurit dhe në këto rrethana por dhe në rrethana tjera, pasuria e cila është përfituar me vepër penale mund të konfiskohet. Ligji shprehet saktësisht se: “Nëse për veprën penale nuk mund të zhvillohet procedura penale për shkak se i pandehuri ka vdekur ose ekzistojnë rrethanatë tjera, të cilat përjashtojnë ndjekjen penale, atëherë, gjykata, me propozimin e prokurorit shtetëror, të dëmtuarit si paditës dhe të paditësit privat, do të veprojnë sipas nenit 6 të këtij Ligji, nëse është e sigurt se dobia pasurore që është fituar me vepër penale në raport me atë që veprohet është së paku 5.000,00 kuna”¹²⁵; (rreth 1.300,00 euro në konvertim). Për zhvillimin e procedurës paraprake të theksuar me aktvendim vendos gjyqtari individual i gjykatës, i cili ka qenë kompetent për gjykimin në procedurën penale, ndërsa kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në një afat prej tre ditësh nga dita e dërgimit të aktvendimit palës së kundërt. Për ankesën vendos gjyqtari individual i gjykatës më të lartë¹²⁶. Kjo dispozitë nuk zbatohet në procedurën e kundërvajtjes¹²⁷.

¹²⁰Ovrha je zapljena dužnikove imovine kao prisilna naplata duga; pljenidba, egzekucija, Hrvatski jezični portal <http://hjp.srce.hr/>

¹²¹ LPKDPK, neni 1, paragrafi 3

¹²² Po aty, paragrafi 4

¹²³ Po aty, paragrafi 5

¹²⁴ Po aty, neni 2, paragrafi 1

¹²⁵ Po aty, paragrafi 2

¹²⁶ Po aty, paragrafi 3

Në vazhdim do të theksojmë edhe domethënien e disa nocioneve të përdorura në Ligj, të cilat janë të rëndësishme për të kuptuar më mirë Ligjin:

- *Dobia pasurore e realizuar me veprë penale*, në pajtim me këtë Ligj dhe me ligjet e tjera është çdo rritje ose pengim i zvogëlimit të pasurisë, e cila e ka prejardhjen nga vepra penale;
- *Pasuria* paraqet sendet dhe të drejtat të cilat i ka fituar autori i veprës penale dhe i kundërvajtjes ose personi i ndërlidhur me ta dhe përfshinë të gjitha sendet dhe të drejtat që mund të jenë objekt i përmbarimit dhe, në veçanti, paluajtshmëritë dhe sendet e luajtshme, kërkesat, aksionet, paratë, metalet e çmueshme në pronësi, posedim ose nën kontrollin e autorit të veprës penale apo të personit të ndërlidhur;
- *Veprë penale* është vepra e parashikuar nga Kodi Penal;
- *I pandehur* është personi fizik dhe juridik sipas përcaktimit në Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale;
- *I dëmtuari* është personi fizik dhe juridik i caktuar me Kodin e Procedurës Penale;
- *Personi i ndërlidhur* është: a) nxitësi dhe ndihmësi në veprën penale, b) pasardhësi juridik i autorit dhe i bashkëpjesëmarrësit në veprën penale, c) personi tjetër fizik dhe juridik për të cilin gjykata, në mënyrën e parashikuar nga ky Ligj, vërteton se në të janë bartur sendet ose të drejtat që paraqesin dobinë pasurore dhe, nuk është në mirëbesim lidhur me fitimin e atyre sendeve ose të drejtave;
- *Paditës* është prokurori shtetëror dhe paditësi tjetër i autorizuar, nëse me këtë Ligj nuk është caktuar ndryshe;
- *Pala e kundërt* është i pandehuri dhe personi i ndërlidhur;
- *Kundërshtar i sigurimit dhe përmbaruesi* është paditësi;
- *Propozuesi i sigurimit dhe përmbaruesi* është paditës;
- *Personi i tretë* është personi që pohon, se në pikëpamje të pasurisë që është objekt i veprimit sipas këtij Ligji, ka të drejtën e cila e pengon zbatimin e tij dhe kërkon që sigurimi ose përmbarimi të shpallen të palejueshme;
- *Zyra* është Zyra Qendrore Shtetërore për Administrimin me Pasurinë Shtetërore ose organi tjetër i caktuar me ligj për administrimin me pasurinë shtetërore¹²⁸.

¹²⁷ Po aty, paragrafi 6

¹²⁸ Po aty, neni 3

5.3.2. Veprimi i gjykatës sipas legjislacionit kroat

Dobinë pasurore të realizuar me vepër penale gjykata e përcakton me aktgjykim. Dispozitivi i aktgjykimit në pjesën që ka të bëjë me përcaktimin dhe konfiskimin e dobisë pasurore të realizuar me vepër penale duhet të jetë i arsyetuar¹²⁹, ndërsa kundër saj paditësi dhe pala e kundërt kanë të drejtë ankese, për të cilën vendos gjykata. Përveç përmbajtjes së parashikuar me ligj, në aktgjykimin me të cilin i pandehuri shpallet fajtor për veprën penale gjykata:

- Përcakton se cilat sende ose të drejta paraqesin dobinë pasurore të realizuar me vepër penale dhe kundërvlerën e tyre monetare;
- Përcakton nëse ato sende ose të drejta janë bërë pronë, përkatësisht pasuri e Republikës së Kroacisë;
- I urdhëron palës së kundërt që ti dorëzojë Republikës së Kroacisë sende të caktuara, përkatësisht që bartin të drejta të caktuara, nëse ato nuk i kanë kaluar Republikës së Kroacisë në bazë të dispozitës nga pika paraprake e këtij neni, ose të paguaj kundërvlerën e tyre monetare në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit;
- Përcakton kryerjen e regjistrimit të të drejtave në dobi të Republikës së Kroacisë në regjistrat publikë që mbajnë gjykatat dhe organet e tjera të caktuara nga ligji¹³⁰.

Pas plotëfuqishmërisë së aktvendimit me të cilin gjykata vendos të zhvilloj procedurën, ajo do të nisë shqyrtimin e çështjes në të cilën do të realizohet kontrolli i palës kundërshtare dhe do të shtjellohen provat e tjera. Nëse vërtetohet se i pandehuri ka kryer vepër penale dhe ka realizuar dobi pasurore nëpërmjet saj, gjykata do të nxjerrë aktgjykimin me të cilin:

- Përcakton se i pandehuri ka kryer vepër penale;
- Vërtetohet se me vepër penale nga pika paraprake është realizuar dobia pasurore në kuptim të rritjes ose pengimit të zvogëlimit të pasurisë, e cila e ka prejardhjen nga vepra penale dhe vendos gjithashtu, se cilat sende ose të drejta paraqesin dobi pasurore të realizuar me atë vepër dhe kundërvlerën e tyre monetare;
- Përcakton nëse ato sende ose të drejta janë bërë pronë, përkatësisht pasuri e Republikës së Kroacisë;

¹²⁹ Po aty, neni 4, paragrafi 1

¹³⁰ Po aty, neni 5, paragrafi 1.

- Urdhëron palën kundërshtare t'i dorëzojë Republikës së Kroacisë sendet e caktuara, përkatësisht ato që bartin të drejta të caktuara, të fituara në bazë të dispozitave nga pika paraprake e këtij neni, ose i urdhëron të paguajnë kundërvlerën e tyre monetare në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit;
- Përcakton që në regjistrat publik që mbajnë gjykatat ose organet e tjera, të kryhet regjistrimi i të drejtave në dobi të Republikës së Kroacisë¹³¹.
- Procedura e theksuar mbahet sipas rregullave të procedurës penale. Nëse gjykata ka vërtetuar se me vepër penale janë përfituar sende të cilat sipas ligjit duhet të konfiskohen, për konfiskimin e tyre duhet të nxirret aktvendim. Nëse nuk është parashikuar me ligj, aktvendimin e nxjerr gjykata para të cilës është zhvilluar procedura, në kohën kur është përfunduar procedura, përkatësisht ndërprerë, ndërsa kundër atij aktvendimi lejohet ankesë për të cilën vendos trupi gjykuesi i gjykatës më të lartë¹³². Në qoftë se para vërtetimit të aktakuzës ose gjatë procedurës penale është ndërprerë procedura, ndërsa ekziston probabiliteti se dobia pasurore është realizuar me vepër penale, procedura sipas këtij Ligji do të vazhdojë me propozimin e prokurorit¹³³. Nëse janë paraqitur pasoja juridike të hapjes së procedurës së likuidimit, kjo nuk ndikon në dispozitat e këtij Ligji për kompetencën.

Organet shtetërore, bankat dhe personat e tjerë fizikë dhe juridik janë të obliguar që, sipas urdhërit të gjykatës, të dërgojnë të dhëna lidhur me vërtetimin e fakteve të nevojshme për nxjerrjen e vendimeve sipas këtij Ligji, nëse me ligj nuk është parashikuar ndryshe. Së bashku me urdhërin e përmendur, gjykata cakton afatin për dërgimin e të dhënave ose të paraqitjes së raportit. Për mos ekzekutimin e urdhërit në afatin e caktuar apo zbatimin jo të plotë të urdhrit, gjykata, me aktvendim, mund të dënoj personin juridik me dënim në të holla, në shumën deri në 500.000,00 kuna (rreth 130.000,00 euro, konvertuar), ndërsa për personin fizik dhe për personin përgjegjës në personin juridik apo në organin shtetëror një dënim në shumën prej 50.000,00 kuna (rreth 13.000,00 euro, konvertuar). Nëse urdhërat nuk zbatohen, personi mund të dënohet me burg deri në plotësimin e tyre, por jo më shumë se një muaj. Ankesa kundër aktvendimit nuk e ndalon ekzekutimin e tij¹³⁴.

¹³¹ Po aty, neni 6, paragrafi 1.

¹³² Po aty, paragrafi 5.

¹³³ Po aty, neni 7.

¹³⁴ Po aty, neni 9, paragrafi 3,4 dhe 5.

5.3.3. Sigurimi i konfiskimit të dobisë pasurore

Me qëllim sigurimin e konfiskimit të dobisë pasurore të realizuar me vepër penale, propozuesi i sigurimit është i autorizuar që para dhe pas zhvillimit të procedurës penale ose të procedurës nga neni 6 i këtij Ligji, të propozojë sigurimin me cilëndo masë të përkohshme me të cilën arrihet qëllimi, e në veçanti:

- Me ndalimin e tjetërsimit dhe ngarkimit të paluajtshmërive ose të të drejtave sendore të regjistruara në paluajtshmëritë, duke shënuar ndalesat në librat e tokës, me konfiskimin e paluajtshmërisë dhe besimin e saj në ruajtje dhe administrim nga Zyra e ngritur për këtë qëllim;
- Me ndalimin e kundërshtarit të sigurimit që të tjetërsoj ose të ngarkojë sendet e luajtshme, me konfiskimin e atyre sendeve dhe besimin e tyre Zyrës për ruajtje;
- Me konfiskimin dhe deponimin e parave të gatshme, të letrave me vlerë dhe dorëzimin e tyre Zyrës;
- Duke i ndaluar debitorit të kundërshtarit të sigurimit të plotësojë vullnetarisht obligimin e vet ndaj kundërshtarit të sigurimit dhe ndalimin e kundërshtarit të sigurimit që të pranojë plotësimin e atij detyrimi, përkatësisht të disponojë me kërkesat e veta;
- Me urdhërin e bankës së kundërshtarit të sigurimit ose personit të tretë, sipas urdhërit të kundërshtarit të sigurimit, t'i heq nga llogaria pagesën e shumës në para për të cilën është caktuar masa e përkohshme;
- Me ndalimin e tjetërsimit dhe të ngarkesës së aksioneve, pjesëve të aksioneve, me shënimin e ndalimit në librat e aksioneve, e sipas nevojës, edhe në regjistrin publik, me ndalimin e shfrytëzimit ose të disponimit me të drejtat sipas bazës së aksioneve të tilla, me besimin e aksioneve ose të pjesëve të aksioneve në administrim Zyrës, me caktimin e administrimit të përkohshëm të shoqërisë;
- Duke i'a ndaluar debitorit të kundërshtarit të sigurimit t'ia dorëzojë sendet, të bartë të drejtën ose të kryejë veprime të tjera jomonetare kundërshtarit të sigurimit¹³⁵.

Lidhur me propozimin për sigurim vendos gjykata, e cila zhvillon procedurën penale. Aktvendimi duhet të përmbajë kohën për të cilën është caktuar masa e përkohshme¹³⁶. Në këtë procedurë supozohet se ekziston rreziku që kërkesat e Republikës së Kroacisë lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore të realizuar me vepër penale nuk do të mund të realizohen ose, se realizimi i tyre do të vështirësohej nëse masa e përkohshme nuk

¹³⁵ Po aty, neni 11, paragrafi 1.

¹³⁶ Po aty, paragrafi 2.

përcaktohet. Sigurimi mund të caktohet edhe para se kundërshtarit të sigurimit t'i jetë mundësuar që të deklarohet për propozimin e propozuesit të sigurimit¹³⁷. Nëse masa e përkohshme duhet regjistruar në regjistrin publik (librat e tokës, regjistrin e anijeve, regjistrin e ushtarakëve, regjistrin e sigurimeve gjyqësore dhe të noterëve publik etj.), vendimi i gjykatës do të përmbajë edhe urdhërin për regjistrim të masës së përkohshme në regjistrin publik. Propozues i sigurimit është pala në procedurën e regjistrimit të masës së përkohshme në regjistrin publik. Në këtë procedurë nuk paguhet taksa¹³⁸. Puna juridike me të cilën kundërshtari i sigurimit pas regjistrimit të masës së përkohshme në regjistrin publik disponon me sendet ose të drejtën që është objekt i sigurimit, nuk ka efekt juridik¹³⁹.

Nëse propozimi për sigurim me cilëndo masë është paraqitur para zhvillimit të procedurës, sigurimi me masën e përkohshme do të abrogohet nëse në një afat prej dy vitesh nga dita kur ajo masë është caktuar nuk vërtetohet akuza, shqyrtimi i caktuar në bazë të padisë private ose propozimi i paraqitur nga neni 2 paragrafi 2 i këtij Ligji¹⁴⁰, më saktësisht, nëse i pandehuri ka vdekur ose ekzistojnë rrethana të tjera. Masa e përkohshme mund të anulohet ose të zëvendësohet me një tjetër para skadimit të kohës së përmendur nëse gjykata, me propozimin e kundërshtarit të sigurimit, vërteton se ajo nuk është e nevojshme apo, se sigurimi mund të arrihet edhe me ndonjë masë tjetër të përkohshme dhe, nëse kundërshtari i sigurimit ose personi i tretë, deponojnë garanci. Dorëzania jepet gjithmonë në para të gatshme, e përjashtimisht në sende dhe të drejta të cilat, sipas vlerësimit të gjykatës, në një afat të shkurtër mund të shndërrohen në të holla¹⁴¹. Nëse masa e përkohshme është caktuar në një kohë e cila është më e shkurtër se afati dy vjeçar nga dita kur ajo masë është caktuar, ose më e shkurtër se afati prej gjashtëdhjetë ditësh pasi gjykata i dërgon propozuesit të sigurimit njoftimin se aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm, propozuesi i sigurimit mund të propozojë që kohëzgjatja e masës së përkohshme të shtyhet. Në procedurën e anulimit, zgjatjes, zëvendësimit ose përcaktimit të masës së përkohshme plotësuese, përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e nenit 11 për sigurimin e konfiskimit të dobisë pasurore, të parashikuara me dispozitat e këtij Ligji¹⁴².

¹³⁷ Po aty, neni 12.

¹³⁸ Po aty, neni 13.

¹³⁹ Po aty, neni 14.

¹⁴⁰ Po aty, neni 15, paragrafi 1.

¹⁴¹ Po aty, paragrafi 2.

¹⁴² Po aty, neni 15, paragrafi 3 dhe 4.

5.3.4. Mbrojtja e drejtave të personit të tretë

Personi i tretë ka të drejtë të paraqesë kundërshtim deri në nxjerrjen e aktvendimit për përmbardim dhe të kërkojë që masa e përkohshme të anulohet. Lidhur me kundërshtimin vendos gjykata që ka nxjerrë aktvendimin për sigurim me masën e përkohshme. Kundër atij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej tre ditësh nga dita e dërgimit të tij, por kjo nuk e pengon zbatimin e sigurimit që caktohet sipas këtij ligji. Për ankesën vendos gjyqtari individual i gjykatës më të lartë. Nëse personi i tretë, të drejtën e vet e dëshmon, ankesa e shtyn zbatimin e aktvendimit për sigurinë me masën e përkohshme¹⁴³.

5.3.5. Përmbardimi

Nëse me këtë Ligj nuk është parashikuar ndryshe, përmbardimi¹⁴⁴ caktohet dhe zbatohet sipas ligjit të veçantë, me qëllim konfiskimin e dobisë pasurore të realizuar me vepër penale, sipas propozimit të prokurorit.

Për nxjerrjen e aktvendimit për caktimin e përmbardimit në bazë të aktgjykimit me të cilën konfiskohet dobia pasurore e realizuar me vepër penale dhe me kundërvajtje dhe për nxjerrjen e aktvendimeve tjera kompetente është ekskluzivisht gjykata komunale, e cila ka kompetencë territoriale në selinë e gjykatës që ka nxjerrë aktgjykimin nga neni 5 parag.1 dhe neni 6 parag.1 i këtij Ligji. Për zbatimin e përmbardimit të përmendur kompetente është gjykata ose organi i caktuar me ligj të veçantë¹⁴⁵.

5.3.6. Veprimi me pasurinë e konfiskuar përkohësisht dhe me pasurinë e konfiskuar

Mjetet monetare përkohësisht të konfiskuara, sendet e dorëzuara dhe të drejtat e bartura i administron Zyra, e cila është e obliguar që të mbajë evidencë për mjetet e theksuara, për sendet dhe të drejtat. Ministri kompetent për drejtësinë, me pëlqimin paraprak të Ministrisë të Financave, nxjerr rregullore për mbajtjen e asaj evidence¹⁴⁶. Zyra mund, pa shpalljen paraprake të ankandit publik, të nxjerrë vendim për shitjen e sendeve të luajtshme të konfiskuara përkohësisht, nëse ruatja e tyre është e rrezikshme ose nëse i paraprin rreziku i drejtpërdrejtë i shkatërrimit të tyre ose i humbjes së dukshme të vlerës së tyre¹⁴⁷. Zyra

¹⁴³ Po aty, neni 18.

¹⁴⁴ Ovrha je zapljena dužnikove imovine kao prisilna naplata duga; pljenidba, egzekucija, Hrvatski jezični portal <http://hjp.srce.hr/>

¹⁴⁵ LPKDPK, neni 19, paragrafi 1, 2 dhe 3.

¹⁴⁶ Po aty, neni 20.

¹⁴⁷ Po aty, neni 21, paragrafi 1.

gjithashtu, mund të nxjerrë vendim që sendet përkohësisht të konfiskuarat t'i jap me qira ose t'i huazojë në pajtim me destinimin e tyre.

Për dëmin në sende, shkaktuar nga dhënia me qira ose me hua përgjigjet Republika e Kroacisë sipas rregullave të përgjithshme për përgjegjësinë për dëmin¹⁴⁸.

Zyra është e detyruar që kundërshtarit të sigurimit t'i dorëzojë mjetet nga shitja, huaja ose qiraja, në një afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit me të cilin kërkesa e prokurorit është refuzuar¹⁴⁹. Kundër vendimit të Zyrës pala e kundërt mund të ushtrojë kundërshtimin brenda afatit 48 ditor nga dërgimi i tij. Për kundërshtimin vendos gjykata që zhvillon procedurën penale dhe gjykatësi individual, i cili ka qenë kompetent për zhvillimin e procedurës penale. Ankesa kundër vendimit të gjykatës nuk lejohet¹⁵⁰.

Pasuria e konfiskuar në bazë të Ligjit administrohet dhe disponohet nga Zyra në pajtim me dispozitatë të posaçme. Paraja e konfiskuar sipas dispozitave të këtij ligji dhe mjetet monetare të realizuara me shitjen e pasurisë së konfiskuar, po sipas këtij Ligji, paguhet në llogarinë e buxhetit shtetëror¹⁵¹.

Siç shihet, sistemi i konfiskimit sidomos atij të përkohshëm është shumë praktik dhe shumë efikas përse i takon të drejtës për shitjen e sendeve nëse Zyra kompetente për administrimin e pasurisë së konfiskuar vlerëson se mund të humbet vlera e sendeve të konfiskuar përkohësisht në pritje të vendimit përfundimtarë të gjykatës. Kjo e shton efikasitetin dhe e rrit sigurinë e palëve në procedurë duke ruajtur të drejtat dhe interesat e tyre pasurore nëse ata shpallen të pafajshëm në procedurë penale. Kjo paraqet njërin ndër problemet në Kosovë, pasi që Agjencia për administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar nuk ka kompetencë për shitjen e sendeve pavarësisht arsyeve pa lejen e gjykatës, e që shpeshherë ndodhë që gjykata nuk jep asnjë përgjigje për kohë të gjatë lidhur me kërkesat e agjencisë.

5.3.7. Pranimi dhe përmbarimi i vendimeve të huaja

Vendimet e organeve të huaja me të cilat caktohen masa të përkohshme ose të ngjashme pa marrë parasysh emërtimin e tyre, e që kanë të bëjnë me sigurimin e konfiskimit të dobisë pasurore të realizuar me vepër penale, do të pranohen dhe do të ekzekutohen në territorin e Republikës së Kroacisë në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare ku Republika e

¹⁴⁸ Po aty, neni 4, paragrafi 2 dhe 3.

¹⁴⁹ Po aty, paragrafi 4.

¹⁵⁰ Po aty, paragrafi 5.

¹⁵¹ Po aty, neni 22.

Kroacisë bën pjesë. Nëse me shtetin përkatës marrëveshja nuk është lidhur, vendimi i organit të huaj do të pranohet:

- Nëse vendimi nuk bie ndesh me rendin publik të Republikës së Kroacisë;
- Nëse kundërshtarit të sigurimit nuk i është pamundësuar, në veçanti me lëshimin e dorëzimit, marrja pjesë në procedurën në të cilën ka dalë vendimi i tillë;
- Nëse ekziston reciprociteti¹⁵².

Megjithëse parashihen këto kritere, Republika e Kroacisë, nëpërmjet legjilacionit të saj tregon gadishmërin për të bashkëpunuar me rastin e pranimi dhe ekzekutimi të vendimeve të shteteve të huaja. Krejt kjo me qëllim të luftimit të kriminalitetit transnacional.

5.3.8. Rastet e veçanta të konfiskimit

Sendet, të cilat kanë qenë të destinuara ose të shfrytëzuara për kryerjen e veprës penale ose janë krijuar me kryerjen e saj, konfiskohen përkohësisht nga policia, e cila i'a dorëzon Zyrës, nëse ligji nuk e ka rregulluar këtë ndryshe ose, nëse urdhëri i prokurorit shtetëror nuk vendos ndryshe. Për konfiskimin e përkohshëm nga policia dhe dorëzimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht në Zyrën përkatëse, njoftohet menjëherë prokurori shtetëror, përveç nëse nuk veprohet sipas urdhërit të tij. Kur konfiskimi i përkohshëm është kryer, për kundërshtimin e personit të tretë vendos gjykata e caktuar nga Ligji për nxjerrjen e aktvendimit për masën e përkohshme të sigurimit të theksuar¹⁵³.

Dispozitat e Ligjit për procedurën e konfiskimit të dobisë pasurore të realizuar me veprë penale dhe kundërvajtje zbatohen në procedurën për vepra penale nga neni 21 i Ligjit që rregullon organizimin dhe funksionimin e Zyrës për luftën ndaj korrupsionit dhe kriminalitetit të organizuar (emërtimi i shkurtër: USKOK), nëse nuk është parashikuar ndryshe me atë Ligj¹⁵⁴.

Nga e tërë kjo, shihet se Kroacia, ka arritur për të plotësuar kornizën ligjore në këtë fushë.

¹⁵² Po aty, neni 26.

¹⁵³ Po aty, neni 28.

¹⁵⁴ Po aty, neni 34.

5.4. Sllovenia

Përcaktimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë jolegale, në Republikën e Sllovenisë, është rregulluar me legjislacionin penal (*Ligjin Penal dhe Ligjin e Procedurës Penale*) dhe me legjislacionin tatimor (*Ligjin për Procedurën Tatimore dhe Ligjin për Shërbimin Tatimor*). Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me veprë penale është rregulluar në kapitullin e shtatë të Ligjit Penal, në të cilin janë përshkruar arsyet dhe mënyra e konfiskimit të dobisë pasurore dhe veprimi me pasurinë dhe sendet e konfiskuara. Konfiskimi i pasurisë së përfituar në mënyrë jolegale, në disa raste, ka mundësi të realizohet edhe pa ndërlikim të drejtpërdrejtë me aktgykimin në procedurën penale¹⁵⁵.

Me Ligjin penal¹⁵⁶ është parashikuar parimi sipas të cilit askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të fituar me veprë penale apo për shkak të saj. Dobia pasurore konfiskohet me vendimin gjyqësor me të cilin, në pajtim me kushtet e caktuara me atë ligj, është vërtetuar kryerja e veprës penale¹⁵⁷. Ligji definon se autorit të veprës penale, përkatësisht shfrytëzuesit e tjerë ose shfrytëzuesit e dobisë (*më tej: Shfrytëzues*) i konfiskohen paratë, sendet e çmuara dhe çdo dobi tjetër pasurore, e cila është fituar me veprë penale ose për shkak të saj. Nëse autorit të veprës penale ose shfrytëzuesit tjetër nuk mund ti konfiskohet dobia pasurore ose pasuria që i përgjigjet dobisë pasurore të fituar me veprë penale, do të urdhërohet patjetër pagesa në të holla, në masën që i përgjigjet vlerës së asaj dobie pasurore. Në rastet e justifikueshme, gjykata mund të lejoj që shuma në para që i përgjigjet dobisë pasurore të paguhet me këste, por afati i pagimit nuk duhet të jetë më i gjatë se 2 (dy) vjet. Ligji slloven detyron konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me veprë penale ose për shkak të saj edhe për personat të cilët kanë bartur pa pagesë pasurinë e fituar me veprë penale, ose kanë përfituar pronësi në shumën e parave që nuk i përgjigjet vlerës së saj të vërtetë, të cilën e kanë ditur, ose kanë mundur ta dinë se është fituar me veprë penale ose për shkak të saj. Nëse dobia pasurore e fituar me veprë penale ose për shkak të saj është bartur në të afërmit e autorit të veprës penale, ose nëse për shkak të pamundësisë së

¹⁵⁵ Me gjersisht, shih: Istraživanje Istraživačkog sektora Državnog zbora Slovenije *Neupravičeno pridobljeno premoženje – pregled zakonodaje*, od 10.04.2008. godine, str. 4, fq.30-39

¹⁵⁶ Krivični zakonik Republike Slovenije (*Ligji Penal i Sllovenisë*), Uradni list RS, br. 55/2008, od 4. 6. 2008; www.uradni-list.si/ (qasur me, 28.09.2011.)

¹⁵⁷ Po aty, neni 74.

konfiskimit të dobisë pasurore në ata persona është bartur në ndonjë pasuri tjetër të tij, ajo pasuri konfiskohet, përveçse nëse dëshmohet se kanë paguar vlerën e vërtetë të saj¹⁵⁸.

Personit juridik i konfiskohet edhe dobia pasurore ose pasuria që i përgjigjet dobisë pasurore nëse autori i veprës penale ose shfrytëzuesi tjetër në të e kanë bartur pa pagesë atë lloj pasurie ose për shumën e parave, e cila nuk i përgjigjet vlerës së vërtetë të saj¹⁵⁹.

5.4.1. Ligji për Procedurën Penale

Ligji i Procedurës Penale, përveç tjerash, ka përcaktuar se paratë ose pasuria që ka prejardhje nga burimi i paligjshëm mund të konfiskohet, përveçse në rastet e shqiptuara në aktgjykimin dënues, edhe në rastet kur ekzistojnë provat për vepra të caktuara penale (p.sh larja e parave, marrja ose dhënia e mitos etj.), të cilat bëjnë me dije se paraja ose pasuria e kanë prejardhjen nga vepra penale, përkatësisht se është pranuar shpërblimi, dhurata, mito ose ndonjë dobi tjetër pasurore¹⁶⁰. Dobia pasurore e fituar me vepër penale ose për shkak të saj përcaktohet në procedurën penale sipas detyrës zyrtare¹⁶¹.

Në pjesën e Ligjit të Procedurës Penale¹⁶² lidhur me veprimin me sendet e dyshimta është parashikuar se, nëse tek i akuzuari gjendet sendi i huaj dhe nuk dihet se kujt i përket, organi i cili zhvillon procedurën do ta përshkruaj sendin dhe përshkrimin do ta shpallë në tabelën e gjykatës së shkallës së parë, në territorin ku i akuzuari jeton dhe në territorin ku është kryer vepra penale. Në shpallje të intresuarit ftohen që, brenda afatit një vjeçar nga shpallja e thirrjes, të paraqiten pasi në të kundërtën sendi do të shitet. Paraja që fitohet me shitjen e sendeve të tilla futet si e ardhur në buxhetin e shtetit. Nëse prona ka vlerë të madhe shpallja mund të publikohet edhe në gazetën ditore.

Ligji sloven është kujdesur edhe për rastet kur sendi është prishur apo ruajtja e tij është e ndërlidhur me shpenzime të mëdha. Në një rast të tillë sendi shitet sipas dispozitave të procedurës përmbartimore, ndërsa paraja i jepet në ruajtje Entit për paratë. Ligji parashikon të njëjtën mënyrë veprimi edhe nëse sendi i takon autorit të veprës penale që është në arrati ose është i panjohur¹⁶³. Më tej, nëse brenda afatit dy vjeçar nuk paraqitet askush për sendin ose për të hyrat e sendit të shitur, nxirret vendimi me të cilin sendi kalon në pronësi të

¹⁵⁸Po aty, neni 75.

¹⁵⁹ Po aty, neni 77.

¹⁶⁰ Neni 498a. *Ligji për procedurën penale të Sllovenisë*.

¹⁶¹ Ligji për procedurën penale të Republikës së Sllovenisë, Uradni list RS, br. 32/2007, od 10. 4. 2007; www.uradni-list.si/ (qasur me, 28.09.2011.)

¹⁶² Po aty.

¹⁶³ Po aty.

Republikës së Sllovenisë, përkatësisht të hollat shkojnë në buxhetin e shtetit. Pronari ka të drejtë që të kërkojë kthimin e sendit ose të të hyrave për sendin e shitur në kontest. Parashkrimi i asaj të drejte fillon në ditën e publikimit të shpalljes¹⁶⁴.

Gjykata duhet të veprojë urgjentisht në rastet kur ka caktuar ruajtjen e sendeve të konfiskuara ose sigurimin e përkohshëm të kërkesave për konfiskimin e dobisë pasurore, përkatësisht të pasurisë në vlerën e dobisë pasurore. Me sendet e konfiskuara dhe me pasurinë që shërben për sigurimin e përkohshëm të kërkesave dhe me sendet ose pasurinë që i janë dhënë si garanci (*nenet 196 deri 199*), duhet të veprohet si nikoqir i mirë. Në qoftë se ruajtja e sendeve të konfiskuara apo siguri i përkohshëm i kërkesave ka lidhje me shpenzime jo proporcionale, apo vlera e pasurisë ose e sendeve zvogëlohet gjatë ruajtjes, gjykata mund të caktojë që ajo pasuri ose sendet të shiten, të shkatërrohen apo të dhurohen për interes publik. Para marrjes së vendimit të saj gjykata duhet të marrë edhe mendimin e pronarit të pasurisë ose të sendit. Nëse nuk dihet pronari apo thirrja për dhënien e mendimit nuk ka mundësi të dorëzohet, gjykata thirrjen e vë në tabelën e gjykatës dhe pas 8 (*tetë*) ditësh konsiderohet se është publikuar dorëzimi i saj. Nëse pronari nuk jep mendimin e tij brenda afatit 8 ditor nga dorëzimi i thirrjes, konsiderohet se pajtohet me shitjen, shkatërrimin ose dhurimin. Për ruajtjen e sendeve të konfiskuara dhe sigurinë e tyre kujdesen organet kompetente shtetërore, organizatat me autorizime publike, përmbauesit dhe organizatat financiare. Veprimet me sendet, me pasurinë dhe nivelin e tyre të sigurisë rregullohen nga vendime të Qeverisë së Republikës së Sllovenisë¹⁶⁵. Lidhur me këtë, ne në këtë punim do të theksojmë më poshtë detajet më të rëndësishme të këtyre akteve qeveritare, të njohura ndryshe nga Ligji Slloven si Dekretet për veprimet e nevojshme në lidhje me sendet e konfiskuara, me pasurinë dhe me letrat me vlerë.

5.4.2. Ligji për Procedurën Tatimore

Ligji Slloven “Për Procedurën Tatimore”¹⁶⁶ parashikon se organi tatimor ka të drejtë të përcaktojë sendin e tatueshëm dhe më pas vlerën e tatimit që i përgjigjet atij. Këtë mund ta bëjë përveç të tjerash edhe nëse:

¹⁶⁴Po aty, neni 226.

¹⁶⁵ Po aty, neni 506a.

¹⁶⁶ Zakon o poreznom postupku Republike Slovenije (*Ligji për procedurën tatimore i Republikës së Sllovenisë*), Uradni list RS, br. 13/2011 od 28. 2. 2011; www.uradni-list.si/ (qasur me, 13.10.2011).

- Vërtetohet se obliguesi tatimor (personi fizik) disponon për konsum privat mjete, përfshirë edhe pasuritë, që tejkalojnë në mënyrë të konsiderueshme të hyrat që obliguesi tatimor ka paraqitur;
- Mëson, në mënyra të ndryshme, të dhëna të papërpunueshme me deklaratimet për mjetet që disponon obliguesi tatimor (*personi fizik*), përkatësisht për shpenzimin e obliguesit tatimor (*të personit fizik*), ose të dhëna për pasurinë e fituar të obliguesit tatimor¹⁶⁷.

Organi tatimor mund të ftoj obliguesin tatimor - personin fizik, t'i paraqes organit tatimor të dhëna për pasurinë e tij ose për atë pjesë të pasurisë së tij, e cila nuk vërtetohet me të hyrat e deklaruara (më tej: paraqitja e pasurisë). Në fletëparaqitjen e pasurisë obliguesi tatimor duhet të deklarojë pasurinë që ka në pronësi (paluajtshmëritë; të drejtat në paluajtshmëritë dhe të drejtat e tjera pasurore; paratë e gatshme në llogaritë e bankave dhe të kursimeve; kërkesat dhe detyrimet nga marrëdhëniet e detyrimeve etj.). Në fletëparaqitjen e pasurisë mund të deklarohet edhe pasuria tjetër. Pavarësisht se Ligji për Tatimin në Republikën e Sllovenisë detyron organin e tatueshëm të paraqesë të dhënat për pasurinë e tij një herë në vit, organi tatimor mund të kërkojë nga personi juridik bashkangjitjen e fletëparaqitjes së pasurisë ose të një pjese të pasurisë më shumë se një herë në vit. Fletëparaqitjen e pasurisë organi tatimor mund ta përdor për vlerësimin e bazës tatimore për tatimet dhe të hyrat e personit fizik¹⁶⁸. Obliguesi, në pajtim me dispozitat e këtij Ligji që kanë të bëjnë me barrën e të provuarit, për pohimet e tij në procedurën tatimore dhe zvogëlimin e detyrimit tatimor duhet të paraqesë prova, ndërsa organi tatimor duhet të dëshmojë veprimet në bazë të të cilave krijohet detyrimi tatimor¹⁶⁹.

Hetimi tatimor është rregulluar me nenin 131 të Ligjit për Procedurën Tatimore. Nëse ekziston shkak për dyshimin se veprimet e kryera kanë shkelur dispozitat për tatimin, organi tatimor mund të nisë hetimin tatimor dhe për këtë lëshon urdhërin për hetim. Në urdhërin për hetim, organi tatimor duhet të theksojë rrethanat që e shtyjnë drejt dyshimit të arsyeshëm dhe përcakton njëherësh pistat e hetimit. Hetimi tatimor kryet nga inspektori i tatimeve, veprimet e të cilit udhëzohen nga dispozitat e këtij Ligji dhe atij për shërbimin tatimor.

Në procedurën e hetimit tatimor kontrollohen të gjitha të dhënat e grumbulluara paraprakisht nga organi tatimor, në përputhje me kompetencat që i njeh atij Ligji.

¹⁶⁷ Po aty, neni 68 paragrafi 5.

¹⁶⁸ Po aty, neni 69 paragrafi 1, 2, 4, 6 dhe 11.

¹⁶⁹ Po aty, neni 76.

5.4.3. Ligji për Shërbimin Tatimor

Ligji për Shërbimin Tatimor¹⁷⁰ parashikon kornizën e procedurës për kryerjen e mbikëqyrjes tatimore. Nëse procedura e hetimit tatimor vërteton mospërputhje mes konstatimeve të organit tatimor dhe deklarimeve të personit fizik, të cilat arsyetojnë kështu dyshimet e organit tatimor, ky i fundit nis procedurën e mbikëqyrjes tatimore, në të cilën si dëshmi do të shfrytëzohen provat dhe të dhënat e grumbulluara gjatë hetimit tatimor.

Sipas nenit 18 të këtij Ligji, me rastin e plotësimit të urdhërit, inspektori, përveç tjerash, ka këto të drejta:

- Të shikoj, kontrolloj dhe inspektoj tërë tokën, lokalet afariste dhe hapësirat e tjera që shfrytëzohen për kryerjen e veprimtarisë ose fitimin e të hyrave, ku me hapësira afariste konsiderohen edhe hapësirat për banim që obliguesi tatimor i ka caktuar si seli të vetën dhe në të cilat kryen veprimtarinë/veprimtaritë e tij;
- Të hyj dhe të kontrolloj hapësirat afariste dhe hapësirat e tjera (përveç hapësirës për banim) që nuk i takojnë obliguesit, kur për to ekziston dyshimi i bazuar se obliguesi ushtron në to veprimtarinë ose atje janë sendet e obliguesit, të cilave u përket kryerja e detyrave nga paragrafi i parë deri te paragrafi i tretë i këtij neni;
- Të kontrolloj librat afariste dhe evidencat, kontratat, dokumentet afariste dhe dokumentacionin afarist të personave të tjerë që gjenden tek personi që kryhen këto detyra nga paragrafi një deri te paragrafi tre i këtij neni;
- Të marrë në pyetje palët dhe dëshmitarët në procedurën administrative;
- Të kontrolloj dokumentet që dëshmojnë statusin juridik të obliguesit tatimor dhe dokumentet e tjera me të cilat mund të përcaktohet identiteti i personit.

¹⁷⁰ Detaje të Ligjit për shërbimin tatimor të Republikës së Sllovenisë janë marrë nga hulumtimet e sektorit kërkimor të Kuvendit shtetëror të Sllovenisë- Istraživačkog sektora Državnog zbora Slovenije *Neupravičeno pridobljeno premoženje – pregled zakonodaje*, od 10.04.2008. godine, str. 6, Qasur në: <https://www.parlament.ba/Publication/Read/3952?title=propisi-o-oduzimanju-imovine-stecene-krivicnim-djelom-i-upravljanju-tom-imovinom-&pageId=0>

5.4.4. Dekreti për veprimin me sendet, pasurinë dhe letrat me vlerë të konfiskuara¹⁷¹

Ky Dekret¹⁷² rregullon procedurën e administrimit:

- Për sendet e konfiskuara në procedurën penale ose të lidhura me të dhe që i janë dorëzuar gjykatës në ruajtje apo gjykata ka caktuar me vendim ruajtjen e tyre;
- Për sendet ose pasurinë që shërben për sigurimin e përkohshëm të kërkesave për konfiskimin e dobisë pasurore, përkatësisht me pasurinë në vlerën e dobisë pasurore;
- Për sendet ose për pasurinë e depozituar si dorëzani¹⁷³.

Sendet dhe pasuria e theksuar në gjykatë mbahen në regjistrin e sendeve të konfiskuara sipas dispozitave të rendit gjyqësor¹⁷⁴. Gjkata mund të caktojë që ruajtjen dhe administrimin e sendeve ta kryejnë përmbaruesit e emëruar sipas Ligjit për procedurën përmbarimore dhe sigurimin, të cilët janë regjistruar në regjistrin e përmbaruesve të autorizuar dhe që administrohet nga Ministri i Drejtësisë. Për regjistrimin në regjistrin e përmbaruesve të autorizuar vendos Ministri i Drejtësisë pas mendimit paraprak të dhënë nga Dhoma e Përmbaruesve dhe nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut, për territorin e të cilës jepet autorizimi. Për territorin e çdo gjykate qarku caktohet të paktën një përmbarues i autorizuar, ndërsa për Gjykatën e qarkut në Lubllanë caktohen të paktën dy të tillë. Përmbaruesi i autorizuar ka të drejtë dhe mund të ruaj dhe administrojë sendet sipas dispozitave ligjore të të gjitha gjykatave në Republikën e Sllovenisë. Ministri i Drejtësisë përcakton me rregullore kushtet që duhen përmbushur nga përmbaruesi i autorizuar për sigurimin e sigurisë teknike dhe fizike të sendeve (*mbikëqyrja video, sistemet e alarmit,*

¹⁷¹Uredba o postupanju s oduzetim predmetima, imovinom i vrijednosnim papirima, Uradni list RS, br. 22/2002 (*Dekreti për veprimin me sendet, pasurinë dhe letrat me vlerë të konfiskuara*) od 13. 3. 2002; Izmjene i dopune Uredba o postupanju s oduzetim predmetima, imovinom i vrijednosnim papirima (*Ndryshimet dhe plotësimet e Dekretit për veprimin me sendet, pasurinë dhe letrat me vlerë të konfiskuara*), Uradni list RS, br. 8/2007 od 29. 1. 2007: www.uradni-list.si/ (qasja me, 13.10.2011).

¹⁷²Dekreti për veprimin me sendet, pasurinë dhe letrat me vlerë të konfiskuara

¹⁷³Po aty, neni 1

¹⁷⁴Rendi gjyqësor në Slloveni rregullohet me akte nënligjore të ministrit kompetent për gjyqësi në pajtim me Ligjin për gjykatat. Në nenin 1 të Ligjit për gjykatat është definuar se “Rregullat e gjykatës caktojnë organizimin e gjykatave dhe të disa llojeve të punëve, organizimin dhe punën e shërbimeve të kujdestarisë, rregullat për ndarjen e punëve të gjykatësve, mënyrën e punës së gjykatave në rastet kur para gjykatës pala, dëshmitari ose pjesëmarrësi e shfrytëzon gjuhën dhe shkrimin e vet, puna shkrimore, tekniko-afariste, informatizimi i gjykatave, ndihma juridike në mes gjykatave dhe organeve tjera dhe ndihmën ndërkombëtare juridike, detyrat e posaçme të personelit gjyqësor dhe çështje tjera, nëse ligji kështu e përcakton. Dispozitat e rregullave gjyqësore shfrytëzohen në punën me librat e tokës, me regjistrin gjyqësor, përmbarimin, vërtetimin në punën lidhur me taksat, në bibliotekat profesionale, në arkivë, me rastin e pranimit dhe dërgimit të postës dhe afarizmin financiar, nëse atë nuk e rregullojnë dispozitat e veçanta.

Sodni red, Uradni list Republike Slovenije, br. 17/1995 od 18.3.1995, www.uradni-list.si/ (qasja me 15.10.2012).

mjetet e veçanta të transportit, sigurimi nga përgjegjësia dhe masat e tjera) së bashku kushtet e tjera për fitimin e autorizimeve për ruajtje dhe administrim me sendet si dhe procedurat për regjistrim në regjistrin e përmendur¹⁷⁵.

Shpenzimet e ruajtjes së pari paguhen nga mjetet e gjykatës që ka caktuar ruajtjen. Tarifën për pagimin e punës së kryer në bazë të këtij Dekreti dhe shpenzimet e përmbaruesit të autorizuar e përcakton me rregullore Ministri¹⁷⁶.

Administrimi, ruajtja, shitja dhe shkatërrimi i sendeve mbikëqyret nga Komisioni për sendet e konfiskuara, i emëruar sipas dispozitave të këtij vendimi (*më tej: Komisioni*). Komisionin për territorin e çdo gjykate qarku e emëron Ministri i Drejtësisë. Kryetari i komisionit dhe zëvendësi i tij emërohen nga mesi i gjyqtarëve, me propozim të kryetarit të gjykatës së qarkut; një anëtar i Komisionit dhe zëvendësi i tij vijnë nga radhët e të punësuarve të autorizuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, ndërsa një anëtar dhe zëvendësi i tij vijnë nga radha e prokurorëve shtetëror sipas propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Sllovenisë¹⁷⁷.

5.4.5. Ruajtja, shitja dhe shkatërrimi i sendeve

Gjykata, përkatësisht përmbaruesi i autorizuar, i cili pranon sendet, i kontrollon dhe, për pranimin, përpilon procesverbalin me të cilin vërteton pranimin e sendeve. Dekreti parashikon detajet që duhet të përmbajë procesverbali. Gjykata mund ti caktojë përmbaruesit të autorizuar kryerjen e veprimeve të caktuara ose t'i japë udhëzime administrative për mënyrën e pranimin dhe/ose të ruajtjes së sendeve, me propozimin e tij ose sipas detyrës së saj zyrtare¹⁷⁸. Gjykata ose përmbaruesi i autorizuar i ruan dhe i siguron sendet si nikoqir i mirë. Për ruajtjen e sendeve të luajtshme shfrytëzohen dispozitat e ligjit që rregullon marrëdhëniet e detyrimit për kushtet e magazinimit.

Dispozita të caktuara të Ligjit rregullojnë fushën e administrimit, ruajtjes, shitjes dhe shkatërrimit të sendeve të veçanta si municionet e luftës dhe mjeteve narkotike të konfiskuara. Ligji sanksionon ruajtjen nga Ministria e Punëve të Brendshme të sasive deri në 5 copë të armëve ushtarake dhe deri 1.000 copë municion, në hapësira të mbrojtura dhe të përcaktuara. Sasitë më të mëdha të armëve ushtarake dhe municionit, që tejkalojnë ato të

¹⁷⁵ Dekretit për veprimin me sendet, pasurinë dhe letrat me vlerë të konfiskuara, neni 3.

¹⁷⁶ Po aty, neni 4.

¹⁷⁷ Po aty, neni 5.

¹⁷⁸ Po aty, neni 6.

përmendura më sipër, i ruan Ministria e Mbrojtjes. Gjykata kompetente, ka të drejtë të kryej kontrollin e ruajtjes së këtyre armëve, pajisjeve luftarake dhe municioneve¹⁷⁹.

Sendet, vlera e të cilave zvogëlohet në kohë nga vlera e tregut ose/dhe obligojnë për ruajtjen e tyre shpenzime të mëtejshme joproporcionale, kur për shkak të kohëzgjatjes së parashikuar të procedurës dhe çmimit të pritur me rastin e shitjes konstatohet, se shpenzimet e ruajtjes të sendeve në raport me vlerën e tyre nuk e arsyetojnë ruajtjen e mëtejshme, duhet të shiten.

Gjatë administrimit me paluajtshmëritë duhet siguruar mbrojtja e të drejtave dhe plotësimi i detyrimeve që kanë personat e tretë, mirëmbajtja e rregullt e tyre dhe ruajtja e vlerës. Gjatë administrimit me kërkesat, me letrat me vlerë, me të drejtat e tjera pasurore ose materiale dhe me aksionet afariste duhet realizuar siguri dhe fitim në pajtim me vlerat e tregut. Gjatë administrimit me paratë duhet të sigurohen kamatat dhe likuiditeti sipas standardeve për kujdesin me afarizmin financiar¹⁸⁰.

Sendet që kanë qenë në ruajtje duhet ti kthehen pronarit pas pushimit të arsyeve për konfiskim, sipas përcaktimeve ligjore. Nëse vlerësohet dhe/ose konstatohet se sendi nuk mund të kthehet ose kthimi tek pronari nuk është i lejueshëm, gjykata ose përmbaruesi i autorizuar, sipas urdhërit paraprak të gjykatës i shet sendet dhe paratë e fituara nga shitja e tyre i ruan deri në vendimin përfundimtar të gjykatës, në përputhje me dispozitat që kanë të bëjnë me ruajtjen e mjeteve monetare. Nëse shitja nuk është e mundur ose shpenzimet e shitjes do ta kalojnë vlerën e sendit përkatësisht të lartësisë së të hyrave të pritura nga shitja, gjykata mund të caktojë shkatërrimin e sendit ose do të urdhëroj dhurimin e sendit për interes publik, në përputhje me dispozitat e këtij Dekreti. Urdhëri për shitjen, shkatërrimin ose dhurimin bëhet sipas propozimit të përmbaruesit të autorizuar në përputhje me detyrën zyrtare. Para nxjerrjes së këtij urdhëri gjykata siguron mendimin e pronarit të sendit¹⁸¹.

Në qoftë se sipas dispozitës së gjykatës sendet i kthehen pronarit, pranimi i tyre realizohet përmes një procesverbali të pranuar nga personi. Kur sendet në procedurën e konfiskimit ose të ruajtjes janë shkatërruar nga ndonjë arsye, veprohet sipas dispozitave të përcajktuar për gjykatën¹⁸².

Shitja e sendeve kryhet sipas dispozitave të akteve ligjore që kanë të bëjnë për procedurën përmbarimore gjyqësore, e cila mbikqyret nga Komisioni për sendet e konfiskuara. Arma

¹⁷⁹ Po aty, neni 6.

¹⁸⁰ Po aty, neni 8.

¹⁸¹ Po aty, neni 9.

¹⁸² Po aty, neni 10.

shitet sipas dispozitave të ligjit që rregullon qarkullimin e armëve dhe mbikëqyrjet nga komisioni i emëruar për territorin e Gjykatës së Qarkut në Lubljanë¹⁸³.

Komisioni kompetent me rastin e shitjes:

- Kontrollon nëse gjykata kompetente ka lëshuar urdhërin për shitje të armës/armëve dhe se regjistrimi i sendeve për shitjen është në përputhje me të dhënat e procesverbalit të përpiluar nga përmbaruesi i autorizuar me rastin e pranimin të sendit për ruajtje;
- Vërteton vlerësimin e vlerës së sendit, e cila është bazë për përcaktimin e çmimit të shitjes;
- Vërteton kushtet për shitjen e sendit dhe mënyrën e shitjes së tij;
- Kontrollon dhe vërteton procesverbalin e shitjes;
- Verifikon nëse është rregulluar statusi i mallit që del jashtë BE-së dhe nëse janë llogaritur taksat importuese¹⁸⁴.

Sendet, që sipas dispozitave të veçanta nuk janë në qarkullim të lirë, që nuk mund të shiten, apo shitja e tyre ndërlidhet me shpenzime joproportionale, Komisioni kompetent mund t'ua dhurojë organeve shtetërore ose organizatave, enteve, institucioneve apo organizatave filantropike, nëse ata dëshmojnë se sendet u nevojiten për ushtrimin e punës së tyre, gjithëherë, në përputhje me dispozitat për financat publike. Sendet me vlerë historike, arkeologjike, etnografike, kulturore, artistike ose shkencore, Komisioni mund t'i dhurojë sipas dispozitave të theksuara vetëm pas marrjes paraprake të mendimit të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Kulturës.

Shkatërrimin e sendeve e kryen gjykata ose përmbaruesi i autorizuar nën mbikëqyrjen e Komisionit për sendet e sekuestruara, ndërsa shkatërrimin e mjeteve narkotike, armëve ushtarake, pajisjeve ushtarake dhe municioneve e kryejnë punëtorët e autorizuar të Ministrisë së Mbrojtjes nën mbikëqyrjen e përhershme të Komisionit. Shkatërrimi bëhet në mënyrën e aprovuar nga Komisioni, i cili e bazon vendimin e tij në propozimin profesional të Ministrisë së Mbrojtjes, për shkak të veçorive të sendeve që shkatërrohen. Për shkatërrimin përpilohet gjithashtu një procesverbal i hollësishëm, vërtetësia e të cilit konfirmohet nga Komisioni. Për shkak të sigurisë së personave dhe të pasurisë mund të shkatërrohen gjithashtu edhe sendet e gjetura, mjetet apo pajisjet e konfiskuara eksplozive. Për nevojën e këtij shkatërimi njoftohet me shkrim gjykata, e cila zhvillon procedurën¹⁸⁵.

¹⁸³ Po aty, neni 11.

¹⁸⁴ Po aty, neni 12.

¹⁸⁵ Po aty, neni 14.

Shpenzimet e administrimit ose ruajtjes së sendeve deri në momentin e dorëzimit tek prokuroria kompetente shtetërore përkatësisht, gjykatës, i'a paguan Ministria e Punëve të Brendshme. Shpenzimet e administrimit dhe të ruajtjes së sendeve pas shitjes së sendeve dhe shpenzimet e shkatërrimit të sendeve të dorëzuara, i paguan prokuroria shtetërore kompetente ose gjykata të cilës i janë dorëzuar sendet nga mjetet buxhetore. Lidhur me pagesën e këtyre shpenzimeve konsiderohet se sendet i janë dorëzuar prokurorisë shtetërore kompetente, përkatësisht gjykatës edhe nëse, me rastin e ngritjes së fletëparaqitjes penale, ato kanë mbetur për ruajtje dhe administrim në polici. Në këto raste prokuroria shtetërore, përkatësisht gjykata, duhet, për çdo ndryshim të procedurës, e cila ndikon në llogaritjen e shpenzimeve, të informojë menjëherë me shkrim njësinë policore që ka paraqitur fletëparaqitjen¹⁸⁶.

5.4.6. Administrimi me depozitat gjyqësore dhe mjetet monetare

Dispozitat e urdhërit për administrimin me mjetet e gatshme dhe jo të gatshme nuk shfrytëzohen për euro dhe mjetet devizore që janë konfiskuar përkohësisht ose janë konfiskuar si send i caktuar individualisht¹⁸⁷. Në urdhërin për konfiskimin e përkohshëm ose nxjerrjen e mjeteve monetare të gatshme në valutën vendore apo në valutat e huaja - dollar amerikan, franga zvicerane apo funta angleze, gjyqtari përcakton që mjetet monetare të konfiskuara të dërgohen në buxhetin e Republikës së Sllovenisë për depozitat gjyqësore pranë Administratës së Republikës së Sllovenisë për pagesat publike. Për mjetet monetare të gatshme, të konvertuara në valutat e tjera të huaja, gjyqtari cakton dërgimin e tyre në llogarinë transaksionale të destinimit të veçantë të Republikës së Sllovenisë për depozita gjyqësore në Bankën e Sllovenisë, dhe njofton njëherësh Ministrinë e Financave. Në qoftë se mjetet monetare përkohësisht të konfiskuara ose të tërhequra në valutën vendore ose në valutën e huaj të konvertuar, gjenden në llogarinë transaksionale të institucionit që kryen qarkullimin e pagesave, gjykata, në të njëjtën kohë me urdhërin për konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin e mjeteve monetare urdhëron institucionin që kryen qarkullimin e mjeteve që t'i dërgojë ato në nën llogarinë përkatëse ose në llogarinë e Republikës së Sllovenisë për depozita gjyqësore. Gjithashtu, gjykata urdhëron institucionet që në momentin e bartjes së këtyre mjeteve finaciare të informojnë gjykatën kompetente, ndërsa në rastet e bartjes së mjeteve monetare në valutat ndërkombëtare të tjera (përpos

¹⁸⁶ Po aty, neni 15.

¹⁸⁷ Po aty, neni 16.

dollarit amerikan, frangës zvicerane dhe funtës angleze), të njoftojë krahas gjykatës kompetente edhe Ministrinë e Financave. Urdhërin për konfiskimin e përkohshëm ose tërheqjen e mjeteve monetare në valutën e konvertuar të huaj, përveç në valutat e tjera të huaja (dollari amerikan, franga zvicerane dhe funta angleze) gjykata ia dërgon gjithashtu Ministrisë së Financave. Për kryerjen e bartjeve të përshkruara në llogarinë e posaçme të Republikës së Sllovenisë për depozita gjyqësore, Ministria e Financave njofton gjykatën që ka lëshuar urdhërin për konfiskimin e përkohshëm ose tërheqjen e mjeteve¹⁸⁸. Drejtoria për pagesa publike në kuadër të Regjistratit të shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë të buxhetit shtetëror ose komunal, vendos listën e veçantë të nënlllogarisë, përkatësisht në llogarinë e Republikës së Sllovenisë për depozita gjyqësore dhe pronarët e tyre, të dhëna këto që publikohen edhe në faqen e internetit të Drejtorisë¹⁸⁹.

Mjetet të cilat nuk kthehen, në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, bëhen pronë e Republikës së Sllovenisë. Vendimi i gjykatës që i bën këto mjete pronë të Republikës së Sllovenisë i dërgohet për dijeni dhe administrim Ministrisë së Financave, kurse lajmërimi i dërgohet edhe llogarisë unike të thesarit të shtetit. Njoftimet dërgohen me shkrim dhe me faks, duke shfrytëzuar përkatësisht edhe teknologjinë e informacionit¹⁹⁰.

Mjetet në nënlllogaritë e Republikës së Sllovenisë për depozita administrohen nga Ministria e Financave, në pajtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë administrimin e likuiditetit të sistemit unik të llogarisë së thesarit. Mjetet afatizohen, ndërsa kamatat në mjetet e afatizuara janë në pronësi të Republikës së Sllovenisë¹⁹¹.

Kthimin e mjeteve monetare të konfiskuara përkohësisht dhe të tërhequra nga llogaria përkatëse e Republikës së Sllovenisë për depozitat gjyqësore, e kryen gjykata kompetente në shumën nominale. Shpenzimet e mundshme të qarkullimit të parave, të cilat krijohen me rastin e kthimit të mjeteve, shkojnë në barrë të Republikës së Sllovenisë¹⁹².

Ministria e Financave për pranimin e mjeteve devizore (përveç dollarit amerikan, frangës zvicerane dhe funtës angleze), të cilat janë të shënuara në llogarinë e veçantë transaksionale të Republikës së Sllovenisë, për depozitat gjyqësore në Bankën e Sllovenisë njofton detyrimisht gjykatën që ka lëshuar urdhërin. Administrimi i këtyre mjeteve

¹⁸⁸ Po aty, neni 17.

¹⁸⁹ Po aty, neni 17a.

¹⁹⁰ Po aty, neni 18.

¹⁹¹ Po aty, neni 19.

¹⁹² Po aty, neni 22.

monetare të konfiskuara nënkupton të njëjtin administrim të tyre nga shteti sikurse administrohen edhe mjetet buxhetore të Republikës së Sllovenisë¹⁹³.

Me propozimin e kryetarëve të gjykatave të qarkut, Ministria e Drejtësisë përpilon listën e propozuesve, të cilët në pajtim me këtë Dekret, i propozojnë Ministrin të Financave kthimin e mjeteve. Kryetari i gjykatës së qarkut, në propozimin e vet deklaron propozuesin dhe zëvendësin e tij dhe depoziton në Ministrinë e Drejtësisë nënshkrimet e tyre. Për ndërrimin e propozuesit, përkatësisht të zëvendësit, kryetari i gjykatës së qarkut njofton menjëherë Ministrinë e Drejtësisë, e cila i propozon Ministrisë së Financave listën e nënshkrimeve të depozituara dhe ndryshimet e saj¹⁹⁴. Për detyrimin e kthimit të mjeteve devizore (përveç dollarit amerikan, frangës zviceriane dhe funtës angleze) në llogari, gjykata informon propozuesin e lartëpërmendur dhe Ministrinë e Financave së paku 5 (pesë) ditë para kthimit, përkatësisht para afatit të arritjes së detyrimit për kthimin e mjeteve që janë pranuar në llogarinë e veçantë transaksionale të Republikës së Sllovenisë për depozitime gjyqësore në Bankën e Sllovenisë dhe e dërgon me postë në formë rekomande. Kthimi bëhet në shumën nominale. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat e më poshtme: dita e parë e dërgimit, shuma e saktë, emërtimi i bankës dhe numri i llogarisë në të cilën duhen kthyer mjetet, urdhëri që ka qenë bazë për dërgimin e mjeteve në llogari të Bankës së Sllovenisë dhe njoftimi për dërgim¹⁹⁵.

Ministri përgjegjës nxjerr rregullore dhe emëron Komisionin për sendet e konfiskuara në afat prej tre muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Dekreti¹⁹⁶. Dispozitat e këtij Dekreti shfrytëzohen edhe për ruajtjen dhe administrimin me sendet e policisë para fillimit të procedurës penale deri në dorëzimin e tyre në prokurorinë kompetente, përkatësisht deri në dorëzimin e tyre gjykatës, pa marrë parasysh nëse sendet ruhen në polici, prokurorinë shtetërore ose në organin tjetër, përkatësisht tek përmbaruesit e autorizuar¹⁹⁷. Përmjet këtyre dispozitave ligjore është përcaktuar një gamë e gjerë e rregullimit të fushës së konfiskimit, që nga sekuestrimi e deri në administrimin e pasurisë së konfiskuar të pëfituar në mënyrë të kundërligjshme.

¹⁹³ Po aty, neni 24.

¹⁹⁴ Po aty, neni 25.

¹⁹⁵ Po aty, neni 28.

¹⁹⁶ Po aty, neni 30.

¹⁹⁷ Po aty, neni 31 paragrafi 1.

5.5. Bosnja dhe Hercegovina

Në legjislacionin e Bosnjës dhe Hercegovinës janë të përmbajtura dispozitat që i përkasin konfiskimit të dobisë pasurore të dalë nga vepra penale. Instituti i konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale në legjislacionin e Bosnjës dhe Hercegovinës për herë të parë është vendosur me reformën e legjislacionit penal në vitin 2003¹⁹⁸, dhe më detajisht është përcaktuar me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës¹⁹⁹. Dispozitat ligjore të shtetit të Bosnjës dhe Hercegovinës që rregullojnë fushën e theksuar janë harmonizuar me ligjet në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe ato të Distriktit të Brçkos, ndërsa me entitetin e Republikës Srbska, në vitin 2012 është nxjerrë tërësisht Ligji i ri për konfiskimin e pasurisë të fituar me kryerjen e veprës penale²⁰⁰. Në bazë të analizës së legjislacionit ekzistues mund të konkludohet se: *“konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale brenda legjislacionit të Bosnjës dhe Hercegovinës është rregulluar në mënyrë jo të njëjtë, jo sistematike dhe joefikase”*²⁰¹. Nxjerrja dhe zbatimi i legjislacionit përkatës lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale është një nga kushtet që bashkësia europine ka vendosur për avancimin e proceseve europiane për Bosnje-Hercegovinën dhe njëherësh është bërë edhe një nga kriteret themelore që vetë shteti i Bosnjës dhe Hercegovinës ka vendosur në strategjinë e tij të luftës kundër korrupsionit. Hartimi i këtij legjislacioni, dhe zbatimi i tij në praktikë, është një nga qëllimet afatmesme strategjike që Qeveria e Bosnje-Hercegovinës ka vendosur në funksion të sundimit të shtetit të së drejtës, hallkë e rëndësishme e të cilit është edhe konfiskimi i pasurisë dhe i të drejtave të fituara në mënyrë të paligjshme. Në Raportin për përparimin e Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 2011, në pjesën lidhur me luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, Komisioni European konstaton se: “Korniza juridike për sekuestrimin plotësisht të pasurisë nuk është kryer, ndërsa konfiskimi i pasurisë së fituar me veprime kriminale edhe më tej është i paunifikuar në tërë territorin e shtetit. Mungojnë struktura efektive për menaxhimin e pasurisë së

¹⁹⁸ Krivični zakon Bosne i Hercegovine, Službeni glasnik BiH, br. 03/03 (*Ligji penal i Bosnës dhe Hercegovinës*)

¹⁹⁹ Zakon o izmjenama i dopunama Krivičnog zakona BiH, Službeni glasnik BiH, br. 8/10 (*Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit penal të Bosnjës dhe Hercegovinës*).

²⁰⁰ Službeni glasnik RS, br. 12/10, *Gazeta zyrtare e RS, nr. 12/10*.

²⁰¹ Mujanović, Eldan, Oduzimanje imovinske koristi pribavljene počinjenjem koruptivnih krivičnih djela, 2011 (analiza pravnog okvira u Bosni i Hercegovini); <https://ti-bih.org/wp-content/uploads/2011/03/Oduzimanje-imovinske-koristi-pribavljenje-pocinjenjem-koruptivnih-krivicnih-dijela-u-BiH.pdf> (qasur me, 20.05.2013)

konfiskuar dhe mirëmbajtjen e tyre”²⁰². Vlerësim për afërsisht identik është dhënë edhe për çështjen e larjes së parave.

Raporti i BE-së për Bosnje-Hercegovinën i vitit 2015 nuk është pozitiv, i cili konkludon se “...BH ... ka ende rrugë të gjatë për të bërë dhe konfliktet politike i kanë prerë rrugën reformave. Zbatimi i strategjisë së reformës në sektorin e drejtësisë 2014-2018 nuk u miratua. Reduktimi i ngadalshëm i lëndëve gjyqësore të prapambetura frymëzojnë korrupsionin dhe krimin, në luftën kundër të cilëve ka një ecje aspak frymëzuese”²⁰³.

Më tej, raporti vë në dukje se: “Kuatridhejshi i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar është i vendosur dhe funksional, por jo gjithmonë efikas. Departamenti përkatës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë së Bosnjës dhe Hercegovinës, i cili është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit dhe respektimin e ligjit dhe Konventave, nuk ka personel të mjaftueshëm. Për më tepër, ekziston mungesa e një ligji të harmonizuar gjatë gjithë kohës. Legjislacioni për ndihmën juridike ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe të bashkëpunimit rajonal duhet të ndryshohen për ta bërë gjykatën të jetë e menjëhershme në vendime, e drejtë dhe për të pasur mundësi për të përmirësuar bashkëpunimin me të gjitha organet e drejtësisë”²⁰⁴. Në përgjithësi vijmë në përfundim se Bosnje dhe Hercegovina ka të meta duke filluar në rregullimin ligjor të kësaj fushe nga jo harmonizimi dhe jo unifikimi i legjislacionit brenda shtetit, por edhe vështirësive që hasin në zbatimin e konfiskimit të pasurive të fituar në mënyrë të kundërligjshme, si rrjedhojë e diversitetit ligjor.

²⁰²Izveštaj o napretku Bosne i Hercegovine u 2011.godini (*Raport për përparimin e Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 2011*); https://www.google.com/search?rlz=1C1NHXL_enXK835XK835&ei=L5tXPuIAaiLmwXgrLOWCw&q=hIzvj%C5%A1taj+o+napretku+Bosne+i+Hercegovine+u+2011&oq=hIzvj%C5%A1taj+o+napretku+Bosne+i+Hercegovine+u+2011&gs_l=psy-ab.3...318439.318439..319697...0.0..0.301.301.3-1.....0....2j1..gws-wiz.SAb1SKSzMwk, fq.55.

²⁰³https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_bosnia_and_herzegovina.pdf

²⁰⁴https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_bosnia_and_herzegovina.pdf

5.5.1. Ligji Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës²⁰⁵

Sikurse në shtetet e tjera, edhe në Bosnjë-Hercegovinë bazë për konfiskimin e dobisë pasurore të dalë nga vepra penale ka parimi se askush nuk mund të mbajë dobinë e tillë pasurore, dhe se dobia e tillë do të konfiskohet me anë të një vendimi gjyqësor, i cili vërteton se vepra penale është kryer në kushtet e parashikuara me këtë ligj, e kryesisht me nenin 110 të Ligjit Penal të Bosnje-Hercegovinës²⁰⁶.

Kur procedura penale zhvillohet për vepra penale nga kreu XVII, XVIII, XIX, XXI, XXI dhe XXII të këtij Ligji, gjykata me vendim të bazuar në nenin 110 paragrafi 2, mund të konfiskoj edhe dobinë pasurore, për të cilën prokurori ofron dëshmi të mjaftueshme që krijojnë dyshimin e arsyeshëm, se dobia e tillë pasurore është përfituar me kryerjen e veprës penale, teksa autori nuk ka ofruar dëshmi bindëse se dobia është përfituar në mënyrë të ligjshme²⁰⁷. Në të vërtetë, veprat penale nga krerët e përmendur të Ligjit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës janë: veprat penale kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, veprat penale kundër ekonomisë dhe tregut unik dhe veprat penale nga fusha e doganave, pastaj veprat penale të korrupsionit dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe detyrës tjetër të përgjegjshme, veprat penale të shkeljes së të drejtave të autorit, veprat penale kundër forcave të armatosura të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe marrëveshja, përgatitja, bashkimi dhe kriminaliteti i organizuar.

5.5.2. Konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale dhe pasojat juridike të dënimit

Sipas Ligjit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës, në rastet e konfiskimit, autorit të veprës penale do ti konfiskohet paraja, sendet me vlerë dhe çdo dobi tjetër pasurore që është përfituar me vepër penale, ndërsa nëse konfiskimi nuk është i mundshëm, autori i veprës penale do të obligohet për të paguar shumën në të holla në përpjestim me dobinë e përfituar pasurore. Dobia pasurore e përfituar me vepër penale mund të konfiskohet nga personi në të cilin është bartur pa kompensim ose me kompensim në masën që pasuria i përgjigjet vlerës reale, kur vërtetohet se zotëruesi i pasurisë e ka ditur ose ka mundur të dijë se dobia pasurore është përfituar me vepër penale. Kur dobia e tillë pasurore është bashkuar me pasurinë e fituar në mënyrë të ligjshme, pasuria e tillë mund të jetë objekt i konfiskimit, por në një masë që e tejkalon vlerën e vlerësuar të dobisë pasurore të përfituar me vepër

²⁰⁵Ligji penal i Bosnës dhe Hercegovinës, Gazeta zyrtare e BH, br. 03/03 i 08/10.

²⁰⁶Po aty, neni 110.

²⁰⁷Po aty, neni 110a.

penale. Të hyrat ose dobitë e tjera nga dobia pasurore të përfituara me vepër penale, ose nga pasuria në të cilën dobia pasurore është përfitur me vepër penale, ose nga pasuria në të cilën dobia pasurore e përfitur me vepër penale është shndërruar ose nga pasuria me të cilën dobia pasurore e përfitur me vepër penale është bashkuar, mund të jenë objekt i masave të theksuara në këtë nen në mënyrën e njëjtë dhe në masën e njëjtë sikurse edhe dobia pasurore e përfitur me vepër penale²⁰⁸.

5.5.3. Mbrojtja e të dëmtuarit

Nëse në procedurën penale të dëmtuarit i është caktuar kërkesa pasurore - juridike, gjykata do të shqiptojë konfiskimin e dobisë pasurore nëse ajo tejkalon kërkesën pasurore-juridike të caktuar të të dëmtuarit. I dëmtuari, i cili në procedurën penale, në pikëpamje të kërkesës së tij pasurore-juridike është udhëzuar në procedurë civile, mund të kërkojë që të përmbushë nga shuma e vlerës së konfiskuar, nëse zhvillon procedurë civile në një afat prej gjashtë muajsh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është udhëzuar procedura civile dhe në një afat prej tre muajsh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është përcaktuar kërkesa e tij që kërkon përmbushjen nga vlera e konfiskuar, nëse me qëllim të përcaktimit të kërkesës së tij, ka ngritur procedurën civile në afat prej tre muajsh nga dita e marrjes në dijeni për aktgjykimin me të cilin i është konfiskuar dobia pasurore, ose në afatin prej dy vitesh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit për konfiskimin e dobisë pasurore²⁰⁹. Një rregullim i tillë ligjor i kushton vëmendje pozitive të të dëmtuarit në një proces penal, që nëpërmjet konfiskimit të dobisë pasurore të përfitur në mënyrë të kundërligjshme, të realizoj të drejtat pasurore përkatësisht kompensimin të dëmit që e ka pësuar nga vepra penale.

5.5.4. Ligji i Procedurës Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës²¹⁰

Teksa jemi duke sjellë në këtë punim dispozitat e Ligjit Penal të Bosnje-Hercegovinës në fushën e konfiskimit, vëmë re se dispozitat më interesante janë ato që kanë të bëjnë me autorizimet e prokurorëve dhe konfiskimin e përkohshëm dhe të përhershëm të pasurisë së dalë nga vepra penale.

²⁰⁸ Po aty, Neni 110.

²⁰⁹ Po aty, neni 112.

²¹⁰ Zakon o krivičnom postupku Bosne i Hercegovine br. 3/03, 32/03, 36/03, 26/04, 63/04, 13/05, 48/05, 46/06, 76/06, 29/07, 32/07, 53/07, 76/07, 15/08, 58/08, 12/09, 16/09, 93/09 (Ligji për Procedurën Penale të Bosnjës dhe Hercegovinës, Gazeta Zyrtare BH).

E drejta dhe detyra themelore e prokurorit sipas ligjit penal të cituar është zbulimi dhe ndjekja e autorit të veprës penale. Prokurori ka të drejtë dhe është i obliguar që:

- Të kërkojë dërgimin e informacioneve nga ana e organeve shtetërore, ndërmarrjeve, personave fizikë dhe juridik në Bosnjë dhe Hercegovinë;
- Të vërtetoj faktet e nevojshme për vendosjen e kërkesës pasuroro-juridike në pajtim me nenin 197 të këtij Ligji dhe, për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, në pajtim me nenin 392 të këtij Ligji²¹¹.

Prokurori është i detyruar që të grumbulloj provat për kërkesën pasuroro-juridike të ndërlidhur me veprën penale. Prokurori, do të kontrolloj të dyshuarin, përkatësisht të akuzuarin për faktet e ndërlidhura me propozimin e personit të autorizuar²¹².

5.5.5. Urdhëri për bankën ose personin tjetër juridik

Nëse mbi ndonjë person ekziston dyshimi i arsyeshëm se ai ka kryer vepër penale, e cila është e ndërlidhur me fitimin e dobisë pasurore, Gjykata mundet, në bazë të propozimit të prokurorit, të urdhërojë që banka apo personi tjetër juridik i cili kryen afarizëm financiar të dërgojë të dhënat për depozitat bankare dhe për transaksionet e tjera financiare të tij si dhe të dhënat e transaksioneve financiare të personave të tjerë, të cilët gjithashtu janë të dyshuar si të përfshirë në këto transaksione. Këto të dhëna marrin rolin e dëshmisë në procedurën penale të nisur me qëllim konfiskimin e pasurisë së dalë nga vepra penale.

Gjykata, me propozimin e prokurorit, mund të urdhërojë edhe ndërmarrjen e veprimeve të tjera nga neni 116 i këtij ligji, me qëllim që të mundësohet përcaktimi dhe zbulimi i pasurisë së përfituar në mënyrë të kundërligjshme dhe grumbullimi i dëshmive për të.

Në rastet urgjente prokurori mund të caktoj masa nga paragrafi 1 i këtij neni në bazë të urdhëresës. Për masat e marra, prokurori njofton menjëherë Gjykatën, e cila në një afat prej 72 orësh duhet të lëshoj urdhërin për konfiskim. Në rast se Gjykata nuk lëshon urdhër, prokurori detyrohet të kthej të dhënat pa hapjen paraprake të hetimit.

Gjykata mundet gjithashtu që, me aktvendim, të urdhërojë personin juridik ose fizik të ndërpresë përkohësisht kryerjen e transaksioneve financiare, për të cilat ekziston dyshimi se paraqesin vepër penale, se destinohen për kryerjen e veprës penale, se i shërbejnë fshehjes së veprës penale ose i shërbejnë fshehjes së dobisë së realizuar me vepër penale. Me këtë aktvendim gjykata cakton se mjetet financiare të destinuara për transaksionin e

²¹¹Po aty, kreu VI.

²¹² Po aty, neni 328.

theksuar dhe shumat monetare të gatshme të valutës vendore dhe të huaj do të konfiskohen përkohësisht sipas nenit 65 paragrafi 1 i këtij Ligji, do të vendosen në llogari të posaçme dhe do të ruhen deri në përfundimin e procedurës, e cila vendos kthimin ose sekuestrimin dhe konfiskimin e tyre. Ky vendim gjykate mund të kundërshtohet nga prokurori, nga pronari i mjeteve financiare ose i parave të gatshme të valutës vendore dhe të huaj, i dyshuari, përkatësisht i padituri, si dhe personat e theksuar fizikë dhe juridikë²¹³. Kjo situatë e tillë ligjore, është ngjashme me dispozitatat ligjore të legjislacionit të Kosovës të cilat parashohin urdhërin për ngrirje të aseteve.

5.5.6. Konfiskimi i përkohshëm i pasurisë me qëllim sigurimin e saj

Gjykata, mundet në çdo kohë gjatë procedurës, me propozimin e prokurorit, të nxjerrë masën e përkohshme të konfiskimit të pasurisë, ose masë tjetër të përkohshme në bazë të Ligjit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës, si masa të dosmosdoshme për të penguar shfrytëzimin, tjetërsimin ose disponimin me atë pasuri.

Personi zyrtar i autorizuar mundet, kur ekziston rreziku nga shtyrja, të konfiskoj përkohësisht pasurinë nga paragrafi i mësipërm i këtij neni (*Neni 72 i Ligjit të Procedurës Penale të BH-së*), të sekuestroj pasurinë ose të ndërmarrë masa të tjera me karakter të përkohshëm, të cilat nuk lejojnë çdo formë të shfrytëzimit, tjetërsimit ose disponimit me atë pasuri. Për masat e ndërmarra personi zyrtar i autorizuar duhet të njoftojë menjëherë prokurorin, ndërsa për masat e ndërmarra vendos gjyqtari në procedurën paraprake që zhvillohet brenda afatit prej 72 orësh. Në rastin kur personi zyrtar i autorizuar mohon lejen, masat e ndërmarra do të pezullohen, ndërsa sendet e konfiskuara dhe pasuria do t'i kthehen menjëherë personit të cilit i janë konfiskuar²¹⁴.

Sendet, të cilat janë konfiskuar përkohësisht do t'i kthehen pronarit, përkatësisht poseduesit, kur gjatë procedurës bëhet e qartë se mbajtja e tyre nuk është në pajtim me nenin 65 të këtij Ligji, dhe konkludohet se arsyet për konfiskimin e tyre nuk ekzistojnë²¹⁵.

²¹³ Po aty, neni 72.

²¹⁴ Po aty, neni 73.

²¹⁵ Po aty, neni 74.

5.5.7. Konfiskimi i dobisë pasurore të përfitur me vepër penale

Dobia pasurore e përfitur me vepër penale përcaktohet në procedurën penale sipas detyrës zyrtare. Prokurori, gjatë procedurës është i obliguar të grumbullojë provat dhe të vëzhgojë rrethanat që janë me rëndësi për vërtetimin e dobisë pasurore të përfitur me vepër penale. Nëse i dëmtuari ka paraqitur kërkesë pasuroro-juridike në pikëpamje të kthimit të sendeve të përfituara me vepër penale, përkatësisht në pikëpamje të shumës së parave që i përgjigjet vlerës së sendeve, dobia pasurore do të përcaktohet vetëm për pjesën që nuk është përfshirë me kërkesën pasuroro-juridike²¹⁶.

Kur vjen në shprehje konfiskimi i dobisë pasurore të përfitur me vepër penale, personi në të cilin është bartur dobia pasurore dhe përfaqësuesi i tij apo i personit juridik do të thirren në shqyrtimin kryesor me qëllim marrjen në pyetje. Thirrja e tyre përmban gjithashtu njoftimin se mungesa e paraqitjes së tyre nuk e bllokoi procedurën, e cila në raste të tilla do të vazhdojë pa prezencën e tyre. Në mënyrë të njëjtë do të veprohet edhe ndaj personit mbi të cilin është bartur dobia pasurore, nëse nuk është ftuar si dëshmitar. Personi mbi të cilin është bartur dobia pasurore, si dhe përfaqësuesi i personit juridik është i autorizuar që, lidhur me përcaktimin e dobisë pasurore, të propozoj prova dhe, me lejen e gjyqtarit, përkatësisht të kryetarit të trupit gjykues, t'i bëjë pyetje të akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve. Përfshirja e publikut nga shqyrtimi kryesor nuk ka të bëjë me personin mbi të cilin është bartur dobia pasurore apo për përfaqësuesin e personit juridik. Nëse Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor vërteton se vjen në shprehje konfiskimi i dobisë pasurore, ajo pezullon shqyrtimin kryesor dhe fton personin në të cilin është bartur dobia pasurore dhe përfaqësuesin e personit juridik²¹⁷. Gjykata, lartësinë e dobisë pasurore të përfitur me vepër penale do ta përcaktojë sipas bindjes së saj të lirë pasi ndryshe përcaktimi i saj do të jetë i vështirë teksa ndërlihet me vështirësitë jo proporcionale ose dhe me zvarritjen e dukshme të procedurës²¹⁸.

Nëse kemi të bëjmë me konfiskimin e dobisë pasurore të përfitur me vepër penale, Gjykata, në mbështetje të dispozitave që vlejnë për procedurën e përmbarimit do të caktojë masat e përkohshme të sigurimit. Në raste të tilla përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e nenit 202 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Penale²¹⁹.

Konfiskimin e dobisë pasurore të përfitur me vepër penale Gjykata mund ta shqiptojë në aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, në aktvendimin për zbatimin e masave

²¹⁶ Po aty, neni 392.

²¹⁷ Po aty, neni 393.

²¹⁸ Po aty, neni 394.

²¹⁹ Po aty, neni 395.

edukative, si dhe në procedurën nga neni 389 të këtij Ligji. Në dispozitiv të aktgjykimit ose të aktvendimit, Gjykata do të theksojë se cili send, përkatësisht shumë e të hollave konfiskohet. Kopja e vërtetuar e aktgjykimit i dërgohet personit në të cilin është bartur dobia pasurore si dhe përfaqësuesit të personit juridik nëse Gjykata ka shqiptuar konfiskimin e dobisë pasurore edhe për atë person²²⁰.

Personi i autorizaur sipas nenit 393 i këtij Ligji mund të paraqes kërkesë për përsëritjen e procedurës penale në pikëpamje të vendimit të konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale²²¹. Dispozitat e nenit 294, paragrafi 2 dhe 3 dhe nenit 302 dhe 317 të këtij Ligji, përshtatshmërisht zbatohen në ankesën kundër vendimit për konfiskimin e dobisë pasurore²²². Nëse me dispozitat e këtij kreu nuk është caktuar ndryshe, në pikëpamje të procedurës për aplikimin e masave të sigurisë ose për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, përshtatshmërisht aplikohen dispozitat e tjera përkatëse të këtij Ligji²²³.

Në përmbartimin e vendimeve të shqiptuara gjyqësore për konfiskimin e pasurisë së paligjshme të fituar me vepër penale, në Bosnje dhe Hercegovinë zbatohen edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore të Bosnjës dhe Hercegovinës para Gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës²²⁴. Kjo nënkupton se vakumet ligjore të ligjit penal mbulohen me legjislacionin e përgjithshëm, që i referohen fushës së konfiskimit të pasurisë të fituar me vepër penale.

5.5.8. Barra e kundërt e të provuarit të prejardhjes së pasurisë

Risia në legjislacionin e Bosnjës dhe Hercegovinës është dispozita e theksuar e nenit 110a, e vendosur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Penal të Bosnjës dhe Hercegovinës në vitin 2010, me objekt konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore. Këtu barra e të provuarit të prejardhjes së pasurisë është bartur pjesërisht edhe në personin e akuzuar në rastet kur gjykata pranon provat e prokurorit, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm se pasuria është fituar me kryerjen e veprave të caktuara penale. Pasuria konfiskohet nëse personi i akuzuar (*autori i veprës penale*), nuk ka mundur të ofrojë prova se dobia është përfituar në mënyrë të ligjshme. Me këtë dispozitë, në legjislacionin e Bosnjës dhe Hercegovinës është aplikuar

²²⁰ Po aty, neni 396.

²²¹ Po aty, neni 397.

²²² Po aty, neni 398.

²²³ Po aty, neni 399.

²²⁴ Zakon o izvršnom postupku, (*Ligji për procedurën e përmbartimit*) BiH pred Sudom BiH, Službeni glasnik BiH, br. 18/03.

pjesërisht instituti i barrës së kundërt të të provuarit të prejardhjes së pasurisë, çka është edhe objekt analize i juristëve në Bosnjë dhe Hercegovinë e më gjërë. Kjo është e nevojshme për të dhënë përgjigje lidhur me përputhshmërinë e dispozitave në fuqi në Bosnje-Hercegovinë, e veçanërisht lidhur me përputhshmërinë e tyre me parimin e prezumimit, përkatësisht të supozimit të pafajësisë, që mbrohet me nenin 6 paragrafi 2 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Lirive Themelore, e cila sanksionon se: “...seicili që është i akuzuar për një vepër penale do të konsiderohet i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk provohet në pajtim me ligjin.

Këshilli i Europës, në raportin e tij për BH konstaton se shumë raste eventuale të konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale nuk kishin kaluar gjithë shkallët e gjyqësorit dhe shumë prej tyre nuk kishin mundur të gjykoreshin nga Gjykata Kushtetuese e Bosnje- Hercegovinës²²⁵.

5.5.9. Zbatimi i vendimeve të huaja penale të konfiskimit nga Bosnje-Hercegovina

Bosnja dhe Hercegovina po bën, ndonëse në masë të vogël, përpjekje konstante në përparimin e saj drejt BE-së dhe, në këtë kontekst, një numër aktesh ndërkombëtare po sillen në sistemin e saj të brendshëm juridik. Në këtë kontekst, Bosnje - Hercegovina ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës për larjen, zbulimin, konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin e dobisë së fituar me vepër kriminale dhe atë për financimin e terrorizmit. Bosnje-Hercegovina ka ratifikuar tërë tekstin e Konventës, në ndryshim nga disa shtete që e kanë ratifikuar Konventën, por në të njëjtën kohë kanë ruajtur të drejtën që të mos zbatojnë nenin 3 paragrafi 4 të saj, si të pajtueshëm me legjislacionin e tyre nacional. Të tilla janë p.sh Sllovenia, Sllovakia, Rumunia etj.

Pjesa e theksuar e nenit 3 të Konventës përcakton se: “Çdo palë do të miratoj masa të caktuara legjislative dhe masa tjera me të cilat kërkon që, për një vepër të rëndë penale ose vepra të definuara me legjislacionet nacionale, autori i veprës penale të ofroj prova për burimin e dobisë së theksuar pasurore ose të pasurisë tjetër që mund të konfiskohet, nëse kërkesa është në pajtim me parimet e legjislacionit të saj nacional ”²²⁶.

²²⁵https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_bosnia_and_herzegovina.pdf

²²⁶Council of Europe, Convention on Laundering, Search, Seizure and Confiscation of the Proceeds from Crime and on the Financing of Terrorism, Warsaw, 16.V.2005; <http://conventions.coe.int/> (qasur me, 20.01.2012.)

Bosnje-Hercegovina aktualisht po punon edhe për vendosjen e bashkëpunimeve bilaterale në funksion të luftës kundër krimit dhe veprave të rënda penale. Një marrëveshje e tillë është nënshkruar mes saj dhe Republikës së Shqipërisë në 2009. Ligji nr. 10 191/2009 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes mes Këshillit të Ministrave të RSH dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjes dhe Hercegovinës për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar” obligon këto dy vende për një startegji të përbashkët dhe një bashkëpunim të pakufizuar në kohë, kryesisht në pengimin dhe zbulimin e veprave të rënda penale, në bazë të interesit reciprok²²⁷.

Në përpjekjen e saj Bosnje Hercegovina ofron hapa inkurajues në raport me bashkëpunimin në fushën e ekzekutimit të dënimeve penale, përfshirë vendimet që kanë lëndë konfiskimin e pasurive të fituara nga veprime kriminale. Kështu Bosnje Hercegovina bën, ndonëse jo plotësisht njohjen e vendimeve të huaja të konfiskimit. Ky konfiskim është i realizueshëm pasi edhe njohja e vendimeve të tilla të huaja nuk kërkon zbatimin e ligjit penal të Bosnje Hercegovina ndaj veprës penale të kondicionuar. Sapo të njihet, aktgjykimi i huaj zbatohet së bashku me urdhrin e konfiskimit, mbështetur në nenin 37 (paragrafi 2 dhe 3) të Ligjit të Bosnje Hercegovina për konfiskimin e të ardhurave nga kriminaliteti.

Vendimet e autoriteteve kompetente në Bosnje dhe Hercegovinë, të miratuara në bazë të Ligjit për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale, të cilat kërkojnë konfiskim të përkohshëm, duhet t'i paraqiten Agjencisë në ekzekutim. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni janë të zbatueshme për vendimet e autoriteteve kompetente në Bosnjë dhe Hercegovinë, të cilat njohin dhe zbatojnë aktgjykimet e huaja, nëse këto vendime përmbajnë një masë konfiskimi të pasurisë dhe të ardhurave nga krimi.

Rrjedhimisht, masa e konfiskimit brenda aktgjykimit është e zbatueshme në territorin e vendit të kërkuar edhe kur ligji penal nuk është i zbatueshëm për veprën.

Dy situata kur konfiskimi duhet të kyhet sipas legjicacionit të Bosnje Hercegovinës për konfiskimin e të ardhurave nga vepra penale janë:

- Kur është marrë një kërkesë e huaj e ekzekutueshme për ekzekutimin e një urdhri konfiskimi të veçantë të lëshuar në vendin kërkues dhe
- Kur është marrë një kërkesë e huaj e ekzekutueshme për konfiskim pa ndonjë urdhër konfiskimi të lëshuar në shtetin kërkues.

Dispozitat e mësipërme janë vërtetë hapat inkurajues por, vërejmë se Bosnje dhe Hercegovina nuk është palë e Konventës Europiane mbi Vlefshmërinë Ndërkombëtare të

²²⁷http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2009/PDF-2009/181-2009.pdf

Vendimeve Penale, as palë e instrumenteve të tjera europiane për njohjen dhe zbatimin e akteve/vendimeve gjyqësore të huaja (gjykimet, urdhëresat). Kjo nuk duhet të jetë një situatë e qëndrueshme, pasi tendenca e përgjithshme në Europë është të përputhet dhe të zbatohet parimi themelor i njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore²²⁸.

Pavarësisht se Bosnje-Hercegovina nuk është pjesë e BE-së, zbatimi i parimit të mësipërm nuk mund të shmanget duke pasur parasysh orientimin e saj drejt BE-së. Ky parim është reflektuar në nenin 82 (1) (i) të Traktatit të vitit 2012 të Funksionimit të Bashkimit European dhe kjo dispozitë nxit njohjen reciproke të sanksioneve (dënimeve dhe masave të sigurisë) në BE, përfshirë urdhërat për ngrirje dhe konfiskim dhe dënimet financiare mbi ekzekutimin në Bashkimin European të urdhrave për ngrirjen e pronës ose provave, mbi zbatimin e parimit të njohjes së ndërsjellë në dënimet financiare²²⁹.

5.6. Serbia

Republika e Serbisë, luftën kundër kriminalitetit të organizuar e ka definuar si prioritet shtetëror dhe një nga bartësit kryesor të kësaj lufte është Ligji për konfiskimin e pasurisë së dalë nga vepra penale²³⁰, i miratuar në fund të vitit 2008. Sipas informacioneve të Ministrisë së Drejtësisë të Serbisë vlera e pasurisë së përhershme ose të përkohshme të konfiskuar deri në mars 2011 është vlerësuar në mbi 300 milion euro²³¹. Në vazhdim do të sjellim dispozitat më të rëndësishme të Ligjit të përmendur, me të cilin është definuar procedura e konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë jolegale dhe administrimi i kësaj pasurie, administrim që kryhet nga një institucion i veçantë, i krijuar për këtë qëllim - Drejtoria për Administrimin me Pasurinë e Konfiskuar.

²²⁸ <https://www.scirp.org/Journal/PaperInformation.aspx?PaperID=78335>

²²⁹ Po aty.

²³⁰ Pjesë e deklaratës së Ministres së Drejtësisë të Republikës së Serbisë në Konferenca Rajonale të Ministrave të Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme të Evropës Juglindore, Bečići, 17 mars 2011; <http://www.mpravde.gov.rs>

²³¹ Po aty.

5.6.1. Ligji për konfiskimin e pasurisë së dalë nga vepra penale

Me këtë ligj rregullohen kushtet, procedura dhe organet kompetente për zbulimin, konfiskimin dhe administrimin e pasurisë së dalë nga vepra penale²³². Ky ligj aplikohet për veprat penale të poshtëshënuara:

- krimi i organizuar;
- shfaqja e materialit pornografik dhe shfrytëzimi i fëmijëve për pornografi²³³;
- krimet kundër ekonomisë²³⁴;
- prodhimi i paautorizuar, mbajtja dhe hedhja në qarkullim e mjeteve narkotike²³⁵;
- krimet kundër rendit dhe qetësisë publike²³⁶;
- abuzimet e zyrtarëve publik²³⁷;
- krimet kundër njerëzimit dhe të mirave tjera të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare²³⁸.

Për vepra penale të caktuara nga Ligji Penal i Republikës së Serbisë²³⁹ zbatohen dispozitat e këtij ligji nëse dobia pasurore e përfituar me vepër penale, përkatësisht vlera e sendit nga vepra penale kalon shumën prej një milion e pesëqind mijë dinarë (më shumë se katërdhjetë mijë euro të konvertuar). Vepra të tilla penale²⁴⁰ janë: shfaqja e materialeve pornografike; shitja, shpërndarja ose fshehja e mallit të pa zhdoganuar ose organizimi i rrjetit të stërshitësve ose të ndërmjetësve për shpërndarjen e mallit të tillë; punimi, shitja, furnizimi, ndërrimi, bartja ose mbajtja e paautorizuar e armës së nxehtë; përfitimi i dobive për veten ose për tjetrin duke mundësuar kalimin e palejueshëm të kufirit të Serbisë ose të qëndrimit të palejueshëm apo tranzitit nëpër Serbi të personit i cili nuk është shtetas i Serbisë, nëpërmjet grupeve të organizuara ose me keqpërdorimin e pozitës zyrtare; pranimi i shpërblimeve ose dobisë tjetër për shkak të ndërmjetësimit të kundërligjshëm me shfrytëzimin e pozitës zyrtare ose shoqërore apo të ndikimit; pranimi i mitos (dhuratave, dobisë pasurore); dhënia e mitos; krimet e luftës kundër popullsisë civile; prodhimi i palejueshëm i armëve, përdorimi i të cilave është i ndaluar; vrasja e kundërligjshme dhe

²³² Neni 1 i Ligjit për konfiskimin e pasurisë së dalë nga vepra penale, miratuar më 23 tetor 2008; www.parlament.gov.rs

²³³ Ligji Penal të Republikës së Serbisë, neni 185 paragrafi 2 dhe 3.

²³⁴ Po aty, neni 223 paragrafi 3, neni 224 paragrafi 2, neni 225 paragrafi 3, neni 226 paragrafi 2, neni 229 paragrafi 2 dhe 3, neni 230 paragrafi 2 dhe neni 231 paragrafi 2 i Ligjit Penal të Republikës së Serbisë.

²³⁵ Po aty, neni 246 paragrafi 1 dhe 2.

²³⁶ Po aty, neni 348 paragrafi 3 dhe neni 350 paragrafi 2 dhe 3.

²³⁷ Po aty, neni 359 paragrafi 3, neni 363 paragrafi 3, neni 364 paragrafi 3, neni 366 paragrafi 5, neni 367 paragrafi 1, 3, 5, dhe 6 dhe neni 368 paragrafi 1 deri 3 dhe 5.

²³⁸ Po aty, neni 372 paragrafi 1, neni 377, neni 378 paragrafi 3, neni 379 paragrafi 3, neni 388 deri 390 dhe neni 393.

²³⁹ www.parlament.gov.rs

²⁴⁰ Po aty.

plagosja e armikut në mënyrë mizore për interes personal gjatë luftës ose konfliktit të luftës; trafikimi i njerëzve; tregëtimi i fëmijëve me qëllim adoptimin e tyre; themelimi i marrëdhënies së skllavërisë dhe transporti i personave në marrëdhënie skllavërie dhe financimi i terrorizmit²⁴¹.

5.6.2. Organet kompetente

Ligji parashikon se organet kompetente për zbulimin, konfiskimin dhe administrimin e pasurisë së dalë nga vepra penale janë prokurori publik, gjykata, njësia organizative e Ministrisë së Punëve të Brendshme, kompetente për hetimin financiar dhe Drejtoria për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar. Komeptenca e prokurorit publik dhe e gjykatës për këtë procedurë përcaktohet sipas kompetencës së gjykatës për veprën penale nga e cila e ka prejardhjen pasuria²⁴².

Njësia organizative kompetente për hetimin financiar (*më poshtë Njësia*), është njësi organizative e specializuar e Ministrisë së Punëve të Brendshme, detyrë e të cilës është zbulimi i pasurisë me prejardhje nga vepra penale dhe funksione të tjera në pajtim me këtë ligj. Punët e Njesisë kryhen sipas detyrës zyrtare ose sipas urdhërit të prokurorit publik dhe gjykatës. Organi shtetëror dhe organi tjetër, organizatat dhe shërbimet publike janë të detyruara ti ofrojnë ndihmë Njesisë. Ministri i Punëve të Brendshme ka tagrin e nxjerrjes së aktit për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Njësi dhe njëherësh emëron drejtuesin e Njesisë pas marrjes më parë të mendimit nga Prokurori Publik të Republikës²⁴³.

Drejtoria për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar (*Drejtoria*), është organ në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë. Sikurse Njësia, edhe Drejtoria ushtron kompetencat e saj në përputhje me detyrën zyrtare ose sipas urdhërit të prokurorit publik dhe gjykatës. Organet shtetërore dhe organet e tjera, organizatat dhe shërbimet publike janë të detyruara t'i ofrojnë ndihmë Drejtorisë në çdo rast²⁴⁴.

Ligji ka definuar se Drejtoria kryen këto punë:

- Adminstron pasurinë e konfiskuar në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë këtë lëndë;
- Kryen vlerësimin profesional të pasurisë së konfiskuar të dalë nga vepra penale;

²⁴¹ Ligji për konfiskimin e pasurisë të dal nga vepra penale, neni 2.

²⁴² Po aty, neni 5.

²⁴³ Po aty, neni 6 dhe 7.

²⁴⁴ Po aty, neni 8.

- Deponon, ruan dhe shet pasurinë e konfiskuar përkohësisht, të dalë nga vepra penale dhe disponon mjetet e fituara nga shitja në përputhje me ligjin;
- Mban evidencat për pasurinë e konfiskuar, si dhe procedurat gjyqësore me të cilat është vendosur për pasurinë e tillë;
- Merr pjesë në ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare;
- Merr pjesë në trajnimin e nëpunësve shtetëror dhe të bartësve të funksioneve gjyqësore lidhur me konfiskimin e pasurisë së dalë nga vepra penale;
- Kryen punë të tjera në pajtim me këtë ligj.

Drejtoria kryen funksione edhe lidhur me administrimin e dobisë pasurore të dalë nga delikti ekonomik, përkatësisht kundërvajtja²⁴⁵.

Në kuadër të luftës kundër kriminalitetit Serbia është përfshirë, ashtu si dhe shumë vende të Europës Juglindore në programet e BE-së, qëllimi i të cilave është të rrisë kapacitetin institucional dhe funksionimin efikas të Drejtorisë për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara në Ministrinë e Drejtësisë, Njësinë e Hetimeve Financiare të Ministrisë së Brendshme si dhe institucione të tjera kyçe²⁴⁶. Objektivi i përgjithshëm synon të kontribuojë në demokracinë dhe sundimin e ligjit përmes parandalimit dhe kontrollit të krimit ekonomik, përmes zhvillimit të sistemit të rikuperimit të pasurive kriminale në përputhje me standardet europiane dhe ndërkombëtare dhe rekomandimet MONEYVAL dhe GRECO për Republikën e Serbisë.

Republika e Serbisë, e mbështetur dhe nga fondet IPA të Bashkimit European, ka përparuar me dispozitat që rregullojnë fushën e konfiskimit të pasurive të dala nga vepra penale dhe ia ka dalë të adresojë legjislacionin përkatës për të siguruar koherencën e tij të brendshme, pajtueshmërinë e tij me standardet ndërkombëtare dhe lehtësim në zbatimin praktik të ligjit. Ligji për ruajtjen dhe administrimin e pasurive të konfiskuara, vendos mirë administrimin e pasurive të konfiskuara të dala nga vepra të ndryshme penale dhe përcakton se kontabiliteti i pronave të sekuestruara kryhet sipas dispozitave të legjislacionit tatimor²⁴⁷. Ai gjithashtu përcakton se si ruhen sendet dhe pronat e sekuestruara dhe kënaqshëm detajon këtë, përherë në funksion të mirë të administrimit të pronave të sekuestruara. Ligji parashikon se përveç depove të magazinimit të pasurive të konfiskuara,

²⁴⁵ Po aty, neni 9.

²⁴⁶ <http://www.coe.int/en/web/belgrade/project-on-criminal-assets-recovery-in-serbia>

²⁴⁷ Rregullat e Procedurës me pronat e luajtshme të konfiskuara gjatë gjithë kontrollit dhe auditimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë", numri i referencës 123/2003).

është e rëndësishme që çdo pasuri e konfiskuar të ruhet mirë në përputhje me elementët e saj të veçantë. Neni 8 i këtij Ligji parashikon se pronat e konfiskuara ruhen përkatësisht në:

1. Bankë - ari, argjendi dhe metale të tjera të çmuara, perlat natyrore dhe produkte të ngjajshme;
2. Rezervat e kompanive të autorizuar për prodhimin, përpunimin dhe shitjen e naftës dhe produktet e naftës - vaji i papërpunuar dhe produktet e naftës të rafinuara;
3. Hapësira publike për parkim - transport ose mjete të tjera të transportit të përdorura për transportin e mallrave dhe tregtimin e mallrave;
4. Depot e kompanive të regjistruara për qarkullimin e barnave mjekësore terapeutike. Mallra në shumicë - droga për përdorim në mjekësi, stomatologji, mjekësi veterinare dhe ndihmëse;
5. Depot e kompanive të regjistruara për prodhimin dhe tregtimin e produkteve ushqimore -Ushqime dhe sende të tjera të prishura;
6. Depoja e kompanive që merren me prokurimin, ruajtjen dhe shitjen e eksplozivëve -Eksplozivë, kimikate dhe substanca të tjera të rrezikshme dhe të lehtë ndezshme.

Këto dhe dispozita të tjera relevante që rregullojnë koordinimin e organeve ligjzbatuese në Serbi së bashku me dispozitat që rregullojnë bashkëpunimin me institucione ndërkombëtare në fushën e konfiskimit të pasurive të dala nga vepra penale, kanë krijuar infrastrukturën e nevojshme teknike dhe institucione kyçe dhe efikase për të drejtuar hetimet financiare, për të analizuar të dhënat mbi pasuritë kriminale, për sekuestrimin dhe konfiskimin e tyre dhe për të kthyer dobinë e kësaj pasurie në jetën e vendit. Si edhe është paraqitë më lartë, Serbia ka arritur rezultate të kënaqshme drejt luftimit të kriminalitetit, nëpërmjet konfiskimit të pasurive të përfituara në mënyrë të kundërligjshme.

5.7. Italia

Konfiskimi është një term i gjendur që në legjislacionin e hershëm italian, në Kodin Penal të vitit 1930, i njohur ndryshe dhe si *Kodi Rocce*. Dispozitat e konfiskimit kanë ndryshuar në funksion të zhvillimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke synuar funksionalitetin e tyre në luftën kundër krimit të organizuar. Por, lufta ndaj aseteve të krimit në Itali mbështetet në një legjislacion më specifik, i cili sqaron dhe bën të funksionojë më mirë dora e shtetit në prarandalimin e veprave penale dhe luftën kundër përparimit dhe forcimit të krimit. Që pas Luftës së Dytë Botërore, për shkak të përmasave të krimit, sistemi ligjor italian njohu nevojën e përsosjes së mekanizmave kundër krimit të organizuar, i njohur ndryshe si MAFIA. Rruga që shteti italian ka bërë për të perfeksionuar mënyrën e sulmit ndaj pasurive mafioze është e gjatë dhe e mbushur me sakrifica, dhunë dhe vonesa, por edhe e pasur me rezultate mbresëlënëse. Kjo rrugë ka ecur nëpër etapa të ndryshme, duke filluar në vitet 60, tek ligji i famshëm i vitit 1982 Rognoni - La Torre, për të arritur në ditët e sotme tek krijimi i Agjencisë Kombëtare të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ndaj krimit të organizuar (ANBSC).

Qëllimi i legjislacionit për konfiskimin, ndryshe nga doktrina që e sheh thjesht si karakter ndëshkues, e përdor një funksion të tillë për parandalimin e krimit, bazuar në bindjen se disponueshmëria e gjërave, instrumentet që përbëjnë veprat, fitim, produkt, etj., nga krimi, mbajnë gjallë idetë dhe ushqejnë mundësi të reja për kryerjen e krimeve të mëtejshme dhe, për këtë arsye, mbajnë gjallë dhe rrezikun.

Kështu, neni 240 i Kodit Penal Italian urdhëron: „Në rast dënimi, gjykata mund të urdhërojë konfiskimin e gjërave që kanë shërbyer ose ishin të destinuara për të kryer krimin dhe të gjërave që janë produkt apo përfitim nga krimi”²⁴⁸ (*Neni referon në nene të tjera, si 676, 773/2, 316 - dhe bën fjalë për veprat e rrënimit të ndërtesave dhe ndërtimeve të reja, dëmtimi i trashëgimënisë arkeologjike, mbajtja e armës, për të cilat parashikohen edhe dënime me gjobë*).

Sipas legjislacionit italian, urdhërohet konfiskimi:

- 1) i gjërave që përbëjnë çmimin e veprës penale, (në Kod, me ligjin e 15 shkurtit 2012, janë futur dispozita të reja mbi masat për të luftuar dukuritë e krimit kibernetik të tilla si përdorimi i mallrave dhe instrumenteve informatike apo elektronike që janë përdorur tërësisht ose pjesërisht për kryerjen e veprave penale të referuara në nenet përkatëse);

²⁴⁸Kodi Italian i Procedurës Penale, Neni 240.

- 2) i sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja, shitja dhe transferimi i të cilave përbën krim, edhe pse nuk është dhënë asnjë dënim.

Dispozita e pikës 1 nuk zbatohet nëse gjëja i takon një personi që nuk është bashkëpunëtor i veprës. Dispozita pikës 2 nuk zbatohet në qoftë se gjërat i takojnë një personi që nuk është bashkëpunëtor i veprës dhe prodhimi, përdorimi, mbajtja, transferimi ose shitja mund të lejohet nga një autorizim administrativ²⁴⁹. Shprehja "*gjërat që i takojnë personit jo bashkëpunëtor në veprën penale*" nënkuptohet si një koncept i gjerë i përkatësisë, dhe jo i kufizuar vetëm në pronësi, duke përfshirë edhe pronarë të palës së tretë, të cilët kanë të drejta për gëzimin e të mirave materiale.

Konfiskimi i aseteve të krimit ose i gjërave që përbëjnë çmimin e krimit, të cilat janë përdorur për kryerjen e veprës penale dhe për ato që janë produkt dhe fitim nga vepra penale shkojnë në funksion të zhvillimit urban dhe në favor të trashëgimisë së qytetit. Një masë e tillë mund të jetë fakultative ose e detyrueshme. Konfiskimi fakultativ vendoset nga gjyqtari në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë së veprës penale dhe duhet të marrë parasysh efektin e *res* (gjërave) tek fajtori.

Konfiskimi është i detyrueshëm kur *res* është thelbësor për fajtorin. Rastet e detyrueshme për konfiskim, përfshijnë rastet e prodhimit, përdorimit, mbajtjes dhe disponimit të gjërave të caktuara, të cilat përbëjnë në vetvete vepër penale, që edhe nëse nuk janë absolutisht të ndaluara, mbajtja dhe përdorimi i tyre i nënshtrohen një autorizimi paraprak.

5.7.1. Ligji Nr. 575, 31 maj 1965

Lufta e gjatë dhe e vështirë kundër krimit të organizuar dhe shpëlarjes së parave nisi me Ligjin nr.575 të 31 majit 1965, i cili përmban dispozita kundër mafias. Ky ligj u mbështet tek Ligji 1423/56 (Masat për Parandalimin Personal), për shkak të rrezikut social të subjekteve që u shenjua si pjesë e shoqatave mafioze. Edhe pse ligjvënësi i vitit 1965 siguroi aplikimin e mbikëqyrjes së veçantë dhe qëndrimit të detyruar brenda territorit për këto subjekte, kishte limite të theksuara për ti bërë ballë fenomenit. Gjyqet kundër mafias përfundonin shpesh herë me zgjidhje të përgjithshme. Në këtë moment ligjvënësit ndjenë nevojën për të sulmuar organizatat mafioze edhe në profilin e tyre ekonomiko-financiar, nëpërmjet masave që urdhëronin sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të paligjshme²⁵⁰.

²⁴⁹ Po aty, neni 676.

²⁵⁰ <http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/law-ways/tancredi/cap1.htm>

5.7.2. Ndryshimi legjislativ i 1982: Ligji Rognoni - La Torre

Italia nuk është thjesht një vend me kriminalitet. Vitet 70 e vendosën atë në krye të organizimit të grupeve mafioze dhe mafia italiane është identifikuar shumë shpejt si mafia më e organizuar në Europë. Kësisoj lufta kundër saj nuk ishte një luftë e re dhe u pa se përpjekjet e përditshme të shtetit kundër saj kishin nevojë për mbështetje ligjore. Mafiozët, të kthyer në një shoqatë kriminale shumë mirë e organizuar nuk mund të mbaheshin më nën kontroll vetëm nëpërmjet luftës ndaj subjekteve individuale. Lindi nevoja për të sulmuar ekonominë që ushqente aktivitetin e përbashkët kriminal të këtyre individëve. I pari që kuptoi rëndësinë strategjike dhe simbolike të pasurisë për mafiozët ishte Pio La Torre, sekretar i Komisionit Antimafie në Sicili dhe deputet i Partisë Komuniste, i vrarë në Palermo në 30 prill 1982 së bashku me Rosario Di Salvo. Ligji i ri 646/1982, do të prezantonte në Kodin Penal italian artikullin 416-bis, i cili i mbështetur dhe nga norma të tjera, i jepte të drejtë gjykatësit të sekuestronte dhe të konfiskonte jo vetëm kapitalet e mafiozëve, por edhe kapitalet e lidhura në mënyrë direkte dhe indirekte me të dyshuarin, prejardhja e të cilave nuk dihej. Ligji që mori emrin e La Torre-s dhe të Ministrit të Brendshëm Virginio Rognoni, fatëkeqësisht njohu një proces parlamentar jashtëzakonisht të ngadaltë, i cili u përshpejtua vetëm pas vrasjes së La Torre dhe sidomos pas vrasjes së Gjeneralit Carlo Alberto Della Chiesa. Miratimi i Ligjit hapi një etapë të re dhe të sukseshme në luftën kundër krimit të organizuar, shoqëruar dhe me sekuestrimet dhe konfiskimet e shpeshta të të mirave materiale. Hetimet e pasurisë u bënë çështje operacionale e shumë prokurorive.

5.7.3. Sekuestrimi i kapitaleve mafioze - Maxi procesi i Cosa Nostra-s

Mundësitë e reja hetimore dhe gjyqësore të krijuara nga art. 416-bis i Kodit Penal u vunë në zbatim për herë të parë, në mënyrë të jashtëzakonshme në procesin më të madh që Italia njohu kundër mafies. I pagëzuar me emrin MAXIPROCESSO, ky proces ndryshoi rrjedhën e jetës së shumë mafiozëve, ashtu si ju kushtoi jetën shumë shërbëtorëve të shtetit, të vrarë nga bosët e mëdhenj të krimit.

Në Maxiprocesso u aplikua për herë të parë, norma mbi pasuritë sipas ligjit Rognoni-La Torre. Neni 7 i artikullit 416 bis deklaroi se: "është gjithmonë i detyrueshëm konfiskimi i të mirave materiale që ndihmuan ose u destinuan për të kryer krimin, i të mirave që janë çmimi, produkti ose/dhe përfitimi"²⁵¹.

²⁵¹ Codice, Antimafia; <http://www.giurdanella.it/2013/05/22/codice-antimafia-testo-aggiornatoalla-legge->

Kjo dispozitë i hapi rrugë sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive mafioze, pasuri që u vunë më pas në shërbim të shtetit.

5.7.4. Peticioni Libera dhe Ligji 109/1996

Pas viteve të masakrave 1992-93, shoqëria civile reagoi dhe u organizua rreth një projekti që përmbante ripërdorimin e të mirave materiale të konfiskuara nga mafia për qëllime sociale. Shoqata Libera, në 1995, mbledhi 1 milion firma në mbështetje të një peticioni, i cili i propozonte Parlamentit rishikimin e disiplinave të përdorura për destinacionin e pronave të konfiskuara, duke nënvizuar në mënyrë të veçantë rëndësinë e kthimit të këtyre pronave në komunitet dhe ripërdorimin për qëllime sociale. Më 7 mars 1996, u miratua Ligji nr. 109 që përcaktoi dispozita për menaxhimin dhe destinacionin e të mirave materiale të konfiskuara ose të sekuestruara.²⁵²

5.7.4.1. Rehabilitimi i pronave në shoqëri

Falë ligjit për përdorimin social të mallrave dhe pronave të konfiskuara, në 12 vjet lindën përvoja sipërmarrëse padyshim me vlera. Shumë të rinj patën mundësinë për një punë të ndershme, pa pasur nevojë të iknin ose të bënin kompromise. Shumë territore, që për vite i përkisnin klaneve mafioze, shërbyen për mirëqënien e shoqërisë civile. Në korrik të 2001, qindra të rinj morën pjesë në përzgjedhjen që ofronte 15 vende në dispozicion për themelimin e një kooperative që merrte në menaxhim toka të komunave si Piana degli Albanesi, Corleone, Giuseppe Jato, San Cipirello e Monreale, të konfiskuara prej mafies. Në nëntorin e të njëjtit vit, të rinjtë e përzgjedhur formuan Kooperativën sociale Placido Rizzotto – tokë e lirë, e pagëzuar me emrin e sindakalistit të vrarë në 1948²⁵³.

Në pak vite kooperativa u bë model për të tjera eksperiencia të ngjashme jo vetëm në Sicili por edhe Kalabri dhe Puglia; gjithmonë me përzgjedhjen përmes tenderave publik. Kjo përvojë e sukseshme vazhdon. Nëse kooperativat bujqëore janë patjetër shembulli më i prekshëm i suksesit të ligjit për konfiskimin e pasurisë, prona të shumta të sekuestruara nga jugu në veri, janë nën kontrollin e shtetit dhe të mirëbesuara tek komuniteti për ripërdorimin e tyre në shoqëri.

stab/ (qasur me, 22.05.2013).

²⁵² Aktiviteti Agenzia del Demanio, www.agenziademanio.it/index.php.htm

²⁵³ Po aty

5.7.5. Policia Financiare

Kur flitet për kontrollin e fitimit të pasurisë në Itali, nuk mund të shmanget institucioni themelor për atë fushë – policia financiare (*Guardia di Finanza*), ose ndryshe, *Roja Financiare*. *Guardia di Finanza* është polici financiar e njohur edhe në botë, historia e të cilës është e gjatë rreth 200 vite. Fillimet e saj i gjejmë në kohën e Mbretërisë së Piemontit në vitin 1774, ndërsa sot ajo është organizatë ushtarako-policore me autorizime të gjera dhe kontrollon respektimin e legjislacionit tatimor dhe në përgjithësi financiar, rishqyrton “nderin” e obliguesve tatimor dhe të ndërmarrjeve, kryen detyra doganore dhe policore në kufi, dete dhe gjetiu²⁵⁴.

Misioni dhe përgjegjësitë institucionale të policisë financiare italiane janë të ndara në mënyrë: *Prioritare* ku përfshijnë (pengimin, hulumtimin dhe paraqitjen e fshehjeve financiare dhe shkeljen, kontrollin e harmonizimit me dispozitat e interesave politiko-ekonomike dhe mbikëqyrjen në det për qëllime financiaro policore) dhe *kontribuese* (detyrat e ndërlidhura me mbajtjen e rendit publik dhe të sigurisë dhe mbrojtjen politiko-ushtarake të kufijve), ndërsa janë theksuar me Ligjin nr. 189 prej 23 prill 1959 dhe në Dekretin Legjislativ nr.68/2001. *Guardia di Finanza* rreth 68.000 policë, disa prej të cilëve shërbejnë në EUROPOL dhe OLAF (Agjencia Europiane për Luftën Kundër Mashtrimeve)²⁵⁵.

Kompetencat e policisë financiare italiane janë të gjëra. Ato përfshijnë aktivitete financiare, gjyqësore dhe aktivitete nga fusha e sigurisë publike: fshehja e tatimit, veprat penale financiare, kontrabandës, larjes së parave, tregtisë ndërkombëtare me drogën, imigrimin ilegal, kontrollet doganore dhe kufitare, shkeljen e tëdrejtavetë autorit, operacionet antimafioze, mashtrimet me kartelat kredituese, falsifikimet, financimin e terrorizmit etj.

Policia financiare italiane me iniciativën e saj dhe me iniciativën e organeve të tjera p.sh të gjykatave, kryen kontrollin e financave, pengimin e fshehjes së tatimit, kontrollin preventiv të subjekteve ekonomike, por kompetencat e saj përfshijnë edhe fushën e luftës kundër krimit të organizuar, fushën e mbrojtjes civile e tjera.

Me reformën tatimore në vitin 1974 *policia financiare* fitoi kompetenca plotësuese në pikëpamje të përcaktimit të tatimeve të drejtpërdrejta dhe indirekte, ndërsa me reformën valutore në vitin 1976 detyrat e saj u shtrinë dhe në kontrollin e rrjedhës së parave dhe

²⁵⁴Istraživanje Istraživačkog sektora Državnog zbora Slovenije *Nepravilčno pridobljeno premoženje - pregled zakonodaje*, od 10.04.2008. godine, str. 11-14.

²⁵⁵Guardia di Finanza, Wikipedia; <http://en.wikipedia.org/> (qasur me 14.10.2011.), f. 11-14.

mundësinë e kontrollit të bankave. Detyra themelore e policisë financiare italiane është preventive: pengimi, rishqyrtimi dhe paralajmërimi për fshehjen e tatimit dhe kundërvajtjet e tjera financiare. Për disa detyra policia financiare ka edhe njësi të specializuara. “Me hulumtimin e burimeve të pasurisë dhe krahasimin, me kompetenca të gjera në pikëpamje të çfarëdo dokumentacioni dhe me përjashtime nga rregullat e fshehtësisë bankare, viteve të fundit *Guarda di Finanza* e ka fituar përfundimisht fizionominë e policisë ekonomike dhe ka zhvilluar një teknologji të lartë, e cila bashkë me personelin e specializuar mundëson zbulimin e kundërvajtjeve dhe shkelësve”²⁵⁶.

Roli i kësaj policie në zbulimin e të ardhurave nga veprimtari të ndryshme kriminale është mjaft evident dhe i sukseshëm dhe kjo strukturë vepron, nga njëra anë si një institucion i pavarur dhe në anën tjetër si drejtues i veprimtarive të ngjajshme të organeve të tjera. Në këtë fushë është interesante dhe e rëndësishme e drejta diskrecionale e saj për hetim të pavarur, çka i mundëson kësaj strukture të shikojë dokumentet e individëve dhe ndërmarrjeve, duke përfshirë edhe koorespondencën me partnerët afarist në banka. Kjo kompetencë themelore quhet *kontrolli i përgjithshëm* dhe është arma themelore kundër fshehjes së tatimit. Rezultati i kontrollit analizohet nga organet përkatëse, të cilat konkludojnë nëse ka ose jo fshehje të tatimit. Interesante shfaqet edhe hetimi i personit që do të hetohet, ai përzgjidhet nga indeksi i probabilitetit të fshehjes së tatimit si dhe dyshimet e ndërlydhura me të.

Por nuk mbaron me kaq. Puna e policisë financiare është e rëndësishme edhe në pikëpamjen gjyqësore. Ajo, në të vërtetë, kryen kontrole të detajuara të dokumentacionit dhe individëve të dyshuar për vepra penale, por Ligji i 1983 i dha *Guardia di Finanza*-s njëherësh kompetencën që, nëse dyshimet vërtetohen me fakte, të “vendos menjëherë prangat” për personat që nga hetimet e saj rezultojnë të kenë kryer veprën penale të fshehjes së të ardhurave dhe kryerjen e evazionit fiskal. Në këto kushte policia financiare është bërë armë thelbësore e gjyqësorit në rastet e çështjeve që lidhen me veprën penale të pastrimit të parave”²⁵⁷.

Pavarësisht viteve të gjata të ekzistencës së Policisë Financiare është e nevojshme të theksojmë se legjislacioni që rregullon kompetencat dhe fushën e veprimit të saj ka ndryshuar ndër vite, duke iu përgjigjur realiteteve që sofistikohen përditë dhe duke u

²⁵⁶Jelec, Nihada dhe Osmanovic, Aida, Drçar-Murko, Propisi o Odozimanje Imovine Stečene Krivičnim Djelom I Upravljanju Tom Imovinom, Sarajevë, 2012, fq. 11-14.

²⁵⁷Po aty.

përshtatur dhe koordinuar me legjislacionin ndërkombëtar që rregullon këtë fushë veprimi. Nga ligjet e rëndësishme, të cilët kanë ndikuar në zhvillimin e saj numërohen:

- Ligji nr.376 i viti 1906, me të cilin është formuar Komanda e Përgjithshme në varësi të Ministrisë së Financave;
- Ligji nr.95/1923 kur pranë Ministrisë së Financave është formuar zyra e policisë financiare;
- Ligji nr.63/1296 me të cilin nëpunësit civil dhe policitë gjyqësore kanë fituar detyra hetimore, autorizime për metoda të fshehta të punës dhe grumbullim të informacioneve me ndihmën e burimeve dhe të bashkëpunëtorëve;
- Ligji nr 4/1929 me të cilin është themeluar njësia e policisë gjyqësore për luftën kundër rrjedhjes së paligjshme të parasë jashtë vendit, kundër falsifikimit të parave dhe letrave me vlerë;
- Ligji nr. 189/1959 dhe Ligji nr. 200/1966 me të cilat Korpusi i rojës financiare është përfshirë në pjesën përbërëse të forcave ushtarake të Republikës së Italisë.

Përgjegjësia e policisë financiare italiane është:

- si polici financiar mbron financat publike nga çdo shfrytëzim i paligjshëm, që ndikon në të hyrat dhe të dalat publike;
- si polici ekonomike kujdeset për luftimin dhe ndalimin e çdo infiltrimi të mundshëm, të dëmshëm për veprimin ekonomik dhe financiar të tregut.

Për kryerjen e këtij misioni, legjislacioni ekzistues i jep kësaj policie autorizime të veçanta hetimore, mundësinë e kryerjes së aksioneve preventive si dhe informimin dhe kontrollin financiar në tërë territorin. Organet e policisë financiare kanë autoritetin të vetëmarrin iniciativa dhe masa në rastin e hetimit të të ardhurave, të kundërvajtjeve financiare dhe shkeljeve të tjera të dispozitave. Pas hetimit, policia financiare mundet, sipas ligjit, të kërkojë provën për ligjshmërinë e pasurisë së fituar, e njohur ndryshe si barra e kundërt e të provuarit.

Në ndërlidhje me këtë janë thelbësore dispozitat e Ligjit nr.356 të vitit 1992 të cilat, në pikëpamje të ngrirjes së pasurisë, caktojnë lehtësim të barrës së dëshmimit që ka të bëjë me veprimet e caktuara penale (tregëtinë e paligjshme me drogën, krimi i organizuar, shpëlarja e parave). Neni 12 i Ligjit parashikon konfiskimin e detyrueshëm të parave, pasurisë dhe pronës së personit, mbi të cilin rëndon akuza për ndonjë nga veprat penale të theksuara më sipër, në rastet kur ai nuk mund të arsyetojë burimin e pasurisë dhe kur pasuria nuk është në proporcion me të hyrat e saj ose të veprimtarive ekonomike të të akuzuarit. Në këto

raste nuk nevojitet të dëshmohet se pasuria rrjedh në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekt nga vepra penale. Pasuria, e cila në mënyrë direkte ka prejardhjen nga të hyrat e paligjshme ose nga mënyra të tjera të fitimit mund të ngrijë, nëse personi i akuzuar nuk dëshmon burimin e saj. Përfundim paraqet pasuria e personit të tretë. Administrimi me pasurinë e ngrirë rregullohet me ligj.

Ligji italian për financat nga viti 2005 përfshinë gjithashtu disa dispozita që i përkasin vlerësimit tatimor me synim përmirësimin e qasjes në informacionet bankare për organin tatimor - *Revenue Agency* dhe policinë financiare - *Guarda di Finanza*. Këto institucione tani mund të kërkojnë informacione jo vetëm nga bankat dhe zyrat postare, por edhe nga ndërmjetësit vendor dhe të huaj, fondet e investimeve dhe shoqëritë për administrim.

Vëllimi dhe llojet e informacioneve që kërkohen shtohen dhe nëse në të kaluarën këto organe mund të kërkonin vetëm kopjet e llogarive të obliguesve tatimor ose kopjet e transaksioneve të ngjashme, tani organet tatimore mund të kërkojnë informacione për cilindo transaksion në mes të obliguesve tatimor dhe bankave ose të ndërmjetësve të tjerë financiar (kjo përfshin edhe shitjen e lirë apo qasjen në kasafortat bankare në cilatdo shërbime financiare). Këto dispozita janë plotësuar në vitin 2006.

Në Republikën Italiane pasuria e sekuestruar dhe e konfiskuar nga rrjetet kriminale administrohet nga një strukturë e veçantë, nga Agjencia Italiane për Pasurinë Publike (*Agenzia del Demanio*)²⁵⁸. Agjencia ngarkohet nga ligji të administrojë pasuritë e konfiskuara që në momentin e konfiskimit deri në ndarjen e tyre për destinime shoqërore ose institucionale.

Italia është gjithashtu pjesëtare e organizatave ndërkombëtare dhe europiane, të krijuara në luftën kundër krimit dhe ka hartuar dispozita që mundësojnë edhe kthimin e pronave dhe aseteve të shteteve të huaja, të transferuara në Itali. Për të nxjerrë Urdhrin për Transferim është e nevojshme të zbatohen tre kërkesa kryesore:

- 1) Të ketë një vendim të gjykatës së huaj për të disponuar konfiskimin e të ardhurave nga vepra penale, i cili duhet të njihet nga autoritetet italiane;
- 2) të ketë një kërkesë zyrtare për transferimin e tyre që duhet të lëshohet nga shteti kërkues;
- 3) njohja e vendimit të gjykatës së huaj nga ana e autoriteteve italiane dhe lëshimi i Urdhrit të Transferimit duhet të mbahen njëkohësisht.

²⁵⁸ Burimi:faqja e internetit e agjencionit Italian për pasurinë publike :www.agenziademanio.it

Modalitetet e ekzekutimit konkret të transferimit të aseteve të huaja, të konfiskuara nga Shteti Italian realizohen pas marrëveshjeve specifike dypalëshe, të lidhura ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Italisë dhe autoriteteve kompetente të vendit kërkues.

Ligji italian lejon konfiskimin e pasurisë që rrjedh nga aktiviteti kriminal, ose në përfundimin e një procedure në lidhje me veprat specifike, ose në varësi të sjelljes së përgjithshme të një personi i cili vazhdimisht është i përfshirë në aktivitete të paligjshme ose i varur nga krime të caktuara, pasuritë e të cilit nuk justifikohen në bazë të të ardhurave të tij legjitime. Si procedurat gjyqësore të zakonshme (që synojnë të përcaktojnë përgjegjësinë e të pandehurit në lidhje me veprat specifike), ashtu dhe procedurat për zbatimin e masave parandaluese, konsumojnë përgjithësisht një kohë gjashtë muaj deri në një vit, ku së pari kryhen inspektimet përkatëse dhe verifikimet - shpesh komplekse për shkak të nevojës për të analizuar të dhënat financiare dhe bilancin – dhe pastaj mbahet një seancë me garancitë thelbësore mbrojtëse.

5.8. Sllovakia

Ideja për një ligj të veçantë me të cilin përcaktohet konfiskimi për një kohë të shkurtër i pasurive të fituara në mënyrë të kundërligjshme është realizuar në Sllovaki²⁵⁹. Pas tentimeve shumëvjeçare (prej vitit 2001), ligji 335/2005 për dëshmimin e burimeve të pasurisë është nxjerrë në qershor të vitit 2005 dhe ka hyrë në fuqi më 1 shtator të po atij viti. Ligji u përball me gjykimin në Gjykatën Kushtetuese të Sllovakisë, i cila më 6 tetor 2005 e cilësoi atë si të papajtueshëm me Kushtetutën. Pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese sllovaqe, autoritetet e vendit e kanë konsideruar të domosdoshëm krijimin e bazës së veçantë juridike që do të mundësonte krijimin e një procedure efikase kundër personave të cilët nuk janë të aftë që, në mënyrë burimore, të dëshmojnë prejardhjen dhe mënyrën e fitimit të pasurisë së tyre. Praktika juridike ka konkluduar se ligji i veçantë është i nevojshëm pasi procedurat mbi pasurimin e paligjshëm që janë zhvilluar në bazë të Ligjit Penal vendas, (të ndërlidhura me ligjin civil dhe me aktet e tjera juridike, në veçanti me ato tatimore), shpesh kanë qenë jo të frytshme.

Ligji kishte vlerë për të gjithë personat fizikë që nuk mund të dëshmonin prejardhjen e pasurisë së tyre. Luftëtarët e përpjekjeve për këtë ligj të veçantë theksuan nevojën e tij në

²⁵⁹ Me gjerësisht: Istraživanje Istraživačkog sektora Državnog zbora Slovenije *Neupravičeno pridobljeno premoženje - pregled zakonodaje*, od 10.04.2008 f. 42-44; (Hulumtimi i Sektorit Kërkimor të komisionit shtetëror i Sllovenisë).

rastet e hetimeve dhe gjykimeve ndaj funksionarëve, zyrtarëve të lartë shtetëror dhe personave tjerë. Ligji ka qenë i nevojshëm me rastin e nxjerrjes së vendimeve ekonomike ose financiare në periudhën prej 1.1.1990 dhe më pas, për të kontrolluar sidomos periudhën kur janë nxjerrë vendime të rëndësishme lidhur me privatizimin ose konkurset publike, nëpërmjet të cilave kanë ekzistuar edhe mundësitë më të mëdha për begatim të paligjshëm²⁶⁰.

5.8.1 Ligji 335/2005 për dëshmimin e burimeve të pasurisë

Ligji ishte bazuar në konceptin që çdokush duhet të jetë i aftë që të dëshmojë burimin e pasurisë së tij. Në rast se nuk mund të dëshmojë, shteti duhet të ketë bazën juridike për fillimin e procedurës civile në gjykatë, në të cilën i akuzuari duhet të përgënjeshtroj dyshimet serioze për burimin e pandershëm të pasurisë së tij. Në rast se personi nuk e dëshmon burimin e pasurisë dhe prejardhja e asaj pasurie është në pikëpyetje, gjykata mund të vendos që pasuria e tillë të konfiskohet në dobi të shtetit. Në pajtim me këtë ligj, organet shtetërore kanë detyrë të informojnë policinë financiare në rastin e dyshimit serioz, se pasuria e personit të caktuar është fituar me mjete të paligjshme.

Në bazë të këtij ligji është shfrytëzuar procedura juridike civile zakonore. Policia financiare, në bazë të thirrjes së shkruar (fletëparaqitjet joanonime të organit shtetëror, të personit fizik ose juridik), ose në bazë të iniciativës vetiake nis hetimin e të hyrave përkatëse të personit, vlerën e pasurisë së tij të përgjithshme dhe mënyrën e fitimit të asaj pasurie. Ligji përcaktonte se policia financiare do të kishte të drejtë të kërkonte sqarime nga personi që hetohet si dhe të kërkonte pjesëmarrjen në hetim të organeve tjera shtetërore dhe personave të tjerë fizik dhe juridik. Policia financiare do të kishte të drejtë të hynte në hapësirat relevante dhe të kontrollonte dokumente dhe shkresa të tjera që i përkisnin personit të caktuar. Në bazë të asaj të drejte do të kishte mundësi që të kërkohej nga bankat informacion relevant për palët, papërfshirë rastet kur informacioni i tillë ishte pjesë e të ashtuquajturës fshehtësi bankare.

Në rastin kur policia financiare vërtetonte se vlera e pasurisë kalonte të hyrat legale të personit së paku 1.000 herë nga paga minimale, kjo doemos duhet t'i paraqitej me shkrim prokurorit të gjykatës kompetente, siç është përcaktuar me Ligjin për Procedurën Civile.

Prokurori pas verifikimit të paraqitjes dhe pas dëshmimit plotësues të mundshëm të personit duhet të hulumtoj prejardhjen e pasurisë, e cila është theksuar në parashtresën e

²⁶⁰Po aty, fq.42.

policisë financiare. Nëse për prokurorin arsyetimi është i pamjaftueshëm, ose nëse personi i dyshuar, nuk e jep sqarimin në afatin e përcaktuar nga ligji (30 ditë), prokurori i paraqet gjykatës kërkesën për procedurën e konfiskimit të pasurisë së fituar me mjete të kundërligjshme në kuadër të procedurës juridike civile. Nëse gjatë kohës së procedurës para gjykatës prokurori publik dëshmon ekzistencën e dallimit mes të hyrave të dëshmuara, që i ka fituar i akuzuari, dhe pasurisë së tij të vërtetë së paku për 1.000 rroga minimale, gjykata duhet të nxirrte aktgjykimin se pasuria e të akuzuarit është fituar me mjete të kundërligjshme dhe për këtë arsye duhet sekuestruar në dobi të shtetit. Përkrahësit e atij ligjit kanë deklaruar se krijimi i një ligji të tillë ishte jo vetëm i nevojshëm, por hartimi dhe pranimi i tij përbënte njëherësh një sfidë të madhe për opinionin slovak, demokracinë dhe mentalitetin e këtij vendi. Të provuarit e burimit të pasurisë, sipas mendimit të tyre, është standard i zakonshëm në shumicën e rregullimeve tatimore botërore dhe, si i tillë, është edhe armë e efektshme kundër shpëlarjes së parave, korrupsionit dhe shmangies së pagimit të tatimit.

Në anën tjetër qëndrojnë kritikët e këtij Ligji, të cilët kanë konsideruar se ndarja e barrës së të provuarit mes prokurorit publik dhe të akuzuarve nuk është e pranueshme nga dy arsye. Sipas tyre, Ligji nuk e arrin qëllimin e ndjekjes së personave të pasuruar në mënyrë të paligjshme sepse është shumë e besueshme se nuk do të kishin problem me “të provuarit” e burimeve të pasurisë (donacionet ose kredi nga personat privat, por edhe nga personat e vdekur), kurse në anën tjetër do të ekzistonte rreziku i caktuar i keqpërdorimit. Ai rrezik del nga fakti se policia financiare është e obliguar që të hulumtojë çdo fletëparaqitje, përveçse nëse tregohet se ka qenë e paarsyeshme. Paraqitësi nuk është i obliguar të theksojë arsyet e dyshimit të tij dhe nuk mban kurrfarë përgjegjësie për paraqitjen e mundshme pa bazë. Edhe pse qëllimi i ligjit sipas mendimit të shumicës së profesionistve ishte i drejtë, mjetet për arritjen e atij qëllimi ishin përzgjedhur keq. Në këto kushte shteti ka shkuar në drejtim të rezistencës më të vogël: në vend që të përdor më mirë kontrollin nëpërmjet mekanizmave represiv që disponon, ka zvogëluar rëndësinë e elementit esencial të shtetit të së drejtës/ligjor, atë që i ngarkon të akuzuarit, barrën e të provuarit. Sistemi juridik ekzistues do të kishte mjaft instrumente për zbulimin e begatimit të paligjshëm. Shumë ekspertë kanë shprehur mendimin se më shumë mjete duhen destinuar për përmirësimin e kualitetit të hulumtuesve, të shërbimit tatimor, të gjyqtarëve etj. Prokurori shtetëror ka shtjelluar vështirësitë e mundshme me respektimin e standardeve juridike. Ai vëren se edhe pse policia financiare është e autorizuar të hyj në ndërmarrje, personi fizik mund të refuzojë hyrjen e policisë në shtëpinë e tij. Kështu, hetuesikufizohet seriozisht në

përcaktimin e vlerës së pasurisë. Prokurori shtetëror ka bërë me dije edhe vështirësitë kur nevojiten informacione nga bankat e huaja për palët sllovake, pasi legjislacioni sllovak nuk mund t'i detyrojë bankat e huaja të japin të dhëna për organet e saj të hetimit.

Sipas mendimit të kritikëve dobësia e atij ligji ka qenë ajo se nuk i ka caktuar as problemet as zgjidhjen e tyre në mënyrë të drejtë, por i ka fshehur. Shumica e vlerësuesve është e mendimit se zbatimi i ligjit, të hedhur tashmë poshtë nga Gjykata Kushtetuese, do të ishte i vështirë dhe efekti praktik i tij do të ishte minimal. Kundërshtarët kanë evidentuar parreshtur rrezikun real se njerëzit e ndershëm do mund të ishin pre e akuzave të fqinjëve të tyre ziliqar ose e njerëzve që nuk dakordoheshin me ta.

Lidhur me këtë lëndë Sllovakia, në përpjekjet e saj për një ligj më kompetent dhe të saktë për konfiskimin, përdor dispozitat e Kodit aktual Penal, nr.301/205, i cili në Nenin 14 deklaron se një gjykatë e specializuar ka juridiksion mbi personat në lidhje me:

1. veprat penale të vrasjes së shkallës së parë;
2. veprat penale të praktikave mashtruese në prokurimin publik dhe ankandin publik në pajtim me Nenin 266 paragrafi 3 i Kodit Penal;
3. veprat penale të falsifikimit, ndryshimeve mashtruese dhe prodhimit të paligjshëm të parave dhe letrave me vlerë në bazë të nenit 270 paragrafi 4 të Kodit Penal;
4. veprat penale të shpërdorimit të pushtetit nga një zyrtar publik në pajtim me nenin 326 paragrafi 3 dhe 4 të Kodit Penal në pajtim me veprën penale sipas shkronjave b), c), e), f), g), j) ose k);
5. veprat penale të ryshfetit pasiv sipas nenit 328 deri 331 të Kodit Penal;
6. veprat penale të ryshfetit aktiv në pajtim me nenin 332 deri në 335 të Kodit Penal;
7. veprat penale të tregtimit të paligjshëm në pajtim me nenin 336 të Kodit Penal;
8. veprën penale të themelimit, të themelimit dhe mbështetjes së një grupi kriminal dhe veprat penale të themelimit, themelimit dhe mbështetjes së një grupi terrorist;
9. krime veçanërisht serioze të kryera nga një grup kriminal ose një grup terrorist;
10. vepra penale kundër pronës sipas Kreut të Katërt të Pjesës së Veçantë të Krimit;
11. veprat penale kundër interesave financiare të Komunitetit Europian;
12. veprat penale që lidhen me ato të referuara në nënparagrafët a) deri në j) ose k)²⁶¹.

I njëjti legjislacion, në nenin 95 të tij rregullon sekuestrimin e pasurive financiare atëherë kur faktet tregojnë se mjetet financiare në një llogari banke ose në një bankë të huaj ose mjetet e tjera financiare janë të dedikuara për kryerjen e një vepre penale...; Në këto raste

²⁶¹<http://policehumanrightsresources.org/wp-content/uploads/2016/08/Criminal-Procedure-Code-No.-301-2005.pdf>.

kryetari i një kolegji gjyqtarësh dhe një prokuror në fazën paraprake mund të urdhërojë marrjen e mjeteve financiare. Urdhëri për sekuestrimin sipas fjalisë së parë mund të përfshijë edhe asetet financiare shtesë të grumbulluara në llogari, duke përfshirë të drejtat ndihmëse, nëse arsyeja e sekuestrimit i referohet edhe atyre.

Nëse rasti nuk lejon vonesën, prokurori mund të urdhërojë sipas paragrafit 1 sekuestrimin edhe më parë se fillimi i procedurës penale. Një urdhër i tillë konfirmohet nga një gjyqtar gjatë procedurës paraprake brenda 48 orësh, ndryshe bëhet e pavlefshëm. Kur urdhri jepet me shkrim dhe arsyetohet.

Konfiskimi nuk përfshin mjetet financiare që janë të nevojshme për të plotësuar nevojat përjetën e personit të akuzuar ose nga të cilat varet edukimi ose ekzistenca e personit për të cilin personi që i është konfiskuar pasuria financiare, është i detyruar të kujdeset.

Nëse sekuestrimi i aseteve financiare nuk është më i nevojshëm për qëllimet e kriminelit sekuestrimi ndalohet ose reduktohet. Kryetari i kolegjit të gjyqtarëve dhe prokurori, gjatë procedurave paraprak e vendosin me urdhër për lënien mënjane ose reduktimin e sekuestrimit.

Urdhëri sipas paragrafit 1 dhe 2 do t'i dorëzohet gjithmonë bankës, degës së bankës së huaj ose personit tjetër juridik ose fizik, i cili disponon asetet financiare dhe tek personi, pasuritë financiare të të cilit janë konfiskuar.

Pasuritë financiare të sekuestruara mund të konfiskohen vetëm në bazë të marrëveshjes së mëparshme të kryetarit të panelit të gjyqtarëve dhe prokurorit në procedurat paraprake. Ndërkohë që konfiskimi ecën, të gjithë aktet ligjore dhe kërkesat për asetet financiare të konfiskuara janë joefektive.

Personi, pasuritë financiare të të cilit janë sekuestruar, lejohet të kërkojë vendosjen e ankesës ose reduktimin e sekuestrimit. Kryetari i kolegjit të gjyqtarëve dhe prokurori në procedurat paraprake do të vendosin pa vonesë për këtë aplikim. Kundër këtij vendimi mund të depozitohet ankesë. Nëse ankesa është hedhur poshtë, personi pasuria financiare e të cilit është sekuestruar lejohet të dorëzojë përsëri ankesë pa qenë i detyruar për të dhënë arsye të reja pas kalimit të 30 ditëve nga ankesa e parë.

Nëse është e nevojshme të konfiskohen pasuritë financiare në procedurën penale për të siguruar kërkesën për dëmet e viktimës, paragrafët 1 deri 8 do të zbatohen *mutatis mutandis*²⁶².

²⁶²<http://policehumanrightsresources.org/wp-content/uploads/2016/08/Criminal-Procedure-Code-No.-301-2005.pdf>

Sipas Kodit të Procedurës Penale të Sllovakisë konfiskimi i pronës kryesisht qeveriset nga nenet 58 deri në 60, ndërsa konfiskimi i një sendi është i rregulluar sipas nenit 83 të Kodit të Procedurës Civile që përcakton kushtet për "Konfiskimin e pronës". Sipas nenit 60 të Kodit të Procedurës Penale gjykata urdhëron edhe konfiskimin e të hollave kur vërtetohet se ato:

- a. janë përdorur për kryerjen e një vepre penale;
- b. kanë qëllim të përdoren për kryerjen e një vepre penale;
- c. janë marrë me anë të një vepre penale, ose si shpërblim për kryerjen e një vepre penale, ose;
- d. janë marrë nga shkelësi në këmbim të një sendi.

Paragrafi i dytë i nenit 60 sqaron edhe rastin kur vlera e një sendi është e paarrtshme ose e paidentifikueshme për shkak të bashkimit me pronën e kryerësit të veprës penale. Në këto raste gjykata mund të imponojë konfiskimin e sendit vlera e të cilit korrespondon me vlerën e sendit që vërtetohet i fituar nga vepra kriminale.

Duke e ditur vlerën dhe rëndësinë e luftimit të kriminalitetit, parlamenti sllovak, tenton, pavarësisht nga ngadalësia e ecjes, të harmonizohet me rregullat e BE. Kjo përpjekje nxitet fort dhe imponohet me forcë edhe nga fakti se Sllovakia është e anëtarësuar në Unione. Në këtë kuadër, në 13 nëntor 2015, parlamenti sllovak miratoi një akt që ka prezantuar konceptin e përgjegjësisë penale të personave juridikë (*i panjohur deri tani*). Akti u botua në fletoren zyrtare të akteve si akt nr. 91/2016 Coll. mbi Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë ("Akti")²⁶³. Data e hyrjes në fuqi e Aktit është 1 Korriku 2016 dhe sfondi i tij është rezultat i përpjekjeve, të cilat duhet pranuar kanë dështuar gjatë viteve të fundit, për të harmonizuar ligjin kombëtar të Sllovakisë me qëndrimet e organizatave ndërkombëtare si BE, OECD dhe Këshilli i Europës. Legjislacioni deri tani ka mbajtur persona juridikë përgjegjës vetëm në mënyrë indirekte, në një kornizë të ngushtë legjislative, që lejonte vetëm konfiskimin e financave ose pasurive të një personi juridik. Akti krijon përfundimisht një instrument legjislativ të dedikuar që mundëson lidhjen e veprimeve kriminale të një personi fizik me atë të një personi juridik kur ai vepron në emër, në cilësi, në dobi dhe/ose brenda fushës së veprimtarisë së një personi juridik. Për të vendosur përgjegjësinë, në raste të tilla, sipas Aktit, duhet të plotësohen dy kushte me qëllim që të krijohet përgjegjësia penale e një personi juridik. Së pari, duhet të kryhet krimi (Akti paraqet një listë të plotë të krimeve që i ngarkohen një personi juridik,) dhe, së dyti, duhet

²⁶³http://www.minv.sk/swift_data/source/policia/finpol/vyroc_spravy/SVK4_MER_MONEYVAL-2011-21_en.pdf

të ketë një lidhje shkakësore midis (i) interesit ose veprimtarisë së një personi juridik me (ii) sjelljen e paligjshme të personit fizik, sjellja e të cilit është përgjegjëse ndaj atij personi juridik.

Ligji paraqet tre "kategoritë" të personave fizikë, sjellja e paligjshme e të cilëve është e përgjegjshme për një person juridik (nëse kushtet e mësipërme janë plotësuar): Personi fizik duhet të jetë:

1. anëtar i organit ligjor të personit juridik;
2. person me kompetenca mbikëqyrëse tek personi juridik ose
3. personi tjetër i autorizuar për të përfaqësuar ose vendosur në emër të personit juridik.

Sipas Aktit nr. 91/2016 Coll., organet shtetërore, komunat dhe personat e caktuar juridik të përcaktuar me ligj përjashtohen nga përgjegjësia penale. Megjithatë, duhet të theksohet se, fakti që këto subjekte mund të mbajnë aksione nga personat e tjerë juridikë nuk i mbron persona të tillë juridikë nga përgjegjësia kriminale sipas kuadrit ligjor të miratuar.

Ndëshkimi i personave fizikë të lidhur me persona juridikë ose edhe të vetë personit juridik ka një katalog të përcaktuar të krimeve, kryesisht në fusha të tilla si tregtia ndërkombëtare e drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, abuzimi seksual, falsifikimi i parasë dhe pastrimi i parave, siguria e të dhënave dhe integriteti i sistemit, ruajtja e mjedisit, terrorizmi, korrupsioni dhe ekstremizmi. Në këtë drejtim, duhet të theksohet se qëllimi i katalogut është një tregues i qartë se pajtueshmëria me detyrimet ndërkombëtare ka qenë prioritet i ligjvënësit slovak. Duket se presionet e organizatave ndërkombëtare për të arritur pajtueshmërinë shërbyen si shtysë kryesore për Sllovakinë dhe për krijimin e Aktit.

Dënimet në dispozicion sipas Aktit përfshijnë shpërbërjen e personit juridik, konfiskimin e aseteve, ndëshkimet financiare deri në 1.6 milion euro, ndalimin e tregëtisë ose veprimtarive të tjera që kërkojnë një autorizim ose licencë, ndalimin kohor të pjesëmarrjes në tenderët e prokurimeve publike, përjashtimin nga aftësia për të marrë grante, subvencione ose përfitime të tjera siç janë kontributet nga fondet strukturore të BE-së ose një lloj i ri dënimi: publikimi i një vendimi dënues²⁶⁴.

²⁶⁴http://www.minv.sk/swift_data/source/policia/finpol/vyroc_spravy/SVK4_MER_MONEYVAL-2011-21_en.pdf

5.9. Irlanda

Në Irlandë është në fuqi sistemi i konfiskimit civil të pasurisë (*civil forfeiture*). Ligji për dobinë pasurore të fituar me vepër penale (*Proceeds of Crime Act, 1996*) i mundëson gjykatës kompetente (*High Court*)²⁶⁵ të caktoj sigurimin ose ngrirjen e mjeteve të ndryshme, të cilat dalin nga veprat penale, përkatësisht kur ekziston dyshimi për burimin e tillë, dhe i mundëson gjithashtu konfiskimin dhe disponimin me ato mjete sa më shumë që është e nevojshme, sikurse i mundëson të kujdeset për punë të tjera lidhura me pronat e konfiskuara. Ligji është përfytyruar më gjerë dhe nuk është i varur nga aktakuza konkrete ose aktgjykimi për veprimin penal²⁶⁶. Në mjetet të cilat janë objekt i ligjit bien paluajtshmëritë, pasuria e luajtshme (p.sh automobilët), paratë e gatshme dhe format e tjera të mjeteve. Ligji është plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2005 (*Proceeds of Crime (Amendment) Act 2005*).

5.9.1 Veprimi i gjykatës në fushën e konfiskimit

Gjykata e theksuar me propozimin e propozuesit të autorizuar dhe atë të policit, të nëpunësve të autorizuar tatimor ose të Zyrës së veçantë për pasurinë e fituar me aktivitete kriminale (*Criminal Assets Bureau – CAB*)²⁶⁷, lëshon urdhëra të llojeve të ndryshme, mes të cilave: urdhërin me afat të shkurtër (*interim order*), urdhërin e përkohshëm (*interlocutory order*) dhe urdhërin për konfiskim (*disposal order*). Gjykata është kompetente për lëshimin e urdhërave nëse p.sh pasuria e personit të caktuar (*respondent*) nxirret në mënyrë të paligjshme nga vendi ose bartet tek një person tjetër. Në një rast të tillë propozuesit duhet të bindin gjykatën se pasuria është fituar me vepër penale, si pasojë e veprimeve penale ose në lidhje me veprimet penale, apo është fituar po në atë kohë, ose është e lidhur me pasurinë që paraqet drejtpërdrejt ose indirekt të hyra të paligjshme nga veprimet penale. Urdhërat afatshkurtër lëshohen më së shumti 21 ditë nëse propozuesi kompetent dëshmon në mënyrë të besueshme se personi posedon ose disponon me

²⁶⁵Gjykata e cila ka kompetencë të gjykatave të rregullta të shkallës së parë dhe të dytë e kryen edhe funksionin e gjykatës kushtetuese.

²⁶⁶Sa i përket sekuestrimit të pasurisë e cila e përcjellë dënimin pas aktgjykimit për veprimin penal, në Irlandë është në fuqi Ligji penal (*Criminal Justice Act, 1994*).

²⁶⁷ Criminal Assets Bureau - CAB është organ në kuadër të policisë irlandeze e cila grumbullon nëpunësit nga sektor të ndryshme. E përbëjnë, pos nëpunësve policor, edhe nëpunësit nga fusha tatimore dhe e doganave, dhe nëpunësit e ministrive kompetent për punë sociale. Krahas pasurisë e cila është e ndërlidhur me veprat penale, kujdeset edhe për e cila është objekt i fshehjes së tatimeve përkatësisht për pasurinë e cila ka qenë e pushtuar për shkak të cfaqjes së rrejshme të rrethanave lidhur me ndarjen e marrjeve sociale.

pasurinë, vlera e së cilës nuk është më e vogël se 13.000 euro. Në urdhër përcaktohet se personit në fjalë ose cilitdo personi tjetër i ndalohet disponimi me atë pasuri. Nëse provohet se ajo pasuri është në pronësi të personit tjetër ose vlera e saj është më e vogël se 13.000 euro gjykata mund të anulojë urdhërin afatshkurtër ose ta ndryshojë atë.

Urdhëri i përkohshëm ndalon disponimin me pasurinë. Gjkata ka tagrin të anulojë këtë urdhër, në të njëjtat kushte me të cilat anulon urdhërin afatshkurtër. Por ligji sanksionon se gjykata nuk mund të lëshojë urdhëra të përkohshëm nëse ekziston rreziku i vërtetë se një urdhër i tillë do të ishte padrejtësi ndaj dikujt. Urdhëri i përkohshëm vlen një kohë të gjatë, kohë që shtrihet deri në disa vite.

Kur urdhëri i përkohshëm zgjat së paku 7 (shtatë) vjet (*Ndryshimet e ligjit në 2005 i lejon palët që me pëlqimin e dyanshëm kjo periudhë të shkurtohet*), gjykata me propozim të propozuesit kompetent lëshon urdhërin për konfiskim (*disposal order*), sipas së cilit pasurinë e bartë në Ministrinë e Financave ose në personin tjetër të caktuar nga gjykata. Ministria e Financave ka të drejtë ta shesë ose të disponojë në mënyra të tjera pasurinë e konfiskuar. Cilado qoftë mënyra e disponimit me pasurinë nga Ministria e Financave, shuma e parave të përfituara nga disponimi shkon në buxhet. Gjkata i mundëson personit që të deklarohet për veprat. Urdhërat për konfiskim nuk lëshohen nëse ekziston rreziku i bazuar se konfiskimi do të çojë në padrejtësi ndaj dikujt.

Në mes të kohëzgjatjes së urdhërit afatshkurtër ose të urdhërit të përkohshëm, gjykata mund të emëroj administratorin (*receiver*), i cili kujdeset për pasurinë e përfshirë me urdhër dhe disponon me pasurinë sipas urdhërimit të gjykatës. Për dëshmimin në gjykatë vlejné standardet e njëjta si në procedurën civile. Gjkata mund të konsideroj si provë të mjaftueshme deklaratat e shkruara nën betim (*affidavit*), ose deklaratat të dhëna në polici gjatë procesit të pyetjes, ose nga personi i autorizuar i shërbimit. Si provë vlen edhe dokumenti i Zyrës për pasuri të fituar me veprime penale, dokument që vërteton se personi, pasuria e të cilit konfiskohet, është krijuar nga vepra penale ose nga veprime që e lidhin atë direkt ose indirekt me veprën penale.

Gjatë tërë procedurës pranë gjykatës, përkatësisht në kohëzgjatjen e urdhërit afatshkurtër ose të urdhërit të përkohshëm, gjykata mund të ftoj personin (*respondent*), që në deklaratën me shkrim nën betim të theksojë pasurinë që posedon ose administron, dhe/ose lartësinë dhe burimet e të gjitha të hyrave, për një periudhë të caktuar kohore, e cila nuk mund të jetë më e madhe se dhjetë vjet.²⁶⁸

²⁶⁸ www.irishstatutebook.ie/ (qasur me: 23.01.2013.)

Gjatë kohëzgjatjes së njërit prej urdhërave, polici hetues ose personi i autorizuar i zyrës së tatimit mund të konfiskoj pasurinë, nëse kjo shfaqet e nevojshme, kurse me pasurinë e konfiskuar veprohet në përputhje me urdhërat e gjykatës. Nëse vërtetohet se dhënia e urdhërit nuk ka qenë e arsyeshme, gjykata mund t'i ndaj personit kompensimin përkatës dhe atë nga mjetet e Ministrisë së Financave.

Me ndryshimet e ligjit në 2005 është vendosur dispozita për pasurimin e pandershëm (*corrupt enrichment order*)²⁶⁹. Konsiderohet se dikush është pasuruar në mënyrë të pandershme nëse ka pranuar para ose privilegje tjera, ose dobi (p.sh. lëshimi i lejes ndërtimore) nga veprime të pandershme, pavarësisht nga koha e kryer. Në kuptim të legjislacionit veprimi i palejueshëm është në fushën e pengimit të korrupsionit, ruajtja e sekretit zyrtar dhe etikës në shërbimet publike. Për shembull, kur propozuesi i autorizuar bind gjykatën që dikush është pasuruar në mënyrë të pandershme, atëherë gjykata lëshon urdhërin sipas të cilit pala në fjalë duhet të dërgojë shumën përkatëse të të hollave të fituara nga veprimet korruptive në Ministrinë e Financave ose tek personi tjetër, të cilin gjithashtu e cakton gjykata.

Personit, sikurse edhe personave tjerë, iu ndalohet disponimi me pasurinë (me paratë dhe pasurinë tjetër, paluajtshmëritë personale të trashëguara, ose me pasurinë e luajtshme, pasuritë e gjendura jashtë shtetit)²⁷⁰. Derisa nuk dëshmohet e kundërta, personi që për shkak të funksioneve të tij ka mundësinë t'u ofrojë të tjerëve shërbime konsiderohet si i përzier në pasurimin e pandershëm, nëse personi tjetër ka patur dobi nga veprimi i funksionarit në ushtrimin e funksioneve të tij publike dhe nëse, në të njëjtën kohë, personi përfitues nga veprimet nuk ka mundur të sqaroj dhe vërtetojë si e ka realizuar pasurinë ose mjetet e tjera të fituara. Personi mundet, sipas urdhërit të gjykatës dhe me propozimin e propozuesit kompetent, të japë deklaratë me shkrim nën betim (*affidavit*) për burimin e pasurisë kontestuese.

Me ndryshimet e ligjit të vitit 2005, është dhënë mundësia e konfiskimit të drejtpërdrejtë të të hollave në vendngjarje, për të cilën supozohet se është krijuar si pasojë ose në lidhje me veprat penale. Para ndryshimeve të 2005, konfiskimi i drejtpërdrejtë kishte vlerë vetëm në rastet që lidheshin me tregëtimin e drogës²⁷¹. Pra vetëm në rastet e veprave penale të atilla të cilat përveç dëmeve që mund t'i sjellë shoqërisë në përgjithësi, arrin të krijoj kushtet për

²⁶⁹ Po aty. Neni 16B I Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për dobinë pasurore të fituar me veprë penale nga viti 2005.

²⁷⁰ Po aty, neni 16B

²⁷¹ www.irishstatutebook.ie/ (qasur me: 23.01.2013.)

pasurimin e paligjshëm të krimineleve dhe bazën për të vazhduar edhe në ardhmën me aktivitete kriminale.

5.10. Anglia

Ngjashëm me Irlandën është edhe Anglia²⁷², në të cilën ekziston Ligji për dobinë pasurore të fituar me vepër penale (*Proceeds of Crime Act, 2002*), i cili është ndryshuar dhe plotësuar dy herë – me Ligjin për veprat e rënda penale dhe policinë (*Seerious Organized Crime and Police Act, 2005*) dhe me Ligjin për veprat e rënda penale (*Serious Crime Act, 2007*).

Deri më 1 prill 2000 - pasurinë e ka konfiskuar Agjencia për Konfiskimin e Pasurisë (*Assets Recovery Agency – ARA*), e cila njëherësh ka realizuar dhe kujdesin për këtë pasuri. Agjencia ishte një organizim i veçantë, kompetencat e të cilës e lejonin të kryente procedurat e konfiskimit civil të pasurisë (*civil recovery*), e fituar nga veprime të paligjshme, që shkelin dispozitat e ligjit/ligjeve tatimore. Agjencia zotëronte gjithashtu kompetencën për konfiskimin e dobisë pasurore sipas aktgjykimit në procedurën penale (*confiscation*). Në thelb, autorizimet ligjore i mundësonin Agjencisë të kërkonte pranë gjykatës së veçantë (*High Court*), konfiskimin edhe para ngrirjes së pasurisë të fituar me vepër penale. Por Agjencia është abroguar me Ligjin për veprat e rënda penale vitit 2007, i cili ia kaluar kompetencat e saj Agjencisë për Vepra të Rënda Penale (SOCA).

Kriteret për përfshirjen e agjencisë (SOCA) në procedurën e konfiskimit civil janë si vijon:

- ndjekja penale nuk është zhvilluar, përkatësisht nuk ka përfunduar me aktgjykim;
- për konfiskimin civil duhet të ekzistojë prova për veprën penale, e cila ka sjellë deri te përfitimi i pasurisë kontestuese, rast në të cilinmjafton standardi civil i të provuarit, p.sh balanca e mundësisë. Mund të përdoren si dëshmi edhe p.sh thashethemet, deklaratat e bashkëakuzuesve etj., të cilat janë konsideruar të pamjaftueshme gjatë procedurës penale, sikurse mund të përdoret si deklaratë e dëshmitarit dhe mendimi profesional i policit me përvojë;
- lidhur me çështjet tatimore duhet të ketë patjetër një material, i cili jep informacione të sigurta si bazë për dyshimin e bazuar se pasuria e patatimuar është krijuar me vepër penale;

²⁷² Istraživanje Istraživačkog sektora Državnog zbora Slovenije *Neupravičeno pridobljeno premoženje - pregled zakonodaje*, prej 10.04.2008, faqja. 15-17.

- pasuria kontestuese duhet ketë vlerë jo më pak se 10.000 funta dhe duhet të jetë fituar gjatë 12 viteve të shkuara, ndërsa, kur bëhet fjalë për pagesa tatimore, gjatë 29 viteve të kaluara;
- agjencisë duhet ti dorëzohen të gjitha dokumentet e nevojshme, si ato penale ashtu edhe ato financiare.

5.10.1 Agjencisë për Vepra të Rënda Penale (SOCA)

SOCA²⁷³ merret me raste, impakti i të cilave është mjaft i rëndësishëm për dobinë e përgjithshme, ndërsa rastet kriminale më pak të rëndësishme i mbulojnë agjencitë e tjera të nivelit lokal. Dërgimi i punëve tek SOCA është i standardizuar dhe për këtë ekziston një formular i veçantë, kurse konfiskimi civil ka mbetur një çështje që mund të kërkohet edhe nga prokuroria.²⁷⁴

Qëllimi i konfiskimit të pasurisë është pengimi i shfrytëzimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale për financimin e veprave të reja penale, pasi shpesh rreziku i humbjes së mjeteve, sipas bindjes së ekspertëve anglezë, i rikthen autorët tek kryerja e veprave të tjera penale. Në dallim nga procedura penale, në konfiskimin civil, theksi nuk është tek individ i dënuar, por tek pasuria e fituar me vepër penale. Agjencia ka kompetenca të shumta për lëshimin e urdhërave, por ajo nuk mund të lëshojë dot një urdhër përfundimtar konfiskimi, lëshimi i të cilit mund të bëhet vetëm nga gjykata (*High Court*). Kurse hetimin tatimor, Agjencia e kryen në rastet kur ekziston dyshimi i bazuar se pasuria e individit është rezultat i aktivitetit/aktiviteteve penale të tij, ose rezultat i aktiviteteve të ndonjë personi tjetër të lidhur me të.

Në qoftë se nuk bëhet fjalë për rezultatin e veprës penale, në etapën kur ende nuk bëhet fjalë për konfiskimin civil si pasojë e mospërfundimit të procedurës penale, pasuria jolegale ose e pasqaruar e individit mund të përcaktohet në procedurën tatimore. Lidhur me këtë, Anglia në vitin 2005, ka aplikuar Kodin e veprimit të Zyrës Tatimore dhe Doganore (*HM Revenue & Customs*). Objekt i hetimit janë mashtrimet e rënda tatimore (*serious fraud*), hetimi i të cilave kryhet kur ekziston dyshimi për parregullësinë lidhur me detyrimet tatimore indirekte ose të drejtpërdrejta (direkte) të individit. Kur Zyra Tatimore dhe Doganore vendos për hetimin civil të mashtrimit tatimor kjo do të thotë se ndjekja penale nuk është zhvilluar akoma. Në këtë etapë, personi i hetuar, ka të drejtën e sqarimit

²⁷³https://www.iap-association.org/getattachment/e45fd52f-da76-469c-8a4d-0e13c43c4981/9ERC_Gary_Balch.pdf.aspx

²⁷⁴ Po aty.

tërësor të parregullsive të tij tatimore, sqarim që duhet të bëhet i mbështetur në deklarata dhe dokumente zyrtare²⁷⁵. Nëse gjatë këtij hetimi konstatohet se i dyshuari procedon me dokumente të falsifikuara ose jo të vërteta, qëllimi i të cilave është sërish mashtrimi tatimor, Zyra Tatimore dhe Doganore mundet të zhvilloj hetim penal me qëllim ndjekjen e një veprimit të tillë.

Zyra Tatimore dhe Doganore dhe SOCA i koordinojnë punët e tyre lidhur me tatimimin e pasurisë së fituar me vepra penale, në sistemin tatimor dhe hetimin civil të dobisë pasurore të fituar me vepra penale.

5.11. Franca

Konfiskimi është një term i shqiptuar në regjimin e vjetër francez dhe preku të gjithë pasuritë e të dënuarve dhe trashëgimtarëve të tyre. Ai u abrogua nga Revolucioni francez dhe u risoll përsëri në të drejtën penale franceze me Aktin e 30 Marsit 1972. Franca njeh konfiskimin civil dhe penal. Në konfiskimin civil, Kodi Civil Francez mban parasysht se e drejta e pronës nuk mund të shkelet dhe për këtë arsye e lidh konfiskimin me zotërimin e sendit²⁷⁶.

Legjislacioni francez për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive kriminale, ndryshoi gjatë viteve, por ai pa një ndryshim të dukshëm që nga viti 2007, vit që realizoi madje një revolucion të vërtetë, pasi reformat legislative në këtë fushë kanë lëvizur kufijtë e parimeve të përgjithshme të së drejtës penale, duke krijuar në veçanti një sistem të gjerë të anulimit të barrës së provës ose duke lejuar konfiskimin e pasurisë në dispozicion të shkelësit edhe kur nuk është pronari ligjor. Legjislacioni zgjeroi fushën e konfiskimit, e cila tani shtrihet në çdo pasuri të shkelësit, qofshin ato të ligjshme apo të paligjshme. Në lidhje me sekuestrimin, rregullat e zbatueshme janë thjeshtuar dhe forcuar, me qëllim që të lejojnë sekuestrimin e të gjitha pasurive që i nënshtrohen konfiskimit, pavarësisht nga lidhja me veprën penale. Koncepte të reja si sekuestrimi dhe konfiskimi me vlerë ekuivalente, të cilat ishin të panjohura në ligjin penal francez, janë dispozitat e reja të futura në legjislacionin e fushës. Ligji mundëson tani kalimin e aseteve të sekuestruara tek agjencitë e përmbarimit, madje edhe përpara një vendimi përfundimtar mbi konfiskimin e mundshëm. Të gjitha këto masa legislative e kanë bërë ligjin francez mbi sekuestrimin dhe

²⁷⁵ <https://www.brightlinelaw.co.uk/news/when-criminal-property-is-not-criminal.html>

²⁷⁶ <https://fr.wikipedia.org/wiki/Confiscation>

konfiskimin një nga më të përparuarit në këtë fushë, i cili prodhon tashmë rezultate në luftën kundër krimit fitimprurës. Të gjitha këto zhvilluan dhe lejuan mundësinë e eksplorimit të mjeteve dhe politikave penale efektive, që kanë sjellë edhe rezultate të rëndësishme²⁷⁷.

E drejta penale franceze e sheh konfiskimin si dënim plotësues dhe e lidh kryerjen e konfiskimeve kryesisht me autorin e veprës penale. Kodi Penal Francez dhe Kodi i Procedurës Penale shqiptojnë sekuestron dhe konfiskimin të lidhur me vendimin e një gjykate, e cila deklaron fajtor personin për veprën penale për të cilën është akuzuar²⁷⁸. Konfiskimi i përgjithshëm ndikon sot pasuritë e autorëve të veprave penale dhe mund të urdhërohet në rastet e krimeve kundër njerëzimit, terrorizmit apo trafikut të lëndëve narkotike. Por ky Kod, ndan objektet e konfiskuara në objekte “për tregëti” ose “jashtë tregëtimit”. Kështu, neni 1128 në përgjithësi armët, narkotikët, etj., i konsideron “pronë jashtë -tregëtimit” duke përcaktuar se “vetëm ato gjëra që janë në tregti mund të jenë objekti i konventave”.

Konfiskimi është një masë gjyqësore dhe jo një dënim. Prandaj mund të ndërhyjë përpara një vendimi përfundimtar. Për konfiskimin e pasurive që rrjedh nga vepra penale, gjyqtari mund të urdhërojë konfiskimin e çdo prone, e cila është rezultat i veprës penale ose është përdorur për të shpërblyer kundërvajtësit, gjithmonë nëse prona nuk mund të rikthehet te pala e dëmtuar. Nëse vlera e aseteve të konfiskuara është e padisponueshme (është shkatërruar, është zhdukur ose është fshehur), gjykatësi vendos një kërkesë kompensuese ekuivalente me asetet e padisponueshme kundër të akuzuarit. Kur kemi të bëjmë me një organizatë kriminale, konfiskimi shkon edhe më tej: ai shtrihet mbi të gjitha pasuritë mbi të cilat organizata ka fuqinë e disponimit.

Pasuritë e konfiskuara përfitohen dhe administrohen nga shteti por ato mund të ndahen edhe në mes të autoriteteve publike dhe ndoshta një shteti të huaj (në rastin e veprimtarisë kriminale në atë shtet), gjithmonë nëse ekziston një marrëveshje mes të dy vendeve²⁷⁹.

Rimëkëmbja e aseteve është gjithashtu një çështje kyçe në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, në mënyrë që t'i privoj kriminelët nga fitimet e tyre të paligjshme dhe të sigurojnë parimin e drejtësisë se krimi duhet të paguaj. Në funksion të kësaj Franca ka synuar forcimin e legjislacionit që rregull fushën e konfiskimit dhe këtu

²⁷⁷http://www.cairn-int.info/abstract-E_RIDP_841_0217--cr.htm

²⁷⁸[https://uk.practicallaw.thomsonreuters.com/2-519-9872?transitionType=Default&contextData=\(sc.Default\)&firstPage=true&bhcp=1](https://uk.practicallaw.thomsonreuters.com/2-519-9872?transitionType=Default&contextData=(sc.Default)&firstPage=true&bhcp=1)

²⁷⁹<http://www.legislationline.org/documents/section/criminal-codes/country/30>

politika kriminale franceze i ka kushtuar vëmendje rimëkëmbjes së aseteve. Kështu, Franca ka zhvilluar mjete efikase që mundësojnë akses të shpejtë mbi informacionin financiar, (p.sh. tek FICOBA, një regjistër i centralizuar i krijuar në 1982) dhe përmirësoi kapacitetet e saj të zbatimit me krijimin e një ligji të specializuar, dedikuar identifikimit të pasurisë së rrjedhur nga veprat penale. Ky ligj krijoi PIAC²⁸⁰ - e cila është një platformë identifikimi e pasurive kriminale. Përveç kësaj, ndryshime të mëdha legjislative janë miratuar në 5 vitet e fundit në funksion të përmirësimit të kuadrit ligjor për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive kriminale. Në luftën e saj kundër krimit Franca mbështet gjithashtu veprime të ndryshme ndërkombëtare, duke marrë pjesë në praktikat më të mira që lehtësojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, si p.sh. Iniciativa për Vjedhjen e Pasurisë së Aseteve (StAR), Institucioni për Rimëkëmbjen e Aseteve Camden-mbështetur nga INTERPOL, Rrjeti i Agjencisë (CARIN), dhe StAR.

5.11.1 Ngrirja dhe konfiskimi i aseteve

Sistemi gjyqësor francez lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të ardhura nga krimi bazohet në dënimin penal: asnjë konfiskim nuk mund të urdhërohet pa deklarin e fajit nga një gjykatë, ndërsa konfiskimi përbën një dënim penal që shqiptohet përveç burgosjes dhe /ose gjobës.

Pasuritë që i nënshtrohet konfiskimit janë të shumta, për shkak të mekanizmave të konfiskimit të zgjeruar dhe barrës sëkundërt të provës. Ndonëse nuk lejohet konfiskimi i bazuar në dënime të pa dënueshme sipas ligjit të brendshëm, Franca mund të pranojë të ekzekutojë një urdhër të huaj sipas a kërkesë MLA-së.

Sistemi francez aktualisht bazohet në parimet e mëposhtme:

- Çdo pasuri e përdorur për kryerjen e veprës mund të konfiskohet nëse i përket personit të dënuar, ose ky i fundit e kishte vënë në dispozicion falas për të realizuar një vepër penale.
- Çdo pasuri që përbën objektin ose të ardhurat e krimit, drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte mund të konfiskohet nga gjykata; dhe
- Të ardhurat e krimit mund të konfiskohen edhe nëse ato i përkasin një palë të tretë nga pikëpamja ligjore.

²⁸⁰ http://www.justice.gouv.fr/art_pix/rapport_ARMSCA_anglais_2011.pdf

Konfiskimi mund të urdhërohet nga gjykata si një dënim shtesë për çdo veprë penale që mban një vit ose më shumë burgim, edhe nëse akti ligjor që përcakton dënimin penal nuk parashikon shprehimisht një dënim të tillë shtesë.

Kodi Penal Francez njeh konfiskimin e zgjeruar:

- Nëse për veprën penale të kryer shqiptohet 5 vjet ose më shumë burgim. Në këto raste çdo pasuri e gjeneruar në pronësi të personit të dënuar ose nga shitja e tyre mund të konfiskohet nga gjykata, deri në masën që i dënuari nuk mund të provojë origjinën e tij të ligjshme (përgjegjësia e provës në këtë rast është tek i pandehuri);
- Kur parashikohet nga akti legjislativ që përcakton veprën penale. Në këto raste konfiskimi i gjithë pasurisë së personit të dënuar mund të urdhërohet nga gjykata, pavarësisht nga ndonjë lidhje me veprën penale dhe pavarësisht nga origjina e ligjshme/e paligjshme (p.sh. e zbatueshme në veprën penale të pastrimit të parave, në veprat e terrorizmit ose në vepra të lidhura me to).

Për të lehtësuar konfiskimin çdo pasuri mund të konfiskohet para gjykimit ose gjatë hetimit, përherë për të garantuar konfiskimin e urdhëruar më vonë nga gjykata²⁸¹.

5.11.2. Agjencia e administrimit të aseteve

Franca ka themeluar dy agjenci të dedikuara për rimarrjen e aseteve, të cilësuar si pikat fokale në rrjetet e sipërpërmendura të bashkëpunimit²⁸². PIAC, platforma për identifikimin e pasurisë kriminale është krijuar me ligj në vitin 2005 dhe është dedikuar për identifikimin e pasurisë kriminale. Ajo është autorizuar për të kryer hetime financiare nën mbikëqyrjen e një autoriteti gjyqësor. PIAC centralizon gjithashtu të gjithë informacionin në lidhje me zbulimin e aseteve të paligjshme në të gjithë territorin francez por edhe jashtë vendit. Ajo është emëruar si pika qendrore në rrjetet e ndryshme të bashkëpunimit të përmendura më lart. AGRASC, agjencia tjetër, e dedikuar për menaxhimin dhe rikuperimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara si dhe për t'iu siguruar gjykatavendihmë ligjore dhe teknike. Ajo gjithashtu mund të urdhërohet për të ekzekutuar kërkesat e MLA, nën kontrollin e një autoriteti gjyqësor. Në Francë, autoriteti qendror legal që jep ndihmë në çështjet penale është Byroja e Ndihmës së Ndërsjellë Ndërkombëtare për Çështjet Penale («Bureau del'Entraide Pénale Internationale »). Është pjesë e Çështjeve Penale edhe Divizioni i Faljeve, strukturë e varur nga Ministria e Drejtësisë në Paris. Franca ka

²⁸¹ <http://www.justice.gouv.fr/justice-penale-11330/agrasc-12207/>

²⁸² Po aty.

gjithashtu magjistratë ndërlidhës në trembëdhjetë vende (Algjeri, Brazili, Kanada, Kroaci, Gjermani, Itali, Marok, Holandë, Rumani, Spanja, Senegal, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara) dhe është organizator i ndërlidhjes së magjistratëve nga dhjetë vende (Algjeri, Kanada, Gjermani, Itali, Marok, Romania, Hollanda, Spanja Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara). Këta magjistratë lehtësojnë përpunimin e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike midis autoriteteve gjyqësore vendase dhe autoriteteve të këtyre vendeve. Ata japin këshilla dhe mbështetje në çështje të tilla penale²⁸³.

5.11.3. Si funksionon AGRASC

Agjencia për Menaxhimin dhe Pasurimin e Pasurive është institucion publik nën autoritetin e përbashkët të Ministrive të Drejtësisë dhe Buxhetit, krijimi i të cilës është parashikuar me ligjin nr 2010-768 të 9 korrikut të vitit 2010 për të lehtësuar sekuestrimin dhe konfiskimin në çështjet penale. Ajo udhëheqet nga një gjykatës i gjyqësorit, ka një bord drejtues të kryesuar nga një magjistrat dhe përbëhet nga 11 agjentë që vijnë nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe ajo e Buxhetit²⁸⁴.

Ky ligj, për të kuptuar më mirë fitimet e krijuara nga krimi dhe krimi i organizuar dhe për të përforcuar efektin parandalues të sanksionit penal, ka zgjeruar fushën e pasurisë që i nënshtrohet sekuestrimit dhe konfiskimit. Ai gjithashtu krijoi një procedurë të posaçme të sekuestrimit të krimit për konfiskim, i cili është më i përshtatshëm për procedura komplekse dhe të kushtueshme të zbatimit të ligjit.

Në këtë kontekst, ai ka futur nenet 706-159 deri 706-164 rregulla për AGRASC në Kodin e Procedurës Penale, pasi hyrja në fuqi e këtyre teksteve varet nga neni 706-165 Dekreti i Këshillit të Shtetit, i cili u botua më 3 shkurt 2011 (dispozitat e të cilave janë të përfshira në nenet R. 54-1 të Kodit të Procedurës Penale).

Organizata dhe misionet e agjencisë janë detajuar në dy qarkore të Ministrisë së Drejtësisë, qarkorja e datës 22 dhjetor 2010, që mbulon tërë ligjin e datës 9 korrik 2010 dhe qarkoren e datës 3 shkurt 2010, në AGRASC.

Roli i agjencisë është të përmirësojë trajtimin gjyqësor të konfiskimeve dhe konfiskimeve në çështjet penale, përveç rolit të përgjithshëm të asistencës, këshillave dhe udhëzimeve që u jepen magjistratëve në çështjet e sekuestrimit dhe konfiskimit (neni 706-161 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale):

²⁸³Po aty.

²⁸⁴www.justice.gouv.fr/art_pix/rapport_ARMSCA_anglais_2011

Për të siguruar menaxhim të centralizuar, Agjencia hapi një llogari në të cilën futen të gjitha pasuritë e personave që janë të arrestuar në pritje të një vendim përfundimtar për një konfiskim të mundshëm.

Neni 706-160 2 ° i Kodit të Procedurës Penale shërben për të kryer të gjitha shitjet e pronave të luajtshme të konfiskuara, të vendosura nga magjistratët kur këto prona të luajtshme nuk janë më të dobishme për shfaqjen e së vërtetës dhe kur ato i janë nënshtruar zhvlerësimit. Në këtë rast, shuma që rezulton nga shitja regjistrohet në llogarinë e agjencisë dhe i kthehet pronarit të pronës nëse ky i fundit përfiton nga lirimi, shkarkimi ose jo- ose nëse prona nuk konfiskohet (nenet 41-5, 99-2 dhe 706-160 4 ° të Kodit të Procedurës Penale).

Sipas Ligjit²⁸⁵ të datës 14 mars 2011 (i njohur si LOPPSI II), Agjencia është gjithashtu përgjegjëse për asgjësimin ose shkatërrimin e automjeteve të konfiskuara në zbatim të nenit L. 325-1- 1 të Aktit të Trafikut të Autostradave;

Nenet 706-151 të Kodit të Procedurës Penale rregullojnë fushën e informimit për të gjitha hapat e konfiskimit nëpërmjet botimeve të domosdoshme të informacioneve që vijnë nga zyrat e hipotekave dhe nga regjistri i konfiskimeve të pasurisë penale. Agjencisë i është besuar gjithashtu, nga neni 707-1 i Kodit të Procedurës Penale, publikimi i konfiskimeve të pasurive të paluajtshme të lëshuara nga gjykatat, ruajtja ose rikuperimi i të cilave është detyrë e Agjencisë. Njëherësh Agjencia publikon edhe aktet administrative që lidhen me këto pasuri, mbështetur në nenin 706-160 1 ° të Kodit të Procedurës Penale.

Kur urdhëri i gjykatës e detyron Agjencinë të menaxhojë një pronë të tillë, Agjencisë i është besuar, (pasi pasuria të jetë konfiskuar dhe tjetërsuar ose shkatërruar , sipas nenit 706-160 3 të Kodit të Procedurës Penale) administrimi i pasurisë, d.mth ajo mund ta shesë pasurinë dhe të ardhurat prej saj duhet ti shpërndajë në përmbushje të çdo kërkesë për ndihmë të ndërsjellë ndërkombëtare ose bashkëpunim nga një autoritet gjyqësor i huaj (neni 706-160 4 i Kodit të Procedurës Penale)²⁸⁶. Agjencia e mori rolin për rimëkëmbjen e pasurive e në 25 shkurt 2011 si një Zyrë në kuptimin e Vendimit 2007/845 / JHA të datës 6 dhjetor 2007 të Këshillit të Bashkimit Europian dhe ushtron këtë funksion në shërbim të kreditorëve ose viktimave publike para ekzekutimit të ndonjë vendimi gjyqësor të kthimit (neni 706-161, paragrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale) si dhe kryen dhe kompensimin

²⁸⁵<https://www.net-iris.fr/veille-juridique/dossier/22348/la-loi-loppsi-ii-pour-renforcer-la-securite-interieure.php>

²⁸⁶<http://www.legislationline.org/documents/section/criminal-codes/country/30>

parësor të palëve civile të lidhura me pasurinë e konfiskuar nga personi i dënuar (neni 706-164).

5.11.4. Identifikimi i aseteve

Identifikimi i pasurisë së vjedhur mund të arrihet përmes databazave të ndryshme, të menaxhuara nga autoritetet publike ose nën mbikëqyrjen e tyre. Mbi këtë bazë, urdhrat e gjykatës mund të lëshohet me qëllim marrjen e informatave plotësuese për individët ose subjektet e interesuara.

Bazat kryesore të të dhënave të përdorura zakonisht janë si në vijim:

- Informacioni bankar vilet nga FICOBA²⁸⁷, i cili është një regjistër bankar i centralizuar, i krijuar në vitin 1982 dhe që menaxhohet nga administrata tatimore. Ai përmban të gjithë informacionin përkatës lidhur me krijimin, modifikimin ose mbylljen e çdo llogarie të çdo individi francez, të çdo institucioni financiar francez ose të çdo institucioni të huaji që vepron në Francë. Ky informacion mund të merret direkt nga banka përkatëse, me kërkesë gjyqësore.
- Baza e të dhënave kombëtare të aseteve (BNDP²⁸⁸) përmban informacione kyçe në lidhje me pasuritë e mbajtura nga persona të njohur në administratën tatimore përmes deklaratave të ndryshme tatimore. Ajo përbëhet kryesisht nga ekstraktet e veprave të transferimit të pronësisë në këmbim të pagesave (shitja e ndërtesave dhe toka), ose pa pagesë (dhurata dhe trashëgimi), dhe identitetet dhe adresat e personave dhe pronave në fjalë.
- TRACFIN është strukturë penale për kontrollin e këtyre pasurive dhe ka qasje në këtë regjistër pa pasur nevojë për një urdher të gjykatës.
- Regjistri i Pronave të paluajtshme: Regjistri i tokës përmban informacion në lidhje me tokën e zhvilluar (ndërtesat) dhe tokën e pazhvilluar. Mund të përdoret për të zbuluar identitetin e pronarëve të lokaleve ose tokës. Dosja e taksës së akomodimit të mobilimit mund të përdoret për të gjetur identitetin e pushtuesve të lokaleve të veçanta (atyre që deklarohen si qiramarrës ose jo pushtues) dhe të pronave të tjera ose shtëpive të para e të dyta;

²⁸⁷ <http://www.fbf.fr/en/banking-issues/fight-against-money-laundering/french-banks-are-fully-committed-to-combating-the-financing-of-terrorism>

²⁸⁸ <https://www.groupe-dvf.fr/glossaire/bndp/>

- Regjistri i Tregtisë dhe Shoqërisë (RCS), i cili përmban informacion në lidhje me kompanitë dhe bizneset e regjistruara dhe veçanërisht të lidhura për identifikimin e aksionarëve, librit dhe financave kryesore, informacion që është edhe në dispozicionin e publikut.²⁸⁹

Por Kodi Penal Francez specifikon qartë se në kontekstin e kërkesave që synojnë identifikimin, ngrirjen ose konfiskimin e pasurive kriminale, është me rëndësi të sigurohen të gjitha informatat e nevojshme mbi lidhjet e vendosura në mes të veprës penale dhe procedimit të pasurisë e kësaj vepre, si dhe të respektohen të gjitha të drejtat e njohura nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat e tjera themelore të mbrojtuar nga Kushtetuta dhe ligjet e tjera të vendit.

Franca njeh gjithashtu konfiskimin civil, por ky ligj mban parasysh se e drejta e pronës nuk mund të shkelet dhe për këtë arsye e lidh konfiskimin me zotërimin e sendit.

5.12. Shqipëria

Republika e Shqipërisë e ka rregulluar fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të krijuara nga veprat penale me Kodin Penal të saj, Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil, ligje dhe VKM të tjera që rregullojnë këtë lëndë.

Masat e karakterit civil që drejtohen ndaj pasurisë së personave të përfshirë në veprimtari korruptive përfshijnë masat kundër rrethanave të ndryshme që lehtësojnë ushtrimin e kësaj veprimtarie kriminale. Përpara legjislatorit, në këtë rast, shtrohet për zgjidhje detyra e vështirë e balancimit të interesave të kundërta në pamje të parë, mes ruajtjes dhe garantimit të të drejtave të individit dhe, në të njëjtën kohë, kufizimit të ushtrimit të tyre për qëllime madhore të luftës ndaj korrupsionit. Legjislatori, pa dyshim, duhet të balancojë shumë mirë këto interesa. Në thelb, zgjidhja e balancuar nënkupton vendosjen e kufizimit të së drejtës së pronës (apo edhe lirisë ekonomike) së një kategorie të caktuar individësh, të dyshuar për përfshirje në krijimin e të ardhurave financiare në mënyrë jo të ligjshme dhe të pajustificuar me veprime të ligjshme, për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore për një kategori më të gjerë personash. Kufizimi i këtyre të drejtave i nënshtrohet kushteve të përgjithshme që vendos neni 17 i Kushtetutës. Kështu,

- kufizimi bëhet për mbrojtjen e interesit publik dhe të drejtave të të tjerëve;

²⁸⁹ www.infogreffe.com

- kufizimi është proporcional me gjendjen që e ka shkaktuar;
- kufizimi nuk tejkalon kufizimet e vendosura nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kurse dispozitat e Kodit Penal (KP) dhe të Kodit të Procedurës Penale (K.Pr.P) rregullojnë fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit në rastet e veprimeve kriminale. Kështu, nenet 208-220 të K.Pr.Penale²⁹⁰ shërbejnë për marrjen dhe ruajtjen e sendeve të caktuara me qëllim që, përmes tyre, organi i akuzës të realizojë procesin e vërtetimit të fakteve, objekt akuze. Organet e autorizuar nga K.Pr.P. për të vendosur këtë masë janë Gjykata ose Prokurori, gjithmonë kundrejt një vendimi të arsyetuar. Por, kur ka rrezik që gjurmët që përmbajnë sende të caktuara mund të ndryshojnë ose të humbasin dhe, kur nuk ka asnjë mundësi praktike për të pritur marrjen e një vendimi nga Prokurori, pa u prishur apo zhdukur këto gjurmë, sekuestrimi mund të vendoset edhe nga një Oficer i Policisë Gjyqësore. Në këto raste ai duhet të vërë në dijeni prokurorin për sekuestrimin e vendosur jo më vonë se 48 orët e ardhshme, i cili ose vleftëson sekuestron e vendosur nga Oficeri i Policisë Gjyqësore ose vendos heqjen e menjëhershme të kësaj mase, në vartësi të faktit nëse masa e vendosur përputhet ose jo me nevojat për marrjen e një prove.

Ky është rregulli i përgjithshëm që ndiqet për sekuestrimin për nevoja të marrjes së provës. Për shkak të sensibilitetit që kanë disa lloj të drejtash, siç është ruajtja e privacisë, Kodi ka parashikuar rregulla specifike për sekuestrimin e korrespondencës²⁹¹ (neni 209) sekuestrimin pranë bankave (neni 210)²⁹² apo sekuestrimin në zyrën e mbrojtësit. Kështu, në rastin e sekuestrimeve të korrespondencës, Policia Gjyqësore nuk gëzon asnjë kompetencë për të vendosur këtë masë, qoftë edhe në kushtet e emergjencës, e cila vetëm mund të pezullojë dërgimin e korrespondencës deri në marrjen e një vendimi nga ana e Prokurorit për vendosjen e sekuestrimit të saj ose heqjen e pezullimit të dërgimit sipas destinacionit që ka.

Kurse sekuestrimi pranë bankave kryhet vetëm nga Gjykata. Vetëm si përjashtim dhe vetëm kur ka arsye urgjencë ky sekuestrim mund të kryhet edhe nga prokurori. Pra siç shihet, sekuestrimi pranë bankave nuk mund të kryhet nga Policia Gjyqësore në asnjë rast. Po kështu, Policisë Gjyqësore nuk i njihen të drejta sekuestrimi edhe në rastet e nevojës për sekuestrim të sendeve që ndodhen në zyrën e mbrojtësit.

²⁹⁰Kodi Penal i RSH, datë 27.1.1995, i ndryshuar

²⁹¹ Kodi Penal i RSH, datë 27.1.1995, i ndryshuar

²⁹² Po aty

Lidhur me sekuestron Ligji për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar (ligji Nr.9284, datë 30.09.2004)²⁹³ solli një pasurim të kuptimit të institutit të sekuestrimit që parashikon K.Pr.P si dhe të regjimit të administrimit të pasurive të sekuestruara. Sipas këtij ligji, sekuestrimi parandalues synon të privojë pronarin apo administratorin e një pasurie për të cilat ka të dhëna se mund të jenë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërim të personit ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një grup veprash penale. Sekuestro parandaluese e parashikuar nga Ligji 9284 ka disa karakteristika të veçanta që lidhen kryesisht me standardet e shqyrtimit të saj.

Së pari, për të aplikuar sekuestron parandaluese barra e provës për të vërtetuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë i takon autorit të veprës penale;

Së dyti, sekuestrimi në parim mund të zbatohet pavarësisht nëse është nisur ose jo një procedim penal ndaj mbajtësit të pasurisë, edhe pse kërkohet prania e një dyshimi të arsyeshëm për kryerjen e një kategorie të caktuar veprash penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr. 9284.

Së treti, ky sekuestrim zbatohet jo vetëm ndaj personave ndaj të cilëve mund të rëndojë dyshimi i arsyeshëm, por edhe ndaj bashkëshortit, fëmijëve, personave në gjini ose krushqi të afërt me ta apo edhe ndaj personave fizikë ose juridikë për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë e tyre zotërohen direkt apo indirekt, drejtpërdrejt apo tërthorazi nga personat e dyshuar për kryerjen e veprave penale të përmendura më sipër;

Së fundi, sekuestrimi i vendosur sipas ligjit nr. 9284, i nënshtrohet disa afateve të përcaktuara në ligj, të cilat janë specifike vetëm për këtë lloj sekuestrimi.

Konfiskimi parashikohet si në K.Pr.P., ashtu edhe në Ligjin 9284. Në të dy rastet ajo përfaqëson një masë të urdhëruar nga gjykata. Por këto konfiskime paraqesin karakteristika të cilat i bëjnë ato të dallohen cilësisht mes tyre. Në rastin e konfiskimit të parashikuar nga K.Pr.P. kjo masë merret në përfundim të një vendimi dënimi. Kurse konfiskimi i parashikuar nga Ligji 9284 edhe pse është një masë e cila vendoset me kërkesën e prokurorit, merret jashtë një procedimi penal. Në këtë kuptim, ai mund të merret pavarësisht nga fakti nëse organi i Prokurorisë ka nisur ose jo një procedim penal.

Nga analiza e konfiskimit të detyrueshëm të parashikuar nga neni 36 i Kodit Penal vëmë re se ky lloj konfiskimi është konceptuar jo vetëm si një konfiskim i bazuar tek paligjshmëria e pasurisë por edhe si një konfiskim i bazuar tek vlera apo kundërvlera e pasurisë në raport me produktet e veprës penale.

²⁹³<http://www.fint.gov.al/doc/9284.pdf>

Kjo do të thotë se konfiskimi i detyrueshëm mund të shtrihet edhe mbi pasuri të ligjshme të autorit të veprës penale, deri në masën që ato mbulojnë vlerën e produkteve të veprës penale. I diskutueshëm është parashikimi i konfiskimit të një pasurie të premtuar si shpërblim për kryerjen e një veprë penale. Në këtë rast mund të ndodhë që premtimi për shpërblim të jetë një mashtrim. Mundet që autorit të veprës penale t'i jetë premtuar një banesë, e cila në fakt nuk ekziston. Pavarësisht nga kjo, sipas nenit 36, germa «c» të K.P., gjykata detyrohet të vendosë konfiskimin e shpërblimeve të premtuara, edhe pse ato nuk ekzistojnë materialisht, dhe për më tepër nuk formojnë produkte të veprës penale.

Në nenin 36 të K.P. nuk përcaktohet detyrimi i Gjykatës për të zbatuar kushtet e konfiskimit sipas renditjes së bërë në këtë nen. Kjo mangësi në praktikë nuk ka krijuar ndonjë problem deri tani. Por ajo mund të lërë shteg për abuzime, pasi mund të ndodhë që gjykata të vendosë konfiskimin e pasurisë së ligjshme në formën e kundërvlerës së produkteve të veprës penale, duke lënë pa konfiskuar vetë produktet e veprës penale. Kuptohet që sekuestrimi i kësaj pasurie të ligjshme duhet t'i nënshtrohet konfiskimit vetëm atëherë kur nuk mundet të bëhet konfiskimi i produkteve të veprës penale. Nga kjo analizë e shkurtër e konfiskimit të detyrueshëm të parashikuar në nenin 36 të K.P. del qartë vështirësia që mund të hasin organet e ndjekjes penale për të arritur në një konfiskim të produkteve të veprave penale kur është fjala për krime të kryera nga organizata kriminale të specializuara në pastrim parash, trafikim lëndësh narkotike, qeniesh njerëzore, etj.,. Përballë tyre qëndrojnë nga njëra anë format dhe metodat e sofistikuar që këto organizata përdorin në veprimtarinë e tyre për fshehjen e lidhjeve mes veprimtarisë kriminale dhe origjinës së produkteve të krimit, dhe nga ana tjetër, qëndron kërkesa apo standardi i lartë i të provuarit të këtyre lidhjeve jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm për të arritur në një konfiskim të mundshëm të tyre. Në fakt, vështirësia lidhur me standardin e të provuarit lidhet sidomos me formulimin jo shumë të saktë të vetë nenit 36 të K.P. duke e konceptuar konfiskimin e detyrueshëm si një masë dënimi. Kjo e bën të pamundur për Gjykatën të aplikojë një standard më të ulët dhe nuk i jep mundësi asaj të kalojë barrën e të provuarit të mungesës së lidhjeve mes pasurisë objekt konfiskimi dhe veprës penale tek personi që është deklaruar fajtor.

Prandaj ky lloj konfiskimi, i parashikuar në nenin 36 të K. Penal, është një instrument ligjor i pamjaftueshëm në fushën e luftës kundër krimit të organizuar. Për këtë vjen në ndihmë konfiskimi, i parashikuar në ligjin nr. 9284, i cili përbën atë që njihet si konfiskim *in rem*, sipas të cilit pasuria apo sendet mund të konfiskohen, nëse provohet sipas kriterëve civile së të provuarit që këto pasuri kanë një origjinë të paligjshme dhe kriminale. Zbatimi i

kritereve civile të të provuarit në këtë lloj konfiskimi parandalues, pra ndërrimi i barrës së provës, e bën sistemin më eficient. Ky ndërrim i barrës së të provuarit mund të konsiderohet edhe si një kosto efektive, pasi pronari i një prone, në parim, mund të tregojë më lehtë se autoritetet origjinën jo kriminale të pasurisë. Megjithatë duke e vërtetuar disa mangësi qoftë në aspektin material por edhe procedural u paraqit nevoja e nxjerrjes së një ligjeve të veçanta, në drejtim të arritjes së rezultateve me të mira.

5.12.1. Ligjet e veçanta që e rregullojnë fushën e konfiskimit të pasurisë të përfituar në mënyrë të kundërligjshme

Shqipëria me qëllim të luftimit të kriminalitetit në përgjithësi, e në veçanti të krimit të organizuar dhe konfiskimit të dobisë pasurore të rrjedhur prej tij, zgjeroj aspektin legjislativ në këtë drejtim, për faktin se baza ligjore vetëm me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, nuk tregonte rezultate të pritshme. Në vitin 2009 dhe 2013, dy ligje të reja, përkatësisht Ligji nr.10192, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe Ligji Nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit" zgjeruan dispozitat ligjore që rregullojnë edhe më tej fushën e konfiskimit të pasurisë.

Ligji nr.10192, me hyrjen e tij në fuqi shfuqizoi ligjin për "Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar" Nr.9284, datë 30.09.2004.

Ligji nr.10192, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", si ligj gjithëpërfshirës të kësaj fushe, në nenin 21 përcakton se:

1. Masa e konfiskimit vendoset me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa.
2. Konfiskimi i pasurisë kërkohet dhe vendoset edhe në raste kur ndaj pasurive nuk është kërkuar dhe nuk është vendosur masa e sekuestrimit.
3. Barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi.

Vendimi i konfiskimit dhe ai për sekuestrimin mund të ankimohen në një gjykatë më të lartë, sipas dispozitave të Kodit Civil Shqiptar. Me marrjen e kërkesës për konfiskim gjykata duhet të japë vendimin brenda 3 muajve me marrjen e kërkesës, por ajo mund ta shtyjë këtë afat deri në një vit, (jo më shumë se një vit) në situata që paraqiten komplekse.

Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;
- b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të ardhurat, kur pasuritë nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe
- c) kur rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë të personit.

Gjykata mund të vendosë pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur:

- a) procedimi penal i filluar ndaj personit pushohet nga organi procedues për shkak:
 - i. të pamjaftueshmërisë së provave;
 - ii. të vdekjes së personit;
 - iii. se personi nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;
- b) personi deklarohet i pafajshëm penalisht për shkak:
 - i. të pamjaftueshmërisë së provave;
 - ii. se vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet;
- c) personi është proceduar për një vepër penale, që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji, por gjatë procedimit penal ndryshohet cilësimi juridik i veprës dhe vepra e re është jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji.

Përveç Ligjit nr.10 192, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" Shqipëria hartoi dhe miratoi edhe Ligjin Nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", i cili paraqet interes për shkak të strukturës përmbajtësore të tij. Kështu ligji shenjon si subjekte të tij veprimtarinë terroriste por termat e tij nuk flasin për konfiskim. Sipas këtij ligji²⁹⁴:

"Bllokim i përkohshëm" është ndalimi i çdo transaksioni ose pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të pasurive të tjera, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet dhe pasuritë e tjera, të bllokuara përkohësisht, mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës të bllokimit të përkohshëm. *"Sekuestrim"* është ndalimi i çdo transaksioni ose pjesëmarrjeje në transferimin, shndërrimin, tjetërsimin ose lëvizjen e fondeve dhe të

²⁹⁴ Ligji Nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"

pasurive të tjera, sipas kushteve dhe kohëzgjatjes së vlefshmërisë të veprimeve të ndërmarra nga organet përkatëse, në përputhje me këtë ligj. Fondet ose pasuritë e sekuestruara mbeten në pronësi të personave që kanë të drejtë pronësie mbi to në çastin e vendosjes së masës së sekuestrimit.

“Fonde dhe pasuri të tjera” janë pasuritë financiare, depozitat monetare dhe pronat e çdo lloji, të luajtshme ose të paluajtshme, pavarësisht nga mënyra e fitimit, si dhe dokumentet ligjore apo instrumentet e çdo lloji, përfshirë ato elektronike ose digjitale, që provojnë pronësinë ose interesat në këto fonde dhe pasuri të tjera. Këtu përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, kreditë bankare, çeqet bankare ose të udhëtarëve, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, bonot, pagesat, letërkreditet dhe çfarëdo interes, dividend ose të ardhura të tjera, si dhe vlerat që grumbullohen a gjenerohen nga fonde ose pasuri të tjera.

Sipas këtij Ligji²⁹⁵ organet përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e masave të marra, të parashikuara janë:

- a) Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për subjektet që licencojnë dhe/ose mbikëqyrin;
- b) Ministria e Drejtësisë, për Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe noterët;
- c) ministritë apo autoritetet përkatëse, për institucionet në vartësi dhe për subjektet që licencojnë dhe/ose mbikëqyrin, që mbajnë ose administrojnë regjistra të fondeve dhe pasurive të tjera.

5.12.2. Agjencitë e zbatimit të ligjit që prekun fushën e konfiskimit të pasurisë

Agjencitë ligjzbatuese dhe organet qendrore dhe lokale detyrohen nga një sërë dispozitash të ndryshme ligjore për bashkëpunimin mes tyre në funksion të identifikimit dhe zbulimit të të gjitha rasteve të cilat lidhen me dobinë pasurore të krijuar nga veprat penale. Në këtë përgjegjësi janë të përfshira edhe strukturat tatimore dhe doganore, ndonëse roli i tyre në Shqipëri nuk është i ngjajshëm me rolin e strukturave analoge në shumë vende të tjera, p.sh si në Itali. Strukturat tatimore dhe doganore në Shqipëri, ashtu si shumë struktura të tjera, mbartin ligjërisht detyrimin për informacion në organet ligjzbatuese, por sidoqoftë roli i tyre nuk shtyhet më tej në këtë aksion.

²⁹⁵ Ligji Nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"

Kështu, bazuar në ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”²⁹⁶, i ndryshuar, organet tatimore mbartin detyrimin të japin pa pagesë informacionin tatimor për tatimpaguesin, kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:

- a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;
- b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;
- c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;
- ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërket në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;
- d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;
- dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;
- e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë, por gjithmonë kërkesa për këto informacione duhet të bëhet me shkrim dhe të depozitohet zyrtarisht.

Si në shumë legjislacione edhe në Shqipëri pasuritë e konfiskuara kalojnë në administrimin e shtetit dhe Ministria e Financave është ministria përgjegjëse për mirëadministrimin e tyre. Një strukturë e veçantë si Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara merret me administrimin e pasurive dhe administratorët e pasurive të konfiskuara janë ata që raportojnë për pasuritë e konfiskuara, deri sa nuk janë zëvendësuar me ndonjë tjetër.

Por Shqipëria pavarësisht nga përparimi ka ende probleme me fushën e zbatimit të ligjit. Arenc Çela, drejtues i Task Forcës në Prokurorinë e Krimeve të Rënda i tha BIRN (*Rrjeti i gazetarëve europianë investigativë*) se është e nevojshme që ligji “Antimafia” të ndryshojë, me qëllim që prokuroria të ketë në duar mekanizma për të kryer veprime të karakterit penal në zbulimin e pasurive të vendosura në mënyrë të paligjshme. “Për momentin, prokurorët bëjnë vetëm hetim mbi bazën e shkresave, pa mundur të dërgojnë as letërporosi jashtë shtetit,” tha Çela për BIRN²⁹⁷. Dokumentet e siguruar nga BIRN tregojnë se 13 kompani

²⁹⁶ Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”

²⁹⁷ Press-raport-total-oc.pdf

biznesi u sekuestruan me vendim gjykatë gjatë vitit 2015, por vetëm njëra prej tyre administrohet nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, AAPSK. Por goditja e financave të krimit është forcuar vitet e fundit thotë Drejtori i agjencisë që administron këto prona Artur Kala. Më tej ai bën më tej me dije se, “Janë 54 llogari bankare me një vlerë 1.1 miliardë lekë dhe rreth 89 pasuri të paluajtshme të bllokuara me një vlerë rreth 2.13 miliardë lekë”²⁹⁸. Sipas Kalës, pjesa dërrmuese e pronave të sekuestruara burojnë nga korrupsioni, trafiqet dhe financat e terrorizmit. Janë kryesisht pasuri që rrjedhin nga vepra penale që parashikohen në ligjin 10192 ose ligji Antimafia, si dhe ligji 9258 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, shton më tej kreu i AAPSK-së, Kala.

Por Shqipëria – e cilësuar “një lavatriçe” e parave të pista në Ballkan, pavarësisht përparimeve po përballlet me vështirësi prej më shumë se një dekade me sfidën e gjurmimit dhe konfiskimit të parave që rrjedhin nga krimi i organizuar. Rezultatet mbeten të vakëta, ndërsa një raport i Institutit të Bazelit për Qeverisjen, e renditi Shqipërinë të parën në rajon për vitin 2015, sa i përket nivelit të lartë të parave të pista që gjenerohen në ekonomi duke diktuar për të nevojën e një hapi cilësor në reformat e drejtësisë dhe arritjen e rezultateve të qëndrueshme.

5.12.3. Ndryshimet legjilative që prekin fushën e konfiskimit të pasurisë të përfituar në mënyrë të kundërligjshme

Përtej statistikave jo frymëzuese, Shqipëria vazhdon të jetë e angazhuar për të mundësuar rezultate të prekshme në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në çdo formë që ato shfaqen. Një shtysë nxitëse drejt këtyre rezultateve është edhe pritshmëria e Shqipërisë për të hapur negociatat drejt procesit të anëtarësimit në BE.

Të ashtuquajturat “**Kriteret e Kopenhagës**”, përcaktuar nga Këshilli Evropian mbajtur në dhjetor të 1993 në Kopenhagen, kërkojnë që edhe Shqipëria si çdo vend kandidat të ketë:

- institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut, respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve;
- një ekonomi tregu funksionale, si dhe aftësinë për të përballuar presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut që veprojnë brenda Bashkimit Europian;

²⁹⁸ www.javanews.al › Kronikë

- aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, në mënyrë të veçantë objektivat politike, ekonomik dhe të bashkimit monetar²⁹⁹.

Me fokus plotësimin e këtyre kriterëve Shqipëria po bën përpjekje në shumë fusha, përfshirë përmirësimin e legjislacionit dhe forcimin e sundimit të ligjit.

Reforma në Drejtësi, i shërbeu këtyre përpjekjeve dhe realizoi ndryshime në të gjithë piramidën legjislative, përfshirë Kushtetutën. Akte të tjera ligjore ekzistuese, mes të cilave edhe legjislacioni që lidhet me fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit reflektojnë ndryshimet kushtetuese dhe ju përgjigjën nevojave të kohës. Ligji Nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, pësoi gjithashtu ndryshime, me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014 dhe me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017.

Këto ndryshime mund ti grupojmë kryesisht në tre shtylla:

1. Zgjerimi i objektit të ligjit. Ligji i parë i shtrinte dispozitat e tij mbi krimin e organizuar dhe trafikimin, por në reflektim të ndryshimeve kushtetuese ligji Nr.10192, datë 3.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” zgjeroi objektin e tij edhe me korrupsionin, kryesisht me korrupsionin aktiv dhe pasiv në sektorin privat, korrupsionin aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike, korrupsionin aktiv të nëpunësve të huaj publikë, korrupsionin aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë dhe ushtrimin e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike, etj.
2. Përmirësimi i procedurave që lidhen me procesin nga nisja e tij që zë fill me kërkesën e prokurorit në gjykatë kur ka indicie/dyshime të arsyeshme se mund të jemi para një akti të krimit të organizuar, trafikimi e deri tek veprime dhe mosveprime që lidhen me korrupsionin. Ripërcaktimi i gjykatave që shqyrtojnë çështjet, përfshirë gjykatën e shkallës së parë dhe atë të Apelit kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, të cilat janë pjesë e sistemit gjyqësor shqiptar me ndryshimet e fundit kushtetuese.
3. Përfshirja nga procesi i përmbareshë gjyqësorë si hallkë mes gjykatës dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Duke gjykuar se përmbareshët kishin krijuar një kosto financiare shtesë për AAPSK-në

²⁹⁹ <http://em-al.org/sq/1865-2/#Kriteret>

dhe njëherësh vonesa në marrjen në administrim të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga AAPSK-ja, ndryshimet e ligjit (*kryesisht nenet 13-21*) mënjanuan këtë hallkë dhe e bënë më efikase veprimtarinë e AAPSK-së si dhe lehtësuan gjendjen e saj financiare.

Këto ndryshime legislative i lehtësojnë gjithashtu edhe veprimet hetimore të prokurorit duke krijuar mekanizma edhe për bashkëpunim me organizma ndërkombëtarë për realizimin e këtyre hetimeve me kusht, që marrëveshjet ndërkombëtare të nevojshme të jenë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

5.12.4 Roli i Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara

Prokuroria, gjykatat dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, më poshtë (AAPSK), janë aktorë kryesorë dhe komplementar të procesit të luftimit së krimit nëpërmjet goditjes së pasurive të vëna nga veprimtaria kriminale dhe korruptive. AAPSK-ja ka në këtë proces një rol të rëndësishëm, që lidhet me:

- Administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara me vendim gjykate, në zbatim të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikëve nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar;
- Administrimin e pasurive të bllokuara dhe të sekuestruara, në zbatim të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”;
- Administrimin e pasurive të tjera të sekuestruara e të konfiskuara, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to, administrimi i të cilave i caktohet kësaj Agjencie me ligj, me vendim gjykate apo urdhër të Ministrit të Financave.

Në thelb qëllimi i administrimit lidhet:

- Me nxjerrjen e përfitimeve prej këtyre pasurive;
- Me kthimin tek publiku i përfitimeve prej këtyre pasurive në formën e projekteve që ndihmojnë viktimat e trafikimit, jetësojnë programe rehabilitimi etj.

Në funksion të këtyre objektivave AAPSK-ja ka një numër administratorësh, detyrat e të cilëve sanksionohen nga neni 16 i Ligjit nr.10 192, “Detyrat e administratorit” që përcakton se: “*Administratori (i cili caktohet nga gjykata nga një listë që Agjencia i dërgon cdo vit gjykatës), ka për detyrë të ruajë dhe të administrojë pasurinë e sekuestruar.*

*Gjithashtu, ai ka për detyrë të rrisë, nëse është e mundur, vlerën e këtyre pasurive*³⁰⁰. Por, AAPSK-ja raporton gati përherë se shpenzimet e administrimit janë të mëdha. Drejtori i Agjencisë, z. Artur Kala, në intervistën që bëme në zyrën e tij, thekson se ndryshimet e ligjit kanë lehtësuar veprimtarinë e Agjencisë në marrjen e shpejtë në administrim të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, kurse neni 20 i ligjit, “Përballimi i shpenzimeve të administrimit” sanksionon se: *“Në rastet e vendosjes së masës së konfiskimit të pasurisë, shpenzimet e përballuara për administrimin e kësaj pasurie nga administratori ose Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përfshihen në llogaritë e administrimit të tyre. Nëse fondet e llogarive të administrimit nuk janë të mjaftueshme për të përballuar pagesën e këtyre shpenzimeve, ato paguhen pjesërisht ose plotësisht nga shteti, pa të drejtë kompensimi*³⁰¹, duke lehtësuar ndjeshëm këssoj financat e Agjencisë, kaq të rëndësishme në punën e saj.

Ligji 70/2017 me ndryshimet që solli në ligjin 10192/2009, uli në mënyrë të ndjeshme shpenzimet buxhetore në mirëadministrimin e pasurive dhe konkretisht çoi në:

- Ofrimin e mundësinë së kërimit të shpenzimeve në gjykata, për mirëadministrimin e pasurisë deri në revokimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar.
- Heqjen e detyrimeve të mëparshme që mund të ketë pasur pasuria, për të mos e ngarkuar atë me këto detyrime në momentin që merret në administrim nga AAPSK-ja.

Por problematikat janë ende evidente.

³⁰⁰ Ligji Nr.192, datë 3.2009 “Për organizimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

³⁰¹ Po aty

5.12.5. Raportet dhe statistikat e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara

Sipas Raportit³⁰² të Agjencisë për vitin 2018 ‘*Bilanci i të ardhurave dhe shpenzimeve*’ është si më poshtë:

Të ardhura	Shpenzime	Bilanci
5,421,284	31,574,075	-26,152,791

Tabela e të ardhurave sipas burimit të krijimit

	Emërtimi	Vlera në lekë	Vlera në %
1	Qiraja e objekteve	5,048,808	93%
2	Të ardhurat nga interesat dhe kamat vonesat	372,626	7%
	Të ardhura gjithsej	5,421,434	100%

Sikundër shihet nga tabela, zërin kryesor të të ardhurave e zënë të ardhurat e krijuara nga pasuritë e dhëna me qira në shumën **5,048,808** lekë ose **93%** të totalit.

Pjesa tjetër e të ardhurave prej **372,626 lekë ose 7%**, vjen nga interesat e llogarive të sekuestruara dhe konfiskuara, të investuara nga AAPSK-ja, deri në momentin e vendimit përfundimtar të gjykatës. Këto interesa reflektohen me së shumti, nga afatet e maturimit të mjeteve monetare dhe kohën e përfitimit të interesave që korrespondon me periodha të tjera të vitit³⁰³, ku me:

- “*Të ardhura nga administrimi i pasurive*” do të kuptojmë të gjitha të hyrat në vlera monetare që përfitohen nga administrimi i pasurive të sekuestruara/konfiskuara apo burime të tjera të ligjshme”; dhe me
- “*Shpenzimet për administrimin e pasurive*”, janë të gjitha të dalat në vlera monetare, që përdoren për administrimin e pasurive³⁰⁴.

³⁰² Raporti i AAPSK-së, marrë në ambjentet e vetë Agjencisë.

³⁰³ Raporti i AAPSK, për vitin 2018, paraqitur në Komitetin Ndërinstitucional të Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar.

³⁰⁴ VKM nr. 687, datë 5.10.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”

Pavarësisht përpjekjeve për të gjeneruar të ardhura nga pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara, duhet pranuar se përdorimi i pasurive të paluajtshme për t'u dhënë me qira, kushtëzohet nga disa faktorë dhe konkretisht:

- Lloji i pasurisë (njësi tregtare, apartament, objekt apo tokë);
- Nga vendi dhe pozicioni i pasurisë;
- Investimet e nevojshme për ta bërë të përshtatshme përdorimin e saj;
- Nga personi të cilit i është sekuestruar pasuria dhe ambienti rreth tij;
- Nga kohëzgjatja e procesit të gjyimit etj³⁰⁵.

Disa nga faktorët e mësipërm janë shpesh vendimtarë në mirëadministrimin e pasurisë dhe këtu, subjekti të cilit i është sekuestruar apo konfiskuar pasuria, rezulton të jetë një problem që pengon rivitalizimin e këtyre pasurive dhe një sfidë që duhet fituar. Në Agjencinë e Administrimit të Pronave të Sekuestruara dhe Konfiskuara, administratori i Agjencisë, z. Qirjako Theodhor, njëherësh lektor në disa universitete private, me të cilin biseduam në zyrat e AAPSK-së, na sjell si shembull rastin e një prone në Lushnje, e cila i përket Aldo Bares, një emër i njohur i krimit në Shqipëri. Prona u destinua për një projekt që lidhej me rehabilitimin e viktimave të trafikut, por ajo nuk iu mundësua dot projektit, pasi frika nga krimi mbizotëroi. Ende Agjencia po përpiqet ta vërë atë në punë duke sjellë si alternativë tashmë kalimin e pronës tek Komisariati i Policisë në Lushnje, për të zgjeruar hapësirën e tij. Kurse projekti u tërhoq nga kjo zonë. Por Lushnja nuk është një rast sporadik.

Një problem i shfaqur shpesh dhe që demoralizon luftën kundër krimit të organizuar janë vendimet e revokimit nga gjykatat (në Shqipëri, gjykimet e këtyre lëndëve i takojnë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit për krimet e rënda, neni 5 i ligjit)³⁰⁶, por vendime mbi gjykime të tilla japing edhe gjyakta e lartë dhe Prokuroria për krimet e rënda.

Sipas raportit të AAPSK-së për vitin 2017 kemi:

Gjate vitit 2017 në adresë të AAPSK-se kanë ardhur **39 vendime**, për **22 subjekte** nga këto:

- 23- Vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda.
- 11- Vendime të Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda.
- 4- Vendime të Gjykatës së Lartë.

³⁰⁵ Raporti i AAPSK-së, marrë në ambjentet e vetë Agjencisë.

³⁰⁶ L. igji Nr.9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave të krimeve të rënda”

1- Vendim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.

Nga vendimet e gjykatës, gjatë këtij viti kemi:

1-Vendime Sekuestrimi;

a- Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda,

5- Vendime për 63 pasuri të paluajtshme dhe 5 pasuri të luajtshme.

b- Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda,

3- Vendime për 16 pasuri të luajtshme dhe 1 pasuri të paluajtshme

c- Gjykata e Lartë,

1 Vendim për 1 pasuri të luajtshme

2-Vendime Konfiskimi;

a- Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda

4- Vendime për 6 pasuri të paluajtshme, 1 shoqëri dhe 2 autovetura

b- Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda

5- Vendime për 18 pasuri të paluajtshme dhe 1 pasuri të luajtshme

c- Gjykata e Lartë

1- Vendim për 13 pasuri të paluajtshme

3-Vendime Revokimi

a- Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda

10- Vendime për 19 pasuri të paluajtshme dhe 6 pasuri të luajtshme

b- Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda

5-Vendime për 11 pasuri të paluajtshme dhe 2 pasuri të luajtshme

c- Gjykata e Lartë

3-Vendime për 10 pasuri të paluajtshme dhe 2 shoqëri

4-Vendime Pushimi

a- Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda

Një Vendim për 2 pasuri të paluajtshme

b- Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda

Dy Vendime për 2 pasuri të paluajtshme

5-Vendime Rigjykimi

a- Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda

Një Vendim për 1 pasuri

6-Vendime për Zgjatje Afati

a- Gjykata e Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda

7 Vendime zgjatje afati për 170 pasuri të paluajtshme, 17 pasuri të luajtshme dhe 5 shoqëri.

Në mënyrë të përmbledhur vendimet e gjykatave sipas statusit të pasurive të marra në konsideratë për vitin 2017³⁰⁷ paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Vendimet e gjykatave për periudhën 1.01-31.12.2017											
Sekuestruar		Konfiskuar		Revokuar		Zgjatje afati		Rishqyrtim		Pushim	
Vend.	Pasuri	Vend.	Pasuri	Vend.	Pasuri	Vend.	Pasuri	Vend.	Pasuri	Vend.	Pasuri
9	86	10	41	18	50	7	192	1	1	2	4

Kurse për vitin 2018 Agjencia bën me dije se janë revokuar 25 pasuri, nga të cilat:

- 13 pasuri janë të paluajtshme (5 pasuri janë apartamente & ndërtesa dhe 8 pasuri tokë & truall).
- 12 llogari bankare dhe depozita³⁰⁸.

Si konstatohet lehtësisht, problematike e madhe e pronave të tilla është fakti se ato shpesh i kthehen pronarit, si dhe konstatohet nga tabelat, duke krijuar jo rrallë një presion demoralizues në luftën kundër krimit dhe korrupsionit ndërmjet masave të luftimit të pasurive të krijuara nga krimi.

Por përtej këtyre duhet pranuar se pasuri të konfiskuara janë kthyer gjithashtu në të mira publike. Legjislacioni i fushës, i ndjekur nga qëllimi që pasuritë e krimit të kthehen si të mira për publikun i ka destinuar ato në mundësi përdorimi për aktivitete ekonomike, tregëtare dhe financiare, kur bëhet fjalë për prona të paluajtshme, dhe për financimin e buxhetit të agjencisë dhe të projekteve të ndryshme sociale kur kemi të bëjmë me mjete financiare.

³⁰⁷ Raporti i AAPSK-s- për vitin 2017, marrë në ambjentet e këtij institucioni. Raporti është i disponueshëm me këto të dhëna nëpërmjet një kërkesë pranë zyrave të AAPSK-së.

³⁰⁸ Raporti i AAPSK-s- për vitin 2018, marrë në ambjentet e këtij institucioni. Raporti është i disponueshëm me këto të dhëna nëpërmjet një kërkesë pranë zyrave të AAPSK-së.

Administrimi i pasurisë, që përfshin “...gjitha veprimet dhe procedurat ligjore që kryhen nga Agjencia apo nga administratori i pasurisë, me qëllim ruajtjen, mirëmbajtjen dhe, kur është e mundur, shtimin e vlerës së pasurisë, që nga çasti i marrjes dijeni për aktin e sekuestros/konfiskimit dhe deri në atë të tjetërsimit ose të revokimit të masës së sekuestrimit të pasurisë” krijon të ardhura që ndahen në:

- Të ardhura nga administrimi i pasurive, që përdoren vetëm për të mbuluar shpenzimet e administrimit të pasurive; dhe
- Të ardhura që përfitohen nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara dhe që shkojnë në:
 - a) Buxhetin e Shtetit;
 - b) Fondin e posaçëm për parandalimin e kriminalitetit;
 - c) Llogarinë e Agjencisë për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara.

Shpërndarja e këtij fondi përcaktohet me urdhër të Ministrit të Financave³⁰⁹, ndërkohë që fondi i posaçëm shërben për:

- a) përmirësimin e funksionimit të drejtësisë penale, duke destinuar pasuritë në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme dhe të Ministrisë së Drejtësisë;
- b) përmirësimin e hetimeve paraprake penale të krimit të organizuar dhe zhvillimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet e rendit publik;
- c) dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale;
- d) dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor.

3. Përveç institucioneve qendrore, përfitues të financimit të projekteve për parandalimin e kriminalitetit mund të jenë:

- a) njësitë e qeverisjes lokale vendore, ku ndodhen pasuritë e paluajtshme të konfiskuara;
- b) organizatat jofitimprurëse, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre rehabilitimin

³⁰⁹ VKM nr. 687, datë 5.10.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara, si dhe mënyrën e administrimit të pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”

social, kulturor e shëndetësor të shtresave në nevojë, veçanërisht atyre të prekura apo të rrezikuara nga krimi, përfshirë organizatat dhe qendrat terapeutike, qendrat e riaftësimit dhe të kurimit të përdoruesve të substancave narkotike, si dhe qendrat e asistencës e të rehabilitimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore, që, në tri vitet e fundit nga paraqitja e kërkesës, zhvillojnë veprimtari të tilla³¹⁰.

Në procesin e administrimit të pronave të sekuestruara dhe konfiskuara, një rol të rëndësishëm luan edhe Komitetit Këshillimor Ndërinstitucional i Ekspertëve për Masat Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, më poshtë (KKNEMKKO), një strukturë rekomanduese për Ministrin e Financave, që është edhe titullari që nxjerr vendimin përfundimtar për destinimin e pasurive nën sekuestro ose të konfiskuara.

Komiteti është një strukturë me 8 anëtarë, përfaqësues nga niveleve të larta të Ministrisë së Financave, përfaqësuesi i të cilës është njëherësh edhe drejtuesi i Komitetit dhe nga përfaqësues që vijnë nga Ministria e Drejtësisë, Ministria që mbulon çështjet sociale, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Njësia e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë. KKNEMKKO mblidhet të paktën një herë në tre muaj, ku dëgjon raportimin e AAPSK-së për veprimtarinë e saj dhe, pasi diskuton problematikat e pronave në administrim nga Agjencia, jep rekomandime tek Ministri i Financave për vendimmarrjen përfundimtare lidhur me to.³¹¹

KKNEMKKO pret çdo 3 muaj raportin e Agjencisë dhe në mbledhje diskutohen problematikat e dala si nga vendimarrja e gjykatave ashtu edhe nga administrimi i pasurive. Por Komiteti nuk është hallkë vendimarrëse, por luan rolin e kontrollorit të veprimtarisë së Agjencisë dhe shërben si hallkë lidhëse mes Agjencisë dhe Ministrisë së Financave, i cili ka tagrin e vendimeve për destinacion e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara.

Nga sa u tha më sipër mund të themi se, Shqipëria s ka një legjislacion tashmë të konsoliduar në luftën kundër krimit dhe korrupsionit, por ajo ende gjendet në përpjekje për të përsosur këtë legjislacion dhe përafrimin e tij me *aquas communitiare*. Një përpjekje e domosdoshme edhe drejt prespektivës së saj evropiane.

³¹⁰ Ligji Nr.192, datë 3.2009 “Për organizimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”

³¹¹ Po aty

KAPITULLI VI

RREGULLIMI LIGJOR I KONFISKIMIT TË DOBISË PASUORE TË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE NË KOSOVË

6.1. Vështrime të përgjithshme

Një nga të drejtat themelore civilizuese dhe njerëzore të garantuara dhe me dokumentet ndërkombëtare juridike dhe me të drejtën e brendshme është e drejta në gëzimin e lirë të pronësisë dhe të drejtave të tjera pasurore të fituara në bazë të ligjit. Kështu, në nenin 1 të Protokollit të parë të Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe të lirive themelore³¹², është paraparë se *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë në gëzimin e papengueshëm të pasurisë së vet dhe se askush nuk mundet të privohet nga pasuria e vet përveçse në interesin publik dhe nën kushtet e parapara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të drejtës ndërkombëtare”*. Dispozita të ngjashme mund të gjenden edhe në dokumentet e tjera ndërkombëtare, por edhe në legjislacionet nacionale (kombëtare) të brendshme duke përfshirë edhe aktin themelor juridik (Kushtetutën).

Kështu, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 46), garantohet e drejta pronës dhe është parashikuar se askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona, përveçse kur Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës bënë ekspropriimin e pronës dhe nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik.

Nga citimet e dispozitave të mësipërme ndërkombëtare dhe të Kosovës, shihet se e drejta për gëzim të qetë të pronës nuk është absolute dhe shtetit i jepet një shkallë e konsiderueshme lirie me rastin e vlerësimit të interesit publik, çka kufizon të drejtën e gëzimit të pasurisë. Kjo shkallë lirie rritet akoma më shumë kur kemi të bëjmë me pasurinë e përfituar me veprimtari kriminale. Në këtë kuptim, Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka parashikuar se: *“Askush nuk mund ta mbajë dobinë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale”*³¹³.

³¹² E miratuar më 4.11.1950 në Romë, ka hyrë në fuqi më 3.5.1953, ndërsa në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Konventë dhe protokollet e saj, garantohen dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës.

³¹³ Neni 96 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.19/13 Korrik 2012, Prishtinë.

Legjislacionet nacionale parashikojnë edhe instrumente të ndryshme për konfiskimin e dobisë pasurore, herë si sanksione të veçanta penale, herë si masa të veçanta penalo juridike dhe të ngjashme. Mirëpo sot ekziston mendimi i përgjithshëm i pranuar se instrumentet tradicionale, në veprimin preventiv dhe represiv kundër formave të caktuara të kriminalitetit, në veçanti të kriminalitetit të organizuar, janë të pamjaftueshme dhe se duhen gjetur forma të reja të veprimit, sepse qëllimi i grupeve kriminale dhe i organizatave kriminale nuk është vetëm fitimi i dobisë së madhe pasurore por edhe legalizimi i asaj pasurie dhe shfrytëzimi për punë legale. Legalizimi i këtyre të ardhurave sjell për ekonominë e çdo vendi një varg pasojash politike dhe ekonomike, impakti i të cilave është negativ. Dobitë e ardhura nga krimi sjellin përherë efekte negative për rendin dhe sigurinë kombëtare, kryesisht në tre aspekte:

- Në pikëpamje të rendit dhe sigurisë, kjo dukuri rrit rrezikun që vjen nga riinvestimi i fondeve të tilla në funksion dhe shërbim të veprimtarive të tjera kriminale;
- Në pikëpamje sociale dhe politike, shton rrezikun që vjen nga krimet e rënda si trafiket e drogës, armëve, kontrabanda etj., dhe krijon mundësi që krimi të organizohet, të fuqizohet dhe të fshihet pas investimeve të ligjshme. Pastrimi i parave kthehet kështu në kërcënim për besueshmërinë dhe stabilitetin e strukturave financiare;
- Në aspektin ekonomik- zvogëlon të ardhurat në buxhetin e shtetit që vijnë nga taksat dhe tatimet dhe krijon një ekonomi paralele që asfikson biznesin e rregullt e të ndershëm dhe destabilizon sektoret dhe institucionet financiare³¹⁴.

Në orvatjen për të luftuar format e ndryshme të kriminalitetit, bashkësia ndërkombëtare harton legjislacione, të cilat bashkë me instrumentet e tjera u rekomandohen shteteve për ridrejtimin e reaksionit penalo juridik nga reagimi ekskluziv me sanksione penale dhe dënimin e autorëve të veprave penale në funksion të dobësimit dhe eliminimit të organizatave kriminale.

Këto sanksione rezultojnë efikase, sakohë godasin pasurinë dhe përfitimet e paligjshme të kriminit dhe mundësojnë arritjen e efekteve të shumfishta si realizojnë qëllime preventive – pasi dobia pasurore është motivi kryesor i shumicës së veprave penale; pengojnë infiltrimin e të hyrave të kundërligjshme në ekonominë legale; zvogëlojnë mundësinë për korrupsion; organizatat kriminale privohen nga mjeti themelor për kryerjen e mëtejshme të

³¹⁴<http://telegraf.al/ekonomi/naim-mecalla-pasojat-e-pastrimit-te-parave>

veprimtarisë kriminale sikundër, realizojnë forcimin e sundimit të së drejtës/ligjit, parim themelor i të cilit është se askush nuk mund të ketë dobi nga kryerja e veprave penale³¹⁵.

Duke patur parasysh rëndësinë e konfiskimit të pasurisë, përkatësisht të dobisë pasurore të fituar me vepra kriminale, si dhe faktin se mjetet tradicionale të luftës kundër formave të reja të kriminalitetit nuk janë të mjaftueshme, kohët e fundit legjislacionet bashkohore parashikojnë masa të veçanta lidhur me kushtet dhe procedurën e konfiskimit të përkohshëm (sekuestrimit) dhe të konfiskimit të përhershëm të dobisë pasurore të përfituar në mënyrë të paligjshme, esenca e të cilave shihet në gjetjen e metodave të veçanta për hyrjen në gjurmë të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, me ngrirjen e saj, me konfiskimin e përkohshëm dhe të përhershëm. Në rregullimin ligjor të kësaj problematike shkohet deri atje sa konfiskohet jo vetëm pasuria që është fituar me veprën penale të lëndës, por edhe pasuria në prejardhjen ligjore të së cilës dyshohet të jetë përfshirë jo vetëm autori i veprës penale por edhe persona të tretë. Gjithsesi, zgjidhja më radikale konsiderohet ajo e dhënë nga disavende, të cilat kanë aplikuar konfiskimin civil dhe administrativ të pasurisë, esenca e të cilave është se është i mundshëm konfiskimi i dobisë së përfituar nga kriminaliteti jo vetëm pa dënim penal, por edhe pa hetim të ndërmarrë për veprën penale. Kjo është karakteristikë e sistemit anglo-sakson, por ne e gjejmë të aplikuar edhe në vendet e sistemit juridik kontinental. Shembujt vijnë nga Italia dhe Belgjika, të cilat aplikojnë ashtuquajturin “sekuestrimin civil” ku kërkesa është e orientuar ndaj sendeve e jo ndaj personit dhe ku bartja e barrës së provës së fitimit të pasurisë bie mbi të akuzuarin, për të cilin vlen supozimi i pafajësisë dhe ku fajësia e të cilit ka shkaktuar dilema dhe kontestime lidhur me zbatimin e këtyre instituteve në sistemin tonë.

6.2. Natyra juridike e konfiskimit të dobisë pasurore

Konfiskimi i dobisë pasurore si institut i pavarur i pjesës së përgjithshme të së drejtës penale është paraqitur për herë të parë në Kodin Penal të Mbretërisë së Norvegjisë në vitin 1902. Në legjislacionin e ish Jugosllavisë deri në nxjerrjen e ligjit Penal 1976, konfiskimi i dobisë pasurore ka qenë masë sigurie, ndërsa Ligji Penal i 1976 e ka themeluar atë si masë të veçantë. Në Kosovë ky institut (si masë e veçantë), vazhdoi të zbatohet edhe në periudhën e administrimit të vendit nga UNMIK-u, në periudhën e veprimtarisë së institucioneve të përkohshme të Kosovës si dhe pas shpalljes së pavarësisë së Republikës

³¹⁵Golobinek, Robert, Hetimet financiare dhe konfiskimi i pasurisë së fituar me vepra penale, doracak për pjestarët e policisë dhe gjyqësorit, Këshilli i Europës, Strazburg, 2006, fq. 16.

së Kosovës. Ndërsa me Kodin e ri Penal të Kosovës të vitit 2012 konfiskimi i dobisë pasurore konsiderohet si sanksion penalo juridik, përkatësisht dënim plotësues³¹⁶.

Siç u cek më sipër, vëmë re se një nga dilemat më të rëndësishme teorike lidhur me konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme kanë të bëjë me natyrën juridike të kësaj mase. Disa pikëpamje konsiderojnë se bëhet fjalë për masën e sigurisë si kategori e pjesës së përgjithshme të së drejtës penale, të tjerat nisen nga ajo se bëhet fjalë për masën e veçantë, ndërsa mendimet e treta e rregullojnë në grupin e sanksioneve penalo juridike. Pikëpamjen për konfiskimin e dobisë pasurore si masë sigurie, e cila definon, se autorit të veprës penale i konfiskohet detyrimisht dobia pasurore e përfituar me kryerjen e veprës penale, e ka përfaqësuar teoria penalo-juridike e mëhershme³¹⁷. Mirëpo sot konsiderohet me të madhe se konfiskimi i dobisë pasurore nuk është as masë sigurie, as pasojë juridike e dënimit. Kemi të bëjmë me një institut të përzier penalo-civilo-juridik të llojit të veçantë (*sui generis*), qëllimi i të cilit është vendosja e gjendjes së prishur me kryerjen e veprës penale dhe ndalimi i pasurimit të paligjshëm me veprimtaritë kriminale³¹⁸.

Nga kjo rrjedh se masa e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme ka efektin preventiv dhe retributiv. Ajo ka rëndësi preventive sakohë autorit të veprës i bëhet me dije se nuk mund të gëzoj dobinë e fituar në mënyrë të paligjshme me kryerjen e veprës penale. Ky institut dallohet nga dënimet dhe masat e sigurisë, sepse për shkak të natyrës së tij *in rem* nuk ka karakter punitiv, ndërsa qëllimi i tij është restorativ, pasi përkatësisht me konfiskimin e dobisë pasurore do të kontribuohet në vendosjen e gjendjes pasurore juridike që ka qenë para kryerjes së veprës penale me të cilën është përfituar dobia pasurore, si dhe realizohet parimi i drejtësisë³¹⁹.

Çështja tjetër me rëndësi lidhur me zbatimin e këtij instituti në praktikë i përket modaliteteve të zbatimit të këtij institute në disa legjislacione, përkatësisht në natyrën e procedurës me të cilën përcaktohet ekzistenca e dobisë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Aktualisht në shtete të ndryshme ekzistojnë zgjidhje të ndryshme legjislative, të cilat shpesh kombinojnë elementet e të drejtës penale, të drejtës procedurale penale, ose të drejtës civile

³¹⁶ Kodi i Penal i Republikës të Kosovës, neni 62.

³¹⁷ Zlataric, Bogdan, dhe Damaška, Mirijan, *Rjecnik krivicnog prava i postupka. (Fjalori i drejtës penale dhe i procedurës)*, Zagreb, 1996.

³¹⁸ Derencinovic, Davor, (1999). Pravna priroda instituta oduzimanja imovinske koristi i njegovo znacenje u prevenciji organiziranog kriminala *Policija i sigurnost*, 8(3-4), fq.196.

³¹⁹ Ivicovic-Karas, E. (2007). Kaznenopravno oduzimanje nezakonito stecene imovinske koristi. *Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu*, 14(2), 674.

dhe administrative, duke krijuar kështu mundësi fleksible dhe të mjaftueshme në luftën ndaj formave të ndryshme të korrupsionit³²⁰.

Si rregull, kjo materie është rregulluar me normat e legjislacionit penal. Përkatësisht, zbatimi i këtij instituti, në shumicën e shteteve, zbatohet në mënyrë ekskluzive gjatë zhvillimit të procedurës penale, çka nënkupton se në këto sisteme, bazë e konfiskimit të dobisë pasurore është çdo vendim gjyqësor me të cilin është vërtetuar se është kryer vepra penale. Në anën tjetër, ekzistojnë edhe legjislacione të tjera brenda të cilave mund të zhvillohet procedura civilo-juridike, e cila përcakton ekzistencën e dobisë pasurore së përfutur në mënyrë të kundërligjshme me kusht, që në të njëjtën lëndën, në mënyrë paralele, të zhvillohet edhe procedura penale në të cilën nxirret vendimi përfundimtar për konfiskimin.

Në pikëpamje të zgjidhjeve të tilla legjislative është paraqitur edhe nevoja për instrumente plotësuese hetimore, të cilat do të zbatohen me qëllim vërtetimin e prejardhjes së vërtetë të pasurisë në rrethana të tilla. Kështu, është paraqitur edhe nocioni i hetimit financiar, i cili zhvillohet njëkohësisht me hetimin në procedurën penale dhe ka për qëllim grumbullimin e të gjitha të dhënave relevante financiare dhe të dhënave të tjera që bëjnë me dije natyrën dhe prejardhjen e pasurisë për të cilën dyshohet se është përfutur në mënyrë të paligjshme. Thënë më saktësisht, me këtë nocion nënkuptohet grumbullimi, kontrolli, kompletimi, përpunimi dhe analiza e të dhënave financiare ose të dhënave të ndërlidhura to, me qëllim zbatimin e ligjit³²¹.

Përpjekjet për qasjen më të gjërë, që përfshijnë edhe masat e të drejtës civile me qëllim konfiskimin e dobisë pasurore të përfutur në mënyrë të paligjshme, janë gjithnjë e më intensive si në teori ashtu edhe në praktikë. Në kontekstin e kuptimit të institutit të konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me veprime korruptive, në mënyrë ekskluzive, nuk duhet të bazohemi në veprime të tilla si veprimet korruptive, vjedhja, mashtrimi, fshjehja e tatimit etj., por duhet kuptuar se në aktivitetet korruptive duhet të përfshihen të gjitha sjelljet që i nënshtrohen përgjegjësisë penale edhe përgjegjësisë civile³²². Në këtë kuptim, sot në të drejtën krahasuese ekzistojnë zgjidhje legjislative që parashikojnë konfiskimin e dobisë pasurore edhe pa ekzistencën e dënimit ose të ndonjë vendimi tjetër në procedurën

³²⁰ United Nations (2003). *UN Guide for Anti-Corruption Policies*. f. 88;
http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/UN_Guide.pdf.

³²¹ Van Duyne, C. P., Pheijffer, M., Kuijl, G. H., Van Dijk, A. & Bakker, J.C.M. G. (2001). *Financial investigation of crime (A tool of the integral law enforcement approach)*. The Hague: Koninklijke Vermande.

³²² Chamberlain, K. (2002). Recovering the Proceeds of Corruption. *Journal of Money Laundering Control*, fq. 157.

penale (eng. *civil recovery*). Gjithashtu, ka mendime se qasja e zgjedhur nga disa legjislacione moderne si SHBA, Britania e Madhe, Australi, Kanada, Irlandë etj.,t ë cilat konfiskimin e dobisë pasurore e realizojnë pa e vërtetuar organet e ligjit, por duke ia lënë barrën e provës së pasurisë të dyshuarit, në bazë të parimit të “mundësisë së balancës”, në fakt bëhet jo efektive³²³. Në të vërtetë, zgjidhje të tilla ligjore u mundësojnë organeve gjyqësore të këtyre shteteve mundësinë e konfiskimit të pasurisë për të cilën dyshohet se rrjedh nga aktiviteti kriminal, pa një aktgjykimi penal. Në anën tjetër, me qëllim mbajtjen e pasurisë, i dyshuari mbart detyrimin e vërtetimit të ligjshmërisë së pasurisë së tij, mbi bazën e të hyrave që dëshmojë prejardhjen e ligjshme të asaj pasurie³²⁴.

Parimi i transferimit (bartjes) të barrës së të provuarit që është paraqitur në këto procedura, e ka pasur zbatimin e tij edhe në kuadër të modeleve klasike të konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale. Vlen të theksohet se lidhur me këtë standard përdoren nocionet e “*konfiskimit të zgjeruar*”, “*të barrës së anasjelltë të të provuarit të prejardhjes së pasurisë*”, “*reduktimit të standardit të të provuarit*” etj. Nëse personi i akuzuar nuk ka mundësi të argumentojë dhe vërtetojë pasurinë e tij, Gjykata kupton se bëhet fjalë për dobinë pasurore të dalë nga kryerja e veprës penale dhe urdhëron konfiskimin e saj të përhershëm.

Çështja kontestuese e radhës ka të bëjë me komponentin e përmbarimit në institutin e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar në mënyrë të kundërligjshme. Në të vërtetë, masa e konfiskimit të dobisë pasurore është kategori ligjore e të drejtës penale dhe, për konfiskimin e saj, vendoset në procedurën penale. Në anën tjetër, për vetë konfiskimin e dobisë pasurore në procedurën penale janë relevante dispozitat e të drejtës së përmbarimit³²⁵. Në këtë kuptim flitet për sistemin e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar në mënyrë të paligjshme, për të cilën dispozitat relevante dhe kapacitetet institucionale duhet të mundësojnë zbulimin efikas, konfiskimin e përkohshëm (sekuestrimit) dhe administrimin me pasurinë e konfiskuar dhe në fund, konfiskimin e përhershëm bashkë me garantimin e plotë të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore (në veçanti të drejtat lidhur me pronën dhe gjykimin e drejtë).

³²³ Smellie, A. (2004). Prosecutorial Challenges in Freezing and Forfeiting Proceeds of Transnational Crime and Use of International Asset Sharing to Promote International Cooperation. *Journal of Money Laundering Control*. 8(2), fq. 107.

³²⁴ Alldridge, P. (2003). *Money Laundering Law (Forfeiture, Confiscation, Civil Recovery, Criminal Laundering and Taxation of the Proceeds of Crime)*. Oxford&Portland: Hart Publishing, fq. 225.

³²⁵ Derencinovic, Davor, (1999). Pravna priroda instituta oduzimanja imovinske koristi i njegovo znacenje u prevenciji organiziranog kriminala. *Policija i sigurnost*, 8(3-4), fq.162.

6.3. Konfiskimi i dobisë pasurore të përfitur me vepër penale në legjislacionin e Republikës së Kosovës

Konfiskimi i dobisë pasurore të përfitur me vepër penale paraqet masë të veçantë penalo juridike. Ky qëndrim del nga fakti se kjo masë/ky sanksion është parashikuar si pasojë e kryerjes së veprës penale me të cilën është përfitur dobia pasurore dhe se atë/sanksion e shqipton gjykata në procedurën penale kur vërteton se me kryerjen e veprës penale është përfitur dobia pasurore. Dobia pasurore e përfitur me vepër penale paraqet forcën shtytëse të aktiviteteve kriminale. Qëllimi i konfiskimit të dobisë pasurore të përfitur me anë të veprës penale do të ishte ndalimi i pasurimit të paligjshëm dhe vendosja e gjendjes së prishur me kryerjen e veprës penale konkrete. Në mënyrë fundamentale, parimi se askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të përfitur me kryerjen e veprës penale është parashikuar edhe në legjislacionin penal të Republikës së Kosovës.

Në të vërtetë, legjislacioni i ri penal në Republikën e Kosovës përmban gjithashtu dispozita për konfiskimin e dobisë pasurore të përfitur me vepër penale. Kjo para së gjithash i përket dispozitave materiale të legjislacionit penal, të cilat përmbajnë bazën ligjore për konfiskimin e dobisë pasurore të përfitur me vepër penale dhe mënyrën e konfiskimit të dobisë së tillë, si dhe normat e legjislacionit procedural penal që rregullojnë procedurën e posaçme për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme. Vlen të theksohet, se me reformën e legjislacionit penal në Republikën e Kosovës pas vitit 2008, për herë të parë në legjislacionin e Republikës së Kosovës është aplikuar edhe instituti i konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Andaj, duke folur më parë për kornizën juridike të masës së konfiskimit të dobisë pasurore të përfitur me anë të veprës penale është theksuar se ekzistojnë dy lloje të rregullimit ligjor të këtij instituti: a) që kjo të rregullohet me një ligj; b) që kjo të rregullohet me më shumë ligje. Në Legjislacionin e Kosovës është miratuar zgjidhja e dytë, prandaj kjo çështje është rregulluar me Kodin Penal³²⁶, me Ligjin Nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfitur me vepër penale³²⁷, me Kodin e Procedurës Penale³²⁸ dhe me Ligjin Nr. 03/L-141 për administrimin e pasurisë së

³²⁶ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 19/ 13 korrik 2012, Prishtinë- KPRK.

³²⁷ Ligjit Nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfitur me vepër penale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 5 / 8 Mars 2013, Prishtinë).

³²⁸ Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë)

sequestruar ose të konfiskuar³²⁹. Duke patur parasysh dispozitat e këtyre ligjeve mund të konstatohet se ekzistojnë dy lloje të konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me veprë penale. *I pari* është legjislacioni i mëparshëm i Kosovës, i njohur deri tani si konfiskimi i pasurisë së dalë nga vepra penale (veprat penale për të cilat gjykohet). Në të vërtetë, siç kemi theksuar, kjo mënyrë tradicionale e konfiskimit të pasurisë së përfituar nga vepra penale është ende mbizotëruese në vendet e sistemeve juridike kontinentale. Mirëpo, duke patur parasysh se me zbatimin vetëm të këtij lloji të konfiskimit të dobisë pasurore, një pjesë e madhe e pasurisë mbetet jashtë largësisë së arritshme të drejtësisë, një numër gjithnjë e më i madh i vendeve po miraton edhe mënyrën tjetër të konfiskimit të pasurisë, e cila nuk buron nga vepra penale për të cilën gjykohet, por paraqitet si produkt i të gjitha aktiviteteve kriminale të të pandehurit³³⁰. Në këtë kuptim, legjislacioni i ri i Republikës së Kosovës ka aplikuar edhe mënyrën e dytë të konfiskimit të dobisë pasurore të dalë nga vepra penale, prejardhja e të cilës dyshohet, i ashtuquajtur i konfiskim i zgjeruar i dobisë pasurore.

6.3.1. Konfiskimi i dobisë pasurore sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës

Kodi Penal i Republikës së Kosovës kushton kapituj të veçantë konfiskimit të dobisë pasurore si masë e posaçme penalo juridike³³¹, ku janë përcaktuar: bazat e konfiskimit të dobisë pasurore; kushtet dhe mënyra e konfiskimit të dobisë pasurore; mbrojtja e të dëmtuarit dhe konfiskimi i dobisë pasurore nga personat juridik.

Kështu, Kapitulli i VII i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Penal) përmban dispozita për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me anë të kryerjes së veprës penale, ndërsa Kapitulli i VIII i Kodit Penal përmban dispozita për pasojat juridike të dënimit. Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me anë të veprës penale dhe pasojat juridike të dënimit nuk janë masa të veçanta penalo juridike, por janë sanksione penalo juridike, përkatësisht dënime plotësuese.³³² E drejta penale e Kosovës deri në hyrjen në fuqi të këtij Kodi, shumicën e dënimeve plotësuese, që tani njihen në nenin 62 të Kodit Penal, i ka

³²⁹Ligji Nr. 03/L-141për administrimin e pasurisë së sequestruar ose të konfiskuar (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti IV/nr.58/10 Gusht 2009, Prishtinë).

³³⁰ Shih: Ismet Salihu, Hilmi Zhitija dhe Fejzullah Hasani “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Botimi I”, i publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIY) GmbH, Mars 2014, fq. 214-315.

³³¹ Po aty, fq. 312.

³³² KPRK, neni 62.

konsideruar si masa sigurimi³³³. (Në Komentarin e Kodit Penal, në faqen 312 –Vështrime të Përgjithshme (pika 3), autorët konfiskimin e konsiderojnë si masë, duke mos e specifikuar se çfarë mase është (masë e sigurisë), ndërsa nuk e konsiderojnë si lloj sanksioni penal. Por kur autorët e komentojnë institutin e dënimit plotësues, nga neni 62, konstatojnë se dënimi plotësues, ku përfshihet edhe konfiskimi është sanksion penal e jo masë e sigurisë?).

Mendoj se instituti i konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me anë të veprës penale i rregulluar në kapitullin VII ka ndërlidhje me nenin 62 të Kodit Penal, sepse pas konstatimit të kryerjes së veprës penale, sipas kushteve të parapara me ligj, të dënuarit sipas nenit 62 mund t'i shqiptohet edhe dënimi plotësues (do të thotë si sanksion penalo juridik), bashkë me dënimin kryesor, edhe për marrjen/konfiskimin e sendeve.

Nga kjo arsye, të rënduarit e dispozitave me të cilat rregullohen institutet: bazat e konfiskimit të dobisë pasurore dhe pasojat juridike të dënimit në dy kapituj të Kodit Penal, edhe përkundër dallimeve që kanë të bëjnë me përmbajtjen e tyre, kushtet për zbatimin e tyre, mënyrën e shqiptimit të paraqitjes dhe masën në të cilën, me dispozitat e këtij Kodi, janë rregulluar këto dy institute, ka justifikim.

Dënimi i konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me anë të veprës penale është instaluar në në Kodin tonë Penal si dënim plotësues penalo juridik³³⁴, që është pasojë e kryerjes së veprës penale me të cilën është përfituar dobia pasurore.

Pikëpamja se konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale sipas natyrës së tij juridike është sanksion penalo juridik, e jo masë e veçantë penalo juridike, siç ka qenë para nxjerrjes së Kodit të Përkohshëm Penal sipas UNMIK/RREG/2003/35 të datës 6 korrik 2003, do të thotë se, me atë Kod (Kodi i Përkohshëm Penal), konfiskimi kryhej pasi gjykata vërtetonte në procedurën penale se dobia pasurore ishte fituar nga kryerja e veprës penale. Duke pasur parasysh dispozitën ligjore me të cilën është përcaktuar se nga se mund të përbëhet dobia pasurore e fituar me anë të veprës penale (neni 96 paragrafi 1 të këtij Kodi Penal), duke patur parasysh ç'mund të jetë objekt i këtij dënimi dhe se qëllimi i këtij dënimi është vendosja e gjendjes pasurore që ka ekzistuar para kryerjes së veprës penale për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me anë të veprës penale, mund të thuhet se është dënim i veçantë penalo juridik i karakterit pasuror. Kështu, të drejtat penale aktuale,

³³³ Shih: Ismet Salihu, Hilmi Zhitija dhe Fejzullah Hasani "Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Botimi I", i publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIY) GmbH, Mars 2014, fq. 235.

³³⁴ Kodi Penal i Kosovës, Neni 62.

regjistrin e sanksioneve penale e begatojnë edhe me dënime plotësuese, të cilat shqiptohen krahas dënimeve kryesore dhe alternative, me qëllim që të kontribuojnë në parandalimin efektiv të kriminalitetit dhe risocializimin e personave të dënuar. Gjithashtu, neni 69 i Kodit Penal urdhëron konfiskimin e “sendeve të përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo të sendeve, të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale”. Ky dënim mund të shqiptohet nëse personi e ka kryer veprën penale, ose ka tentuar a ndërmarrë veprime përgatitore për kryerjen e veprës penale. Gjithashtu, me këtë dënim, merren edhe sendet që janë rezultat (pasojë) i kryerjes së veprës penale³³⁵. Në të vërtetë, sipas kësaj dispozite, dallohen tri lloje të sendeve që mund të konfiskohen:

- (i) sendet që janë përdorur për kryerjen e veprës penale – çdo send me të cilin autori i veprës penale është shërbyer me rastin ekryerjes së veprës penale, me të cilin e ka kryer veprën penale (p.sh pushka ose revolveri me të cilën është kryer vrasja; mjetet me të cilat janë falsifikuar paratë; mjetet për peshkimin e ndaluar etj.);
- (ii) sendet që janë dedikuar për kryerjen e veprës penale (p.sh armë të ndryshme, revolver, pushkë, mjetet të cilat mund të shërbejnë për evitimin e pengesave – çelësat, kallauzët, vegla të ndryshme etj.);
- (iii) sendet që janë rezultat (pasojë) i veprës penale (p.sh paratë e vjedhura, droga e prodhuar, dokumentet e falsifikuara etj.).

Për zbatimin e këtij dënimi plotësues duhet të ekzistojnë lidhje të caktuara mes sendit që merret dhe veprës penale të kryer³³⁶. Kjo dispozitë³³⁷, karakteristika e të cilës është detyruese, ka parashikuar se ky dënim mund të shqiptohet edhe në rastet kur sendet janë pronë e personit tjetër, por e kushtëzon këtë vetëm kur kjo është në dobi të sigurisë së përgjithshme; për arsye të moralit; si dhe nëse kjo nuk ndikon dëmshëm mbi të drejtat e palës së tretë, e cila duhet të përfitojë nga autori i veprës kompesimin për shkaktimin e çfarëdo dëmi.

Shqiptimi i dënimit të konfiskimit të sendeve është kryesisht i karakterit fakultativ dhe për këtë arsye gjykata duhet ta shqiptojë këtë lloj dënimi kur konstaton se është i nevojshëm për luftën efikase ndaj kriminalitetit. Mirëpo Kodi Penal, për disa raste të veprave penale, ka parashikuar konfiskimin e sendeve në mënyrë obligative (p.sh për veprën penale të

³³⁵ KPRK, neni 69.

³³⁶ Ismet Salihu, Ilmi Zhitia dhe Fejzullah Hasani “Komentar – Kodi Penal i Republikës së Kosovës” i publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, mars 2014, faqja 248.

³³⁷ KPRK, neni 69, paragrafi 2.

falsifikimit të parave, falsifikimin e shenjave për shënimin e mallit, të masave dhe peshave etj.)³³⁸.

Vlentë theksohet se në Kodin Penal nuk është cekur shprehimisht se, së bashku me cilat lloje të sanksioneve dhe masave mund të shqiptohet konfiskimi i sendit si lloj dënimi plotësues. Por, duke marrë parasysh qëllimin dhe arsyeshmërinë e këtij dënimi plotësues dhe praktikën e deritanishme gjyqësore në Kosovë dhe në vende të tjera të rajonit, mund të konstatohet se ky lloj dënimi plotësues mund të shqiptohet nëse autorit të veprës penale i shqiptohet dënimi me kusht, me vërejtjen gjyqësore ose me lirimin nga dënimi³³⁹. Gjithashtu, sipas nenit 36 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur³⁴⁰, ky lloj dënimi plotësues mund t'u shqiptohet edhe autorëve të mitur të veprave penale jo vetëm kur është shqiptuar njëri prej tri llojeve të dënimeve, por edhe kur janë shqiptuar masat e diversitetit, masat edukative dhe masat e trajtimit të detyrueshëm.

Në Kapitullin XIII – “Domethënia e shprehjeve”, është dhënë përkufizimi i shprehjes “Dobi pasurore”. Në të vërtetë, sipas Kodit Penal³⁴¹, me shprehjen dobi pasurore të përfutur me vepër penale nënkuptohet çdo pasuri e fituar drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga vepra penale. Pasuria e fituar tërthorazi nga vepra penale përfshin pasurinë në të cilën është konvertuar, transformuar apo përzier çfarëdo pasurie drejtpërdrejtë e fituar nga vepra penale, si dhe të ardhurat, kapitali apo dobitë tjera ekonomike të fituara ose realizuara për pasurinë e tillë në çdo kohë, që prej kryerjes së veprës penale.

6.3.1.1. Baza ligjore, kushtet dhe mënyra e konfiskimit të dobisë pasurore

Instituti i konfiskimit të dobisë pasurore të përfutur me anë të veprës penale e ka bazën në një nga parimet themelore të drejtësisë, në atë se askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të fituar në mënyrë të kundërligjshme.

Sipas Kodit Penal, dobia pasurore e fituar me anë të veprës penale konfiskohet nga gjykata e cila konstaton kryerjen e veprës penale, sipas kushteve të parashikuara me ligj³⁴². Kodi Penal³⁴³ ka parashikuar kushtet dhe mënyrën e konfiskimit të dobisë pasurore si vijon:

³³⁸ Ismet Salihu, Ilmi Zhitia dhe Fejzullah Hasani “Komentar – Kodi Penal i Republikës së Kosovës” i publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, mars 2014, faqja 249.

³³⁹ KPRK, neni 62 paragrafi 3.

³⁴⁰ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti / Nr. 78/20 Gusht 2010

³⁴¹ KPRK, neni 120 paragrafi 1 pika 1.34.

³⁴² Po aty, neni 96 paragrafi 2.

³⁴³ Po aty, neni 97.

- Kryerësit të veprës penale i konfiskohet dobia pasurore ose kur konfiskimi nuk është i mundshëm, autori i veprës penale detyrohet të paguaj shumën e të hollave, e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore.
- Nëse dobia pasurore nuk gjendet tek kryerësi i veprës penale.

Dobia pasurore mund t'i konfiskohet personit të cilit i është bartur pa kompensim ose me kompensim dobia pasurore, e cila nuk i përgjigjet vlerës reale, nëse personi i tillë e ka ditur ose është dashur ta dijë se dobia pasurore është fituar me kryerjen e veprës penale; dhe, kur dobia pasurore është bartur tek anëtarët e familjes, dobia konfiskohet nga anëtarët e familjes, përveç nëse anëtari i familjes dëshmon se si kompensim ka dhënë vlerën e plotë. Në të vërtetë, dobia pasurore, para se gjithash, i konfiskohet autorit të veprës penale. Mirëpo, Kodi Penal ka parashikuar se dobia pasurore i konfiskohet edhe çdo personi që ka bashkëpunuar në kryerjen e veprës penale dhe, për këtë arsye, ka përfituar dobi pasurore të paligjshme.

Kjo do të thotë se kjo masë shqiptohet edhe ndaj organizatorit të bashkimit kriminal ose anëtarit, shtytësit, ose ndihmësit i cili ka fshehur veprën penale ose autorin e saj. Por në paragrafin 1 të nenit 97 të Kodit Penal vërehen mangësi në formulim, kur theksohet se: "...dobia pasurore konfiskohet nga autori...", sepse siç vërehet, kjo masë shqiptohet edhe ndaj çdo personi, që ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale dhe ka pasur përfitim pasuror prej saj. Në qartësimin e këtyre situatave një ndihmë të madhe ka dhënë praktika gjyqësore, e cila ka konsideruar me të drejtë si fitim pasuror edhe kur autorit të veprës penale p.sh., i janë paguar shpenzimet e rrugës, pagesa e qëndrimit në shtetin e huaj, pagesa e pushimit veror në det ose pushim dimëror në skijim, ose nëse i është dhënë kredi e beneficuar-me kamatë më të ulët ose shërbime të ngjashme.

Në rastet kur përfitimi pasuror është realizuar nga kryerja e veprës penale në bashkëpunim, atëherë, duke respektuar parimin e përgjegjësisë subjektive dhe individuale, këtë masë gjykata ia shqipton secilit pjesëmarrës dhe cakton për secilin lartësinë e fitimit të realizuar. Praktika tregon se në disa raste kjo nuk është e mundur të konstatohet. Në këto raste, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, gjykata është e autorizuar që sipas bindjes së saj të lirë t'i caktojë secilit lartësinë e fitimit të realizuar, e cila konfiskohet, kjo duke u bazuar në rrethanat e rastit konkret. Lidhur me këtë, në praktikën gjyqësore, mbisundon mendimi se në rastet e veprës penale të kryer në bashkëpunim, me të cilën është realizuar përfitimi pasuror, bashkëpunëtorëve nuk mund t'u konfiskohet përfitimi pasuror në mënyrë solidare. Lidhur me kushtet dhe mënyrën e konfiskimit të dobisë pasurore, sipas këtij neni, në teori dhe praktikë ekzistojnë dilema lidhur me faktin se çfarë i konfiskohet autorit të veprës nëse

ai, paratë e fituara me kryerjen e veprës penalei ka përdorur për të blerë sende të tjera, ose nëse sendet që ka fituar me veprën penale i ka ndërruar me sende tjera, p.sh, me paratë e vjedhura ka blerë automobil ose kompjuter e kështu me rradhë. Në raste të tilla, pyetja që shtrohet është: a do të konfiskohen këto sende, cilatdo qofshin ato, apo personat që i kanë në pronësi do të detyrohen të paguajnë para në vlerën e sendeve që kanë përfitur me veprën penale. Mendimi që sundon është se në të tilla raste mund të konfiskohen vetëm sendet të cilat janë prokuruar me veprën penale, ndërsa nëse kjo nuk është e mundur, autori detyrohet të paguajë shumën e parasë në vlerën e sendeve të prokuruar.

6.3.1.2.Mbrojtja e të dëmtuarit

Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me anë të veprës penale nga autori i veprës penale është i detyrueshëm. Mirëpo, me Kodin Penal është rregulluar se mbrojtja e interesave të personit që është dëmtuar me veprën penale ka prioritet, prandaj kur me procedurë penale i caktohet dëmi pasuror të dëmtuarit, gjykata urdhëron konfiskimin e dobisë pasurore nëse ajo tejkalon shumën e dëmeve pasurore që i është caktuar palës së dëmtuar³⁴⁴. Gjithashtu, nëse i dëmtuari, i cili gjatë procedurës penale është udhëzuar të fillojë procedurën e kontestit civil për kërkesën pasurore juridike, ai mund të kërkojë kompensim nga dobia pasurore e konfiskuar me kushtin, që të fillojë procedurën e kontestit civil brenda gjashtë muajve nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit që e udhëzon për inicimin e kontestit civil dhe brenda tre muajve nga dita kur vendimi gjyqësor për vendosjen e kërkesës pasurore juridike është bërë i plotfuqishëm³⁴⁵.

6.3.1.3.Pasojat juridike të dënimit

Pasojat juridike të dënimit në të drejtën tonë penale janë instaluar në Kodin Penal dhe janë parashikuar si institute të veçanta penalo juridike³⁴⁶.

Kodi Penal, në nenin 100 paragrafi 3, ka parashikuar se dënimet për disa vepra penale të caktuara mund të kenë si pasojë shuarjen ose humbjen e të drejtave të caktuara ose ndalimin e fitimit të drejtave të caktuara, ndërsa në nenin 62, si dënime plotësuese, ka parashikuar ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik; ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, konfiskimin etj., çka

³⁴⁴ KPRK, neni 98.

³⁴⁵ Po aty, paragrafi 2.

³⁴⁶ Po aty, neni 100.

do të thotë se në të ardhmen pasojë juridike do të konsiderohet edhe sanksioni penal, edhe konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale³⁴⁷.

Lidhur me pasojat juridike të dënimit, Kodi Penal përcakton vetëm kornizën brenda të cilës ligje të veçanta rregullojnë materjen e caktuar dhe njëherësh, mund të parashikojnë pasojat juridike të dënimit³⁴⁸. Duke e rregulluar atë kornizë, Kodi Penal i Kosovës përcakton kushtet për lindjen e pasojave juridike të dënimit, në të cilën mund të përmbahen pasojat juridike të dënimit, cilat lloje të pasojave juridike të dënimit mund të parashihen me ligj të veçantë dhe fillimin e kohëzgjatjes së pasojave juridike të dënimit. Kodi Penal ka parashikuar se pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur autorit i shqiptohet gjoba, dënimi me kusht ose vërejtja gjyqësore apo kur autori i veprës penale lirohet nga dënimi³⁴⁹. Edhe pse asnjë pasojë juridike e dënimit nuk mund të lind në bazë të këtij Kodi, por vetëm nëse parashikohet nga ligji i veçantë me të cilin rregullohet fusha e caktuar, ose kur gjykata në vendimin e saj ka vërtetuar kryerjen e veprës së caktuar penale sipas fuqisë ligjore me të cilin janë paraparë, pasojat juridike të dënimit, sipas natyrës së tyre, janë dënime plotësuese penale juridike³⁵⁰. Argumentet për kuptimin e tillë të pasojave juridike të dënimit gjenden, para se gjithash, në faktin, se me pasojat juridike të dënimit përcaktohet statusi juridik i personit që është dënuar për një vepër penale të caktuar dhe, për këtë shkak, kushtet për parashikimin e pasojave juridike të dënimit me ligjet e veçanta si dhe për lindjen e tyre janë parashikuar me Kodin Penal³⁵¹.

Si shohim, pasojat e një dënimi të tillë kanë në thelb humbje, përkatësisht në pushimin e drejtave të caktuara ose në ndalimin e fitimit të drejtave të caktuara, çka do të thotë se nuk mund të mohohet karakteri represiv i pasojave juridike të dënimit. Njëherësh, qëllimi i tyre është edhe preventiv pasi dispozita të tilla synojnë pengimin e kryerjes së veprave të reja penale. Ato janë të justifikueshme vetëm në masën në të cilën kanë qenë mjet i domosdoshëm për preventivën e kriminalitetit. Ndonëse, mund të shërbejnë si mjet i

³⁴⁷ Në disa ligje të huaja si pasoja juridike të veprës penale konsiderohen edhe sanksionet penale, si dhe konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale (Nënkreu i tretë i Kodit Penal të Gjermanisë –neni 38-76a). Gjithashtu, disa ligje të huaja, përveç sanksioneve penale, përmbajnë edhe dispozita të veçanta për “masat penale” tjera të cilat nuk janë sanksione, por e përcjellin kryesin për shkak të veprës së kryer penale. Kështu Kodi Penal i Zvicrës njeh këto masa penale: (1) dorëheqja nga shërbimi shtetëror – Neni 51,1), marrja e drejtës prindore- neni 53,3), ndalimi i ushtrimit të profesionit –Neni 54,4), dëbimi jashtë shtetit – neni 55,5), ndalimi i vizitës të restorantit – neni 56,6), pengu preventive – Neni 57,7), Konfiskimi i pasurisë – nenet 58 dhe 59,8) dhe shpallja e aktit akuzues ose dënues – Neni 61.

³⁴⁸ KPRK, neni 100.

³⁴⁹ Po aty, paragrafi 2.

³⁵⁰ Po aty, neni 62.

³⁵¹ Po aty, neni 101.

mbrojtjes së autoritetit ose prestigjit të funksionit të caktuar, të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në rastet kur personave të dënuar përnjë vepër të caktuar penale si dënim plotësues u ndalohet ushtrimi i atij funksioni, profesioni, veprimtarie ose të detyrës, të paraparit e paraqitjes së pasojave juridike të tilla gjithmonë duhet të kenë për qëllim represivën e kryerjes së veprave penale. Me këtë rast, duhet patur parasysh edhe preventiva e veçantë dhe e përgjithshme e veprave penale, sepse të parashikuarit dhe paraqitja e pasojave juridike të dënimit edhe në mënyrë preventive duhet të veprojnë mbi personin e dënuar në funksion të ndihmës për të mos kryer në të ardhmen vepra të tjera penale.

6.4. Konfiskimi i zgjeruar të dobisë pasurore

Kriminaliteti i organizuar është sot një problem shoqëror global dhe kërcënim serioz për shumë shtete. Ai është problem i përbashkët në tranzicionin politik dhe ekonomik të shumë vendeve, sikurse është prezent edhe në vendet e zhvilluara, të cilat paraqiten si vende tranziti dhe vende destinimi.

Përfitimi shumë i madh dhe i shpejtë i ardhur nga veprimtaria kriminale motivon këta të fundit dhe grupet kriminale në përsosjen e veprimtarisë dhe teknikave të krimit si dhe në gjetjen e rrugëve të mundshme për kontrollin dhe bashkëpunimin me institucionet nacionale e më tej. Nga ana tjetër, procesi i globalizimit të tregut dhe avancimi i teknologjisë informative ka favorizuar aktivitetet e tyre. Strategët e sistemit të ri botëror kanë harruar se ekziston ana tjetër e medaljes dhe se globalizimi bart me vete edhe komponentin e rrezikut global. “Uria për përfitim” ka hapur kutinë e pandorës dhe autorëve të veprave penale u ka dhënë mundësi që, në mënyrë globale, të marrin vrull. Në këto kushte shtetet gjenden përherë e më tepër në angazhimin e tyre për të punuar me sistemet e tyre të sigurisë dhe mbrojtjes. Por duhet pranuar se krimi ia ka dalë të jetë përherë më përpara se strukturat e ligjit dhe mafia është sot një organizatë botërore e mirëorganizuar.

Përfitimet më të mëdha në aspektin e kriminalitetit, sipas të gjitha raporteve të institucioneve ndërkombëtare, i sjell tregëtia e drogës, armëve dhe trafiku njerëzor. Kështu, raporti i Kombeve të Bashkuara, deklaron se 700.000 gra, fëmijë dhe meshkuj bëhen çdo

vit viktimave të trafikimit dhe fitimi vjetor i realizuar nga trafikimi njerëzor është rreth 60 miliard dollarë³⁵².

Nuk ka vlerësime të sigurt se cilat nga këto veprimtari janë më përfitueset, por me të drejtë theksohet se dileri, drogën mund ta shes vetëm një herë, armën disa herë, ndërsa njeriun – femrën, mashkullin dhe fëmijën – shumë herë.

Regjioni ballkanik është i përfshirë me të tri këto veprimtari kriminale. Metodatat klasike të reaksionit shoqëror ndaj kriminalitetit, duke përfshirë edhe kornizën legislative, dukshëm, nuk janë të mjaftueshme. Problemi i shkatërrimit kriminal të stabilitetit ekonomik të vendeve në njëzet vitet e fundit është në fokus të interesit të institucioneve ndërkombëtare. Shumë dokumente politiko-juridike ndërkombëtare nxisin ose obligojnë shtetet anëtare që të krijojnë mekanizma të veçantë ligjor të identifikimit, sekuestrimit dhe të konfiskimit të dobisë pasurore e cila rrjedh nga aktivitetet kriminale³⁵³, duke përfshirë edhe konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore.

Konfiskimi i zgjeruar i dobisë pasurore paraqet inversion/anasjellje të barrës së të provuarit të prejardhjes së paligjshme të pasurisë mes paditësit dhe të dyshuarit. Legjislacioni i Republikës së Kosovës, me qëllim harmonizimin e legjislacionit penal lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore të kundërligjshme me dokumentet ndërkombëtare, në vitin 2013 ka nxjerrë Ligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale. Ky ligj, në të vërtetë, përmban dispozita materialo juridike dhe paraqet zgjerim të dispozitave të Kodit Penal për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me anë të veprës penale, kryesisht dispozita procedurale, duke e rregulluar në mënyrë të veçantë zhvillimin e procedurës penale lidhur me konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore.

³⁵² Organizatat ndërkombëtare disponojnë me të dhëna të ndryshme për numrin e viktimave të trafikimit njerëzor dhe përfitim të ardhura nga kjo veprimtari. Për shembull, Departamenti Shtetëror i SHBA-së vlerëson se ky numër është rreth 900.000.

³⁵³ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër organizimit transnacional të kriminalitetit prej 15 dhjetor 2000, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit prej 31 dhjetor 2003, konventa e Këshillit të Europës për larjen, hulumtimin, konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin e të hyrave të fituara me vepër penale prej 08. Dhjetor 1990, Rekomandimet (2001) 11 të Këshillit të ministrave të Këshillit të Europës për parimet udhëheqëse të luftës kundër krimit të organizuar nga viti 2001. Aktet relevante të Bashkësisë Europiane lidhur me harmonizimin e legjislacionit nacional me trashëgimin juridike europiane: Protokollin i dytë bashkëngjitur Konventës për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkësisë Europiane prej 19 korrik 1997, Vendimi kornizues i Këshillit prej 26 korrik 2001 për larjen e parave, identifikimin, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e mjeteve dhe të hyrave nga vepra penale. Vendimi kornizues i Këshillit prej 22 qershor 2003 për ekzekutim në Bashkësinë Europiane të urdhrit për ngrirjen e pasurisë dhe të provave, Vendimi kornizues i Këshillit prej 24 shkurt 2005 për konfiskimin e të hyrave, të mjeteve dhe të pasurisë të ndërlidhura me veprën penale, Vendimi kornizues i Këshillit prej 06 shtator 2006 për zbatimin e parimit mbi pranimin reciprok të urdhërave konfiskues.

6.4.1. Nocioni i konfiskimit të zgjeruar

Konfiskimi i zgjeruar paraqet reduktim të standardit të dëshmisë, i cili zbatohet gjatë përcaktimit të prejardhjes së paligjshme të pasurisë, dhe kthimit ose të ndarjes së barrës së dëshmisë të prejardhjes së paligjshme të pasurisë në mes të paditësit dhe të paditurit³⁵⁴. Për herë të parë baza juridike për konfiskimin e zgjeruar paraqitet në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër kriminalitetit transnacional të organizuar prej 15 janarit 2000. Sipas kësaj Konvente, konfiskimi është i mundshëm në pajtim me parimet e të drejtës vendore dhe natyrës së procedurave gjyqësore (neni 12.7). Bazë të njëjtë përmban edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër korrupsionit prej 31 shtatorit 2003 (neni 31.8).

Në Rekomandimin (2002)11 të Këshillit të Ministrave të KE për parimet udhëheqëse sugjerohet që në legjislacionet vendore të futet edhe *reduktimi i standardit provues, në nivelin e dyshimit të kuptueshëm, me rastin e dëshmimit të prejardhjes së paligjshme të pasurisë, e cila rrjedh nga kriminaliteti i organizuar (neni 11)*. Në kuadër të akteve juridike të Bashkësisë Europiane, Vendimi Kornizues i Këshillit prej 24 shkurt 2005 për konfiskimin e të ardhurave/të hyrave, të mjeteve dhe të pasurisë së ndërlidhur me veprën penale parashikon mundësinë e konfiskimit të zgjeruar të dobisë pasurore (*extended powers of confiscation - neni 3*) për rastet e kriminalitetit të organizuar dhe terrorizmit.

Standardi ndërkombëtar për aplikimn e konfiskimit të zgjeruar, në esencë, nuk është kontestues. Shtrohet pyetja a është kjo në pajtim me parimet e të drejtës vendore dhe me natyrën e procedurave gjyqësore, siç e parashikon Konventa e Kombeve të Bashkuara e vitit 2000 dhe, para së gjithash, a e lejon supozimi i pafajësisë, në të cilën bazohet legjislacioni procedural vendor kalimin e barrës së dëshmisë nga i akuzuari në të dyshuarin?

Këtë pyetje teoricientët juridik vendor nuk e kanë shqyrtuar, ndërsa në mes të praktikientëve ekzistojnë mendime të ndryshme. Disa konsiderojnë se korniza ligjore ekzistuese nuk e lejon konfiskimin e dobisë pasurore të lidhur me veprën penale konkrete, shuma e të cilës nuk është e vërtetuar në procedurën penale konkrete, duke e arsyetuar me prezumimin e pafajësisë si parim procedural themelor, i parashikuar nga neni 3 i Kodit të Procedurës Penale³⁵⁵. Ndërsa të tjerët, ku spikasin sidomos teoricienët e të drejtës kroate, konsiderojnë se prezumimi i pafajësisë i përket veprës kryesore dhe fajit të të akzuarit,

³⁵⁴ Më gjerësisht shih: Elizabeta Ivecic Karas: Kaznenopravno oduzimanje imovinske koristi, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu nr. 2/2007, f. 683.

³⁵⁵ In dubio pro reo.

dhe nuk shtrihet edhe mbi konfiskimin e dobisë pasurore si lloj të procedurës që duhet konsideruar bashkim/adhesion (lat. Adharere-të mbahesh në diçka)³⁵⁶.

Meqenëse supozimin e pafajësisë e përmban edhe neni 6.2 i Konventës Europiane për të Drejtat Njeriut, duhet marrë parasysh edhe praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. A e lejon Gjykata Europiane kalimin e barrës së dëshmisë nga akuza tek i akuzuari?

Në çështjen *Salabiaku kundër Francës* Gjykata Europiane i ka dhënë përgjigje kësaj pyetjeje. Në shqyrtimin e kësaj çështjeje Gjykata Europiane thekson, se supozimet faktike dhe juridike të cilat ekzistojnë në sistemin nacional penalo juridik vetëvetiu nuk janë në kundërshtim me supozimin e pafajësisë së të akuzuarit, me kusht që shtetet kontraktuese të mos i tejkalojnë kufijtë e kuptueshëm, duke marrë parasysh rëndësinë e roleve dhe duke ruajtur të drejtën e mbrojtjes (7 shtator 1988 f. 347-348)³⁵⁷. Edhe pse kriteret e gjykatës janë mjaft të papërcaktuara dhe të paqarta (*kufijtë e kuptueshëm, rëndësia e roleve- janë terma shumë të përgjithshëm dhe lehtësisht të interpretueshëm*), mbisundon mendimi se është themeluar qëndrimi i çartë: faktet dhe supozimet juridike nuk janë në kundërshtim e supozimin e pafajësisë së të akuzuarit, me kusht që i akuzuari të ketë mundësinë të dëshmojë të kundërtën e supozimit dhe nëse janë garantuar të drejtat e mbrojtjes. Ky qëndrim është vërtetuar në lëndët *Pham Hoang kundër Francës* dhe *Radio Francë kundër Francës* prej 30 mars 2004.

Është interesant rasti *Philips kundër Mbretërisë së Bashkuar*³⁵⁸. Paraqitësin e ankesës, Gjykata Britanike e ka dënuar për veprën penale të tregëtisë së mjeteve narkotike me burg dhe njëkohësisht i ka konfiskuar pasurinë në bazë të supozimit juridik të rrëzueshëm që rrjedh nga vepra penale e tregëtisë me drogën në gjashtë vitet e fundit, të parashikuara me dispozitat *Drug Trafficking Act* nga viti 1994 (DTA). Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut ka shqyrtuar rastin/ankesën, thelbi i të cilës është a është shkelur për ankuesin e drejta për gjykim të drejtë, e mbrojtur nga neni 6.1 i Konventës dhe a është marrë qëndrim i qartë në faktin se e drejta në respektimin e supozimeve të pafajësisë së të pandehurit në procedurën penale nuk është absolute? Gjykata konkludon se supozimet ligjore kontestuese nga DTA nuk janë zbatuar për lehtësuar vërtetimin e pafajësisë së të pandehurit, por që përcaktohet shuma që duhet konfiskuar, pa harruar asnjëherë respektimin e dispozitave të ligjit penal, të cilat përmbajnë garancitë e të drejtave të mbrojtjes. Gjykata në veçanti

³⁵⁶ Më gjerësisht shih: Elizabeta Ivecic Karas: Kaznenopravno oduzimanje imovinske koristi, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu nr. 2/2007, f. 684.

³⁵⁷ Shih: <http://hudoc.echr.int>, f. 347-348.

³⁵⁸ Aktgjykimi prej 5 qershor 2001, <http://hudoc.echr.coe.int>

thekson garancitë: a) që i akuzuari duhet të ketë mundësi të rrëzojë supozimin ligjor për prejardhjen kriminale të pasurisë së tij duke e provuar këtë dhe b) gjykata ka të drejtën diskrecionale që mos zbatojë supozimin juridik nëse konsideron se me të vihet në dyshim procedura e gjykimit të drejtë.

Në këtë përfundim vjen edhe gjykimi kushtetues i Republikës së Shqipërisë. Kështu Gjykata Kushtetuese e RSH, në interpretimin e prezumimit të pafajësisë deklaroi se gjykatat e zakonshme nuk duhet të fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet të mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejtë dhe të tërthorta, që duhet të provohen nga akuza. Më tej, po kjo Gjykatë saktëson se, interpretimi i këtij neni (Neni 30 - Prezumi i Pafajësisë) i Kushtetutës, lidhet ngushtësisht me proceset penale, ndërsa konfiskimi është një procedim i veçantë, i pavarur nga procesi penal, ndaj garancitë e procesit penal nuk mund të gjejnë zbatim në procesin e konfiskimit³⁵⁹.

6.4.2. Zgjidhjet në legjislacionin krahasues

Konfiskimi i pasurisë së fituar me veprimtari kriminale nuk është një koncept i ri. Që nga viti 1970, kur Kongresi i SHBA nxori dispozitat e para për konfiskimin e deri më sot, koncepti ka evoluar dhe përmbledh konfiskimin e produkteve të krimit “*fruta sceleris*”, të mjeteve të krimit “*sceleris instrumentum*” ose objektin e krimit “*objectum sceleris*”. Shumë sisteme të drejtësisë penale kanë përshtatur format tradicionale të konfiskimit, si konfiskimin e mjeteve të krimit ose subjektit të krimit, por nuk kanë folur për konfiskimin e të ardhurave nga krimi, duke krijuar boshllëqe në procedurën penale. Të tjerët e ndajnë konfiskimin në ndëshkues dhe parandalues. Kështu ligji *holandez*³⁶⁰ bën dallim ndërmjet konfiskimit të mjeteve të krimit, i cili konsiderohet se përbën saksion penal dhe konfiskimit të produkteve të krimit, i cili shihet vetëm, si masë parandaluese. *Luksenburg*³⁶¹ dhe *Zvicra*³⁶² i ndajnë në konfiskime ndëshkuese dhe parandaluese.

Kroacia – Kodi Penal i Kroacisë, i 1998, është amenduar në 2003, 2004, 2005, 2006, dhe shumë dispozita i janë kushtuar luftës kundër kriminalitetit dhe qasjes së gjetjes së burimeve të pasurisë së dalë nga vepra penale. Të rëndësishme sa i takon kësaj lënde janë

³⁵⁹Vendime të GJK së RSH, Nr. 9, dt 28.04.2004; Nr.23.07.2009; Nr. 294, dt 23.02.2011.

³⁶⁰For critical approach of this distinction: Cambridge University Press. Virtual Publishing 2003, fq. 30.

³⁶¹Po aty.

³⁶²Po aty.

amendimet e vitit 2006, të cilat flasin për konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore, e cila konsiderohet se rrjedh nga vepra penale nëse ajo është në lidhshmëri kohore me veprën penale (neni 82). Zgjidhja Kroate kritikohet, sepse jep mjaft kushte të papërcaktuara të zbatimit dhe ndërlidh mundësinë e konfiskimit për veprën e kryer, duke ngushtuar kështu dukshëm mundësinë e zbatimit³⁶³.

Republika e Serbisë – në fund të vitit 2008 ka nxjerr Ligjin e veçantë për konfiskimin e pasurisë të dalë nga vepra penale me të cilin rregullohen kushtet, procedurat dhe organet kompetente për zbulimin, konfiskimin dhe administrimin me pasurinë e dalë nga vepra penale.

Të veçantat e këtij ligji janë në theksimin në formë katalogu të veprave penale për të cilat zbatohet ligji dhe fakti se këto dispozita zbatohen edhe për veprat penale kundër njerëzimit dhe të mirave tjera të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare (krimet e luftës). Ligji për pasurinë e dalë nga vepra penale nënkupton pasurinë e të akuzuarit, pasurinë e dëshmitarit bashkëpunues ose trashëgimtarit. Prokurori publik ka me ligj autorizimin për të paraqitur kërkesën për konfiskimin e përkohshëm të pasurisë si dhe për të nxjerrë urdhër për ndalimin e disponimit me pasurinë. Për kërkesën e prokurorit vendos gjykata. Prokurori, në procedurë dëshmon ekzistencën e pasurisë, e cila sipas vlerës tejkalon të hyrat e ligjshme, ndërsa barra e të provuarit të ligjshmërisë së fitimit të kësaj pasuri bie mbi të akuzuarin, dëshmitarin, përkatësisht trashëgimtarët e trashëguesit³⁶⁴.

Kodi Penal Anglez (Prosceeds of Crime Act) – nga viti 2002 (PCA) parashikon mundësinë e konfiskimit të pasurisë për të cilën supozohet se është përfituar me kryerjen e veprës penale, nëse i akuzuari ka stil jetese kriminale (*criminal lifestyle*). Ligji madje parashikon një periudhë prej gjashtë vitesh para kryerjes së veprës penale për të cilën duhet supozuar se pasuria është përfituar me kryerjen e veprës penale.

E Drejta Federale e *Shteteve të Bashkuara të Amerikës* - njih dy modele të konfiskimit të pasurisë: penalo juridik (*criminal forfeiture*) dhe civilo juridik (*civil forfeiture*). Konfiskimin penal gjykata e shqipton në procedurën penale në rastet e trafikimit të drogës,

³⁶³ Më gjerësisht shih: Elizabeta Ivecic Karas: Kaznenopravno oduzimanje imovinske koristi, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu, nr. 2/2007, f. 688-689.

³⁶⁴ Shih:më gjerësisht: Vladan M. Drašković: „Novi instrumenti za obračun s mafijom“, Tužilačka reč, nr.10-11, Beograd;
https://www.google.com/search?rlz=1C1NHXL_enXK835XK835&ei=J91tXJyoH87RrgT85IL4BA&q=Vladan+M.+Dra%C5%A1kovi%C4%87%3A+%E2%80%9ENovi+instrumenti+za+obra%C4%8Dun+s+mafijom%E2%80%9C%2C+Tu%C5%BEila%C4%8Dka+re%C4%8D&oq=Vladan+M.+Dra%C5%A1kovi%C4%87%3A+%E2%80%9ENovi+instrumenti+za+obra%C4%8Dun+s+mafijom%E2%80%9C%2C+Tu%C5%BEila%C4%8Dka+re%C4%8D&gs_l=psy-ab.3...4165.4165..5364...0.0..0.121.121.0j1.....0....2j1..gws-wiz.....0i71.xXs0uu-Gb3w

shpëlarjes së parave, reketit, korrupsionit dhe abuzimit me fëmijët dhe ajo përfshin pasurinë që rrjedh nga vepra penale ose mund të ketë lidhje me veprën penale. Konfiskimi civil nuk është i kushtëzuar për ngritjen e aktit akuzues. Qeveria zhvillon procedurën në bazë të identifikimit të pasurisë dhe supozimit deri në shkallën e besimit më të madh (*preponderance of evidence*) se fitimi i saj lidhet me veprën penale. Nëse qeveria ka sukses në të provuarit e epërsisë së dëshmive se pasuria rrjedh nga veprimtaria kriminale, barra e të provuarit kalon tek individi, pasuria e të cilit konfiskohet (zakonisht tek pronarin)³⁶⁵.

Kodi Penal Gjerman (paragrafi 73 d StGB) – parashikon konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore me kusht që kryerja e veprës penale të jetë vërtetuar me aktgjykim dhe rrethanat e kryerjes e justifikojnë supozimin se dobia pasurore e caktuar është përfituar me kryerjen e veprave penale. Bashkë me to është e nevojshme të dëshmohet ekzistenca e veprave penale dhe ligjshmëria e përfitimit të pasurisë.

Në Kodin Penal Austriak – për konfiskimin e zgjeruar të dobisë pasurore prokurorit i mjafton të dëshmojë lidhshmërinë kohore të fitimit të dobisë pasurore të caktuar me kryerjen e veprës penale nga kategoria e krimeve (*Veebrechen*) bazuar në dëshmi që e bëjnë të bazueshëm supozimin e prejardhjes kriminale të pasurisë. Pas kësaj barra e të provuarit të prejardhjes së pasurisë kalon tek i akuzuari (paragraph 20 (2) StGB).

*Kodi Penal hollandez*³⁶⁶ privon autorin e veprës penale nga produktet e krimit dhe shqipton konfiskimin e të ardhurave nga krimi, kurse Kodi i Procedurës Penale³⁶⁷ i jep prokurorit fuqinë për të deklaruar të pavlefshëm çdo transaksion ligjor të autorëve të veprave penale ose veprës së pastrimit të parave, me kusht që prokurori të vërtetojë se ata nuk kanë qenë të detyruar ta bënin këtë ose kanë vepruar në keqbesim.

6.5. Konfiskimi i zgjeruar i dobisë pasurore sipas Legjislacionit Kosovar

Konfiskimi i dobisë së ardhur nga veprimtaria kriminale, në Republikën e Kosovës është rregulluar me dispozitat e neneve 96 dhe 97 të Kodit Penal kurse më tej, ligji i veçantë nr 04/L-140 “Për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale”³⁶⁸ përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar nga personat që kanë kryer vepër penale, kur procedurat e përcaktuara në Kodin e Procedurës

³⁶⁵ E. Ivičević, O pravnoj prirodi instituta oduzimanja imovinske koristi stečene kaznenim djelom..., Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu, 2004, f. 698.

³⁶⁶ Article 36 e of the Dutch Criminal Code, fq.67-63.

³⁶⁷ https://books.google.com/books/about/Money_Laundering.html?id=3q3GEY8y_u8C

³⁶⁸ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 5 / 8 Mars 2013, Prishtinë.

Penale nuk janë të mjaftueshme³⁶⁹. Ky ligj në të vërtetë është i karakterit material sepse zgjeron kompetencat për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale jashtë kompetencave të përcaktuara me Kodin Penal, dhe në anën tjetër, kryesisht, është i karakterit formal juridik, përkatësisht procedural sepse, për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit të pasurisë, përcakton rregulla të veçanta procedurale për zhvillimin dhe përfundimin e procedurave në lëndët e konfiskimit të zgjeruar të pasurisë së fituar me vepër penale. Andaj, ky ligj në pjesën e tij të përgjithshme rregullon qëllimin, fushëveprimin, vendimin e gjykatës për zbatimin e këtij Ligji për zbatimin e kompetencave të zgjeruara të konfiskimit, ndërsa në pjesën e tij të veçantë, përkatësisht në Kapitullin II – “Kompetencat e zgjeruara të konfiskimit”, përcakton: kushtet për konfiskimin e pasurisë së përfituar nga aktiviteti kriminal; kushtet kur mund të konfiskohet pasuria në pronësi të të pandehurit i cili ka vdekur; dhe kushtet kur mund të konfiskohet pasuria në pronësi të të pandehurit në arrati. Ndërkaq, në Kapitullin III- “Ekzekutimi dhe administrimi i pasurisë së konfiskuar”, rregullohet ekzekutimi i vendimeve të gjykatës lidhur me pasurinë e konfiskuar, për të cilat në vazhdim do të bëhet fjalë duke u dhënë karakteristikat themelore të çështjeve që rregullohen me këtë ligj.

6.5.1. Pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit

Dispozitat e këtij Ligji zbatohen për pasurinë e fituar nga personat që kanë kryer vepër penale të parashikuar me Kodin Penal³⁷⁰. Pasuria e cila sipas këtij Ligji i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit është pasuria që është në pronësi të pandehurit ose që mbahet në emër të të pandehurit, e cila i nënshtrohet urdhrit ndalues nga neni 265 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, i ndryshuar, ose i nënshtrohet konfiskimit të përkohshëm nga neni 267 i po këtij Kodi³⁷¹. Në të vërtetë, sipas nenit 5 të këtij Ligji, zbatimi i kompetencave të zgjeruara të konfiskimit aplikohet nëse:

- pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit, të cilat nuk janë dobi pasurore nga vepra penale e përshkruar në aktakuzë mund t’i nënshtrohen konfiskimit nga neni 6 i këtij ligji;
- pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit, e cila është fituar nga i pandehuri i vdekur mund t’i nënshtrohet konfiskimit nga neni 7 i këtij ligji;

³⁶⁹ Neni 1 i Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituara me vepër penale.

³⁷⁰ Po aty, neni 2.

³⁷¹ Po aty, neni 3 paragrafi 1.5.

- pasuria që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit, e cila është fituar nga i pandehuri i cili është larguar nga Republika e Kosovës mund t'i nënshtrohet konfiskimit nga neni 8 i këtij ligji; dhe
- pasuria e cila i është bartur palës tjetër nga personi i cili është apo bëhet i pandehur apo i dënuar. Pala tjetër ka të drejtë për të provuar se është blerës *bona fide* i pasurisë. Pasuria nuk mund të konfiskohet nga blerësi *bona fide* i asaj pasurie.

Zbatimi i kompetencave të zgjeruara të konfiskimit nga ky ligj bëhet nga gjykata në procedurën penale sipas kërkesës së prokurorit të shtetit, por vetëm nëse prokurori i shtetit ka provuar se kushtet nga neni 6, 7 dhe 8 i këtij ligji janë të zbatueshme³⁷². Gjithashtu, prokurori i shtetit është i obliguar që në kërkesë të përshkruaj çdo pasuri që i nënshtrohet kompetencave të zgjeruara të konfiskimit me saktësi të mjaftueshme për identifikimin e qartë të pasurisë³⁷³.

Fillimin e procedurës për zbatimin e kompetencave të zgjeruara të konfiskimit, Ligji³⁷⁴ i veçantë e kushtëzon me ekzistencën paraprake të aktgjykimit të formës së prerë, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor dhe parashikon afatin e paraqitjes së kërkesës gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues. Për zbatimin e kompetencave të zgjeruara, përveç ekzistencës së aktgjykimit të formës së prerë me të cilën i pandehuri shpallet fajtor, ligji përcakton se i pandehuri duhet të jetë i shpallur fajtor për veprat penale nga Kapitujt XV, XXIII, XXIV, XXV ose XXXIV të Kodit Penal. Kërkesa e Prokurorit të shtetit, Gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, duhet të ofrojë prova³⁷⁵ për të treguar arsye të bazuar se:

- i pandehuri ka fituar pasuri të tjera që nuk kanë qenë dobi pasurore nga ato vepra penale, për të cilat i pandehuri është dënuar;
- pasuritë e tjera janë marrë pas 31 dhjetorit 1999;
- të hyrat legjitime të të pandehurit kanë qenë të pamjaftueshme për të mundësuar blerjen e atyre pasurive tjera; dhe
- I pandehuri ka qenë i përfshirë në sjellje të ngjashme me ato për të cilat është shpallur fajtor dhe që i mundësonin blerjen e atyre pasurive të tjera.

³⁷² Po aty, neni 4 paragrafi 2.

³⁷³ Po aty, paragrafi 4.

³⁷⁴ Po aty, neni 6 paragrafi 1.

³⁷⁵ Po aty, paragrafi 1.1 deri 1.5.

6.5.2. Kushtet e veçanta për disa raste të konfiskimit

Risitë e këtij ligji, të rëndësishëm për zbatimin e kompetencave të zgjeruara të konfiskimit, e që dallojnë nga dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, kanë të bëjnë me:

- a) kushtet kur mund të konfiskohet pasuria në pronësi të të pandehurit i cili ka vdekur³⁷⁶;
- b) kushtet kur mund të konfiskohet pasuria në pronësi të të pandehurit në arrati³⁷⁷;
- c) shfrytëzimi i urdhërit ndalues ose konfiskimit të përkohshëm gjatë pezullimit të hetimit³⁷⁸.

Ndryshe nga Kodi i Procedurës Penale (neni 160), ku është parashikuar se: "...kur gjatë rrjedhës së procedurës penale vërtetohet se i pandehuri ka vdekur, prokurori i shtetit merr aktvendim për pushimin e procedurës penale", ky ligj përcakton kushtet për vazhdimin e procedurës së konfiskimit edhe në rastin e vdekjes së të pandehurit. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 7 të këtij ligji është parashikuar se Gjykata, në bazë të propozimit të Prokurorit të shtetit apo të të dëmtuarit mund të vazhdojë procedurën e konfiskimit nga ky ligj nëse:

- a) pasuria i nënshtrohet urdhrit ndalues nga neni 265 i Kodit të Procedurës Penale dhe konfiskimit të përkohshëm nga neni 267 i Kodit të Procedurës Penale;
- b) është ngritur aktakuzë në të cilën theksohet pasuria që i nënshtrohen konfiskimit nga neni 241, paragrafi 1., nënparagrafi 9 i Kodit të Procedurës Penale;
- c) vlera e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit tejkalon njëmijë (1.000) Euro; dhe
- d) vazhdimi i procedurës është në interes të drejtësisë.

Sipas paragrafit 2 të nenit 7 të këtij Ligji, Gjykata është e autorizuar të marrë vendim për të vazhduar procedurën e konfiskimit pavarësisht vdekjes së të pandehurit dhe thekson arsyet përse procedura penale kundër të pandehurit nuk mund të fillohet apo të vazhdohet, vlerën e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit dhe arsyet përse është në interes të drejtësisë për të vazhduar procedurën e konfiskimit³⁷⁹.

Kur Gjykata çmon se i pandehuri ka kryer vepër penale dhe pasuria që i nënshtrohet konfiskimit është dobi pasurore e fituar nga vepra penale, ajo (Gjykata) nxjerr aktgjykim, me të drejtë ankese. Ligji përcakton përmbajtjen e aktgjykimit³⁸⁰ në të cilin: përcakton se i pandehuri ka kryer vepër penale, përcaktohet se pasuria është fituar nga kryerja e veprës

³⁷⁶ Po aty, neni 7.

³⁷⁷ Po aty, neni 8.

³⁷⁸ Po aty, neni 9.

³⁷⁹ Po aty, neni 7, paragrafi 2.

³⁸⁰ Po aty, paragrafi 8.

penale ku përcakton llojin e pasurisë dhe vlerën monetare të saj e më pas urdhëron që pasuria apo të drejtat të kalojnë në pronësi të Republikës së Kosovës apo të palës së dëmtuar, siç është e përshtatshme.

Në nenin 8 të këtij Ligji janë përcaktuar kushtet kur mund të konfiskohet pasuria në pronësi të të pandehurit në arrati. Gjykata, në bazë të propozimit të Prokurorit të shtetit mund të vazhdojë procedurën penale³⁸¹ nëse: prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se i pandehuri është në arrati, vlera e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit është më e lartë se pesëmijë (5.000) Euro dhe vazhdimi i procedurës është në interes të drejtësisë.

Kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, Gjykata merr vendim për vazhdimin e procedurës penale³⁸² dhe përshkruan arsyet për dyshimin e bazuar që i pandehuri është në arrati, vlerën e pasurisë që i nënshtrohet konfiskimit dhe arsyet se përse është në interes të drejtësisë për të vazhduar procedurën penale.

Kodi Penal³⁸³ precizon ç'është dobia pasurore e përfituar me vepër penale, mënyrën e përfitimit dhe përbërjen e saj. Kështu, me shprehjen dobi pasurore të përfituar me vepër penale nënkuptojmë çdo llojpasurie, e cila fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga vepra penale. Pasuria e cila fitohet tërthorazi nga vepra penale përfshin pasurinë në të cilën është konvertuar, transformuar apo përzier çfarëdo pasurie drejtpërdrejtë, e fituar nga vepra penale, si dhe të ardhurat, kapitali apo dobitë e tjera ekonomike të fituara ose të realizuara për pasurinë e tillë në çdo kohë, që prej kryerjes së veprës penale. Prandaj, kjo dobi pasurore e përfituar me vepër penale, sipas nenit 97 paragrafi 1 të Kodit Penal, do të konfiskohet ose kur konfiskimi nuk është i mundur, autori detyrohet të paguajë shumën e të hollave, e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore.

Dobia pasurore mund t'i konfiskohet personit të cilit i është bartur pa kompensim ose me kompensim dhe që nuk i përgjigjet vlerës reale, nëse personi i tillë e ka ditur ose është dashur ta dijë se dobia pasurore është fituar me kryerjen e veprës penale. Kur dobia pasurore është bartur tek anëtarët e familjes, dobia konfiskohet nga anëtari i familjes, përveç nëse anëtari familjar dëshmon se si kompensim ka dhënë vlerën e plotë.

Me nxjerrjen e legjislacionit penal (Kodit Penal dhe të Kodit të Procedurës Penale), të Ligjit Nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 5 / 8 Mars 2013, Prishtinë) dhe të Ligjit, Për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar (Gazeta zyrtare e

³⁸¹ Po aty, neni 8, paragrafi 2.

³⁸² Po aty, paragrafi 3.

³⁸³ KPRK, neni 120 paragrafi 1 pika 1.34.

Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti IV/nr.58/10 Gusht 2009, Prishtinë), janë realizuar qëllimet e përcaktuara në dy drejtime kryesore. *Drejtimi i parë* shihet në faktin se ligjdhënësi ka shfrytëzuar tërësisht mundësitë dhe zgjidhjet e ofruara, të cila shihen në harmonizimin e zgjidhjeve të çështjeve të konfiskimit të pasurisë së dalë prej veprës penale me zgjidhjet e çështjeve indentike në standardet e arritura europiane në këtë plan, të përmbajtura në konventat përkatëse të bashkësisë europiane.

Në bazë të konkluzioneve të Samitit Europian, të mbajtur në Tempera në vitin 1999, i cili iu kushtua luftës kundër kriminalitetit, Këshilli i Ministrave për Drejtësi dhe Punë të Brendshme të Bashkësisë Europiane, miratoi në vitin 2000, Strategjinë e Shekullit për preventivën dhe kontrollin e kriminalitetit të organizuar. Strategjia përmban 39 rekomandime të hollësishme. Një nga ato udhëzon se është i domosdoshëm konfiskimi i pasurisë së përfituar nga kriminaliteti, duke arsyetuar se përfitimi i dobisë financiare të kundërligjshme paraqet motivin themelor për kryerjen e veprave më të rënda penale. Të hyrat nga aktiviteti i kundërligjshëm shërbejnë për financimin e aktiviteteve të reja kriminale dhe mundësojnë larjen e parasë me qëllim futjen e saj në rrjedhat legale.

Si orientime themelore strategjike të preventivës dallohen: harmonizimi i legjislacionit për konfiskimin e pasurisë së dalë nga vepra penale; pranimi reciprok dhe ekzekutimi i aktgjykimeve gjyqësore dhe koordinimi e procedurave të dënimit. Orientimet e theksuara strategjike janë realizuar me zgjidhjet legjislative në kodet dhe ligjet e lartëtheksuara.

Drejtimi i dytë shihet në atë se ligjdhënësi në këtë legjislacion të ri, parë nga aspekti i përmbajtjeve të tyre, në masë të madhe, ka ruajtur me sukses disa nga parimet themelore kushtetuese të cilat i përkasin, para së gjithash, gëzimi të qetë të pronës private, të drejtës së gjykimit të drejtë dhe ndalimit të zbatimit retroaktiv të Kodit Penal, duke shfrytëzuar në mënyrë të përshtatshme dhe të domosdoshme, standardet e arritura në pikëpamje të zbatimit të këtyre parimeve në praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Në të vërtetë, me zbatimin e masës së konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale plotësohet një nga postulatet më të rëndësishme të legjislacionit penal, të atij se askush nuk mund të mbajë dobinë e përfituar në mënyrë të paligjshme. Me analizën e kornizës juridike për konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale arrijmë në konkluzionin se ky institut gjen zbatim në praktikë, por vështirësitë janë evidente, sidomos në dispozita të caktuara të Ligjit për kompetencat e zgjeruara të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.

6.6. Procedura e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me veprë penale sipas Kodit të Procedurës Penale

Konfiskimi është pjesë vitale e procedurës penale bashkëkohore, posaçërisht në kuptim të krimit të organizuar ndërkombëtar, korrupsionit dhe veprave tjera penale, të cilat krijojnë pasuri të kundërligjshme për grupe të vogla njerëzish.

Kodi Penal konfiskimin e dobisë pasurore me anë të veprës penale e parashikon si masë të posaçme penalo juridike³⁸⁴. Kjo masë nuk konsiderohet lloj i sanksionit penal, edhe pse me të, në mënyrë specifike, realizohet qëllimi i sanksioneve penale – lufta kundër kriminalitetit. Dispozitat formalo juridike, përkatësisht procedurale për zbatimin e kësaj mase të posaçme penale janë përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës³⁸⁵ (më tej: Kodi i Procedurës Penale). Kodi i ri i Procedurës Penale, në mënyrë të hollësishme, në një mori dispozitash ka parashikuar në mënyrë bashkëkohore edhe procedurën e konfiskimit, duke rregulluar çështjet themelore si: kontrollin dhe sekuestrimin e përkohshëm; konfiskimin e përhershëm të sendeve të konfiskuara përkohësisht; ngrirjen e aseteve dhe urdhërat ndalues; procedurat e konfiskimit të përkohshëm para ngritjes së aktakuzës; procedurat e konfiskimit pas ngritjes së aktakuzës; marrja dhe komunikimi i vendimeve; ekzekutimi i aktgjykimeve lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore etj.

6.6.1. Konfiskimi i përkohshëm (sekuestrimi)

Konfiskimi i përkohshëm i sendeve, gjithashtu, është veprim tipik penalo-procedural, me kryerjen e të cilës sigurohen dokumentet, si burim i provave materiale. Pra, qëllimi themelor i kryerjes të këtij veprimi është konfiskimi i përkohshëm i sendeve që, sipas Kodit Penal, duhet të konfiskohen ose sendet që shërbejnë si burim i provave materiale në procedurën penale.

Ky veprim mund të realizohet në mënyrë paralele me kontrollin e pronës dhe personit ose shikimin në vend të sendeve, teksa mund të zhvillohet edhe një veprim procedural i pavarur. Në rastin e kontrollit të pronës, kur i pandehuri në mënyrë vullnetare jep pëlqimin e tij me shkrim për kontrollin e pronës,³⁸⁶ sendet e gjetura gjatë kontrollit mund të sekuestrohen përkohësisht dhe konsiderohen pronë e pranueshme në shqyrtim gjyqësor.

³⁸⁴Ismet Salihu, Ilmi Zhitia dhe Fejzullah Hasani “Komentar – Kodi Penal i Republikës së Kosovës” i publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, mars 2014.

³⁸⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë.

³⁸⁶ KPRK, neni 105 paragrafi 1.

Mirëpo, në anën tjetër, nëse i pandehuri nuk ka dhënë pëlqimin për kontrollin e pronës, atëherë Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar se sendet e gjetura gjatë kontrollit nuk mund të sekuestrohen përkohësisht dhe konsiderohen provë e papranueshme, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë nen³⁸⁷.

Për sendet të cilat mund të konfiskohen përkohësisht, ligji rendit shprehimisht edhe pajisjet elektronike pakufizim, të tilla si kompjutera, kamera, telefona celularë, pajisje elektronike mobile ose pajisje elektronike mobile për ruajtje, nëse ka shkak të bazuar për kontroll. Urdhërkontrolli, i cili autorizon konfiskimin e përkohshëm të pajisjes ose të pajisjeve të tilla duhet të përshkruaj llojin e të dhënave elektronike për të cilat zyrtari i autorizuar i policisë mund të kontrollojë dhe t'i kopjoj³⁸⁸.

6.6.2. Urdhërkontrolli, koha dhe vendi i kontrollit

Për konfiskimin e përkohshëm të këtyre sendeve është i nevojshëm urdhërkontrolli, në bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit, ndërsa në raste të ngutshme, në bazë të kërkesës me shkrim të zyrtarit të autorizuar të policisë, të cilin e lëshon gjyqtari i procedurës paraprake, kur ka gjasa se ky kontroll do të rezultojë në zbulimin e gjurmëve ose në konfiskimin e provave të një veprë penale. Sa i përket kohës dhe vendit të kontrollit, Kodi i Procedurës Penale ka përcaktuar rregullin se gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit të shtetit, mund të urdhërojë në çdo kohë gjatë fazës së hetimit, kontrollin e një shtëpie, të lokaleve të tjera dhe të pronës së të pandehurit në të gjitha rastet kur ekziston dyshim i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale dhe kur për shkak të bazuar kontrolli do të rezultojë me arrestimin e personit të tillë ose me zbulimin dhe sekuestrimin e provave të rëndësishme për procedurën penale³⁸⁹.

Kodi i Procedurës Penale përcakton si risi edhe rastet kur gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërojë kontrollin e një shtëpie ose të lokaleve të tjera dhe të pasurisë së një personi që nuk dyshohet për kryerjen e një veprë penale. Një kontroll i tillë, sipas paragrafit 4 të nenit 105 të Kodit të Procedurës Penale mund të urdhërohet nga gjyqtari i procedurës paraprake vetëm në rastet kur:

- a) ka gjasa reale se kontrolli do të rezultojë me arrestimin e të pandehurit;
- b) është e nevojshme të ruhen provat e veprës penale ose të konfiskohen sendet përkatëse të cilat nuk mund të ruhen apo të sigurohen pa zbatimin e kontrollit; dhe

³⁸⁷ Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 37 / 28 Dhjetor 2012, Prishtinë, - KPPRK, neni 105 paragrafi 2.

³⁸⁸ Po aty, paragrafi 8.

³⁸⁹ Po aty, paragrafi 3.

- c) kur ka gjasa reale se provat ose sendet e tilla ndodhen në lokalet apo në pasurinë që i nënshtrohet kontrollit.

Kontrolli mund të kryhet edhe tek dëshmitarët e privilegjuar, të cilët nuk mund të merren në pyetje, sipas nenit 126, dhe tek dëshmitarët e liruar nga detyrimi për të dëshmuar, sipas nenit 127³⁹⁰. Gjithashtu, edhe kontrollin personal ndaj një personi të caktuar mund ta urdhërojë gjyqtari i procedurës paraprake. Ky kontroll zbatohet në kushtet e parashikuara për kontrollin e shtëpisë, kur ka gjasa reale se ky kontroll do të rezultojë në zbulimin e gjurmëve ose në konfiskimin e provave të një veprë penale³⁹¹. Kontrolli personal përfshin kontrollin e veshëmbathjes dhe kontrollin e gjësendeve të tij/saj (çanta, valixhe etj.), por edhe kontrollin etrupit të tij/saj, me qëllim zbulimit e gjurmëve ose në konfiskimin e provave të një veprë penale, me rëndësi për procedurën penale.

Për konfiskimin e përkohshëm të këtyre sendeve është i nevojshëm urdhërkontrolli i lëshuar me shkrim në bazë po të kërkesës me shkrim të prokurorit të shtetit, ndërsa në raste të ngutshme lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim të zyrtarit të autorizuar të policisë. Përmbajtja e urdhërkontrollit e përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 105 të Kodit të Procedurës Penale veç identifikimit të vendit ose personit kundër të cilit lëshohet urdhri, kërkon përshkrimin e veprës penale për të cilën lëshohet urdhri, shpjegimin e arsyeve për shkak të bazuar në pajtim me nenin 105, përfshin përshkrimin e sendeve të kërkuara me kontroll, përshkrimin e veçantë të personit, të lokaleve apo të pasurisë ku zbatohet kontrolli dhe informacionin tjetër të nevojshëm për zbatimin e kontrollit. Me këtë nen është rregulluar gjithashtu edhe kontrolli në vende të fshehta, në vetura ose në mjete të tjera të transportit, duke parashikuar zbatimin subsidiar të dispozitave të këtij neni edhe gjatë kontrollit në vende të fshehta të përmendura në legjislacion³⁹².

Për çdo kontroll të personit, të shtëpisë ose të lokaleve përpilohet procesverbali, i cili nënshkruhet nga personi i kontrolluar ose nga personi, lokalet ose pasuria e të cilit janë kontrolluar, avokati i tij nëse është i pranishëm gjatë kontrollit dhe personat, prania e të cilëve është e detyruar³⁹³. Me paragrafin 7 të këtij neni është rregulluar gjithashtu se gjatë zbatimit të kontrollit mund të konfiskohen vetëm sendet dhe shkresat lidhur me qëllimin e kontrollit të caktuar. Në rastin e konfiskimit, sendet dhe shkresat e konfiskuara deklarohen

³⁹⁰ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani “Komentar – Botimi i Kodit të Procedurës Penale” i publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë.

³⁹¹ KPPRK, neni 105, paragrafi 5.

³⁹² Po aty, paragrafi 8.

³⁹³ Po aty, neni 108, paragrafi 7.

në një procesverbal në të cilin gjithashtu përfshihen, përshkruhen qartë dhe shënohen të gjitha vërejtjet për sendet ose shkresat e konfiskuara. Të gjitha këto shkruhen edhe në vërtetimin që i jepet menjëherë pas konfiskimit personit, sendet dhe shkresat e të cilit janë konfiskuar. Organi i procedurës siguron gjithashtu ruajtjen e sendeve të konfiskuara përkohësisht. Në paragrafin 8 të nenit 108 është përcaktuar se sendet dhe shkresat e konfiskuara gjatë kontrollit mbahen në kontenierët përkatës ose në qese transparente plastike. Organet e procedurës, përkatësisht zyrtari i autorizuar dhe prokurori i shtetit mbajnë procesverbal mbi mbikëqyrjen e secilit send ose grup shkresash.

Sekuestrimi i sendeve, sipas Kodit të Procedurës Penale, mund të bëhet edhe për sendet, që nuk kanë lidhje me bazën e kontrollit, por që tregojnë një vepër tjetër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 109 të Kodit të Procedurës Penale³⁹⁴. Në raste të tilla për konfiskimin e sendeve zbatohet procedura e njëjtë si në rastin kur kontrolli zbatohet në bazë të urdhërit për kontroll (neni 105 paragrafi 3), ashtu edhe atëherë kur ai aplikohet pa urdhër të gjyqtarit kompetent (neni 110). Në të dy rastet trajtimi i sendeve të sekuestruara është i njëjtë, ndërsa sendet e sekuestruara sipas këtij neni, përshkruhen në një procesverbal për të cilat menjëherë lëshohet vërtetim për sekuestrimin e tyre.

Për sendet e sekuestruara njoftohet menjëherë Prokurori i shtetit. Nëse Prokurori i shtetit konstaton se nuk ka bazë për ndjekje penale, e as ndonjë bazë tjetër ligjore për konfiskimin e sendeve, atëherë sendet e konfiskuara kthehen menjëherë.

6.6.3. Sekuestrimi i përkohshëm i sendeve

odi i Procedurës Penale, sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, e rregullon në mënyrë të hollësishme në nenin 112, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve të: sendeve të cilat i nënshtrohen sekuestrimit të përkohshëm; urdhërave të organeve; veprimit me sendet e sekuestruara dhe ruajtjen e tyre; mbikëqyrjen e sendeve të sekuestruara; organin për ekzekutimin e urdhërit për sekuestrim të përkohshëm të sendeve dhe çështje të tjera të rëndësishme për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve.

Vlen të theksohet se në Kod, herë -herë, ka jo konsekuencë lidhur me përdorimin e termave “*sekuestrim*” dhe “*konfiskim*”. Për shembull, në nenet 267, 105, paragrafi 4, nënparagrafi 4.2, nenin 108, paragrafi 8 etj., bëhet fjalë për konfiskim (të përkohshëm) të sendeve gjatë kontrollit, ndërsa në të vërtetë fjala është për sekuestrimin e sendeve.

³⁹⁴ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani “Komentar – Bitimi I Kodi i Procedurës Penale” i publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 315.

Ndërkaq, në nenin 115, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 dhe në paragrafin 3, është shënuar sekuestrim i përhershëm e fjala, në të vërtetë, është për konfiskim, ngase, sipas atyre dispozitave, marrja e sendit është e karakterit të përhershëm, përkatësisht kemi të bëjmë me konfiskim³⁹⁵. Për të qartësuar kuptimin e këtyre termave, duhet patur parasysh Ligji “Për Kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale” dhe Ligji “Për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar”, ligje që japin përkufizime që shprehin qartëkuptimin e këtyre shprehjeve. Shprehja “konfiskim” në Ligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale ka kuptimin e: *“Konfiskimit të përhershëm të pasurisë, të urdhëruar me vendim të formës së prerë nga Gjykata kompetente apo organi tjetër kompetent në pajtim me ligjin në fuqi”*³⁹⁶. Përkufizimi i këtij termi është dhënë edhe në Ligjin për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, sipas të cilit “*Konfiskim*” do të thotë “*...marrje e përhershme e sendit në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente, apo organit tjetër kompetent, në pajtim me ligjin në fuqi.*” Gjithashtu në këtë Ligj është dhënë edhe përkufizimi i termit “*sekuestrim*”, i cili nënkupton “*...marrjen e përkohshme të sendit në bazë të vendimit të gjykatës apo organit kompetent, në pajtim me ligjin në fuqi*”³⁹⁷.

Sa i përket sendeve që përkohësisht mund të sekuestrohen, paragrafi 1 i nenit 112 të Kodit të Procedurës Penale dallon tri lloje sendesh: 1) sendet që mund të jenë prova gjatë një procedure penale; 2) sendet ose pasuria që kanë mundësuar kryerjen e veprës penale; ose 3) sendet që konsiderohen dobi pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale dhe për të cilat ligji parashikon sekuestrimin. Sekuestrimi i përkohshëm i sendeve, pasurisë, provave ose parave sipas këtij neni bëhet vetëm me urdhër të gjykatës, të cilit i paraprin kërkesa e prokurorit të shtetit³⁹⁸. Kërkesa e prokurorit të shtetit duhet të theksojë në veçanti:

- sendet, pasurinë, provat ose paratë;
- të përshkruajë si mund të jenë këto sende, prova të veprës penale;
- si këto sende, pasuri ose para mund të mundësojnë kryerjen e veprës penale; ose
- si këto sende, pasuri apo para përbëjnë dobi pasurore të fituar me vepër penale.

Mirëpo, Kodi ka parashikuar edhe situatën kur zyrtarët e autorizuar të policisë gjatë kontrollit apo arrestit të ligjshëm mësojnë për sendin, pasurinë, provat ose paratë e tilla. Në

³⁹⁵ Po aty, fq. 321.

³⁹⁶ Ligji Nr. 04/L-140 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 5 / 8 Mars 2013, Prishtinë, neni 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.

³⁹⁷ Ligji nr. 03/L-141 për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti IV / Nr. 58 / 10 Gusht 2009), neni 2 paragrafi 1 nënparagrafet 2 dhe 6.

³⁹⁸ KPPRK, neni 112 paragrafi 3.

rastet e tilla, sipas paragrafit 2 të nenit 112 të këtij Kodi, sendet, pasuria, provat ose paratë mund t'i nënshtrohen kufizimit të përkohshëm sipas urdhërit të prokurorit të shtetit, por që zgjat jo më shumë se pesë ditë. Krahas kësaj, prokurori i shtetit kërkon urdhër për sekuestrim të përkohshëm të tyre nga gjyqtari i procedurës paraprake, ndërsa kërkesa e prokurorit të shtetit duhet të përmbajë me saktësi sendet, pasurinë, provat ose paratë³⁹⁹.

Për shkak të natyrës së ndryshme të sendeve të sekuestruara përkohësisht, ligdhënësi në paragrafet 4–9 të këtij neni ka parashikuar mënyrën e veprimit me këto sende. Kështu, fillimisht, sendet e sekuestruara përkohësisht fotografohen dhe mbahen në kontenierët përkatës ose në qeset transparente të plastikës. Për shkak të rëndësisë së tyre, zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit duhet të mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal për mbikëqyrjen e secilit send ose grup shkresash. Të njëjtat veprime kryhen sa u përket sendeve të tilla si armët, automjetet, aeroplanët ose sendet e tjera me vëllim të madh, të cilat janë sekuestruar përkohësisht; edhe ato fotografohen dhe duhet të mbahen në zona përkatëse të sigurta, për të cilat zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit mban regjistër të fotografive dhe procesverbal për mbikëqyrjen e secilit send ose grup shkresash. Lidhur me sendet e paluajtshme (ndërtesat ose prona e paluajtshme) të cilat sekuestrohen përkohësisht, në to vendosen njoftimet me të cilat informohen qytetarët se paluajtshmëria i është nënshtruar sekuestrimit të përkohshëm dhe për këtë fakt duhet të kenë kujdes.

Kur kemi të bëjmë me paratë ose monedhat e sekuestruara përkohësisht, gjithashtu është parashikuar se ato duhet të fotografohen dhe mbahen në kasafortë, ndërsa zyrtari i autorizuar i policisë ose prokurori i shtetit do të mbajnë regjistër të fotografive dhe procesverbal mbi mbikëqyrjen për secilin send ose grup të shkresave.

Në qoftë se është fjala për paratë e mbajtura në llogarinë bankare, të cilat janë sekuestruar përkohësisht ato duhet të mbahen në një llogari bankare, e cila domosdoshmërisht është nën autoritetin e gjykatës, cka do të thotë se nuk janë në mbikëqyrjen dhe kontrollin e zyrtarit të autorizuar policor ose të prokurorit të shtetit.

Në paragrafin 10 të këtij neni është përcaktuar senë rastet e sekuestrimit të përkohshëm të sendeve, autoritetet e autorizuar duhet të përshkruajnë sendet dhe të tregojnë se ku janë gjetur dhe, nëse është e nevojshme, duhet të vërtetohet edhe identiteti i tyre duke u lëshuar vërtetimi për sendet e sekuestruara. Në fund, paragrafi 11 i këtij neni, si dispozitë ndëshkimore, për mos zbatimin e urdhërit të gjyqtarit të procedurës paraprake, përkatësisht

³⁹⁹Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani “Komentar – Bitimi I Kodi i Procedurës Penale” i publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 321.

për refuzim të dorëzimit të sendit, pasurisë, provave ose të parave tek zyrtari i autorizuar i policisë si përgjegjës për ekzekutimin e urdhërit, ka parashikuar mundësinë e shqiptimit të gjobës për personin ose organin e tillë nga gjyqtari i procedurës paraprake deri në pesëdhjetë përqind (50%) të vlerës së sendit, pasurisë, provave ose parave që janë objekt i kontestit. Gjithashtu, parashikohet edhe mjeti i rregullt juridik, përkatësisht e drejta për personin ose organin ndaj të cilit shqiptohet gjoba e tillë, për paraqitje të ankesës⁴⁰⁰ kundër gjobës apo edhe mundësia e shmangies së gjobës duke iu bindur urdhërit të gjyqtarit.

Sa i përket mbikëqyrjes dhe kujdesit për sendet e sekuestruara përkohësisht nga paragrafi 5, 6 dhe 8 të këtij neni, është përcaktuar se kjo bëhet nga prokurori i shtetit, i cili këtë përgjegjësi mund t'ia delegojë zyrtarit të autorizuar të policisë.

6.6.3.1. Sendet që nuk mund të sekuestrohen përkohësisht

Neni 113 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se cilat sende nuk mund të sekuestrohen përkohësisht. Në kuptim të këtij neni ndalohet sekuestrimi i përkohshëm i sendeve të tilla si:

- komunikimet me shkrim ndërmjet të pandehurit dhe personave të cilët, sipas Kodit të Procedurës Penale nuk mund të dëshmojnë. Kemi të bëjmë me dëshmitarët e privilegjuar nga neni 126 i Kodit të Procedurës Penale (lidhur me ruajtjen e fshehtësisë shtetërore ose ushtarake derisa organi kompetent të mos e lirojë nga ky detyrim), kryesisht idëshmitarëve të liruar nga detyrimi për të dëshmuar ngaqë kanë refuzuar që të dëshmojnë;
- shënimet e mbrojtësit lidhur me informacionin e fshehtë që i është besuar nga i pandehuri; dhe
- sendet e tjera, të mbrojtura me të drejtat e personave nga nenet 126 dhe 127 të Kodit të Procedurës Penale.

Në paragrafin 2 të këtij neni është parashikuar se këto kufizime (për pamundësinë e sekuestrimit të përkohshëm të sendeve), zbatohen vetëm nëse sende të tilla janë nën mbikëqyrjen e personit që nuk mund të dëshmojë ose që lirohet nga detyrimi për të dëshmuar dhe ka refuzuar dhënien e dëshmisë. Gjithashtu, sendet e mbrojtura nga e drejta e personave të parashikuara në nenin 127, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nuk i nënshtrohen sekuestrimit të përkohshëm nëse ata janë nën mbikëqyrjen e ndonjë spitali ose të ndonjë institucioni tjetër shëndetësor. Njëherësh, kufizimet nuk zbatohen edhe kur personat që nuk mund të dëshmojnë, janë liruar nga detyrimi i dëshmisë ose kanë refuzuar dhënien e

⁴⁰⁰Po aty.

dëshmisë, dyshohen për nxitje ose bashkëpunim, për pengim të drejtësisë, për pranimin e mallrave të vjedhura apo, kur sendet përkatëse janë marrë me vepër penale, janë përdorur ose janë parashikuar të përdoren për kryerjen e veprës penale⁴⁰¹.

6.6.4. Konfiskimi i përhershëm i sendeve të konfiskuara përkohësisht

Në fund të procedurës penale, si rregull sendet, pasuria, provat ose paratë e konfiskuara përkohësisht⁴⁰² i kthehen pronarit ose poseduesit. Këto sende mund t'i kthehen pronarit ose poseduesit edhe kur procedura pezullohet ose pushohet dhe kur nuk ka bazë për konfiskimin e tyre⁴⁰³. Gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, sipas nenit 284 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, së bashku me aktgjykimin lëshon edhe urdhërin e arsyetuar, i cili përcakton nëse duhen të konfiskohen përherë ose të lirohen ndërtesat, paluajtshmëritë, sendet e luajtshme ose asetet e përcaktuara në aktakuzë, në pajtim me nenin 241 paragrafi 1, nënparagrafi 1.9 i Kodit të Procedurës Penale. Mirëpo, për faktin nëse në fund të shqyrtimit gjyqësor duhet të kthehen sendet e sekuestruara përkohësisht ose asetet për të cilat është lëshuar urdhëri për ndalimin afatgjatë, gjykata vendos sipas nenit 266 të Kodit të Procedurës Penale, pavarësisht se cilin lloj të aktgjykimit ka marrë në rastin konkret. Në rastin e aktgjykimit fajësues, sendet e sekuestruara përkohësisht mund të merren si dobi pasurore e fituar me anë të veprës penale (neni 96 i Kodit të Procedurës Penale)⁴⁰⁴.

Në rastin kur pezullimi i procedurës penale ka gjasa të arsyeshme që të rifillojë, atëherë prokurori i shtetit ka të drejtë që të kërkojë afat shtesë për sekuestrimin e përkohshëm, ndërsa gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të lejojë kthimin e sendit të sekuestruar nëse ka arsye të forta se hetimi mund të rifillojë⁴⁰⁵.

Konfiskimin e përhershëm të sendeve në procedurë penale e urdhëron gjyqtari i vetëm ose trupi gjykues në pajtim me ligjin⁴⁰⁶. Që gjyqtari i vetëm ose trupi gjykues të urdhërojnë konfiskimin e përhershëm kërkojnë këto kushte:

- a) nëse prokurori i shtetit në aktakuzë përcakton ato sende, pasuri, prova ose para të cilat i nënshtrohen konfiskimit të përhershëm;

⁴⁰¹Po aty.

⁴⁰² KPPRK, neni 112.

⁴⁰³ Po aty, neni 116, paragrafi 1.

⁴⁰⁴ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani “Komentar – Botimi “Kodi i Procedurës Penale” i publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, f. 328.

⁴⁰⁵ KPPRK, neni 116 paragrafi 2.

⁴⁰⁶ KPPRK, neni 115, paragrafi 2.

- b) gjatë shqyrtimit gjyqësor vërtetohet se sendet, pasuria, paratë ose provat e sekuestruara përkohësisht kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose përbëjnë dobi pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale; dhe
- c) nëse ligji lejon konfiskimin e tyre (kjo bazë zakonisht gjendet në Kodin e Procedurës Penale).

Kodi i Procedurës Penale në paragrafët 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 115 përcakton veprimet me sendet, pasurinë ose provat për të cilat bëhet konfiskimi i përhershëm. Varësisht nga llojet e sendeve, pasurisë dhe provave, në paragrafët e përmendur parashikohen këto rregulla:

- sendet, pasuria, paratë ose provat shiten⁴⁰⁷ dhe të ardhurat nga këto shitje përdoren për kompensimin e të dëmtuarve, kurse pjesa e mbetur derdhet në buxhetin e shtetit;
- armët dhe sendet e kontrabanduara shkatërrohen me përjashtim të sendeve që mund të përdoren nga shoqëria, pasi ato të mos kenë më vlerë si prova në shqyrtimin kryesor ose në procedurën e ankimit, siç është parashikuar për pasurinë që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit⁴⁰⁸;
- automjetet ose aroplanët për të cilët është bërë konfiskimi i përhershëm, me kërkesë të prokurorit të shtetit mund t'i transferohen Qeverisë së Republikës së Kosovës për shfrytëzim, nëse transferimi i tillë nuk e zbeh mundësinë e të dëmtuarit për të siguruar kompensimin.

Sa i përket kthimit të sendeve të sekuestruara përkohësisht, Kodi i Procedurës Penale përcakton arsyet e kthimit. Në të vërtetë, sendet e sekuestruara përkohësisht, gjatë procedurës penale i kthehen pronarit ose poseduesit kur: procedura pezullohet ose pushohet dhe kur nuk ka bazë për konfiskimin e tyre⁴⁰⁹, çka do të thotë se i kthehen pronarit ose poseduesit që i janë marrë. Ndërkaq, në rastin kur pezullimi i procedurës penale bëhet për shkak të arratisjes së të pandehurit, për shkak të paaftësisë së tij mendore ose kur ekzistojnë gjasat e justifikueshme që hetimi i pezulluar të rifilloj, ligji parashikon të drejtën që prokurori i shtetit të kërkojë afat shtesë për sekuestrimin. Në bazë të kërkesës së tillë të prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të vendos për lejimin e kthimit të sendit të sekuestruar, por vetëm nëse ka arsye të forta⁴¹⁰.

⁴⁰⁷ Sipas nenit 284 paragrafi 6 të Kodit të Procedurës Penale është përcaktuar se “Urdhëri i arsyetuar për konfiskimin e pasurisë e udhëzon, Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar që edhe të shes, likujdojë ose të mbajë ose pasurinë e paluajtshme, të luajtshme ose asetin”.

⁴⁰⁸ KPPRK, neni 282 paragrafi 3.

⁴⁰⁹ Po aty, neni 116 paragrafi 1.

⁴¹⁰ Po aty, paragrafi 2.

6.6.5. Ngrirja e përkohshme e aseteve dhe urdhri ndalues

Kodi i Procedurës Penale, në funksion të efikasitetit të procedurës penale ka parashikuar mundësinë, format dhe mënyrën e sekuestrimit të përkohshëm dhe të konfiskimit të përhershëm të dobisë pasurore të fituar me anë të veprës penale. Mirëpo, sipas Kodit të Procedurës Penale, përveç sekuestrimit, prokurori i shtetit ka mjete të reja për të bërë identifikimin dhe ngrirjen e pasurive.

Megjithëse për zbulimin e të dhënave financiare kërkohet urdhëri i gjykatës, sipas nenit 91 (3) të Kodit të Procedurës Penale, prokurori i shtetit mund të urdhërojë zbulimin e të dhënave financiare nëse ka dyshim të bazuar se të dhënat financiare do të ishin relevante për procedure penale që zhvillohet për veprën penale në Kapitullin XXIV, XXV apo XXXIV të Kodit Penal. Këta kapituj përfshijnë veprat penale që kanë të bëjnë me krimin e organizuar (Kapitulli XXIV), veprat penale kundër ekonomisë – përfshirë shpëlarjen e parave (Kapitulli XXV) dhe korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare (Kapitulli XXXIV). Gjatë punës së përbashkët me Njësinë e Inteligjencës Financiare, prokurori i shtetit tani ka mjete juridike më fleksibile për sigurimin e shpejtë të të dhënave financiare dhe gjetjen e të gjitha përfitimeve të kundërligjshme.

Kështu, me gjetjen e këtyre përfitimeve të kundërligjshme, prokurori i shtetit mund të veprojë shpejt. Prokurori i shtetit jo vetëm që mund të sekuestrojë sendet sipas nenit 115, por në rastet kur ai është duke hetuar ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 90 të Kodit të Procedurës Penale, ai mund të nxjerr urdhër për ngrirjen e përkohshme të tyre, me të cilin pengohet shitja, transferimi i pasurisë ose tërheqja nga llogaria bankare e cilitdo send të përshkruar në paragrafin 2 të nenit 264 të Kodit të Procedurës Penale⁴¹¹ si dhe të çfarëdo llogarie financiare që i takon të pandehurit nën hetim, në të cilën mund të ketë mjete që janë të ardhura nga vepra penale nën hetim ose janë përdorur në kryerjen e vazhdueshme të veprës penale nën hetim. Urdhrin për ngrirje të përkohshme të aseteve nga neni 264 i Kodit të Procedurës Penale prokurori i shtetit mund ta lëshojë vetëm një herë dhe urdhëri është i vlefshëm vetëm për 72 orë duke filluar nga koha e lëshimit të tij⁴¹².

Sipas nenit 264 (2), prokurori i shtetit duhet të ketë prova në të cilat mbështetet dyshimi i bazuar se pasuria e përdorur në kryerjen e veprës penale rrjedh nga vepra penale apo është

⁴¹¹ Paragrafi 2 i nenit 264 i Kodit të Procedurës Penale “Çdo ndërtesë, pasuri e paluajtshme, pasuri e luajtshme ose aset për të cilën prokurori i shtetit ka prova të artikulueshme që tregojnë dyshim se: 2.1 ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset është përdorur në veprën penale nën hetim; 2.2 ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset është provë penale nën hetim; ose 2.3 ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset është fituar nga vepra penale nën hetim”.

⁴¹² Po aty, paragrafi 5.

provë e veprës penale. Kjo përfshin llogaritë apo pasurinë e cila mund t'i takojë apo të mos i takojë të pandehurit. Nëse ka llogari financiare të cilat i takojnë të pandehurit sipas nenit 264 (3), standardi është më i ulët; prokurori i shtetit duhet të provojë vetëm se *mund* të ketë mjete financiare që janë dobi pasurore e veprës penale apo të cilat janë shfrytëzuar për kryerjen e veprës penale.

Në të njëjtën kohë kur prokurori i shtetit nxjerr urdhër për ngrirjen e pasurisë sipas nenit 264, ai duhet t'i paraqesë kërkesë gjyqtarit të procedurës paraprake për urdhër ndalues nga neni 265. Prokurori i shtetit në urdhrin për ngrirjen e përkohshme të aseteve duhet të përshkruaj ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme, llogarinë financiare ose asetin, duke i ndaluar pranuesit të urdhërit që të ndalojë shitjen, shkëmbimin e pronësisë ose tërheqjen nga llogaria për 72 orë nga koha e lëshimit të urdhërit. Gjithashtu në urdhër ceket edhe koha e lëshimit dhe koha e skadimit të urdhërit. Kodi e kushtëzon lëshimin e këtij urdhëri nëse prokurori i shtetit i paraqet (në mënyrë paralele) kërkesë gjyqtarit të procedurës paraprake për urdhër ndalues gjyqësor për asetin përkatës⁴¹³.

Urdhri ndalues - si një lloj i vendimit gjyqësor, lëshohet në procedurën e përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale. Në të vërtetë, kur prokurori i shtetit lëshon urdhërin për ngrirjen e përkohshme të aseteve sipas nenit 264 të Kodit, menjëherë i paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake kërkesën urdhër-ndalimi për asetin e përcaktuar në urdhërin për ngrirjen e përkohshme të asetit. Kjo do të thotë se urdhëri i prokurorit të shtetit për ngrirjen e përkohshme të aseteve ndiqet njëkohësisht nga kërkesa e prokurorit të shtetit përpara gjyqtarit të procedurës paraprake, e cila përmban⁴¹⁴: kopjen e urdhërit për ngrirjen e përkohshme të aseteve; përshkrimin e provave të artikuleshme⁴¹⁵ që arsyetojnë urdhrin; përshkrimin e arsyeve që urdhëri ndalues të ndalojë shitjen, shkëmbimin apo tërheqjen nga llogaria e asetit të përshkruar dhe identitetin e të gjithë personave që kanë interes pasuror në asetin e përshkruar, siç përcaktohet në regjistrat kadastral apo regjistrat e tjerë qeveritar. Kështu, bazuar në provat e artikuleshme të paraqitura në kërkesën për urdhër ndalimi nga prokurori i shtetit me të cilën ai tregon se ka shkak të arsyeshëm, gjyqtari i procedurës paraprake lëshon gjithashtu urdhër ndalimi të përkohshëm për ngrirjen e aseteve. Gjyqtari i procedurës paraprake refuzon ose lëshon urdhrin e ndalimit para skadimit të urdhërit për

⁴¹³ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani "Komentar – Botim "Kodi i Procedurës Penale" i publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 697.

⁴¹⁴ KPPRK, neni 265, paragrafi 2.

⁴¹⁵ Sipas nenit 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale, shprehja "Artikuleshëm" ka kuptimin "kur informata apo prova duhet të jetë e artikuleshme, pala e cila paraqet informacionin apo provën duhet të specifikojë në detaje informatën apo provën në të cilën mbështetet".

ngrirjen e përkohshme të aseteve⁴¹⁶, ndërsa urdhëri i ndalimit vlen për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Urdhëri i dërgohet institucionit financiar ose palës tjetër për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirjen e përkohshme të aseteve.

Urdhri i ndalimit përcakton objektin e ndalesës (ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme, llogarinë financiare ose asetin dhe urdhëron pranuesin e urdhërit që të ndalojë shitjen, shkëmbimin e pronësisë ose tërheqjen nga llogaria për 30 ditë nga koha e lëshimit të urdhrit). Si thamë urdhëri ndalues i dërgohet institucionit financiar ose palës tjetër për të cilën është lëshuar urdhri për ngrirjen e përkohshme të aseteve, por ai i dërgohet gjithashtu të pandehurit, institucionit përkatës financiar apo palëve dhe personave tjerë që kanë ndonjë interes në atë pasuri. Urdhëri ndalues, cakton gjithashtu shqyrtimin brenda tre (3) javësh, shqyrtim në të cilin analizohen pretendimet e prokurorit të shtetit të paraqitura në kërkesën e tij për lëshim të urdhrit për ngrirje të aseteve. Në urdhër tekstualisht shënohet teksti⁴¹⁷ i paragrafit 8 të nenit 265 të Kodit të Procedurës Penale.

Për të vendosur nëse duhet lëshuar urdhri ndalues afatgjatë, gjyqtari i procedurës paraprake mund të marrë parasysh provat që ka vlerësuar te urdhri ndalues, pastaj ai poashtu mbështet urdhërin ndalues afatgjatë në provat e paraqitura gjatë shqyrtimit për ndalim, përkatësisht:

- a) provat ose dëshmitarët e paraqitur nga prokurori i shtetit;
- b) provat ose dëshmitarët e paraqitur nga i pandehuri -për të kundërshtuar provat në mbështetje të urdhërit ndalues;
- c) provat ose dëshmitarët e paraqitur nga palët e tjera të cilët kanë të drejta në pasuri, për të kundërshtuar provat në mbështetje të urdhrit ndalues, ose mund të paraqesin argumente kundër bazës juridike për urdhërin ndalues, ose dëshmitarët në mbështetje të urdhrit ndalues të lëshuar më parë gjatë çmuarjes, derisa të tjerët mund të paraqesin argumentet kundër urdhrit ndalues.

Sipas nenit 266 (5), gjyqtari i procedurës paraprak nxjerr urdhër për ndalim afatgjatë të pasurisë nëse ka prova të artikulueshme, të cilat tregojnë shkak të arsyeshëm për arsyetimin e urdhrit.

Gjykata, gjithashtu mund të urdhërojë sekuestrimin e pasurisë nëse bindet se urdhri ndalues nuk është i mjaftueshëm për të parandaluar zhvendosjen e pasurisë jashtë Kosovës.

⁴¹⁶ Paragrafi 4 i nenit 265 të Kodit të Procedurës Penale.

⁴¹⁷ Teksti: “Pasuria e përcaktuar në urdhërin ndalues është ngrirë për tridhjetë ditë. Shqyrtimi është caktuar. Nëse pretendoni të kundërshtoni ngrirjen e kësaj pasurie, ju duhet të merrni pjesë në shqyrtim dhe do të keni mundësinë të paraqitni argumentet tuaja për heqjen e kësaj ngrirjeje. Nalimi afatgjatë i kësaj pasurie mund të urdhërohet në këtë shqyrtim dhe kjo prek të drejtën tuaj në këtë pasuri”.

Nëse urdhëri për ndalim afatgjatë nxirret nga gjyqtari i procedurës paraprake, sipas nenit 266 (10) ky urdhër nuk skadon deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ose deri në momentin kur gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues urdhëron lirim të pasurisë për shkak të mospërfshirjes së pasurisë në aktakuzë.

Është mjaft e rëndësishme që prokurori të cek në aktakuzë çdo ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme apo send, i cili i nënshtrohet konfiskimit. Kjo duhet gjithsesi të përfshijë të gjitha sendet e sekuestruara me masat për sigurimin e pasurisë nga neni 273 dhe të gjitha sendet të cilat i janë nënshtruar urdhërit për ndalim afatgjatë nga neni 266. Nëse sendet nuk ceken në aktakuzë dhe nëse nuk janë subjekt i ndonjë procedure tjetër të konfiskimit, sipas nenit 274, i pandehuri dhe pronarët mund të kërkojnë nga gjykata që të bëjë lirim të pasurisë. Gjykata mund të refuzojë këtë kërkesë nëse sendet do të shërbejnë si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor apo nëse prokurori i shtetit tregon se sendet do të ceken në aktakuzën që pritet të ngritet.

Pas ngritjes së aktakuzës, në të cilën listohen të gjitha pasuritë që i nënshtrohen konfiskimit, prokurori i shtetit duhet të paraqesë prova gjatë shqyrtimit gjyqësor për të arsyetuar kërkesën për konfiskim. Me fjalë tjera, ai duhet të vërtetojë se sendi është përdorur në kryerjen e veprës penale sipas nenit 283 ose rrjedh si dobi pasurore e fituar me vepër penale.

Nëse gjykata është e bindur se urdhër ndalimi nuk do të mund të parandalojë largimin e pasurisë nga kompetenca territoriale e saj, Kodi i Procedurës Penale⁴¹⁸, në përfundim të shqyrtimit, parashikon se gjykata mund të urdhërojë që pasuria të administrohet nga organi kompetent për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar⁴¹⁹. I pandehuri ose shfrytëzuesi i pasurisë, sipas paragrafit 8 të Kodit të Procedurës Penale, përveç mjeteve të mbajtura në llogaritë financiare të ngrira ose në llogaritë financiare të ndaluara, ka të drejtë të vazhdojë me shfrytëzimin e pasurisë, por duke u ndaluar ta shesë ose ta shkëmbejë pasurinë e sekuestruar ose konfiskuar.

Vlefshmëria, skadimi dhe mjeti juridik kundër urdhërit për ndalim afatgjatë është rregulluar në paragrafët 9, 10 dhe 12 të nenit 266 të Kodit të Procedurës Penale. Kështu, Urdhëri për ndalim afatgjatë i lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake vlen për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe nuk skadon deri në pushim të hetimit ose deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Gjithashtu, nëse pasuria e përcaktuar në urdhrin për

⁴¹⁸ KPPRK, neni 266, paragrafi 7.

⁴¹⁹ Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

ndalim afatgjatë, nuk ceket në akatakuzë⁴²⁰, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të vendosë për lirimin e pasurisë për të gjitha palët e përfshira në urdhrin për ndalim afatgjatë.

6.6.6. Procedura e konfiskimit të përkohshëm dhe masat e përkohshme për sigurimin e Pasurisë

6.6.6.1. Konfiskimi i përkohshëm⁴²¹

Siç kemi parë me rastin e shtjellimit të çështjes së kontrollit dhe sekuestrimit të përkohshëm, gjatë zbatimit të kontrollit në bazë të nenit 105 të Kodit të Procedurës Penale, si rregull, me urdhër të gjykatës mund të bëhet sekuestrimi i përkohshëm i sendeve⁴²², ndërsa sekuestrimi ka përfshirë:

- a) sendet që mund të jenë provë në procedurën penale;
- b) sendet ose pasuritë të cilat kanë mundësuar kryerjen e veprës penale; dhe
- c) sendet që konsiderohen dobi pasurore e fituar me vepër penale, për të cilat parashikohet me ligj sekuestrimi. Sipas paragrafit 2 të këtij neni, në rastet kur policia gjatë kontrollit ose arrestimit të ligjshëm ka mësuar për sende, pasuri, prova ose para, prokurori i shtetit mund të urdhërojë kufizimin e këtyre sendeve për 5 ditë. Pas urdhrit për kufizim të përkohshëm, prokurori i shtetit mund të kërkojë urdhër nga gjyqtari i procedurës paraprake për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, provave dhe të parave, me justifikimin se ato mund të shërbejnë si provë në procedurën penale, se kanë mundësuar kryerjen e veprës penale ose janë dobi pasurore e përfituar me vepër penale. Në raste të tilla prokurori i shtetit kërkon urdhër nga gjyqtari i procedurës paraprake për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, pasurisë, provave ose parave, sepse këto sende, mund të sekuestrohen përkohësisht vetëm me urdhër të gjykatës.

Kështu, në paragrafin 1 të nenit 267 të këtij Kodi është përcaktuar se si duhet të veprojë gjykata në rastet e sekuestrimit të përkohshëm të ndërtesave, pasurisë së paluajtshme, pasurisë së luajtshme dhe aseteve sipas nenit 112⁴²³ të Kodit të Procedurës Penale. Në

⁴²⁰ KPPRK, neni 266, paragrafi 11.

⁴²¹ Konsideroj se në vend të shprehjes “konfiskim” duhet përdorur shprehjen “sekuestrim”.

⁴²² KPPRK, neni 112.

⁴²³ Në të vërtetë, kur bëhet sekuestrimi i përkohshëm i sendeve sipas paragrafit 1 të nenit 112 të Kodit të Procedurës Penale, është parashikuar se ato ose duhet t’i kthehen pronarit në pajtim me nenin 116 të kodit të

paragrafin 3 të këtij neni udhëzohet, se në bazë të cilave dispozita rregullohet më së afërmi procedura e sekuestrimit të përkohshëm. Kështu, të gjitha asetet e sekuestruara që i nënshtrohen konfiskimit sipas ligjit në fuqi, konsiderohen se janë sekuestruar përkohësisht ose janë konfiskuar në pajtim me dispozitat e kapitullit XVIII të këtij Kodi, me të cilin rregullohet procedura e konfiskimit para ngritjes dhe pas ngritjes së aktakuzës.

6.6.6.2. Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë

Duke patur parasysh nenin 212 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilës pasuria e sekuestruar përkohësisht nga i pandehuri mund të shitet, të bartet ose t'i transferohet dikujt tjetër, sipas paragrafit të këtij neni, prokurorit të shteti i është dhënë autorizimi që, brenda 60 ditëve nga sekuestrimi/konfiskimi i ndërtesës, pasurisë së paluajtshme, pasurisë së luajtshme ose asetit, të kërkojë masë të përkohshme për sigurimin e pasurisë në pajtim me nenin 268 të Kodit të Procedurës Penale, me qëllim arsyetimin para gjykatës të domosdoshmërisë për shqiptimin e masave të përkohshme.

Kodi i jep rëndësi të veçantë kërkesës për masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, duke e rregulluar objektin për të cilat mund të kërkoen këto masa, autorizimet, detyrimet e prokurorit dhe përmbajtjen e kërkesës për masë të përkohshme për sigurimin e pasurisë. Procesi i përcaktimit të këtyre masave është rregulluar në mënyrë të hollësishme dhe gjithëpërfshirëse sipas neneve 267-273 të Kodit të Procedurës Penale.

Kërkesën me shkrim për masa të përkohshme për sigurimin e pasurisë prokurori i shtetit ia paraqet gjyqtarit të procedurës paraprake. Objekt i kërkesës⁴²⁴ për masa të përkohshme për sigurimin e pasurisë janë: ndërtesat, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme dhe asetet e sekuestruara përkohësisht, të cilat do të shfrytëzohen si provë ose do t'i nënshtrohen konfiskimit të përhershëm.

Në paragrafin 2 të këtij neni janë parashikuar taksativisht elementët që duhet të përmbajë kërkesa e prokurorit të shtetit për masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë. Kështu, kërkesa duhet të përmbajë elementet si vijon:

Procedurës Penale; të mbahen deri në shfrytëzimin e tyre si prova deri në konfiskimin e përhershëm në pajtim me nenin 268 të Kodit të Procedurës Penale.

⁴²⁴ KPPRK, neni 268 paragrafi 1.

- a) ndërtesën, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme ose asetin që është objekt i kërkesës;
- b) dyshimin e bazuar se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset i është rrjedhojë e veprës penale nën hetim, ose është përdorur ose ka pasur për qëllim të përdoret në kryerjen e veprës penale;
- c) nëse ka gjasa të konsiderueshme se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset i nuk do mund të konfiskohen në përfundim të procedurës penale ose do të përdoren në kryerjen e veprës penale nëse nuk merren masa mbrojtëse;
- d) të gjithë personat që kanë ndonjë të drejtë ligjore në ndërtesë, pasuri të paluajtshme, pasuri të luajtshme ose në aset;
- e) masat e përkohshme që propozohen të merren në bazë të nenit 269 të Kodit të Procedurës Penale.

Ky nen, përcakton detyrimin e posaçëm për prokurorin e shtetit që kopjen e kërkesës për masën e përkohshme t'ia dërgojë secilit person që ka ndonjë të drejtë në sendet ose asetet⁴²⁵. Në rast se kopja e kërkesës nuk mund t'i dërgohet personit që ka ndonjë të drejtë tek sendet ose asetet, prokurori i shtetit duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta njoftuar secilin person që ka ndonjë të drejtë ligjore për sendet ose asetet për ekzistencën dhe pasojat e kërkesës për masë të përkohshme.

Për ekzekutimin e masave të përkohshme sipas nenit 296 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale është përgjegjëse Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar. Duke vepruar sipas kërkesës së prokurorit të shtetit, Agjencia, lidhur me ekzekutimin e masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë, ka përgjegjësi që t'i ekzekutojë dhe, varësisht nga lloji i pasurisë, përgjegjësia e saj është përcaktuar taksativisht për:

- a) mbajtjen e pasurisë në kasafortë;
- b) mbajtjen e pasurisë në depo të sigurt;
- c) mbajtjen e pasurisë së paluajtshme nga administratori i pasurisë së paluajtshme;
- d) mbajtjen e mjeteve në llogarinë bankare të autorizuar nga gjykata;
- e) tjetërsimin e pasurisë (kur për mbajtjen e saj kërkohen shpenzime të mëdha ose ajo humb shpejt vlerën ose është e zëvendësueshme);
- f) masa të arsyeshme për mbajtjen e pasurisë si provë; ose
- g) masa të arsyeshme për mbajtjen e pasurisë ose ekuivalentit të saj si aset.

⁴²⁵ Po aty, paragrafi 2 nënparagrafi 2.4.

Masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, ekzekutimin e të cilave prokurori i shtetit ia kërkon Agjencisë janë të precizuara, por për shkak të rëndësisë dhe shumëllojshmërisë së tyre prokurorit të shtetit i është dhënë autorizimi, për të qenë fleksibil në rastet e propozimit për ekzekutimin e këtyre masave⁴²⁶. Kjo para së gjithash duke pasqyruar natyrën e sendeve, të cilat i nënshtrohen sekuestrimit të përkohshëm.

Ndonëse Kodi nuk i precizon të gjitha masat e mundshme, me të cilat do të zvogëloheshin dukshëm shpenzimet për të ruajtur vlerën reale të pasurisë, ai përcakton shprehimisht masat e arsyeshme. Kështu, prokurori i shtetit, ndër të tjera, mund të kërkojë shitjen e pasurisë për vlerën e saj aktuale në treg, përzierjen e pasurisë ose përpunimin e të lashtave apo materialeve në produkte për konsum të përgjithshëm.

Pasuritë që janë objekt i sekuestrimit të përkohshëm dhe konfiskimit janë të ndryshme dhe të shumta. Kodi i Procedurës Penale ka veçuar pasuri që, për shkak të disa karakteristikave të tyre, e humbin shpejt vlerën e tyre reale (p.sh. frutat sezonale etj.). Kodi ka përcaktuar se për pasuri që i humbin shpejt vlerat e tyre dhe janë plotësisht të zëvendësueshme, prokurori i shtetit mund të kërkojë masa të justifikueshme me qëllim parandalimit e humbjes së vlerës reale ose shpenzime të panevojshme të mirëmbajtjes. Se cilat janë masat me të cilat do të ruhet vlera reale e një pasurie është çështje faktike që varet nga vetë natyra e pasurisë që është objekt i konfiskimit⁴²⁷. Kështu, sipas këtij paragrafi, prokurori i shtetit ka autoritetin të kërkojë, ndër të tjera, shitjen e pasurisë me vlerën e saj aktuale në treg, përzierjen e pasurisë ose përpunimin e të lashtave ose materialeve në produkte.

Sa i përket procedurës së shitjes dhe organit që zbaton këtë procedurë, neni shprehet se shitja e pasurisë bëhet në pajtim me nenin 8 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar⁴²⁸. Ndërkaq, procedura e shitjes së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar sipas dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, zhvillohet në mënyrë që, me propozim të Agjencisë, prokurori i shteti ose organi tjetër kompetent kërkon nga gjykata të vendos lidhur me shitjen e pasurisë së zëvendësueshme, që humbet vlerën në rast magazinimi apo kur shpenzimet e magazinimit janë jo proporcionale me vlerën e pasurisë së sekuestruar. Lidhur me kërkesën për shitjen e pasurisë, gjykata ka për detyrë që palët në procedurë, së bashku me Agjencinë, t'i njoftojë për vendimin e shitjes kurse procedura zhvillohet nga

⁴²⁶ Po aty, neni 269, paragrafi 3.

⁴²⁷ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani "Komentar – Botimi I Kodi i Procedurës Penale" publikuar nga Deutsch Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 708.

⁴²⁸ Ligji Nr. 03/L-141, 10 korrik 2009.

Agjencia pas pranimit të vendimit të gjykatës, në pajtim me ligjet në fuqi që rregullojnë shitjen e pasurisë.

Pas përfundimit të procedurës së shitjes së pasurisë, Agjencia është e detyruar që, në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, të mundësojë që shuma e parave të fituara me shitjen të zëvendësojë vlerën e pasurisë së shitur dhe njëherësh të informojë gjykatën e cila ka marrë vendim për shitjen e pasurisë⁴²⁹. Përveç kësaj, neni 9 i Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, i ngarkon Agjencisë në fjalë detyrime shtesë:

- Për të administruarçdo shumë e cila fitohet nga shitja e pasurisë së konfiskuar;
- Që të hyrat e realizuara nga shitja t'i deponojë në xhiro-llogarinë bankare të Agjencisë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës;
- Që në afat prej 15 ditësh të ekzekutoj vendimin e gjykatës ose të organit tjetër kompetent me të cilin është vendosur kthimi i pasurisë së palës në procedurë; dhe
- Mjetet nga shitja e pasurisë së konfiskuar, pas vendimit përfundimtar të gjykatës, t'i derdhë në Buxhetin e Kosovës⁴³⁰.

6.6.6.3. Kundërshtimet nga palët e treta dhe kundërshtimi nga i pandehuri

Vëmendje të posaçme Kodi i Procedurës Penale i kushton edhe krijimit të instrumenteve juridike për personat që kanë ndonjë të drejtë për masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, si dhe rregullon kundërshtimet nga i pandehuri.

6.6.6.4. Kundërshtimet nga palët e treta

Kështu, në nenin 270 të këtij Kodi personave të cilët kanë ndonjë të drejtë në ndërtesë, pasurinë e paluajtshme, pasurinë e luajtshme ose tek aseteve nga neni 268 paragrafi 4, iu është dhënë e drejta për të kundërshtuar masat e përkohshme të propozuara nga prokurori i shtetit. Kundërshtimi i masave të përkohshme sipas këtij paragrafi është shprehje e parimit kontradiktor dhe ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të personave që gëzojnë të drejta në sendet që janë objekt i sekuestrimit ose i konfiskimit⁴³¹.

⁴²⁹ Ligji për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, neni 9 paragrafi 1.

⁴³⁰ Po aty, paragrafët 2, 3 dhe 5 të nenit 9.

⁴³¹ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani "Komentar – Botimi Kodi i Procedurës Penale", publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 710.

Personi që kundërshton masën e përkohshme, kur pretendohet se ndërtesa, pasuria e paluajtshme dhe e luajtshme ose asetet janë përdorur në kryerjen e veprës penale, në kundërshtim duhet të vërtetojë se:

- ai nuk ka ditur ose nuk ka mundur të dijë për përdorimin e pasurisë në kryerjen e veprës penale;
- pasuria nuk ka mundur të përdoret prapë për veprën penale; dhe
- masa e përkohshme e propozuar do të dëmtonte në mënyrë të paarsyeshme të drejtat e personit që e kundërshton atë.

Kur pretendohet se ndërtesa, pasuria e paluajtshme apo e luajtshme ose aset i janë dori pasurore e fituar me vepër penale, me paragrafin 3 të këtij neni, personit i cili kundërshton masën e përkohshme i përcaktohen kushte plotësuese që kanë të bëjnë me vërtetimin se:

- ai ka pasur të drejtë pronësore tek sendet e sekuestruara për më shumë se gjashtë muaj para sekuestrimit të përkohshëm të pasurisë;
- ai ka paguar çmimin e tregut për të drejtën pronësore në ato sende dhe pasuri;
- ai ka qenë në padijeni për veprimet, të cilat kanë mbështetur veprën penale;
- i dyshuari ose i pandehuri nuk do të mund të shfrytëzonte, shkëmbente ose në ndonjë formë tjetër të siguronte qasje tek ndërtesa, pasuria e paluajtshme ose e luajtshme apo aset; dhe
- masa e përkohshme e propozuar do të dëmtonte në mënyrë të pajustificueshme të drejtat e personit që kundërshton atë.

Në kundërshtim ka mundësi që të kundërshtohet edhe saktësia e përshkrimit të ndërtesës, pasurisë së paluajtshme, pasurisë së luajtshme ose asetit të përfshirë në atë kërkesë⁴³². Nëse personi, i cili kundërshton kërkesën e prokurorit të shtetit për masën e përkohshme nuk arrin t'i argumentojë faktet negative të lartëpërmendura, mundësitë që gjykata të mos aprovoj kërkesën për masë të përkohshme, do të shtoheshindukshëm⁴³³.

Gjithashtu, personi i cili kundërshton kërkesën për masë të përkohshme, në kundërshtim mund të propozojë masë tjetër, përkatësisht të urdhërohet një masë e përkohshme më pak kufizuese ose të mos urdhërohet asnjë masë e përkohshme⁴³⁴.

⁴³² KPPRK, neni 270, paragrafi 5.

⁴³³ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani "Komentar – Botimi i Kodit të Procedurës Penale", publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 711.

⁴³⁴ KPPRK, neni 270, paragrafi 4.

6.6.6.5. Kundërshtimi nga i pandehuri

Lidhur me të drejtën e kundërshtimeve nga i pandehuri, në nenin 271 janë parashikuar arsyet për të cilat i pandehuri mund të kundërshtojë kërkesën për masë të përkohshme nga neni 268 i këtij Kodi. Në kundërshtim mund të kontestohen faktet lidhur me:

- saktësinë e përshkrimit të ndërtesës, sendit të paluajtshëm ose të luajtshëm apo asetit të përfshirë në kërkesë;
- dyshimin e bazuar se ndërtesa, sendet e paluajtshme, të luajtshme ose asetet janë rrjedhojë e veprës penale nën hetim apo janë përdorur ose kanë pasur qëllim që të përdoren në kryerjen e veprës penale;
- ekzistencën e gjasave të konsiderueshme se ndërtesa, sendet e paluajtshme, të luajtshme ose asetet nuk kanë mundësi të konfiskohen në përfundim të procedurës penale ose mund të përdoren në kryerjen e veprës penale nëse nuk do të merren masa të përkohshme; dhe
- atë nëse masat e përkohshme të propozuara nga prokurori i shtetit nga neni 269 i Kodit të Procedurës Penale janë të justifikueshme ose të nevojshme.

Procedura e vendosjes lidhur me kërkesën e prokurorit të shtetit për masë të përkohshme për sigurimin e pasurisë, është rregulluar me dispozitën e nenit 272 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë vlen vetëm për ato raste kur ndaj kërkesës për masë të përkohshme të sigurisë së pasurisë nuk është ushtruar fare kundërshtim nga palët e përcaktuara në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale. Në të vërtetë, gjyqtari i procedurës paraprake merr aktvendim mbi kërkesën për masë të përkohshme të paraqitur nga prokurori i shtetit sipas nenit 273 të këtij Kodi nëse gjykata nuk pranon kundërshtimin brenda 14 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës nga personat që kanë të drejtë në kundërshtim. Do të konsiderohet se nuk është paraqitur kundërshtim,⁴³⁵ përkatësisht se gjykata nuk ka pranuar kundërshtim edhe në rastet: kur kundërshtimi paraqitet ndërsa gjykata e hedh kundërshtimin si të parregullt, sepse është paraqitur nga personat e paautorizuar, ose nëse është paraqitur jashtë afatit (14 ditë) të përcaktuar me këtë Kod. Gjyqtari i procedurës paraprake, në rastin kur brenda 14 ditëve nga paraqitja e kërkesës pranon kundërshtim nga palët e autorizuar (nga i pandehuri ose nga palët e treta), mund të lëshojë urdhër me shkrim, mbështetur në nenin 273 të Kodit të Procedurës Penale pa mbajtur shqyrtimin. Ndërkaq nëse gjyqtari i procedurës paraprake lidhur me kërkesën për masë të përkohshme vendos ta shqyrtojë atë para se të urdhërojë masën e përkohshme,

⁴³⁵Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani “Komentar – Botim - Kodi i Procedurës Penale”, publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 713.

nëse i pandehuri ose pala e tretë ka ngritur çështje faktike që kërkojnë marrjen e provave dhe sqarimin e fakteve, atëherë lëshimi i urdhërit nga gjyqtari i procedurës paraprake bëhet pas mbajtjes së shqyrtimit.⁴³⁶ Vlen të theksohet, se me këtë dispozitë zgjidhen dilemat e mundshme në praktikën gjyqësore se kur mund të vendoset lidhur me kërkesën për masë të përkohshme pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor dhe kur mund të lëshohet urdhëri për masë të përkohshme pas mbajtjes së shqyrtimit. Në të vërtetë, për të urdhëruar masën e përkohshme sipas nenit 273 të Kodit të Procedurës Penale, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor apo pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, para së gjithash duhet mbështetur nga vetë përmbajtja e kundërshtimit e paraqitur nga palët e treta ose nga i pandehuri. Kështu, nëse në kundërshtimin e paraqitur nga palët e treta ose nga i pandehuri ngriten çështje faktike që kërkojnë marrjen e provave dhe sqarimin e fakteve, atëherë gjyqtari i procedurës paraprake mund ta caktojë shqyrtimin gjyqësor para se të urdhërojë masën e përkohshme nga neni 273 i këtij Kodi. Në të kundërtën, gjykata, kurrë kundërshtim nuk janë ngritur çështje faktike të cilat kërkojnë marrjen e provave dhe shqyrtimin gjyqësor të fakteve, vendos për masën e përkohshme pa mbajtur shqyrtim gjyqësor.

6.6.6.6. Urdhri për masë të përkohshme

Urdhrin për masën e përkohshme të sigurimit të pasurisë, si lloj i vendimit gjyqësor, e nxjerr gjyqtari i procedurës paraprake në pajtim me procedurën, formën dhe përmbajtjen e përcaktuar me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale. Kjo do të thotë se masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë e vendos me *urdhër për masa të përkohshme*⁴³⁷ gjyqtari i procedurës paraprake duke urdhëruar, ndryshuar ose refuzuar kërkesën për masën e përkohshme të paraqitur nga prokurori i shtetit sipas nenit 268 të Kodit të Procedurës Penale.

Këto masa i vendos me urdhër prokurori i shtetit, në shqyrtim ose pa mbajtur shqyrtimin. Në rastin kur gjyqtari i procedurës paraprake e aprovon kërkesën për masën e përkohshme, prokurori i shtetit urdhëron kryerjen e saj, ndërsa kur gjyqtari e refuzon kërkesën për masë të përkohshme, prokurori urdhëron që pasuria e pronarit ose e poseduesit të lirohet.⁴³⁸

Në këtë nen është parashikuar shprehimisht përmbajtja e urdhërit për masën e përkohshme me të cilën urdhërohet ose ndryshohet masa e përkohshme, si dhe përmbajtja e urdhërit kur refuzohet masa e përkohshme e kërkuar nga prokurori i shtetit. Kështu, sipas paragrafit 2 të

⁴³⁶ KPPRK, neni 272, paragrafi 3.

⁴³⁷ Po aty, neni 273.

⁴³⁸ Po aty, paragrafi 3.

nenit 273 të Kodit të Procedurës Penale, urdhëri i gjyqtarit nga paragrafi 1 i këtij neni, me të cilin urdhërohet ose ndryshohet masa e përkohshme, kërkohet nga prokurori i shtetit sipas neni 268 të Kodit të Procedurës Penale dhe duhet të përmbajë këto elemente:

- a) ndërtesën, pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme ose aset in që është objekt i kërkesës;
- b) dyshimin e bazuar se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose asetet janë rrjedhojë e veprës penale nën hetim apo janë përdorur ose kanë pasur për qëllim të përdoren në kryerjen e veprës penale;
- c) nëse ka gjasa të konsiderueshme që ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme apo aset in nuk do mund të konfiskohen në përfundim të procedurës penale ose do të përdoren në kryerjen e veprës penale nëse nuk merren masa mbrojtëse;
- d) masën e përkohshme nga neni 269 i këtij Kodi që duhet zbatuar;
- e) arsyetimin për refuzimin e kundërshtimeve të pranuar nga neni 270 ose 271 i këtij Kodi, ose arsyetimin për ndryshimin e masës së përkohshme në bazë të atyre kundërshtimeve;
- f) mund të përcaktojë një afat të arsyeshëm për masën e përkohshme.

Ndërkaq, urdhëri me të cilin refuzohet masa e përkohshme e kërkuar nga prokurori i shtetit sipas neni 268 të këtij Kodi urdhëron që pronarit apo poseduesit t'iu lirohet pasuria⁴³⁹. Urdhëri i dërgohet Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, e cila ekzekuton urdhërin brenda 15 ditëve nga lëshimi i urdhërit, përveç nëse paraqitet ankesë nga paragrafi 4 i këtij neni (*paragrafi 4 që përdor si mjet ankesën dhe jo kundërshtimin, nuk e ka të rregulluar afatin për paraqitjen e kundërshtimit/ankesës*). Edhe nënparagrafi 2.7 të paragrafit 2 të këtij neni ku është përcaktuar se urdhëri i dërgohet Agjencisë brenda 10 ditëve është i diskutueshëm. Ç'ndodh nëse nuk dërgohet në këtë afat, çfarë ndodh me urdhërin?).

Në paragrafin 4 të neni 273 është përcaktuar mjete juridik, përkatësisht e drejta e palëve për ta kundërshtuar urdhërin e gjykatës lidhur me masën e përkohshme. Kundërshtimi ka karakter devolutiv dhe e pezullon ekzekutimin e urdhrit nga neni 273 deri në marrjen e aktvendimit nga kolegji shqyrtues.

Dipozitat që i referohen kësaj mase të përkohshme, do duhej rishikuar nga ligjvënësi, me qëllim të caktimit të një afati kohor të arsyeshëm për zbatim, e jo të varet nga përfshirja në aktakuzë e kësaj pasurie të konfiskuar përkohësisht.

⁴³⁹ Po aty.

6.6.7. Procedurat e konfiskimit të dobisë pasurore pas ngritjes së aktakuzës.

Përfshirja në aktakuzë e pasurisë që është objekt i konfiskimit.

Aktakuza është akt formal, përmbajtja e të cilës përcaktohet taksativisht me ligj.⁴⁴⁰ Në grupin e elementëve të domosdoshëm të aktakuzës bën pjesë edhe paracaktimi me saktësi i çdo ndërtese, pasurie të paluajtshme, pasurie të luajtshme, fonde ose pasuri të tjera që mund t'i nënshtrohen konfiskimit. Në aktakuzë, gjithashtu përshkruhen provat e nevojshme që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin nga Kapitulli XVIII⁴⁴¹. Në këtë kontekst, në praktikë mund të ndodhë që ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset i që është objekt i urdhrit nga neni 273 ose i urdhrit për ndalim afatgjatë nga neni 266 të Kodit të Procedurës Penale të mos jetë përfshirë në përmbajtjen e aktakuzës në pajtim me nenin 241, paragrafi 1, nënparagrafi 1.9 të Kodit të Procedurës Penale, para shqyrtimit të dytë. Në raste të tilla, kur aktakuzës i mungon ky element i domosdoshëm, pra i mungon përcaktimi me saktësi i çdo ndërtese, pasurie të paluajtshme, pasurie të luajtshme, aset apo pasuri të tjera që mund t'i nënshtrohen konfiskimit si edhe provat e domosdoshme që e justifikojnë konfiskimin, atëherë pronari ose poseduesi mund t'i paraqesë kërkesë gjyqtarit të vetëm gjykues për t'i liruar pasurinë që ka në pronësi ose e posedon. Arsyeja kryesore e nevojës për të përfshirë në aktakuzë pasuritë në të cilat i akuzuari ka të drejta pronësi edhe që mund t'i nënshtrohen konfiskimit lidhet me faktin se prokurori i shtetit ka detyrimin dhe njëherësh do të bëjë përpjekje para gjykatës për të provuar se pasuri të tilla duhet të konfiskohen. Në të kundërtën, nëse këto pasuri nuk përfshihen në aktakuzë, ato duhet t'i kthehen të akuzuarit. Kështu, neni 274 i Kodit të Procedurës Civile, në paragrafet 2-5 të tij përcakton veprimet e gjykatës në rastet e pasurive të luajtshme, të paluajtshme, aseteve ose pronave të tjera si më poshtë:

- nëse ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset i që është objekt i urdhrit nga neni 273 ose i urdhrit për ndalim afatgjatë nga neni 266 i këtij Kodi është objekt i ndonjë procedure tjetër ligjore të konfiskimit⁴⁴², ose nevojitet si provë në shqyrtim gjyqësor⁴⁴³, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues refuzon kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni;
- nëse ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset i që është objekt i urdhrit nga neni 273 ose i urdhrit për ndalim afatgjatë nga neni 266 i këtij Kodi

⁴⁴⁰ Shih: neni 241 dhe 243 të Kodit të Procedurës Penale.

⁴⁴¹ Shih: nenin 241 paragrafi 1 nënparagrafi 1.9 i Kodit të Procedurës Penale.

⁴⁴² KPPRK, neni 274, paragrafi 2.

⁴⁴³ Po aty, paragrafi 3.

mund të ceket në aktakuzën e pangritur ende, prokurori i shtetit njofton gjyqtarin e vetëm gjykues ose kryetarin e trupit gjykues, të cilët këta kanë autorizim që të pezullojnë kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni, por i lejon paraqitësit të kërkesës që të ripërtërijë kërkesën pas 6 muajve nëse nuk ngritet aktakuzë tjetër⁴⁴⁴;

- nëse nuk ngritet aktakuzë tjetër dhe paraqitësi i kërkesës ripërtërin kërkesën pas 6 muajve, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nxjerr urdher nga paragrafi 6 i këtij neni, ndërsa prokurori i shtetit mund të kërkojë vazhdimin prej 3 muajsh vetëm në rrethana të jashtëzakonshme⁴⁴⁵.

Teksa në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet e drejta e pronarit apo poseduesit për të kërkuar lirimin e pasurisë dhe në paragrafet 2, 3 dhe 4 autorizimi i gjykatës për të refuzuar ose pezulluar kërkesën për lirim të pasurisë, në paragrafin 6 të nenit 274 përcaktohen shprehimisht rastet në të cilat gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues miraton kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni. Kjo do të thotë se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues miraton kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni pasi të ketë vërtetuar se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset, që janë objekt i urdhrit nga neni 273 ose i urdhrit për ndalim afatgjatë nga neni 266 të Kodit të Procedurës Penale nuk janë përfshirë në përmbajtjen e aktakuzës në pajtim me nenin 241, nënparagrafi 1.9 të Kodit të Procedurës Penale. Ky nen lejon paraqitjen e ankesës, e cila nuk e zvarrit procedurën penale ose ekzekutimin e urdhrit, çka do të thotë, se ankesa e paraqitur nuk ka efekt devolutiv juridik.

Sipas dispozitës së nenit 275 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori i shtetit, para se gjykata të lëshojë urdherin përfundimtar për të konfiskuar sendet që janë objekt i konfiskimit detyrohet që në aktakuzë, por edhe në shqyrtim gjyqësor të paraqesë prova me të cilat do të provohet se ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset kanë qenë dobi pasurore e fituar me vepër penale. Kjo do të thotë se, në aktakuzë jo vetëm që precizohet çdo ndërtesë, pasuri e paluajtshme, pasuri e luajtshme ose aset që mund t'i nënshtrohen konfiskimit, por njëkohësisht paraqiten edhe provat e nevojshme të cilat argumentojnë nevojën për konfiskim. Në procedurën e të provuarit, prokurori i shtetit, i

⁴⁴⁴ Po aty, paragrafi 4.

⁴⁴⁵ Po aty, paragrafi 5.

dëmtuari ose i pandehuri gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të marrin në pyetje dëshmitarë dhe të paraqesin prova për të mbështetur ose kundërshtuar provat.⁴⁴⁶

Kodi i Procedurës Penale përcakton në mënyrë eksplicite kriteret nëpërmjet të cilave vlerësohet nëse një send është dobë pasurore e fituar me anë të veprës penale.

Kështu, sipas paragrafëve 1-4 të nenit 276 të Kodit të Procedurës penale dobë pasurore:

- është çdo ndërtesë, pasuri e paluajtshme, pasuri e luajtshme ose aset që është fituar drejtpërdrejt nëpërmjet veprimeve që përbëjnë vepër penale;
- janë mjetet e përfituara drejtpërdrejt si rezultat i veprimeve që përbëjnë vepër penale;
- është ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset i blerë me mjetet e përfituara drejtpërdrejt nga veprimet që përbëjnë vepër penale;
- janë mjetet e përfituara në mënyrë indirekte si rezultat i veprimeve që përbëjnë vepër
- penale, përfshirë interesin, fitimin bruto, ose rritjen nga kursi i këmbimor valutor;
- është ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset i blerë me mjetet e përfituara në mënyrë indirekte në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni⁴⁴⁷.

6.6.7.1. Llogaritja e dobisë pasurore dhe dobë pasurore nga vepra penale që gjendet në posedim të palës së tretë.

Kodi i Procedurës Penale, disa situatave specifike si për shembull llogaritjes së dobisë pasurore të fituar me vepër penale, të përziera me mjete që nuk janë dobë pasurore e veprës penale dhe dobisë pasurore nga vepra penale që gjendet në posedim të palës së tretë, i kushton vëmendje të veçantë. Kështu, kur mjetet të cilat janë dobë pasurore e veprës penale përzihen me mjete që nuk janë dobë pasurore e veprës penale, sipas nenit 277 të këtij Kodi, llogaritja e dobisë pasurore bëhet duke u zbatuar rregulla se çdo shumë që është e mundshme për konfiskim dhe e cila është e barabartë ose më e ulët se shuma e dobisë pasurore konsiderohet si dobë pasurore⁴⁴⁸. Në një rast të tillë, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, për llogaritjen e dobisë pasurore mbështeten në rregullat e kontabilitetit dhe provat që kanë në dispozicion për të përcaktuar një vlerësim të arsyeshëm të shumës së

⁴⁴⁶Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani “Komentar – Botim-Kodi i Procedurës Penale”, publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 720-721.

⁴⁴⁷ KPPRK, neni 276, paragrafi 5.

⁴⁴⁸ Po aty, neni 277.

dobisë pasurore të veprës penale.⁴⁴⁹ Situata të tilla kemi kur i pandehuri një shumë të caktuar të të hollave të marra, p.sh nga mitoja, e deponon në xhirollogarinë bankare, në të cilën paraprakisht ka pasur mjete tjera të pastra të cilat nuk kanë qenë rezultat i veprës penale. Në këtë rast, është e qartë se bëhet fjalë për përzierje të mjeteve të pista me mjetet e pastra. Dobia pasurore përkatëse në shumën e caktuar të mjeteve sipas rregullës së përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 277 të këtij Kodi, duhet të konfiskohet pa marrë parasysh sa herë i pandehuri ka tërhequr mjetet të cilat përbëjnë dobinë pasurore dhe ka deponuar mjetet të cilat nuk përbëjnë dobinë pasurore të fituar me vepër penale. Sigurisht, në të gjitha këto raste duhet të jetë aktiv angazhimi i prokurorit të shtetit në drejtim të urdhërit të ngrirjes së mjeteve në këto xhirollogari për të siguruar konfiskimin e dobisë pasurore deri në shumën e cila përbën dobinë pasurore të fituar me vepër penale⁴⁵⁰.

6.6.7.2 Dobia pasurore nga vepra penale që gjendet në posedim të palës së tretë

Sipas Kodit të Procedurës Penale, një pasuri mund të konfiskohet edhe në rastet kur formalisht nuk është në pronësi të të pandehurit por mbahet nga një person tjetër. Kjo merret në konsideratë në rastet kur personi tjetër është pjesëmarrës në veprën penale ose në shpëlarjen e pasurisë e cila duhet të konfiskohet. Mirëpo jo gjithëherë pasuria e cila i kalohet personit të tretë konfiskohet, sidomos kjo ndodh në rastet kur pasuria është bartur te personi tjetër me mirëbesim⁴⁵¹ dhe kur blerësi ka paguar çmimin e tregut dhe më pas ka marrë kontrollin e plotë mbi atë pasuri. Për këtë arsye, pragrafi 1 i nenit 278 të këtij Kodi, duke rregulluar kushtet e konfiskimit të dobisë pasurore të dalë nga vepra penale dhe që gjendet në posedim të personave të tretë, ka parashikuar rastet e konfiskimit të të ardhurave nga vepra penale kur këto i kalohen personit tjetër. Kështu, në paragrafin 1 të këtij neni, kur të ardhurat nga vepra penale i kalohen personit tjetër, organizatës afariste ose personit juridik para se të bëhet konfiskimi, këto të ardhura konfiskohen nëse plotësohen këto kushte:

- nëse të ardhurat nga vepra penale janë kaluar nga posedimi i të pandehurit;
- nëse kalimi i të ardhurave nga vepra penale ka qenë për një shumë substancialisht më të ulët se sa çmimi real i tregut; dhe

⁴⁴⁹ Po aty, paragrafi 2.

⁴⁵⁰ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani “Komentar – Botim - Kodi i Procedurës Penale”, publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 724.

⁴⁵¹ KPRK, neni 97 paragrafi 2 dhe Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, neni 5 paragrafi 4.

- nëse ka prova se i pandehuri ende kontrollon ose shfrytëzon të ardhurat nga vepra penale.

Konfiskimi ka mundësi të urdhërohet edhe në rastet kur të ardhurat nga vepra penale janë në posedim të ndonjë personi tjetër, organizate afariste apo personi juridik, por për këtë duhet të përmbushen këto kushte⁴⁵²:

- personi, organizata afariste ose personi juridik ka siguruar posedimin e të ardhurave nga vepra penale si rezultat i drejtpërdrejtë i veprës penale;
- ka prova se i pandehuri kontrollon ose shfrytëzon të ardhurat nga vepra penale ose mban kontrollin mbi organizatën afariste ose personin juridik.

Sipas Kodit të Procedurës Penale⁴⁵³ palët e treta, të cilat posedojnë dobinë pasurore nga vepra penale gëzojnë të drejta të caktuara. Këto të drejta janë përcaktuar varësisht nga fakti se për cilat palë të treta bëhet fjalë. Në rastin kur shqyrtohet konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale personi të cilit i është kaluar dobia pasurore si dhe përfaqësuesi i organizatës afariste ose personi juridik thirren për t’u marrë në pyetje gjatë hetimit dhe në shqyrtim gjyqësor. Këta persona sipas rregullit thirren për t’u marrë në pyetje gjatë hetimit dhe në shqyrtim gjyqësor, që përkon me shqiptimin e masës për konfiskimin e dobisë pasurore për të cilën nuk ka prezumim të domosdoshëm procedural⁴⁵⁴. Kjo nënkupton se marrja në pyetje e këtyre personave paraqet një mundësi që iu jepet këtyre personave për t’u deklaruar lidhur me dobinë pasurore të bartur tek ta nga i pandehuri dhe e cila mund të konfiskohet. Kjo zgjidhje vjen në shprehje vetëm në rastet kur personi në fjalë nuk e ka cilësinë e dëshmitarit. Kur personi e ka cilësinë e dëshmitarit, atëherë zbatohen rregullat e përgjithshme të thirrjes dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve.⁴⁵⁵ Lidhur me të drejtat e palës së tretë që posedon dobinë pasurore nga vepra penale vlen të përmenden të drejtat e parashikuara sipas paragrafit 2, 3 dhe 4 të nenit 279 të këtij Kodi. Kështu:

- përfaqësuesi i organizatës afariste ose personi juridik në shqyrtimin gjyqësor merret në pyetje pas të akuzuarit;
- personi, të cilit i është kaluar dobia pasurore dhe përfaqësuesi i organizatës afariste ose personi juridik kanë të drejtë të propozojë marrjen e provave për përcaktimin e

⁴⁵² KPPRK, neni 278, paragrafi 2.

⁴⁵³ Po aty, neni 279.

⁴⁵⁴ Sipas paragrafit 1 të nenit 279 të Kodit të Procedurës Penale është përcaktuar se: “Në thirrje paralajmërohet se procedura mund të zbatohet edhe pa praninë e tij”.

⁴⁵⁵ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani “Komentar – Botim i Kodit të Procedurës Penale”, publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 726.

dobisë pasurore, ose me lejen e gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues, t'i bëjnë pyetje të pandehurit, dëshmitarëve dhe ekspertëve;

- në rastet e përjashtimit të publikut nga shqyrtimi gjyqësor, përjashtimi i tillë nuk vlen për personin në të cilin ka kaluar dobia pasurore dhe përfaqësuesin e ndërmarrjes afariste ose personin tjetër juridik.

Në procedurën për palën e tretë që posedon dobinë pasurore nga vepra penale, gjykata me vendime mund të shqiptojë konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale. Vendimet⁴⁵⁶ me të cilat mund të shqiptohet kjo masë janë:

- aktgjykimi me të cilin i akuzuari shpallet fajtor;
- aktgjykimi mbi vërejtjen gjyqësore; si dhe
- aktvendimi me të cilin shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitimin e kryerësve të veprave penale të varur na alkoli ose droga.

Në dispozitivin e aktgjykimit ose të aktvendimit, gjykata është e obliguar të përcaktojë shumën e parave apo sendin e konfiskuar. Kur gjykata vlerëson se ekzistojnë shkaqe të justifikueshme, mund të lejojë pagesën me këste të dobisë pasurore të fituar nga veprat penale dhe cakton afatin e pagesës dhe shumën e saj. Gjykata, një kopje të aktgjykimit dhe aktvendimit, ia dërgon edhe personit në të cilin ka kaluar dobia pasurore dhe përfaqësuesit të organizatës afariste ose personit tjetër juridik,⁴⁵⁷ të cilët, sipas nenit 381, paragrafi 4 i këtij Kodi, kanë të drejtë të ushtrojnë mjetin e rregullt juridik, përkatësisht ndaj aktgjykimit ose aktvendimit.

Vlen të theksohet se në këtë rast, ndaj vendimit gjyqësor me të cilin është shqiptuar masa e konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale zbatohen dispozitat që vlejnë për ankesën kundër aktgjykimit, edhe pse në Kodin e Procedurës Penale në fuqi, në pjesën e konfiskimit, është hequr dispozita me të cilën përcaktohet shprehimisht zbatimi i dispozitave që kanë të bëjnë me ankesën si mjet i rregullt juridik kundër aktgjykimit.

Kjo dispozitë dallon nga ajo e Kodit të mëparshëm të Procedurës Penale, i cili ankesën ndaj aktgjykimit e ka parashikuar me dispozitë të veçantë, përkatësisht me nenin 496. Gjithashtu, Kodi ekzistues nuk parashikon mjete juridike të jashtëzakonshme, si në Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale, i cili me nenin 495 parashikonte si mjet juridik të jashtëzakonshëm kërkesën për rishikim të procedurës penale duke i lejuar kështu personit në të cilin ka kaluar dobia pasurore edhe përfaqësuesit të organizatës afariste ose personit tjetër juridik, të drejtën ta përdorin këtë mjet.

⁴⁵⁶ KPPRK, neni 280, paragrafi 1.

⁴⁵⁷ Po aty, paragrafi 3.

6.6.7.3 Konfiskimi i dobisë pasurore pa ekzistencën e aktgjykit penal

Fjala është për standardin që, nëse nuk janë plotësuar kushtet për zhvillimin e procedurës penale për shkak të vdekjes ose mungesës (arratisë) së të dyshuarit, apo rrethanave tjera që përjashtojnë ndjekjen penale ose në kushtet e dhënies së imunitetit, mund të zhvillohet një procedurë e veçantë për konfiskimin e dobisë së tillë (eng. Confiscation Without a Criminal Conviction), sakohë ekzistojnë bazat e dyshimit se me kryerjen e veprës penale është përfituar dobi pasurore. Në disa marrëveshje ndërkombëtare⁴⁵⁸ është parashikuar ky detyrim.

Në rekomandimet e FATF (Rekomandimi nr. 3) sygjerohet konfiskimi i dobisë pasurore edhe pa ekzistencën e aktgjykit penal (personit i është dhënë imuniteti), ndërsa në Direktivën e re të Unionit Evropian⁴⁵⁹, vendoset standardi i detyrueshëm “mungesa e dënimit penal” me zgjerimin e zbatimit të masës së konfiskimit të dobisë pasurore nën aktivitetin kriminal të supozuar. Direktiva vendos standardin minimal në parimet themelore dhe deklarohet se:

- a) pasuria e prejardhjes jo ligjore duhet të jetë objekt i konfiskimit; dhe
- b) ky parim duhet zbatuar si standard minimal të paktën në rrethanat specifike (sëmundje e përhershme që pengon ndjekjen momentale penale ose cilëndo ndjekje të ardhshme penale të të akuzuarit, sëmundja ose arratisja nga ndjekja penale apo vuajtja e dënimit pengon ndjekjen efektive penale, ose kur ndjekja efikase është pamundësuar me paraqitjen e parshkrimit për shkak të sëmundjes ose arratisjes, për shkak të vdekjes së të dyshuarit ose të akuzuarit, nëse personit i është dhënë imunitet apo ndjekja penale është e pamundshme për shkak të miturisë).

Mënyra e realizimit⁴⁶⁰ të këtij qëllimi është lënë në vlerësimin e vendeve të Unionit, të cilat e mund të nxjerrin dispozita për konfiskimin e pasurisë pa aktgjykim gjyqësor ose me vendim të ndonjë gjykate tjetër. Kështu Suedia, përderisa ishte kryesuese e shteteve të BE-së, ka inicuar që edhe në këtë dokument standardi minimal të rritet në konfiskimin civil të pasurisë.

Kurse në Kosovë, në bazë të Kodit të Procedurës Penale, dobia pasurore e fituar me anë të veprës penale konfiskohet me aktgjykimin që shpall fajtor të akuzuarin⁴⁶¹.

⁴⁵⁸P.sh, Konventa e KB-së për luftën kundër korrupsionit - Konventa e Nju Jorkut, neni 54 paragrafi 1c.

⁴⁵⁹ Më 13 mars 2012 KE i ka dërguar për miratim Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Europës Propozimin e Direktivës për konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskim të mjeteve të përfituara me vepër penale në BE, propozim që është miratuar në 3 Maj 2014.

⁴⁶⁰ Shih: Govedarica, M., Oduzimanje imovine stečene izvršenjem krivičnog djela (preventivni-represivni aspekt), Visoka škola unutrašnjih poslova, Banja Luka 2013, 51–52.

⁴⁶¹ KPPRK, neni 365 paragrafi 4.

Lidhur me dobinë pasurore që rezulton nga veprimet korruptive, Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar se konfiskimi mund të bëhet edhe pa aktgjykim. Në të vërtetë, sipas paragrafit 1 të nenit 281 të këtij Kodi është parashikuar, se sendet e fituara me vepër penale mund të konfiskohen edhe nëse procedura penale nuk përfundon me aktgjykim. Kodi i Procedurës Penale, neni 281 parashikon se mund të konfiskohen sendet e fituara me vepër penale nga neni 344 i Kodit Penal dhe marrja ose dhënia e kundërligjshme e shpërblimit, dhuratës ose përfitimit nga nenet 214, 314, 315, 428, 429, 430 dhe 431 të Kodit Penal⁴⁶², të cilat kanë të bëjnë me veprat penale të blerjes, pranimi ose fshehjes së sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345, keqpërdorimit të detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve nga neni 214, dhënies ose marrjes së rryshfetit në lidhje me votimin nga neni 215, pranimi të paarsyeshëm të dhuratave nga neni 315, marrjes së rryshfetit nga neni 428, dhënies së rryshfetit nga neni 429, dhënies së rryshfetit për zyrtarit publik të huaj nga neni 430 dhe ushtrimit të ndikimit nga neni 431.

Sendet e fituara me anë të kryerjes së veprave penale të lartëtheksuara gjykata mund t'i konfiskojë vetëm nëse janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 281 paragrafi 1.1 dhe 1.2 të këtij Kodi. Sipas kërkesës së arsyetuar të prokurorit të shtetit, gjykata vendos me aktvendim konfiskimin e sendeve të fituara me veprat penale të theksuara. Kopjen e aktvendimit të posaçëm, me të cilin është vendosur për konfiskimin e sendit, gjykata ia dërgon pranarit të parave ose pasurisë së konfiskuar, në qoftë se pronari është i njohur për gjykatën, në të kundërtën aktvendimi shpallet në stendën e gjykatës dhe pas 8 ditëve konsiderohet se i është dorëzuar pronarit të panjohur. Kundër aktvendimit të tillë, pronarët e parave ose të pasurisë së konfiskuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë nëse konstatojnë se aktvendimi i tillë nuk ka bazë ligjore për konfiskim⁴⁶³.

⁴⁶² Po aty, neni 281.

⁴⁶³ Po aty, paragrafi 3 dhe 4.

6.6.7.4 Pasuria që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit

Neni 281 i Kodit të Procedurës Penale ka përcaktuar kushtet për konfiskimin e pasurisë që rezulton e fituar nga veprimet korruptive dhe mundësinë e konfiskimit të sendeve të fituara me vepër penale edhe kur procedura nuk përfundon me aktgjykim fajësie, ndërsa po ky Kod ka përcaktuar me dispozitë të veçantë⁴⁶⁴ edhe rastin kur pasuritë i nënshtrohen automatikisht konfiskimit.

Ky institut juridik është risi në Kodin e Procedurës tonë Penale. Sipas paragrafit 1 të këtij neni përcaktohet në mënyrë decitive se çdo pasuri që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme konfiskohet automatikisht, pa marrë parasysh nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose trupit gjykues ka vërtetuar fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit. Ky nen përcakton gjithashtu në mënyrë taksative se cila pasuri dhe nga cilat vepra penale nga Kodi Penal përfshihen, e thënë ndryshe, ky nen përcakton se cilat konfiskime kryhen automatikisht dhe kur poseduesit, shfrytëzuesit ose të pandehurit i kufizohet shfrytëzimi i të drejtës së ankesës⁴⁶⁵.

Neni 282 i jep rëndësi edhe çështjes së veprimit me pasurinë që është qenësisht e rrezikshme ose e paligjshme. Kështu, në qoftë se këto sende mund të shfrytëzohen si provë në shqyrtim gjyqësor, ato shkatërrohen ose, kur ka mundësi sigurohen. Po ky nen përcakton se gjatë shqyrtimit gjyqësor, fotografitë, testet laboratorike ose ekspertiza shërbejnë si prova të pranueshme për ekzistencën, identitetin dhe përbërjen e mjetit qenësisht të rrezikshëm. Ndërkaq, për kimikatet, sendet, substancat, pajisjet ose armët që janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet e parashikuara në nënparagrafin 2.2 deri 2.5 të këtij neni ruhet një mostër e vogël. Në të vërtetë, veprimet lidhur me shkatërrimin e sendeve ose sigurimin e tyre kur ato mund të shërbejnë si provë në procedurën penale nga paragrafi 3 i këtij neni janë tejet të ndërlikuara dhe, zakonisht, mund të kryhen me ndihmën e ndonjë institucioni profesional dhe për këtë arsye ligjdhënsi ka parashikuar organin mbikëqyrës të këtyre veprimeve. Kështu, sipas paragrafit 5 të këtij

⁴⁶⁴ Po aty, neni 282.

⁴⁶⁵ Sipas paragrafit 2 të nenit 282 të Kodit të Procedurës Penale, në grupin e këtyre veprave penale bëjnë pjesë:

1) armët të cilat janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet 371 deri 376 të Kodit Penal; 2) kimikatet, sendet, substancat, pajisjet ose armët që janë krijuar apo përdorur në veprën penale nga nenet 121, 122, 124, 125, 127- 129, 135-140, 143, 144, 147 - 163, 172 - 176 të Kodit Penal; 3) kimikatet ose substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 262 - 266, 269, 270, 346 - 348, 350, 353 - 355 të Kodit Penal, si dhe kafshët, të lashtat, ushqimi apo uji i kontaminuar me vepër penale; 4) kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 272-280 të Kodit Penal; 5) paratë apo sendet e falsifikuara të krijuara apo të përdorura në veprën penale nga neni 292, 293, 301, 303 i Kodit Penal.

neni mbikëqyrjen e këtyre veprimeve e bën policia, e cila për veprimet e ndërmarra njofton brenda 24 orëve nga nisja e tyre prokurorin e shtetit.

Por Kodi i Procedurës Penale deklarohet se askush nuk mund të privohet nga posedimi i pasurisë së tij pa pasur prova të mjaftueshme në shqyrtim gjyqësor. Duke patur parasysh nenin 241 paragrafi 1.9, sipas të cilit në aktakuzë përcaktohen me saktësi pasuritë që i nënshtrohen konfiskimit si dhe provat të cilat kërkohen për të arsyetuar konfiskimin, si dhe nenin 365 paragrafi 1.4, sipas të cilit në aktgjykimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, ndër të tjera shënohet urdhri për konfiskimin e dobisë pasurore, ligjdhënësi në nenin 283 të Kodit të Procedurës Penale ka përcaktuar disa veprime lidhur me provat që janë evidentuar për konfiskimin në aktakuzë, të cilat gjykata duhet t'i analizojë para se të japë urdhërin përfundimtar për konfiskimin e pasurisë. Sipas këtij neni, përpara se gjykata të lëshojë urdhrin përfundimtar për konfiskimin e pasurisë së përcaktuar në aktakuzë, prokurori i shtetit është i obliguar që në shqyrtimin gjyqësor të provojë se pasuria (ndërtesat, sendi i luajtshëm ose i paluajtshëm ose aseti janë përdorur në kryerjen e veprës penale). Mënyrat e përdorimit të sendeve që janë objekt i konfiskimit në kryerjen e veprës penale janë përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, varësisht nga objekti i përdorimit në veprën penale⁴⁶⁶. Dilemat e mundshme në qoftë se një send është përdorur për kryerjen e veprës penale mund të tejkalohen në mbështetje të zgjidhjes që ofrohet në këtë nen, në nënparagrafin 2.4, e që duhet konsideruar se ndërtesa, sendi i paluajtshëm, sendi i luajtshëm ose aseti është i nevojshëm për lehtësimin e veprimit kriminal në ato raste kur vepra penale nuk do të ishte kryer po të mos ishte përdorur ato (ndërtesa, sendi i paluajtshëm, sendi i luajtshëm ose aseti)⁴⁶⁷.

Prokurori i shtetit, të dëmtuarit dhe të pandehurit janë të autorizuar që, për të mbështetur ose kundërshtuar në shqyrtimin gjyqësor faktin, mund të marrin në pyetje dëshmitarë, nëse sendi i cili është objekt i konfiskimit, është përdorur në kryerjen e veprës penale. Gjithashtu, përpos dëshmitarëve, gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të merret në pyetje edhe

⁴⁶⁶Në paragrafin 2 të nenit 283 të Kodit të Procedurës Penale është paraparë se *për qëllim të këtij neni, ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aseti është përdorur në veprën penale: 2.1 është përdorur drejtpërdrejtë për kryerjen e veprimit në mbështetje të veprës penale; 2.2 ka ofruar strehimin e nevojshëm për kryerjen e veprimit në mbështetje të veprës penale; 2.3 është përdorur për financimin e veprimit apo veprimeve në mbështetje të veprës penale; 2.4 është i nevojshëm për të lehtësuar veprimin në mbështetje të veprës penale*”.

⁴⁶⁷ Shih: Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani “Komentar – Botim - Kodi i Procedurës Penale” i publikuar nga Deutsch Gesellschaft fur Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, Prishtinë, fq. 734.

eksperti⁴⁶⁸ si dhe duhen shqyrtuar të gjitha provat e tjera përpara se gjykata të japë urdhrin përfundimtar lidhur me sendet që janë objekt i konfiskimit të pasurisë. Lidhur me këtë, eksperti financiar i kualifikuar në analizën financiare nga neni 148 i këtij Kodi, por edhe gjatë dëshmisë në shqyrtimin gjyqësor mund të shprehë mendimin e tij se ndërtesa, sendi i paluajtshëm, sendi i luajtshëm ose aset i përcaktuar në aktakuzë është rrjedhojë e veprës penale për të cilën është zhvilluar hetimi.

6.6.7.5. Urdhëri për konfiskimin e pasurisë

Veprimet me të cilat sigurohen provat dhe sendet që shërbejnë për vërtetimin e fakteve, përkatësisht të provuarit në procedurën penale, si bastisja e banesës, të lokaleve tjera dhe të sendeve të luajtshme, përkatësisht me kontrollin e personit, realizohen me konfiskimin e përkohshëm të sendeve dhe pasurisë.

Konfiskimi i përkohshëm i sendeve dhe pasurisë, me natyrën e shumëfishtë dhe të shumëllojshme shënohet si masë e detyrimit procedural. Kështu, në literaturë flitet në një anë për konfiskimin e përkohshëm për shkak të të provuarit ose të masës me të cilën sigurohen provat, dhe në anën tjetër, për konfiskimin e përkohshëm si masë ekufizimit ose masës, qëllimi i të cilës është sigurimi i sigurisë së njerëzve. Në vendin e tretë duhet theksuar ndikimi i kësaj mase në zhvillimin efikas të procedurës penale. Veçantitë e përshkruara të konfiskimit të përkohshëm të sendeve dhe të pasurisë i kontribuojnë afirmimit të qëllimeve legjitime. Në fillim është i nevojshëm sigurimi i provave që i duhet gjykatës për zhvillimin e procedurës dhe për nxjerrjen e vendimit. Në këtë kuptim, konfiskimi i përkohshëm i sendeve dhe i pasurisë është masë karakteristike për sigurimin e provave. Qëllimi i dytë është sigurimi i sigurisë së njerëzve dhe pasurisë me pengimin e kryerjes së veprave penale (p.sh që kryesi sendin e rrezikshëm mos ta shfrytëzojë për kryerjen e veprave penale, përkatësisht për përsëritjen e veprës penale). Ndërsa qëllimi i tretë është efikasiteti, nëpërmjet të cilit konfiskimi i përkohshëm i sendeve, e në veçanti i pasurisë, i kontribuon zhvillimit më efikas të procedurës penale dhe luftës së suksesshme ndaj formave të reja dhe të vjetra të kriminalitetit.

Ajo çka e karakterizon këtë veprim të të provuarit është karakteri detyrues, natyrisht i një shkalle më të vogël se bastisja, por në këto procedura nuk duhet harruar asnjëherë se ushtrimi i tagrave të sekuestros dhe konfiskimit duhet të respektoj parimet themelore të të drejtave të qytetarëve, çka si rregull kërkon urdhrin e gjykatës, ndonëse në situata të

⁴⁶⁸ KPPRK, neni 283, paragrafi 4.

caktuara dhe të veçanta zbatimi i kësaj mase lejohet edhe pa urdhërin e gjykatës. Ekzistenca e këtij urdhri gjyqësor ose kushteve për zbatimin e këtij veprimi të të provuarit pa urdhër gjyqësor, ndikon thelbësisht në ligjshmërinë e këtij veprimi. Kur është në pyetje klasifikimi i masave dhe veprimeve, të cilat bien nën veprimin e të provuarit të konfiskimit të përkohshëm të sendeve dhe të pasurisë, ato janë si vijon:

- Urdhri për konfiskimin e sendeve;
- Konfiskimi i përkohshëm i letrave, telegrameve dhe dërgesave të tjera;
- Urdhëri bankës ose personit tjetër juridik; dhe
- Konfiskimi i përkohshëm i pasurisë me qëllim të sigurimit.

Në pikëpamje të urdhërit për konfiskimin e pasurisë, Kodi i Procedurës Penale, në nenin 284 përcakton kushtet për lëshimin e urdhërit dhe detyrimet që dalin nga urdhëri. Në të vërtetë, në nenin 365 paragrafi 1, nënparagrafet 1-6 kanë parashikuar elementet themelore të dispozitivit të aktgjykimit fajësues dhe, në kuadër të këtyre elementëve, në nënparagrafin 1.4 të këtij neni është përcaktuar se duhet të shënohet edhe urdhri për konfiskimin e dobisë pasurore që i nënshtrohet konfiskimit të pasurisë. Ndërsa, sipas nenit 370 paragrafi 9, në rastet kur në aktakuzë përcaktohet pasuria që i nënshtrohet konfiskimit, aktgjykimi duhet të përmbajë vendimin me të cilin pasuria konfiskohet apo jo. Aktgjykimi i tillë përmban arsyetimin për konfiskimin e secilës pasuri për të cilën urdhërohet konfiskimi dhe arsyetimin për secilën pasuri për të cilën nuk urdhërohet konfiskimi. Në këtë kontekst vlen të përmendet edhe neni 241. Në paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet që, së bashku me aktgjykimin, gjyqtari i vetëm ose trupi gjykues lëshon edhe urdhrin e arsyetuar për konfiskim, ndërsa çdo ndërtesë, pasuri e paluajtshme, pasuri e luajtshme ose aset i përcaktuar në aktakuzë, në pajtim me nënparagrafin 1.9 të nenit 241 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të shqyrtohet veçmas në urdhrin e arsyetuar për konfiskim.

Në kuadër të shqyrtimit të pasurive të cilat janë objekt i konfiskimit, prokurori i shtetit mund të kërkojë që ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset të shitet ose të likuidohet⁴⁶⁹, ose, sipas paragrafit 4 të këtij neni, prokurori i shtetit mund të kërkojë që këto sende dhe pasuria të mbahen për shfrytëzim nga Qeveria e Kosovës. Kur mjetet konfiskohen drejtpërdrejtë ose grumbullohen nga shitja apo likuidimi, prokurori i shteti, i dëmtuari ose mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë që mjetet të përdoren për kompensimin e të dëmtuarit, ndërsa mjetet e tjera të mbetura i kalohen buxhetit të shtetit. Urdhëri i arsyetuar për konfiskimin e pasurisë i lëshuar nga gjyqtari i vetëm ose trupi

⁴⁶⁹ KPPRK, neni 284, paragrafi 3.

gjykues, gjithashtu, duhet të përmbajë udhëzimin për Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar për shitjen, likudimin ose mbajtjen e ndërtesës apo të pasurisë, si dhe mund të përcaktojë kushte shtesë lidhur me përdorimin e pasurisë, nëse pasuria mbahet nga Qeveria⁴⁷⁰. Ndaj urdhrit, i cili i dërgohet cilitdo personi që ka të drejtë pronësore tek ndërtesa, pasuria e paluajtshme, pasuria e luajtshme ose aset, mund të ushtrohet ankesë brenda një (1) jave. Nëse personi që ka të drejtë ankese kundër urdhërit për konfiskim të pasurisë, nuk e paraqet atë brenda afatit të caktuar, atëherë urdhri i dërgohet për ekzekutim Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

6.7. Agjencionet e zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore

Lufta kundër kriminalitetit në përgjithësi dhe krimit të organizuar është ndër detyrat kryesore të organeve ligj zbatuese të Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të sigurisë dhe rendit.

Çelësi i suksesit në këtë drejtim është edhe konfiskimin i pasurisë të përfituar me vepër penale dhe privimi i fuqisë ekonomike të krimineleve. Si hallkë e fundit në procesin e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, është puna e agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar. Kjo Agjenci u themelua më 1 janar 2010, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe ka për mandat të ruajë dhe administroj pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokuroritë, gjykatat, si dhe organet dhe agjencitë tjera. Në të vertetë në kuadër të drejtave dhe detyrave, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar ushtron funksionet si në vijim: administron me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar të përdorura apo të përfituara nga vepra penale, përfshirë pasurinë e përfituar nga aktet e terrorizmit, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore. Po ashtu ekzekuton urdhrin e gjykatës për masën e përkohshme për sigurimin e pasurisë, sipas legjislacionit në fuqi duke zbatuar ekzekutimin aktgjykimin të formës së prerë të gjykatës. Sipas legjislacionit në fuqi, mund të bëjë shitjen e sendeve duke derdhur të ardhurat e grumbulluara nga shitja në buxhetin e Kosovës ose dorëzimin e pasurive për shfrytëzim nga Qeveria. Njëkohësisht bën vlerësimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, si dhe përcakton mënyrën e ruajtjes së kësaj pasurie si dhe

⁴⁷⁰ Po aty, paragrafi 6.

mbanë evidencat për pasurinë të cilën e administron dhe për vendimet gjyqësore në të cilat është vendosur për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar.

6.7.1. Evidenca për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar mbanë evidencën për pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar me të cilën administron, në evidencë shënohen të dhënat për numrin e vendimit gjyqësorë, emrin e gjykatës, baza ligjore dhe afati i sekuestrimit ose konfiskimit, të dhënat për pasurinë si dhe vlera e vlerësuar e pasurisë, mban evidencë për emrin, mbiemrin, numrin personal identifikues dhe adresa e personit fizik, përkatësisht emri, selia dhe numrin e regjistrimit të biznesit të subjektit juridik nga i cili është sekuestruar ose konfiskuar pasuria nëse figurojnë në vendimin e Gjykatës pa lënë anash edhe vendin ku mbahet pasuria si dhe koha kur është inspektuar për herën e fundit.

6.7.2. Shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi ndërkombëtar i agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar

Gjykata ia dërgon Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar vendimin për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, në ditën e marrjes së vendimit ose ditën vijuese të punës, por në asnjë rast jo më vonë se afatet e përcaktuara me dispozitat ligjore. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar mund të kërkojë nga gjykata, prokurori i shtetit dhe organet e institucionet tjera dërgimin e të dhënave të caktuara, apo informacionet të cilat i nevojiten për kryerjen e punëve, ndërsa institucioneve përkatëse u kërkohet të përgjigjen brenda afatit të kërkuar, të dërgojnë përgjigje dhe të veprojnë në pajtim me kërkesën e saj.

Çdo person fizik, apo juridik, të cilit i është sekuestruar pasuria, apo personat e tretë fizikë apo juridikë, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të informohet për pasuritë e tyre të sekuestruara të cilat janë nën administrimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar. Kërkesa e tillë i drejtohet gjykatës kompetente, e cila mund të urdhërojë Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar për llojin e informacionit që mund t'i ofrohet palës kërkuuese. Secili zyrtar i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar është i detyruar që t'i ruaj fshehtësitë për të gjitha të dhënat, të cilat konsiderohen të mbrojtura me ligj përkatës për mbrojtjen e të dhënave personale. Informatat e caktuara mund të zbulohen vetëm në përputhje me dispozitat përkatëse në lidhje me qasjen në dokumentet zyrtare.

Nëse gjatë administrimit të pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar, vërtetohet se pasuria e tillë është përdoruar drejtpërdrejt, apo tërthorazi për ndonjë vepër penale, apo nëse gjatë

administrimit zbulon prova tjera që e lidhin këtë pasuri me veprën apo veprat tjera penale, informatat e tilla duhet të dorëzohen menjëherë pranë prokurorit kompetent. Në rastet kur një autoritet kompetent në Republikën e Kosovës, posedon informata të cilat do të asistojnë Agjencinë në kryerjen e funksioneve të saj sipas ligjit në fuqi, do t'ia transmetojë informatat e tilla, pavarësisht rregullave të konfidencialitetit.

Në rastet kur në Republikën e Kosovës pranohet një kërkesë nga një shtet tjetër në lidhje me pasuritë, dhe kur gjykatat në Kosovë e kanë pranuar kërkesën dhe pasuritë që përbëjnë subjektin e kërkesës janë transferuar në Agjenci për t'u administruar, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar do të ketë përgjegjësinë për ato pasuri njësoj sikur çështja do të kishte nisur në Republikën e Kosovës. Bashkëpunimi ndërkombëtar në administrimin me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar realizohet në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare.

6.7.3. Roli i agjencisë në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

Roli mbështetës i Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, ofron ndihmë profesionale dhe teknike për të gjitha organet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, me qëllim të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me sekuestrim apo konfiskim të pasurisë.

Sipas kërkesës së Prokurorit të Shtetit dhe Gjykatës, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar ofron këshilla në lidhje me natyrën specifike të procesit të administrimit të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, dhe ofron mbështetje në planifikimin e sekuestrimit, apo konfiskimit të pasurive. Në bazë të kërkesës nga organi kompetent, në rastet e përshtatshme, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar mund të ofrojë mbështetje profesionale dhe teknike jashtë ambienteve të punës, duke ndihmuar në zhvendosjen fizike të pasurisë me qëllim të vendosjes së saj në posedim të Agjencisë.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar është e detyruar që në çdo kohë, t'ia mundësojë organit përgjegjës për ekzekutimin e vendimit gjyqësorë, dorëzimin fizik të pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar në ambientet apo depotë përkatëse.

6.7.4. Roli ekzekutues i Agjencisë

Në momentin e pranimi të pasurisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar bën ekzekutimin e plotë të të gjitha kërkesave të përcaktuara me vendimin përkatës të Gjykatës kompetente, të cilat përcaktojnë mënyrën e disponimit me pasurinë përkatëse të sekuestruar apo konfiskuar. Në mungesë të kërkesave të qarta në vendimin e Gjykatës kompetente, Agjencia mund të kërkojë sqarime konkrete në përputhje me legjislacionin në fuqi. Me pranimin e pasurisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar është përgjegjëse për ruajtjen, kontrollin dhe mbrojtjen e pasurisë, e cila është sekuestruar apo konfiskuar përderisa shpenzimet e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore i bartë vet Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar.

6.7.5. Administrimi me pasurinë e sekuestruar

Zyrtari i autorizuar i policisë që është përgjegjës për ekzekutimin e Urdhrit për sekuestrim është prezent në pranim dorëzimin e pasurisë së sekuestruar. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar ndërmerr veprimet e nevojshme me qëllim që të mirëmbajë dhe ruaj në mënyrë adekuate vlerën e pasurive. Për pasurinë e paluajtshme të sekuestruar, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar duhet të njoftojë organin kompetent për kryerjen e punëve të evidencës së paluajtshmërive, me qëllim të shënimit të barrës mbi këtë paluatjshmëri në evidencën përkatëse. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar administron letrat me vlerë (bonot e thesarit), në pajtim me ligjin i cili rregullon qarkullimin e letrave me vlerë. Agjencia shënon heqjen dhe tjetërsimin e pronësisë së këtyre letrave me vlerë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe mund të angazhojë pjesëmarrësin e autorizuar në tregun e letrave me vlerë, me qëllim të ndjekjes së lëvizjeve të tregut të këtyre letrave me vlerë të sekuestruara.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar bën vlerësimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar, i cili përmban po ashtu një alternativë për vlerën që pasuria e sekuestruar do të kishte në rast të shitjes së detyruar nga Agjencia. Alternativa për vlerën e shitjes së detyruar do të përfshijë po ashtu llogaritjen e të gjitha kostove dhe shpenzimeve që mund të bëhen nëse pasuria e sekuestruar do të shitej ose jo.

Ruajtja e vlerës mund të sigurohet me mbajtjen, apo shitjen e pasurisë së sekuestruar nga ana e Agjencisë, në mënyrë që të zëvendësohet me një kundërvlerë monetare. Në të gjitha

rastet me pasuritë të cilat kërkojnë një administrim të veçantë të kompanive, bizneseve të veçanta, apo pasuri specifike për të cilat nevojiten njohuri të veçanta në fushën relevante, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar angazhon administratorë të pavarur të fushës përkatëse me synim të administrimit efikas dhe funksionimit të mirë të kësaj prone.

Pasuria dhe paratë e fituara me shitjen e pasurisë bëhen pronë e Republikës së Kosovës kur vendimi për konfiskim merr formën e prerë. Në rastet kur Gjykata nxjerr një urdhër për konfiskim, për një pasuri e cila nuk është ende nën kontrollin e Agjencisë, zyrtari i policisë, përgjegjës për ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës, do të jetë prezent gjatë pranim dorëzimit të pasurisë së konfiskuar në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar Agjenci.

Vlen të theksohet se Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar nuk administron me pasurinë e sekuestruar dhe të konfiskuar, e cila bie nën ndonjërin nga kategoritë në vijim si:

- substancat narkotike, substancat psikotropike, analoge apo veglat, pajisjet apo materialet narkotike;
- armët, municionet apo materialet plasëse;
- prodhimet alkoolike, të duhanit dhe prodhimet tjera për të cilat nuk ekziston deklarata doganore ose nëse janë falsifikuar;
- pasuria tjetër, e cila nuk mund të shitet për shkak të sigurisë shëndetësore, veterinare, apo të sigurisë publike.

6.7.6. Vlerësimi i vlerës monetare të pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar

Me pranimin e pasurisë për nevoja të procedurës, Agjencia kryen vlerësimin e vlerës së pasurisë në raport me çmimin e saj të tregut në momentin e pranimin të pasurisë, duke shfrytëzuar shërbimet e vlerësuesve të punësuar në Agjenci ose vlerësuesit e licencuar të Republikës së Kosovës. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar lidhë kontratë, me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet reciproke, si dhe kushtet e shkëputjes së kontratës.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar mund të kryej vlerësimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, të sekuestruar për nevoja të dhënies

me qira, dhënies në shfrytëzim pa kompensim, ose të shitjes të asaj pasurie po ashtu vlerëson pasuritë e pranuar sipas vlerës së saj aktuale të tregut në momentin e pranimi.

6.7.7. Shkatërrimi i detyrueshëm i pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar dhe kthimi i saj

Pasuria e sekuestruar dhe e konfiskuar, e cila duhet të shkatërrohet për shkak të mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe të kafshëve, mbrojtjes së mjedisit, dhe për arsye tjera siguruese, shkatërrohet nën mbikëqyrjen e organeve kompetente, në pajtim me ligjin. Vendimin përfundimtar për shpenzimet e shkatërrimit e nxjerrë gjykata pas përfundimit të procedurës.

Mirëpo në rastet kur pasuria në baza ligjore duhet të kthehet, gjykata është e obliguar që agjencisë t’ia dërgojë vendimin me të cilin pasuria e sekuestruar kthehet. Nëse pasuria është dhuruar apo është shkatërruar, pronari ka të drejtë të kompensohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Këto janë ato raste kur pronari i pasurisë së sekuestruar apo të konfiskuar ka arrit të faktoj që pasuria i është marrë pa të drejtë.

6.7.8. Shitja e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara

Me propozim të Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, Prokurori i shtetit, apo organi tjetër kompetent mund të kërkojë nga gjykata të vendosë për shitjen e një pasurie që mund ta humbë vlerën ose në rast të magazinimit të saj e tejkalon vlerën e saj, apo kur shpenzimet e magazinimit janë joproporcionale me vlerën e pasurisë së sekuestruar. Të hyrat e realizuara nga shitja deponohen në xhirollogarinë bankare të Agjencisë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

6.7.9. Analiza e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave për konfiskim të pasurisë

Me qëllim të administrimit profesional të pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, Ministria e Drejtësisë ka themeluar Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar.

Agjencia në fjalë ruan dhe administron pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente. Ajo, ndihmon në ekzekutimin e vendimeve për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, (sipas kërkesës së

organeve kompetente), i mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, sipas autorizimit të organit kompetent, angazhon (ekspert sipas nevojës) për vlerësimin e vlerës së pasurisë dhe mënyrën e ruajtjes së sendit të sekuestruar ose të konfiskuar si dhe administron të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në një sistem të centralizuar kompjuterik⁴⁷¹.

Po ashtu, Agjencia siguron mbështetje logjistike për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë⁴⁷², mbledh, administron dhe procedon të dhënat, përfshirë vendimet e organeve kompetente dhe të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë; administron dhe ruan të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar dhjetë vite nga data kur Agjencia ka pranuar vendimin e formës së prerë për konfiskim nga gjykata apo organi tjetër kompetent; dhe ruan privatësinë e subjekteve të përfshirë në rastin konkret sipas ligjit në fuqi⁴⁷³. Siç dihet, pas marrjes së ndonjë vendimi përfundimtar nga institucionet kompetente, pasuritë i mban Banka Qendrore e Kosovës në objektet e ndërtuara pikërisht për këto çështje. Kështu, vetëm në gjashtëmuorin e parë të vitit 2012 Agjencia kishte nën administrim 1 milion e 100 mijë euro. Për momentin administrohet makineri e rëndë, bizhuteri, ari dhe vetura. Në momentin kur merret një vendim, pasuria, siç u theksuar më lartë deponohet në Bankën Qendrore të Kosovës, përfshirë arin.

Për agjencitë e zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës është obligimi i ri, marrja e detyrimeve të reja që çdo pasuri e sekuestruar të kalojë sa më shpejt në administrim. Përfitimet kërkohet të jenë sa më të prekshme dhe në frymën e ligjit. Së këndejmi, shkëmbimi në kohë i informacioneve dhe bashkëpunimi, duhet të jetë objektiv për ta bërë më pak të vështirë luftën kundër krimit përgjithësisht dhe fenomenit të shpëlarjes së parave në veçanti.

Në fakt, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve apo fitimeve mbetet një “thembër akili” për çdo grup kriminal. Së këndejmi, çdo goditje e fortë nga ana e agjencive të zbatimit të ligjit jo vetëm që i privon ato nga mundësia për të gjeneruar aktivitete kriminale në vijimësi, por, paralelisht u heq mundësinë për të “pastruar” pasurinë e paligjshme, u heq mundësinë që të “rehabilitojnë” përfitimet e tyre nga aktivitetet kriminale, duke penguar maksimalisht përpjekjet për avancimin e krimit të organizuar.

⁴⁷¹ Ligji nr. 03/L- 141, Për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar, neni 4.

⁴⁷² Po aty, neni 5.

⁴⁷³ Po aty, neni 6.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara si një institucion shumë i rëndësishëm në luftën për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe trafikimit me narkotikë, qenie njerëzore, kontrabandës, korrupsionit etj. nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, ka nevojë për ndihmën dhe mbështetjen e të gjitha institucioneve që përfshihen në këtë fushëveprim.

Në vazhdim, do të theksohen tri arsyet kryesore që e bëjnë të domosdoshëm konfiskimin e pasurive: Ato janë;

- a) **Së pari**, kryerësit e veprave penale nuk duhet të lejohen të përfitojnë prej krimeve të tyre. Prokuroria duhet të bëjë çdo përpjekje për të sekuestruar përfitimet e fituara në mënyrë të paligjshme nga të pandehurit;
- b) **Së dyti**, sekuestrimi i përfitimeve prej krimit ndihmon në parandalimin e aktiviteteve të paligjshme nga “kriminelët individual”, e sidomos nga grupet kriminale; dhe
- c) **Së treti**, kur një qeveri është e përkushtuar dhe e aftë të konfiskojë pasuri, atëherë ajo shërben zbatimit të ligjit⁴⁷⁴.

Rrjedhimisht, krimi i organizuar duhet goditur aty ku i dhëmb më së shumti, në pasurinë e tij. Së këndejmi, agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të bëjnë gjithçka që ata të ndalen, që të mos hyjnë me pasuritë e tyre në ekonominë e ligjshme⁴⁷⁵.

Kosova është një vend i hapur dhe mundësitë për t’u kryer transaksione të paligjshme, në vlera të mëdha monetare, janë të shumta. Problematikë e mprehtë është fakti se pasuri të krijuara në mënyrë të paligjshme ka dyshime se përdoren për të korruptuar organet e zbatimit të ligjit atyre që zhvillojnë hetimet për këtë lloj aktiviteti kriminal. Po ashtu, prirje e personave të përfshirë në aktivitete të krimit të organizuar është përdorimi i këtyre të ardhurave në aktivitete të ligjshme, duke synuar në këtë mënyrë fshehjen e prejardhjes kriminale të tyre. Për këtë arsye, është detyrë themelore e organeve të zbatimit të ligjit që të përdorin të gjitha mjetet dhe mekanizmat ligjore që kanë në dispozicion për të luftuar këto sjellje kriminale.

Përvoja tregon se mafia, grupet kriminale dhe kriminelët i ngrenë urat e bashkëpunimit më shpejt se qeveritë e agjencitë e zbatimit të ligjeve, duke shkaktuar rrezik real për shoqërinë,

⁴⁷⁴ Shih punimi i doktoratës të Dr.sc. Fatos Haziri, Parandalimi dhe zbulimi i shpëlarjes së parave nga agjencionet e zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës fq. 222, Universiteti i Prishtinës viti 2016, Prishtinë.

⁴⁷⁵ Po aty.

prandaj kërkohet që “Qeveria dhe agjencitë duhet të bashkohen dhe t’i kundërpërgjigjen krimit me të njëjtin intensitet”.

Ndër të arriturat e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar janë shënuar këto aktivitete për të cilat konsiderojmë se ngërthen në vete një game të gjerë të aktiviteteve në përmbushje dhe realizim të vendimeve gjyqësore.

Të dhënat dëshmojnë se Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara gjatë vitit 2012 ka shënuar trend pozitiv të ushtrimit të përgjegjësisë së saj sepse ajo vetëm për gjashtë mujorin e vitit 2012⁴⁷⁶ ka marrë në administrim mbi 1 milion e 100 mijë euro. Kjo agjenci nën administrim ka edhe sende me vlerë si ari, bizhuteri, vetura etj. Po ashtu vlen të theksohet se viti 2012 shënon vitin kur edhe agjencionet e tjera të zbatimit të ligjit kanë ndërmarrë vendime për konfiskim dhe sekuestrim. Në këtë drejtim, vlen të përmenden këto fakte:

- a) Gjykatat për në agjenci kanë proceduar 61 raste të konfiskimit dhe sekuestrimit të pasurisë së paligjshme;
- b) Prokuroritë 11 raste;
- c) Agjencia e e ushqimit dhe veterinarisë 11 raste;
- d) Dogana 27 raste; dhe
- e) Këshilli i pavarur për miniera dhe minerale 12 raste⁴⁷⁷.

Vlera e përgjithshme e pasurisë së sekuestruar ka mbetur në nivel të duhur gjatë viteve 2012-2013 duke qenë 1 555 258,43 euro në vitin 2013, por që në vitin 2014 pasuria e sekuestruar është rritur ndjeshëm duke arritur vlerën prej 21 256 142,70 euro. Vlera e përgjithshme e pasurisë së konfiskuar ka pasur rënie gjatë viteve 2012-2014 nga 103 647,57 EUR në 26 350,90 euro, në 2014. Informatat në dispozicion dëshmojnë se vlera e përgjithshme e të ardhurave të sekuestruara është rritur⁴⁷⁸.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, gjatë periudhës janar – dhjetor 2015 ka konfiskuar vlerë monetare nga 20 grupet kriminale të shkatërruara në vlerë prej 2 milion e gjysmë euro⁴⁷⁹.

⁴⁷⁶ Gazeta koha ditore 08.10.2012.

⁴⁷⁷ Shih raportin vjetor për vitin 2012 të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

⁴⁷⁸ Shih raportin vjetor 2013, të Qeverisë së Kosovës, fq. 24.

⁴⁷⁹ Shih raportin vjetor 2015, të Qeverisë së Kosovës, fq. 18.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar , gjatë kësaj periudhe janë ekzekutuar 93 vendime të cilat kanë të bëjnë me pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, të cilat arrijnë shumën e përafërt në total prej €624,689.49, nga të cilat të sekuestruara janë €497,696.85 ndërsa të konfiskuara janë €126,992.64 , dhe janë realizuar gjithsej 13 ankande publike⁴⁸⁰.

Si përmbyllje e gjithë asaj që u trajtua më sipër të njërës ndër problematikat më të mëdha me të cilat ballafaqohet bota sot, mund të konkludojmë se nga kjo analizë e detajuar e gjendjes, rezulton se si shoqëri kemi ende sfida dhe vështirësi në ngritjen e kapaciteteve për të luftuar fenomenet kriminale, sidomos dukurisë së shpëlarjes së parave, krimit të organizuar, trafikeve të të gjitha llojeve dhe financimit të terrorizmit. Së këndejmi, shikuar situatën aktuale në Republikën e Kosovës edhe pse nuk mund të thuhet se ka mungesë të legjislacionit të mjaftueshëm, problemi paraqitet në zbatimin praktik të tij dhe goditjen e atyre që njihen nga masa e gjerë e popullit por që në instancë të fundit del se janë të lidhur me strukturat para politike dhe politike dhe përmes tyre ushtrojnë ndikim edhe në sistemin e drejtësisë dhe kështu i shpëtojnë dënimit për vepër penale dhe konfiskimit të dobisë pasurore të fituar prej saj.

Globalizimi i krimit kërkon globalizimin e normave juridike dhe në veçanti, harmonizimin dhe koordinimin e veprimit në nivele ndërkombëtare që kapërcejnë nivelet nacionale. Nga arsyeja e theksuar pritet me të drejtë që ligjet, aktet juridike dhe marrëveshjet që përpunojnë materien e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale dhe me anë të krimit të organizuar, do të hapin mundësi të reja të veprimit konkret në praktikë.

Konfiskimi në shumicën e legjislacioneve është një masë dënimi plotësues dhe ai shqiptohet nga gjykata në përfundim të një procesi që vërteton se prona e konfiskuar (në cilëndo formë që shfaqet), është, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë e adhur nga krimi.

Një varg instrumentesh ligjore ndërkombëtare dhe europiane synojnë të krijojnë një legjislacion ndërkombëtar që i ndihmon veprimeve të shpejta dhe efektive që lidhen me sekuestrimin dhe konfiskimin e pronave të ardhura nga krimi, ashtu sikundër një përpjekje në rritje është duke u realizuar nga shtetet në funksion të rezultateve të prekshme dhe të qëndrueshme në luftën e vështirë ndaj krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme.

Shumica e shteteve të sjella në këtë punim dhe shumë të tjera, të cilat janë konsultuar në funksion të temës na kanë demonstruar se Kodi Penal dhe ai i Procedurë Penale konsistojnë

⁴⁸⁰ Shih raportin vjetor 2016, të Qeverisë së Kosovës, fq. 42.

të pamjaftueshme në luftën kundër krimit nacional dhe ndërkombëtar. Lëvizja e lirë e njerëzve dhe mallrave i kanë ndihmuar veçanërisht përhapjes gjeografike të krimit, sikurse kanë krijuar rrugë të reja dhe lehtësira për kalimin e tyre nëpër kufijtë nacionalë. Kjo i ka drejtuar vende të ndryshme drejt hartimit të normave të reja ligjore dhe të veçanta lidhur me sekuestrimin dhe konfiskimin e pronave të ardhura nga krimi, sikundër ka mundësuar krijimin e agjensive të posaçme për të administruar dhe proceduar me këto prona.

KAPITULLI VII

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT, PYETËSORËT DHE ANALIZA

Punimi aplikon përdorimin e hulumtimit përshkruese që të jetë në gjendje për të përcaktuar nivelin e ndërgjegjësimit të publikut në luftimin dhe parandalimin e çështjet në lidhje me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale dhe veprimet e autoriteteve. Në metodologjinë e hulumtimit të aplikuar, qëllimi kryesor është paraqitja e të dhënave të mbledhura në lidhje me temën kërkimore. Një lloj i procesit të hulumtimit që u shfrytëzua është hulumtimi dhe studimi që përcakton pikëpamjet e mostrës së respondentëve. Ajo gjithashtu përcakton shpërndarjen në lidhje me qëndrimet e tyre për tezën e paraqitur.⁴⁸¹

Anketa është lloji kryesor i procesit të hulumtimit që u përdor në studimin e kryer në lidhje me ndërgjegjësimin e popullsisë për çështjet e me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale. Qëllimi kryesor është për të llogaritur shpërndarjen e popullatës në studim në lidhje me pyetjet e bëra. Kjo është ndërmarrë duke i studiuar përgjigjet e dhëna nga mostra e popullatës. Këto përgjigje janë shënuar, sistematizuar dhe vlerësuar për të qenë në gjendje për të arritur rezultatet e nevojshme të përgjithshme. Në këtë lloj të kërkimit, është theksuar rëndësi e vecantë procesit të vëzhgimit. Kjo për shkak të faktit se në krahasim me llojin e kërkimit eksperimental, nuk ka kontroll mbi ndërtimin e pyetësorit. Kjo është një teknikë sasiore që mbledh informacion në lidhje me karakteristikat cilësore të popullsisë.⁴⁸²

Përdorimi i hulumtimit mundëson teknika si pyetësorët, intervistat dhe gjenerimin e teknikave për të dhënat tjera. Kjo cilësi e të dhënave të grumbulluara dhe të përpunuara kontribuonë në avantazhet e këtij lloji të procesit kërkimor sidomos në hulumtimet sociale. Në punim të hulumtimit, nuk përfshihen vetëm grumbullimi i të dhënave por hapi fillestar është vëzhgimi dhe regjistrimi objektivë i informatave të anketuara. Pjesa thelbësore e procesit të hulumtimit është studimi krahasues para ekzistimit të rezultateve të ngjashme. Në këtë fazë, studiohen edhe teoritë mbi rezultatet e studimit. Racionalizimi i rezultateve të grumbulluara mund të bëhet nëpërmjet zbatimit të dy metodave. Formulimin e konceptit dhe vlerësimit të koncepteve e që janë procedurat jetike në studimin e të dhënave përshkruese. Në hulumtimin e zhvilluar, krijimi i konceptit me konfiskimin e dobisë

⁴⁸¹ Davis, J. *Metodat e hulumtimit kërkues*. 1997. Metodat kërkimore psikologjike 2. 4 qershor 2006. rishikuar ne: <http://www.naropa.edu/faculty/johndavis/prm2/survey1.html>

⁴⁸² Po aty.

pasurore të përfituar me vepër penale është ndërmarrë fillimisht nga anketat e vetëdijes së publikut në lidhje me rreziqet e kriminalitetit me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale. Në këtë procedurë kërcënimet e mundshme janë sjellë nga konceptet që ishin të vendosur në pikëvështrimin e publikut.⁴⁸³

7.1. Formulimi i pyetësorit kërkimor

Në procesin e hulumtimit, janë vendosur pyetjet kërkimore me qëllim të kryerjes së studimit. Ato udhëzojnë në rrugë të gjatë të hulumtimit. Kjo pastaj mund të modifikohet përmes procesit me studimin e mëtejshëm të temës me interes, ku mund të lindin problemet që mund të konsiderohen të rëndësishme për analizimin e rezultateve. Në një proces kërkimor nga konceptet më të rëndësishme janë variablat apo ndryshimet. Kjo është një lloj atributi i popullatës në studim. Variablat mund të jenë të varur, të pavarura dhe të ndërhyra. Këto lloje të variablave ndryshojnë varësisht nga funksioni i procesit. Variabli i pavarur ka efekte në sjelljen e variablave të varura. Në hulumtimin e zhvilluar variabla që është studiuar është kërcënimi i mundshëm që mund të sjellë me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale. Përgjigjet e grupit në studim janë shenjat dhe karakteristikat e vëzhgueshme të variablit të varur. Variabli i varur është matës i efekteve të sjelles nga variabli i pavarur⁴⁸⁴.

7.2. Konsideratat etike në mbledhjen e të dhënave

Përveç shqetësimeve teknike të përfshira në studimin që kryesisht merret me arritjet akademike të rezultateve të kërkuara, shqetësimet etike janë thelbësore në lidhje me analizën e të dhënave të mbledhura. Në studimin e kryer të 300 të anketuarit (nga lokalitete të ndryshme) që janë kontaktuar ishin të ndërgjegjshëm për objektivat e studimit në fjalë. Kjo siguron që mostra e popullsisë u bazua në zgjedhjen e pjesëmarrjes së plotë. Ata janë kontaktuar përmes emailit dhe kontaktit personal ku objektivat janë diskutuar dhe pastaj janë ndërmarrë analizat paraprake. Në mesin e popullatës si synim fillestar ishin të zgjedhur dhe për të marrë pjesë 300 të intervistuar. Ata kanë dhënë lejen e tyre që të dokumentohen përgjigjet dhe të botohen si rezultate të hulumtimit.

⁴⁸³ De Vaus, David. *Anketat e studimeve sociale*. Londër: Shtypi UCL, 1996.

⁴⁸⁴ Po aty.

Në anën tjetër, konfidencialiteti i plotë i identitetit personal të të anketuarve është siguruar paraprakisht. Në rastet ku janë kryer intervistat personale, të dhënat personale nuk janë botuar, pra duke marrë për bazë marrëveshjen me ata. Janë të regjistruar vetëm të dhënat përkatëse të tilla si informata bazë që mund të përdoren për klasifikimin dhe organizimin e të dhënave. Informatat demografike janë shembulli kryesor.

Kjo siguron që shqetësimet etike të hulumtimit janë ndërmarrë. Nga ana tjetër, ky proces rrit paragjykimin dhe ul konfidencialitetin e studimit të kryer. Kjo ndodhë për shkak të faktit se përgjigjet e popullsisë mostrës janë të prekura shpesh nga synimet e procesit të hulumtimit.⁴⁸⁵

7.3. Procesi i marrjes së mostrave

Mbledhja e të dhënave është një fazë thelbësore e procesit të hulumtimit. Disa metoda janë ndërmarrë duke u bazuar në mbledhjen e informatave të nevojshme për procesin e kërkimit. Në këtë hulumtim janë përdorë mostrat e rastit ku janë përdorur metodat e shanseve të rastësishme⁴⁸⁶. Edhe pse teknika e marrjes së mostrave që është përdorur është tashmë e njohur, prap se prap faza paraprake që është ndërmarrë është përgatitja e pyetësorit për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për hulumtim.

Në përgatitjen e pyetësorëve, ka faktorë të marrur në konsideratë në mënyrë efikase që zhvilluan kërkimin që është ndërmerrë. Është e rëndësishme për të përcaktuar përparësitë e të dhënave që janë të nevojshme për të siguruar matjen e të dhënave përkatëse për çështjen e mbledhur. Një hap tjetër i rëndësishëm është përcaktimi shënues që mund të matet. Këta shënues përshkruajnë të dhënat cilësore të cilat janë duke u zhvilluar për hulumtim. Krijimi i të dhënave për analizë është gjithashtu i rëndësishëm, kështu që pyetjet e rëndësishme janë në gjendje të mbledhin të dhënat përkatëse në përcaktimin e vetëdijes publike për kërcënimet e kriminalitetit me theks të posaçëm me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale. Në lidhje me metodën e mbledhjes së të dhënave dhe formulimin e pyetësorit, sistemi i analizës së të dhënave është i domosdoshëm. Kështu, në procesin e hulumtimit, është me rëndësi jetike për studiuesit që të përqëndrohen në objektivat e vendosura të atij hulumtimi dhe pritjet që të jenë në gjendje të mbledhin të dhënat e duhura.⁴⁸⁷

⁴⁸⁵ De Vaus, David. *Anketat e studimeve sociale*. Londër: Shtypi UCL, 1996

⁴⁸⁶ Davis, J. *Metodat e hulumtimit kërkues*. 1997. Metodat kërkimore psikologjike 2. 4 qershor 2006. rishikuar ne: <http://www.naropa.edu/faculty/johndavis/prm2/survey1.html>

⁴⁸⁷ De Vaus, David. *Anketat e studimeve sociale*. Londër: Shtypi UCL, 1996.

Në proces përveç marrjes së mostrave dhe formulimit të pyetjeve, hapi i mëvonshëm ishte zhvillimi i intervistave dhe përgjigja në pyetësorët. Puna e parë që mund të bëhet është administrimi i pyetësorëve.

Metodat e ndryshme janë të vlerësuara në bazë të normës së reagimeve, cilësisë së të dhënave, cilësisë së procesit të marrjes së mostrave dhe mundësisë së metodës së bërë.⁴⁸⁸ Shkalla e reagimet të metodës konsiderohet se përcakton afatin që mund të shpenzohet në mbledhjen e të dhënave. Metoda të tilla si ballë për ballë dhe me anë të telefonit janë më të efektshme kur norma feedback-ut apo përgjigjeve është kriteri kryesor. Cilësia e të dhënave të grumbulluara nga ana tjetër, përcakton faktorët që janë të lidhur me paragjykimet që mund të shkaktohen gjatë procesit të hulumtimit. Cilësia e procesit të marrjes së mostrave varet nga metoda e përdorur në përzgjedhjen e popullsisë mostrës. Metoda që është përdorur për hulumtimin e zhvilluar është mostër e thjeshtë e rastit që kërkohet rastësia e shansit. Rastësia e shansit rrit cilësinë e të dhënave për shkak të faktit se studimi nuk ka kontroll mbi rezultatet e zgjedhjes të popullsisë mostër. Në këtë proces probabilitetit për të qenë të zgjedhur është i barabartë për gjithë popullsinë.⁴⁸⁹ Nga ana tjetër, mundësa e studimit varet nga konsiderata praktike. Kjo përfshin koston që mund të jetë e shkaktuar në ndërmarrjen e procesit të hulumtimit. Kështu, zgjedhja e metodës për mbledhjen e përgjigjeve nga popullata e synuar duhet të konsiderohet metodë që mund të bëhet në kohën më të shkurtër me efikasitetin më të lartë të koston dhe që ka cilësinë më të lartë të dhënave të arritshme.

7.4. Metodat e përdorura në anketat kërkimore

Ka metoda të ndryshme që mund të përdoren në mbledhjen e të dhënave në një studim hulumtues. Këto përfshijnë intervistat ballë për ballë, intervistat telefonike, anketat që janë bërë nëpërmes internetit dhe me anë adresave elektronike dhe pyetësorëve që janë dërguar përmes postës elektronike apo edhe përmes rrjeteve sociale si p.sh twitter, facebook etj. Ka edhe dallime të tjera që përfshijnë kombinimin e këtyre metodave. Mund të bëhen zgjedhjet që të merren në konsideratë vetëm të dhënat e efikasitetit të koston dhe cilësisë së tyre.⁴⁹⁰

⁴⁸⁸ Po aty.

⁴⁸⁹ Glenberg, Arthur. *Të mësuarit nga të dhënat: Hyrje në arsytimet e statistikës*. NJ: Shoqata Lawrence Erlbaum, 1996. fq 304.

⁴⁹⁰ De Vaus, David. *Anketat e studimeve sociale*. Londër: Shtypi UCL, 1996

Në studimin e kryer, janë përdorur dy lloje të metodave të administrimit. Këto metoda janë ballë për ballë dhe intervistat telefonike dhe nëpërmes të internetit dhe adresave elektronike. Metoda kryesore e përdorur është intervista përmes internetit dhe facebookut dhe ato ballë për ballë. Kjo përfshin të intervistuesit dhe përgjegjësit. Me pyetësin si udhëzues, intervistuesi zgjedh informacionin e duhur i cila është regjistruar me shkrim manual apo elektronik në mënyrë automatike.

Intervista telefonike është metodë e përdorur edhe në këtë hulumtim të zhvilluar. Kjo është një metodë ku pyetësi ishte përgatitur administrohet nga biseda telefonike. Kjo është një variant i intervistës personale e bërë me ndërveprime ballë për ballë⁴⁹¹.

7.5. Mostra e respondentëve

Popullsia ishte zgjedhur rastësisht nga 300 anëtarë fillestare që janë marrë dhe kontaktuar paraprakisht për këtë studim. Hulumtimi i kryer shërbeu si shtesë për hulumtim akademik që u zhvillua më pas. Pas përzgjedhjes së të anketuarve më pas është bërë studimi i administrimit të pyetësorëve. Të anketuarit përbëhen nga një total i 300 personave që shërbejnë si bazë e studimit që duhet të kryer.

Në përcaktimin e popullsisë mostrës është e rëndësishme që të ketë ndryshim të popullsisë mostër.

7.6. Organizimi i të dhënave dhe analizat

Kjo fazë përfshin organizimin e të dhënave të para që janë mbledhur nga hulumtimi dhe studimi i kryer. Kjo ka shërbyer si përgatitje për analizën e të dhënave. Prioriteti kryesor në organizimin e të dhënave është përcaktimi i marrëdhënieve me objektivat kryesore dhe synimet. Përgjigjet e mbledhura edhe të përkthyer në të dhëna ishin të nevojshme për përfitimin e njohurive të reagimit të popullsisë për rreziqet e sjellura nga kriminaliteti.

Tabelat e frekuencave të shpërndarjes janë përdorur në organizimin e të dhënave. Meqë variabla e ndryshme kërkojnë tabela të posaçme. Pas prezantimit, të dhënat mund të analizohen. Në lidhje me pyetjet e hapura dhe të mbyllura, është i nevojshëm edhe modifikimi i përgjigjeve. Aftësia e të dhënave që janë mbledhur është e nevojshme përcaktohet me metoda më efikase të prezantimit të rezultateve dhe analizës së të dhënave. Analiza përfshin përkthimin e të dhënave cilësore të mbledhura në përshkrimin e

⁴⁹¹ Houtkoop-Steenstra, Hanneke. *Anketa ndërveprimi dhe Intervista të standardizuara: Pyetësor jetësor*. Angli: Gazeta e Universitetit të Cambridge-it, 2000. fq. 20.

respondentëve. Kjo gjithashtu përfshin krahasimin e rezultateve të studimeve të lidhura para ndërmarrjes së këtij hulumtimi.⁴⁹²

7.7. Cilësia e të dhënave të grumbulluara

Cilësia e të dhënave është e prekur nga paragjykimet që mund të jenë të shkaktuara në planin e studimit. Kjo ndikon në vlefshmërinë e të dhënave të grumbulluara. Një faktor që ndikon në vlefshmërinë e të dhënave është edhe vetë studiuesi. Prania e intervistuesit ka ndikim të caktuar në përgjigjet e të anketuarve. Sjelljet e të anketuarve janë të prekur nga idenja se përgjigja që duhet të jepet është ai e saktë, kështu që ndikojnë në vlefshmërinë e përgjigjes. Opinionet e vërteta të të anketuarve, numërimi i hulumtimeve dhe studimeve hulumtuese duhet të theksojë se përgjigjet nuk janë të bazuara mbi saktësinë e tyre, por studimi është ndërmarrë që të përcaktojë statistikat dhe shpërndarjen cilësor të të dhënave në lidhje me këtë temë.

Një faktor tjetër që ka nevojë për vëmendje, është ndërtimi i pyetjeve të bëra. Pyetjet e caktuara që të çojnë në një përgjigje pozitive ose negative mund të jenë paraprijëse. Kjo është për shkak të faktit se zakonisht të anketuarit kanë tendencë që të jenë dakord me pyetjet e tyre. Në lidhje me këtë, duke bërë një pyetje, aty për aty, mund të largojë të anketuarit nga pamja e tyre reale. Një prej arsyeve është se kjo çështje nuk është diskutuar kurrë, edhe pse vetëdije ka qenë e pranishme në një nivel dhe e orientimi i opinionin mund të ndryshojë me realizimin e mëtejshëm.

Një tjetër faktor që mund të çojë në paragjykim në procesin e kërkimit është trendi që mund të ndodhë në përgjigjet e dhëna. Kjo është e domethënia e modelit përgjigjes i cili mund t'i miratoj përgjigjet që kanë lidhje me përgjigjet e mësipërme. Një tjetër faktor që mund të zvogëloj integritetin e të dhënave të grumbulluara është konsiderata etike. Kjo është për shkak të faktit se përgjigjet e dhëna nga anëtarët e popullsisë mostër mund të ndikohen nga njohuritë e objektivave të hulumtimit. Kjo ndodhë në lidhje me konsideratat etike që të anketuarit duhet të kenë njohuri për qëllimin e studimit. Kjo mund të çojë të intervistuarit për t'iu përgjigjur në mënyrat se si ato konsiderojnë të rëndësishme përgjigjet e tyre për rezultatet e studimit.⁴⁹³

Paragjykimi i procesit të hulumtimit mund të zvogëlohet me përdorimin e teknikave statistikore si atë të rastësisë për të zvogëluar kontrollin e njeriut dhe gabimet në rezultatet

⁴⁹² De Vaus, David. *Anketat e studimeve sociale*. Londër: Shtypi UCL, 1996.

⁴⁹³ Po aty.

e studimit, të cilat janë përdorur në përcaktimin e vetëdijes së publikut për kërcënimet e mundshme të bëra me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.

7.8. Rezultatet nga anketa

Studimi është bërë kërkimor dhe përshkruar për të paraqitur opinionet e të anketuarve.

7.8.1. Demografia e popullsisë mostër

Anketat e popullsisë janë bërë nga 250 - 300 të anketuar të moshës 21 deri 65 vjeç. Ky grup u nda në 5 grup moshë. Klasifikimi i moshës është paraqitur në Tabelën 1. Grupet e moshës përfshijnë: studentët, që e përbëjnë popullsinë e re dhe grupet tjera që përfshijnë popullsinë më të vjetër. Kjo është për t'u siguruar se të anketuarit janë përfaqësues të grupeve të ndryshme në shoqëri. Frekuenca më e lartë e të anketuarve i takon grupmoshave 26 – 35 vjeç.

Kjo ndodhë për shkak të faktit se ata mund të kontaktohen dhe mund të përgjigjen me lehtësi më të madhe për përdorimin e internetit në një anë dhe me konfirmimin përmes telefonit dhe email adresës apo facebook-ut .

Tabela 1. Klasifikimi i moshës së popullsisë mostër.

Mosha	Përqindja
21– 25	
26 – 35	
36 – 45	
46 – 55	
56 – 65	

7.8.2. Njohuritë e respondentëve rreth institutit të konfiskimit të pasurisë të përfituar me vepër penale

Ndërgjegjësimi i respondentëve në këtë hulumtim tregon se, këtë anketë 250 respondent të intervistuar në pyetjen për kuptimin e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, 98% e tyre kanë shprehur përkufizim të ngjashëm të fjalës. Kjo tregon se popullsia ka nivel të caktuar të vetëdijes në lidhje me çështjen e me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale. Ata paraqiten se informacionet kryesore i kanë nga ana e mediave të shkruara dhe elektronike. Rezultatet treguan se gjeneratat e reja kanë shumë më tepër njohuri rreth institutit të konfiskimit në raport me gjeneratat më të vjetëra.

Shih tabelën 2.

Tabela 2: Njohuritë e respondentëve rreth institutit të konfiskimit të pasurisë të përfituar me vepër penale

Mosha	Nr. respondentëve	Kanë njohuri	S'kanë njohuri	Përqindja R. Kanë njohuri	Përqindja R. Japin
21– 25	50	40	10	80%	20%
26 – 35	50	48	2	96%	4%
36 – 45	50	45	5	90%	10%
46 – 55	50	42	8	84%	16%
56 – 65	50	30	20	60%	40%

7.8.3. Opinionet rreth efektivitetit të parandalimit të kriminalitetit në të ardhmën nëpërmjet konfsikimit të pasurisë së paligjshme të tyre.

Lidhur me pyetjen e parashtruar, rreth efektivitetit të parandalimit të kriminalitetit në të ardhmën nëpërmjet konfsikimit të pasurisë së paligjshme të tyre, 60 % e respondentëve sidomos popullësia e mesme shprehen se me rrijten e konfsikimit të pasurisë të përfituar në mënyrë të kundërligjshme, mund të ngritet vetëdija e qytetarëve dhe do jetë preventivë edhe për kryesit e veprave penale pasi që ata nuk do të ndihen asnjëherë të sigurtë nga reagimi i shtetit dhe konfsikimi i pasurisë së fituar me vepër penale. kapaciteti. Pjesa tjetër nuk e shohin konfsikimin si mënyrë të vetme në parandalimin e kriminalitetit por shprehin mendime të ndryshme për parandalimin e kriminalitetit nëpërmjet metodave tjera jo punitive. Ajo që vlen për të theksuar është se, një pjesë e madhe e respondentëve mendojnë se investimet e shtetit, duhet bërë në hartimin e planprogrameve mësimore për gjeneratat e reja.

Tabela 3. Opinionet rreth efektivitetit të parandalimit të kriminalitetit në të ardhmën nëpërmjet konfsikimit të pasurisë së paligjshme të tyre.

Mosha	Nr. responentëve	Ka efekt parandalim kriminalitetit	S'ka efekt parandalim kriminalitetit	Përqindja R. Pranojnë se ka efekt në parandalim	Përqindja R. Japin mendim e tjera
21– 25	50	30	20	60%	40%
26 – 35	50	27	23	54%	46%
36 – 45	50	35	15	70%	30%
46 – 55	50	20	30	40%	60%
56 – 65	50	10	40	20%	80%

7.8.4. Njohuritë rreth aktiviteteve kriminale në Republikën e Kosovës

Pjesa dërmuese e respondentëve kishin njohuri rreth aktiviteteve kriminale në Kosovë. Mendimet e shumicës janë se korrupsioni i prinë listës së veprave penale, si vepër penale më e shprehur në Kosovë. Pjesa tjetër japin përgjigje të ndryshme rreth asaj se cila vepër penale është më e shprehur në Republikën e Kosovës. Si përgjigje e përgjithshme e të gjithë respondentëve është se veprat penale të cilat ndërlidhen me pasurinë e fituar me vepër penale janë më të shprehura në Kosovë duke i specifikuar korrupsionin, shpëlarjen e parave dhe fajdeve. E përbashkëta e të gjithë respondentëve është se paraqesin shqetësimet e tyre për numër të madh të rasteve të kriminalitetit.

Tabela 4. Njohuritë rreth aktiviteteve kriminale në Republikën e Kosovës

Mos ha	Nr. respondentëve	Kanë njohuri	S'kanë njohuri të mjaftushme	Përqindja R. Që kanë njohuri	Përqindja R. Japin mendime të
21– 25	50	35	15	70%	30%
26 – 35	50	40	10	80%	20%
36 – 45	50	45	5	90%	10%
46 – 55	50	40	10	80%	20%
56 – 65	50	30	20	60%	40%

7.8.5. Opinionet rreth agjencive të zbatimit të ligjit në lidhje me konfsikimin e

pasurive të paligjshme

Gjysma e respondentëve/ anketuarve besojnë se organet e zbatimit të ligjit duhet edhe më tej të rrisin aktivitetet e tyre lidhur me konfsikimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale. Gjysma tjetër mendon se konfsikimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale nuk mund të bëhet pa pasur vullnet politik për forcimin e mekanizmave shtetëror në luftën kundër kriminalitetit. Pjesa më e madhe e respondentëve mendojnë se agjencitë e zbatimit të ligjit nuk janë sa duhet efikase në konfsikimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale dhe rekomandojnë se duhet të rriten kapacitetet e tyre në këtë drejtim si në aspektin kadrovik e gjithashtu edhe në specializimin e kuadrove për hetimin, zbulimin e kryesve të veprave penale dhe konfsikimin e aseteve të kundërligjshme të cilat gjinden në posedim të kriminelve. Të dhënat janë të paraqitura në tabelën 5.

Tabela 5. Opinionet rreth agjencive të zbatimit të ligjit në lidhje me konfsikimin e pasurive të paligjshme

Mosha	Nr. respondentëve	Agjen. Janë efikase në konfsikim të p. të kundërligjshme	Agjen. nuk janë efikase në konfsikim të p. të kundërligjshme	Përqindja R. agj. konfsikim në pasurisë së kundërligjme Janë efikase.	Përqindja R. agj. konfsikim në pasurisë së kundërligjme
21 – 25	50	15	35	30%	70%
26 – 35	50	10	40	20%	80%
36 – 45	50	10	40	20%	80%
46 – 55	50	20	30	40%	60%
56 – 65	50	18	32	36%	14%

7.8.6. Mendimet e respondentëve lidhur me kategoritë më të rrezikuara të subjekteve nga format e sofistikuara të krimeve

Opinionet e respondentëve të anketuar shkojnë në drejtim të asaj se ndër kategoritë më të rrezikuara shoqërore nga aktivitetet kriminale mendojnë se organizatat biznesore janë më të rrezikuara nga sulmet e grupeve kriminale përmes formave të sofistikuara të shantazhit dhe shpërlarjes së parave përmes tyre nga ana e grupeve kriminale. Formë e shprehur është edhe reketi dhe detyrimi i ndërmarrjes së veprimeve në dëm të pasurisë së bizneseve, me çka edhe pengohen investimet në vendet me sistem të brishtë juridik, ekonomik dhe të sigurisë së kapitalit. Kjo është edhe arsya që një pjesë e respondentëve shprehin shqetësimet e tyre për mungesën e investitorëve të huaj në shtetin e Kosovës.

Sipas respondentëve shpeshëherë edhe organizatat jo qeveritare dhe ato humanitare ka rezultuar se kanë qenë të atakuara nga grupet kriminale përmes depërtimit në llogaritë bankare dhe pagesat e tyre, përmes formave të sofistikuara të krimeve kibernetike.

Pjesa tjetër e respondentëve mendojnë se edhe qytetarët janë të rrezikuar nga aktivitetet e ndryshme kriminale në dëm të pasurisë së tyre personale dhe familjare.

Tabela 6. Mendimet e respondentëve lidhur me kategoritë më të rrezikuara të subjekteve nga format e sofistikuara të krimeve

KATEGORITË E RREZIKUARA	MENDIMET E RESPUDENTËVE
Organizatat Qeveritare	30 %
Organizatat financiare	80 %
Qytetarët	40 %
Organizatat jo Qeveritare	40 %
Bizneset Private	60 %

Tabela 7. Mendimet e respondentëve lidhur me aftësinë e agjencioneve të zbatimit të ligjit në trajtimin e kërcënimeve nga kryesit e veprave penale

Pjesa dërmuese e respondentëve janë të pakënaqur dhe skeptik me mundësitë e organeve të zbatimit të ligjit që të bëjnë konfiskimin e dobisë pasurore që rrjedh nga veprat penale, pasi që në Kosovë deri vonë ka pasur shumë raste në praktikën gjyqësore kur kryesit e veprave penale janë shpallur fajtor dhe janë dënuar për vepër penale por nuk është bërë sa duhet për konfiskimin e dobisë pasurore që ka qenë derivat i veprës penale dhe kjo i ka inkurajuar kriminelët të përfitojnë pasuri e cila do tu mbetet përgjithmonë në shkëmbim të pak viteve burgim. Kjo ka ndodhë sidomos te veprat penale korruptive. Nga ana tjetër nuk janë të rralla rastet edhe të kërcënimeve ndaj zbatuesve të ligjit, në mënyrë që të janë më të përmbajtur karshi krimit.

Një pjesë e respondentëve mendojnë se do duhej futur në sistemin e drejtësisë gjenerata të reja të shkolluara qoftë brenda apo jashtë vendit për të pasur sukses efikasiteti i organeve të zbatimit të ligjit në fushën e konfiskimeve. Rol vendimtar sipas tyre do luante edhe krijimi i policisë gjyqësore e cila do të përbëhej nga juristë të shquar përkatësisht elita e policisë dhe me këtë nuk do të dështonin rastet si ndodhë tani, ku policia siguron prova, por ato i siguron në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale dhe shpeshëherë ata shpallen prova të papranueshme edhe pse dihet se vepra penale është kryer. Kjo për pasojë ka dështimin e organeve të shtetit në luftimin me sukses të kriminalitetit në përgjithësi, e më pas edhe konfiskimin e të ardhurave të paligjshme nëpërmjet kriminalitetit. Tabela 7.

M.	Nr. R	Agjen. E zbatimit të ligjit, kanë nën kontroll trajtimin e kërcënimeve të mundshme	Agjen. E zbatimit të ligjit, nuk kanë nën kontroll trajtimin e kërcënimeve të mundshme	Përqindja R. se AZL zbatimit të ligjit, kanë nën kontroll trajtimin e kërcënimeve të mundshme	Përqindja R. se AZL zbatimit të ligjit, nuk kanë nën kontroll trajtimin e kërcënimeve të mundshme
21– 25	50	15	35	30%	70%
26 – 35	50	10	40	20%	80%
36 – 45	50	10	40	20%	80%
46 – 55	50	20	30	40%	60%
56 – 65	50	18	32	36%	64%

7.8.8. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për arsyet e operimit të grupeve të ndryshme kriminale në Kosovë që ndërlidhen me shpëlarjen e parave, trafikimin me qenie njerëzore, prostitucionin, trafikimin me narkotik etj.

Shumica e respondentëve mendojnë se njëra ndër arsytet e operimit të grupeve të ndryshme kriminale në Kosovë është fakti se ato e shfrytëzojnë brishtësinë e organeve shtetërore të zbatimit të ligjit, duke përfshirë edhe blerjen e lirisë me një sasi të vogël parashë të dhëna në formë ryshfeti. Kjo i inkurajon kriminelët që të intensifikojnë veprimet e tyre në vende me sistem jo stabil për të fituar paratë dhe pastaj për ta bërë shpëlarjen e tyre dhe duke i investuar pastaj në veprimtari të ndryshme. Shpeshëherë sipas respondentëve organet kompetente lajmrohen se në lokale të veçanta zhvillohen aktivitete të kundërligjshme dhe në terren shihen të rralla aksionet e policisë në drejtim të bastisjes, identifikimit dhe kapjes së trafikantëve të ndryshëm që ushtrojnë veprimtari kriminale. Sipas mendimit të respondentëve sikur të ishin më efikase organet e shtetit, atëherë niveli i konfiskimit të pasurisë së kundërligjshme do të ishte shumë i madh dhe rrjedhimisht kriminelët përveç burgut do të mbeteshin duarthatë pas konfiskimit të pasurisë, ashtu që pas ekzekutimit të sanksioneve penale ata do të trajtoheshin si raste sociale pa mundësi ndikimi përmes pasurisë.

7.8.9. Ndërgjegjësimi i qytetarëve për efikasitetin dhe mundësitë e institucioneve të zbatimit të ligjit në Kosovë që të garantojnë siguri me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit

Pjesa dërmuese e respondentëve mendojnë se ekzistojnë të gjitha kushtet dhe mundësitë që organet e zbatimit të ligjit të jenë efikase në punën e tyre pasi që kanë legjislacionin adekuat dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare me qëllim të luftimit të kriminalitetit, e gjithashtu ekzistojnë edhe institucione të shumta të themeluara për këtë qëllim. Fatkeqësia sipas respondentëve qëndron aty se në shumicën absolute të rasteve kriminelët janë të lidhur me politikën dhe ata financojnë partitë politike për të ardhur në pushtet fillimisht dhe pastaj përmes pushtetit kapin sistemin e drejtësisë dhe operojnë lirishëm në tregun e zi.

7.8.10. Njohuritë për zbatimin e konfiskimit të pasurisë së paligjshme

Shumica e respondentëve deklarojnë se nuk i njohin mirë dispozitat konkrete ligjore por e dinë se ka rregulla që e rregullojnë këtë fushë. Ata mendojnë se njohuritë më të shumta i kanë përmes mjeteve të informimit publik dhe rrjeteve sociale, ku nëse shikohet vetëm pasuria e deklaruar në Agjencinë Kundërkorrupsion del se pas luftës në Kosovë e deri më sot kemi shumë milioner të pa merituar që i janë rrekur politikës dhe është vështirë që të gjinden gjyqtarë dhe prokuror që mund të ndërmarrin veprime në drejtim të konfiskimit të pasurisë së tyre të fituar me vepër penale për shkak të fuqisë së tyre.

Pjesa tjetër e respondentëve mendojnë se edhe Kosova nuk bën rast përjashtimor nga shtetet në region dhe se janë optimist për një të ardhme më të mirë.

7.8.11. Opinionet për efikasitetin e masave të deritanishme të agjencioneve të zbatimit të ligjit në konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale

Shumica e respondentëve mendojnë se nuk janë ndërmarrë masa të mjaftueshme as prej organeve dhe institucioneve vendore dhe as prej atyre ndërkombëtare në Kosovë përgjatë viteve dhe mendojnë se aksione të caktuara dhe rritje e efikasitetit ndodhë zakonisht kur kemi të bëjmë me përmirësimin e të gjeturave të raporteve ndërkombëtare qoftë atij të progresit të komisionit Evropian e gjithashtu edhe raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, si dhe raporteve tjera të organizatave kredibile botërore. Gjithashtu edhe ndryshimi i pushteteve sipas respondentëve ka ndikim në luftimin e kriminalitetit nga secila qeveri e re në fillimin e punës së saj. Pjesa tjetër e respondentëve mendojnë se janë pjesërisht të kënaqur me punën e agjencive të zbatimit të ligjit.

Tabela 8.

Mos ha	Nr. responentëve	Masat janë të suksesshme	Masat nuk janë të suksesshme/ mendime tjera	Përqindja R. Masat janë të suksesshme	Përqindja R. Masat nuk janë të suksesshme/ mendime tjera ndryshme
21– 25	50	15	35	30%	70%
26 – 35	50	10	40	20%	80%
36 – 45	50	15	35	30%	70%
46 – 55	50	22	28	44%	56%
56 – 65	50	20	30	40%	60%

7.8.12. Informacionet për rastet e proceduara lidhur me konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale

Shumica e responentëve deklarojnë se nuk kanë shumë njohuri lidhur me rastet konkrete të konfiskimit të pasurisë pasi që ka pak transparencë nga organet e ybatimit të ligjit në këtë fushë. Responentët gjithashtu theksojnë se Kosovës i mungojnë numrat e konfiskimit të pasurisë dhe më shumë ka fjalë dhe zhurmë pa veprime konkrete. Responentët deklarojnë se statistikatat e konfiskimeve nuk janë të qasshme për publikun nga ana e Agjencive të zbatimit të ligjit.

Pjesa tjetër e responentëve të cilët vinë nga fusha e drejtësisë kanë njohuri për rastet ku ata i kanë trajtuar personalisht në cilësi të personave zyrtar e gjithashtu deklarojnë se arrijnë të sigurojnë raportet e konfiskimeve, por që situata aktuale len shumë për të dëshiruar. Shih tabelen 9.

Tabela 9. Informacionet për rastet e proceduara lidhur me konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale

Mosha	Nr. responentëve	Kanë njohuri	S'kanë njohuri të mjaftushme	Përqindja R. Që kanë njohuri	Përqindja R. Japin mendime të
21– 25	50	2	48	4%	96%
26 – 35	50	5	45	10%	90%
36 – 45	50	8	42	16%	84%
46 – 55	50	10	40	20%	80%
56 – 65	50	6	44	12%	88%

7.8.13. Gadishmëria e qytetarëve për mbikëqyrjen nga institucionet në sistemin e tyre bankarë

Shumica e responentëve mendojnë se shteti ka të drejtë në çdo kohë të ketë qasje të papenguar në të gjitha të dhënat e personave të dyshuar për vepra penale dhe identifikimin e pasurive dhe transaksioneve të ndryshme të dyshimta të tyre të cilat mund të dërgojnë drejt konfiskimit të pasurisë. Pjesa dërmuese e tyre pranojnë pa hezitim se lejojnë qasje të papenguar të autoriteteve kompetente shtetërore për të pasur qasje në llogaritë e tyre bankare me qëllim të identifikimit dhe luftimit të kriminelve.

Pjesa tjetër e të anketuarve nuk pajtohen me qasjen në llogaritë bankare nga organet e zbatimit të ligjit me arsyetimin e shkeljes së privatësisë, si dhe arsye tjera.

7.8.14. Vlerësimi i shkallës së koordinimit në mes të organeve të zbatimit të ligjit

Shumica e respondentëve deklarojnë se nuk janë aspak të knaqur me nivelin e koordinimit ndërinstitucional në fushën e sekuestrimit, ngrirjes dhe konfiskimit të pasurisë në mes të organeve të zbatimit të ligjit. Për më tepër ata pohojnë se ka raste kur njëri organ tregon më shumë gatishmëri sesa organi tjetër por që në mungesë të koordinimit kriminelët mbesin të pa prekur ose fare pak të prekur në pasurinë e tyre.

Pjesa tjetër e respondentëve, përfaqësues të institucioneve mendojnë se janë bërë hapa të dukshëm në drejtim të konfiskimit të dobisë pasurore dhe se shkalla e koordinimit sipas tyre ka shënuar ngritje viteve të fundit por që akoma është larg nga ajo e dëshiruara.

7.8.15. Pritjet në të ardhmen lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore

Shumica e respondentëve deklarojnë se janë optimist se e ardhmja do të jetë më e mirë dhe deklarojnë se situata në terren do të ndryshoj atëherë kur Qeveria do të alokoj mjete të mjaftueshme për organet e zbatimit të ligjit, e pastaj të kërkohej llogaridhënie për punën dhe efikasitetin e tyre në luftimin e kriminalitetit dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Ata janë optimist gjithashtu edhe me faktin se sistemi i drejtësisë është në konsolidim e sipër dhe me këtë mendojnë se do të rritet efikasiteti i organeve në fushën e konfiskimeve.

Pjesa tjetër e respondentëve shprehin zhgënjimin e tyre dhe nuk shpresojnë për të ardhme më të mirë në këtë fushë dhe të vetmën shpresë e mbajnë emigrimin në botën e jashtme.

7.9. Përfundimet e anketës

Rezultatet treguan se ka një nivel të ndryshëm të vetëdijes së popullsisë. Pothuajse të gjithë përgjegjësit i dhanë një përgjigje pozitive, kur u pyetën për vetëdijen kundër kriminalitetit. Kjo ndodhë për shkak të faktit se mediat shërbejnë si një metodë e fuqishme dhe mënyrë e mësimdhënies së popullsisë në shpërndarjen e informacionit. Po ashtu vigjilenca praktikohet në gjykimin e informatave që mund të mbahet në mend si njohuri dhe si konsideratë e faktit që, edhe autoritetet kanë një sasi të kufizuar të dijes lidhur me qendrimet konkrete që i referohen konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.

Përcaktimi i vetëdijes së popullatës për çështjen e konfiskimit të dobisë pasurore sillet rreth faktit se shumica e njohurive janë tashmë të njohur për popullatën e që mund të konsiderohet si informacion i dorës së dytë.

Në lidhje me kërcënimet e mundshme që janë të vënë nga kriminaliteti, respondentët besonin në rrezik, jo vetëm në të ardhmen, por edhe në kohën e sotme ku zhvillimet e metodave dhe përparimeve të tjera ndodhin në të njëjtën kohë. Po ashtu vendi i origjinës dhe mjedisi nuk janë marrë në konsiderim në studimin e kryer, kjo mund të shërbejë si një arsye për vetëdijesimin e të anketuarve për rreziqet e mundshme të kriminalitetit. Një rezultat i rëndësishëm mund të vërehet tek popullsia e re që kanë përqindjen më të lartë të njerëzve që u besojnë rreziqeve të sjella nga kriminaliteti.

Gjithashtu, një pjesë më e madhe të popullatës besonin se është e mundur që të ketë përfitime të dobisë pasurore për kryerjes së veprave penale. Megjithëse ky është rasti, rezultatet e anketës tregojnë që publiku e njih nevojën për veprim për shkak të faktit se kjo ka një rrezik në rritje që mund të rezultojë nga kriminaliteti.

Ky është shqetësimi kryesor i popullsisë, në këtë mënyrë, rezultatet treguan se një përqindje më e madhe besojnë në kërcënim potencial se ai mund të sjellë.

Në relacion me mendimet e popullatës për veprimet e bëra nga zbatuesit e ligjit, të anketuarit konsiderojnë se autoritetet e nevojshme nuk janë në gjendje për të luftuar dhe në fund për të parandaluar efektet e mundshme që janë të dëmshme e që mund të vijnë nga kriminaliteti. Edhe pse ky është mendimi i popullsisë mostër të hulumtimit, shihet se nuk ka besim i pranishëm në lidhje me aftësinë e autoritetit për të luftuar format e ndryshme kriminale. Andaj propozojnë në shtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe ngritjes profesionale të tyre. Mënyrat tjera të mundshme që janë të konsideruar të jenë të dobishme është edhe studimi në thellësi i metodave të veprimit konkret nga strategjia e qeverisë, i cili është thelbësor që t'i përcaktojë planet e mundshme për të luftuar veprimet e tilla.

Në lidhje me veprimin që është duke u ndërmarrë nga qeveria në bashkëpunim me organizata të ndryshme dhe agjencitë, mendimi i publikut u vlerësuar mesatarisht. Kjo tregoi se agjencitë nuk kanë bërë më të mirën e tyre. Në përgjithësi, përpjekjeve në të ardhmën nga qeveria u ishte dhënë prioritet.

Rezultatet zbuluan se të anketuarit kanë nevojë për njohuri në lidhje me kërcënimin që shkaktohet nga format e ndryshme kriminale. Kjo ndodhë për shkak të faktit se është një keqkuptim i zakonshëm që të çon në nënvlerësim të kërcënimeve që mund të vijnë në shoqëri.

Gjithashtu rezultatet treguan se pjesa me e madhe nuk kanë njohuri konkrete lidhur me konfiskimin e pasurisë të përfituar në mënyrë të kundërligjshme, çka orienton që në të ardhmën të hapa konkret në drejtim të dhënjës së informacioneve nga vet agjencitë e zbatimit të ligjit që merren më këtë fushë.

7.9.1. Kufizimet

Në hulumtim që është kryer janë hasur edhe kufizimet e caktuara. Një kufizim është pengesë në realizimin e të dhënave lidhur me statusin e tanishëm të kryerësve të veprave penale në shoqëri dhe konfiskimit të pasurisë së tyre që e kanë fituar nëpërmjet kriminalitetit.

Edhe pse metoda e studimit mund të paraqesë përfitime të caktuara, kjo metodë gjithashtu paraqet një pasqyrë vetëm të një pjese të popullatës, dhe nuk mbulon mendimet e përgjithshme të popullsisë. Kështu, mundësia e kryerjes së një studimi krahasues me rezultatet e studimit të kryer para se është bërë ky studim ka mundur të shërbejë si referencë.

Pengesa në këtë anketë, janë paraqit edhe kufizimet praktike në procesin e kërkimit dhe kufizimet e kohës.

SHTOJCË

A. Titulli i projektit / punimi i temës së doktoraturës

KONFISKIMI I DOBISË PASURORE TË PËRFITUAR ME VEPËR PENALE

Informatat e Responentëve:

Emri dhe Mbiemri:

Posti /pozita që punon aktualisht:

Adresa elektronike – e-mail:

Informata tjera relevante:

Shënim: A dëshironi që autori i hulumtimit kërkimor shkencor të ju citoj në publikimin e tij apo dëshironi të mbeteni anonim? Ju lutem e nënvizoni në tekstin në vijim

- Ju lutem më citoni
- Dëshiroj të mbetem anonim

P.S

Nëse dëshironi të ju citoj vetëm në disa pyetje atëherë ju lutem më bëni të ditur në cilat pyetje duke u përcaktuar në fund të përgjigjes.

I nderuar respondent,

Qëllimi i këtij studimi është të mësoj më shumë konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale në Republikën e Kosovës dhe më gjerë (vendet e rajonit) – dhe krahasimet me vendet e zhvilluara në SHBA dhe BE si dhe ndikimin negativ në shoqërinë dhe zhvillimin politik të vendit.

Si përmbledhje e kësaj është punimi i doktoratës -hulumtimi tenton që të grumbulloj informacionet rreth konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, analizoj dhe të fokusohet në:

1. Në luftën kundër pastrimit të parave dhe
2. Në luftën kundër kontrollit dhe koncentrimit të pasurisë në duart e elementëve të lidhur me krimin e organizuar; dhe
3. Për të rezultuar me sukses kjo do mbështetje të pakushtëzuar, ka rezultuar shpesh në vështirësi konsekuente mes të cilave, përpjekja për të zbuluar barrën e provës në lidhje me prejardhjen e pasurisë, rezulton ndër më sfidueset.

Në mënyrë që të vazhdoj me hulumtimin e projektit, unë dëshiroj që tju shpreh admirimin tim për vullnetin tuaj për të shkëmbyer opinionin dhe mendimin tuaj rreth çështjes së studimit që kam përpara. Për fat të keq burime financiare nuk kam për kompenzimin gjatë participimit të kohës suaj në këtë studim mirëpo e konsideroj se kjo çështje është shumë e rëndësishme për vendin tonë por edhe për zhvillimet në shtetet e Ballkanit përendimor. Pra do dëshiroja që adresimin e problemit / çështjes së studimit të diskutoj, të ua adresoj në formë të shkruar si formë e pyetësorit me ju ekspertët (hetues, doganier, zyrtar të administratës tatimore, prokuror, gjykatës dhe analist financiar) në mënyrë që konkluzionet të jenë udhërrëfyes për ata që krijojnë politika, që aplikimi i tyre të jetë i kuptueshëm edhe për zbatuesit e ligjit pranë agjencioneve të zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Ju lutëm provoni të përgjigjeni në sa më shumë pyetje që keni njohuri dhe ndihuni të lirë të përgjigjeni dhe të shfrytëzoni hapësirë për përgjigjet e juaja edhe më shumë se sa që kam planifikuar në hapësirat e krijuara për përgjigjet tuaja. Po ashtu ndihuni të lirë që të shtoni informata shtesë që ju i konsideroni që janë të nevojshme. Çdo përgjigje dhe koment tuajin e vlerësoj në mënyrë që studimi të jetë sa më objektiv dhe profesional. Pyetësori është i ndarë në dy pjesë, e para, konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale fokusohet në aspektin e përgjithshëm të njohurive rreth fenomenit të dhe e dyta, ndikimi i grupeve kriminale në çështjet e sigurisë nacionale dhe kërcënimet e sfidat që paraqiten për agjencionet e zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës. Këto çështje ne mund ti

diskutojmë përmes telefonit, ose të ndani kohë për 20 – 30 minuta në mënyrë që të kompletoni pyetësin dhe të më ktheni përgjigjet e juaja përmes faksit, e-mailit (në varësi të vullnetit dhe gatishmërisë suaj).

Ju mund të mbeten në tërësi anonim mirëpo, nëse dëshironi të citoheni në të gjitha apo në disa pyetje ju lutem më bëni të ditur sepse në përfundim të këtij studimi autori planifikon në tërësi ta botoj hulumtimin apo disa pjesë të saj në revistat shkencore dhe në rast se dëshironi të citoheni paraprakisht do marrë pëlqimin tuaj nëse jo atëherë ju garantoj se i tërë pyetësi do mbetet konfidencial dhe i pacituar nën emrin dhe personalitetin tuaj.

Po ashtu krejt në fund ju bëj me dije se ju eksperti i anketuar dhe intervistuar sapo ta përfundoj studimin do të pranoni një kopje të këtij studimi.

Ju falenderoj që më parë për kohën dhe interesimin tuaj në pjesëmarrjen në këtë studim, nëse keni ndonjë pyetje rreth kësaj çështjeje ju lutem mos hezitoni të më kontaktoni në çdo kohë.

Me konsideratën time më të thellë,

Sevdali Zejnullahu Kandidat për PhD

Tel. +383 44 360500

e-mail: sevdali.zejnullahu@hotmail.com

Kopje e këtij pyetësi njoftohet mentori i temës së doktoraturës:

Prof. Dr. Bashkim Zahiti, (LL.M)

Tel. +49 157 5349 55 23

e-mail: bashkimzahiti@web.de

B. Pyetje rreth çështjes nga konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale:

1. Cilat janë njohuritë e juaja rreth institutit të konfiskimit të pasurisë të përfituar me vepër penale?

2. Cilat janë opinionet e juaja rreth efektivitetit të parandalimit të kriminalitetit në të ardhmën nëpërmjet konfiskimit të pasurisë së paligjshme të tyre?

3. A keni njohuri rreth aktiviteteve kriminale në Republikën e Kosovës?

4. Çka mendoni, cilat janë arsyejet e operimit të grupeve të ndryshme kriminale në Kosovë që ndërlidhen me shpëlarjen e parave, trafikimin me qenie njerëzore, prostitucionin, trafikimin me narkotik etj.?

5. Cilat janë mendimet e juaja për efikasitetin dhe mundësitë e institucioneve të zbatimit të ligjit në Kosovë që të garantojnë siguri me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit?

6. Cilat janë njohuritë e juaja për zbatimin e konfiskimit të pasurisë së paligjshme në Republikën e Kosovës?

7. Cilat janë opinionet e juaja për efikasitetin e masave të deritanishme të agjencioneve të zbatimit të ligjit në konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale?

8. A keni njohuri apo informacionet për rastet e proceduara lidhur me konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale në Republikën e Kosovës?

8. Sa jeni të gatshëm që të pranoni mbikëqyrjen nga institucionet në sistemin e tuaj bankar?

9. Çka mendoni cila është shkalla apo niveli i koordinimit në mes të organeve të zbatimit të ligjit lidhur me konfiskimin e pasurisë të përfituar me vepër penale?

10. Cilat janë pritjet e juaja në të ardhmen lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale?

11. Cilat janë opinionet mbi ndjeshëmrin e organizatave dhe agjencive të zbatimit të ligjit ndaj dobisë pasurore të përfituar me vepër penale?

12.Përgjigjet në lidhje me aftësinë e qeverisë për t'u marrë me konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale?

- Po ka zhvilluar kapacitetet
- Ka pak mundësi

13.Sipas juve cilat janë mënyrat apo metodat për të luftuar kriminalitetin dhe ngritur nivelin e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale?

14. Opinionet mbi efektet e të dhënave në internet, kundër kryerësve të veprave penale me qëllim të konfiskimit të dobisë pasurore?

15. Sipas mendimit tuaj, sa i kushtohet rëndësi alokimit të fondeve nga qeveria për sundimin e rendit dhe ligjit me theks të veçantë në ngrijten e nivelit të konfiskimit?

16. Opinioni lidhur me informacionin që jepet nga qeveria për popullsinë, lidhur me konfiskimin e pasurisë të përfituar me vepër penale?

17. Lufta kundër kriminalitetit dhe konfiskimi i pasurisë – dobisë pasurore?

- Ulët
- Mesatar
- Lartë
- Shumë Lartë
- Nuk e di

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

I. Përfundime

Gjatë hartimit të punimit, jemi përpjekur që në kuadër të çdo kapitulli, të nxirren përfundime individuale të cilat na qojnë drejtë përfundimeve si tërësi, duke i nënvizuar fushat të cilat vlerësohen si thelbësisht të rëndësishme në zbatimin e konfiskimit të dobisë pasurore të përfituar me vepër penale.

Krimi i organizuar, korrupsioni, shpëlarja e parave, duke përfshirë edhe të gjitha llojet e trafikimit si të qenjeve njerëzore e gjithashtu edhe trafikimit të armëve dhe drogave të ndryshme si format më profitabile për kriminelët, janë prezente në të gjitha shtetet, e posaçërisht në shtetet në tranzicion siç janë shtetet e Ballkanit Perëndimor, të cilat kanë sistem të brishtë juridik, ekonomik dhe financiar, pjesë e të cilit është edhe Kosova. Përpjekjet për parandalimin e veprimtarive kriminale në Republikën e Kosovës, janë të vazhdueshme, si në aspektin legjislativ duke avancuar gjithnjë e më tepër rregullat për parandalimin, e gjithashtu edhe ashpërsimin e dënimeve ndaj kryesve të këtyre veprave penale, por që nuk janë treguar të suksesshme.

Republika e Kosovës përkundër progresit evident, me kornizën më të re ligjore nuk i ka rezultatet e dëshiruara në fushën e konfiskimit të pasurisë së paligjshme. Mangësitë ligjore të identifikuara do duhej rishqyrtuar me rastin e ndryshimeve, plotësimeve dhe të përpunimit të ardhshëm të dispozitave ligjore.

Në këtë aspekt, qëllimi është që të theksohen propozimet më të rëndësishme *de lege ferenda*, të cilat janë me rëndësi thelbësore për realizimin e qëllimit që dëshirohet të realizohet me zbatimin e masës së konfiskimit të pasurisë së përfituar në mënyrë të kuundërligjshme.

Sipas llojeve të efekteve që dëshirohet të realizohen, përfundimet e paraqitura mund t'i përmbledhim me sa vijon:

- Konfiskimi i pasurisë të fituar në mënyrë të kundërligjshme në të gjitha shtetet të cilat janë pjesë e hulumtimit të këtij disertacioni të doktoratës, gjejmë se, është i rregulluar me ligj të veçantë, për faktin se vetëm kodi penal dhe procedural janë të treguar të pamjaftueshëm në ngritjen e shkallës së konfiskimit të pasurisë së paligjshme.

- Konfiskimi i pasurisë së fituar nga vepra penale është masë e re në të drejtat vendore të Shqipërisë dhe të Kosovës, e cila nuk e ka fituar mjaftueshëm bazueshmërinë e saj në dispozitat e të drejtës penale (edhe pse rregullimi më i detajuar i saj me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale do të ishte e dëshirueshme), por është vendosur me ligjet e veçanta me të cilat janë përcaktuar dispozita specifike, me të cilat është rregulluar fusha për konfiskimin e pasurisë të fituar nga vepra penale. Institutin e konfiskimit të pasurisë, në një anë, e ka determinuar dukuria e formave bashkohore të kriminalitetit i cili nuk njeh kufijë, por njëkohësisht kjo është edhe kërkesë permanente e bashkësisë ndërkombëtare, e cila ka vendos detyrimin e standardizimit të rregullave në fusha të caktuara, e në të cilat bie edhe detyrimi i vendosjes së masave me të cilat bëhet goditja në pasurinë kriminale.
- Konfiskimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale është masë specifike (*sui generis*) e të drejtës penale.
Konfiskimi i dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, është e përcaktuar si dënim plotësues, në esencë është masë specifike (*sui generis*) e cila restitucionin e ka si qëllim primar të saj, bashkë me realizimin e efekteve speciale dhe gjenerale të preventivës dhe të prezencës së karakterit penal.
- Republika e Kosovës në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë has në probleme të vazhdueshme, në veçanti në identifikimin e pasurive të fituara në mënyrë të kundërligjshme të cilat gjinden jashtë Kosovës, për shkak të statusit të saj politik dhe mos anëtarësimit në organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare.
- Problem në vete në identifikimin e pasurive të paligjshme, paraqesin edhe remitencat e larta të emigrantëve si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri.
- Mungesa e kordinimit të mjaftueshëm ndërinstytucional midis organeve të zbatimit të ligjit, paraqet problem në mos efikasitetin konfiksimit të pasurisë së paligjshme në praktikë.
- Sipas ligjit të veçantë për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit të pasurisë, të provuarit, bazohet në të ashtuquajturën barra e ndarë e të provuarit, të cilën e drejta e Kosovës nuk e ka njohur më herët.
Me këtë veprim, është devijuar nga disa principe klasike të të drejtës penale, për çka ka nxitë debate në qarqe akademike dhe praktikën gjyqësore, mirëpo me analizën e thellë të rregullave për barrën e të provuarit të cilat vlejné në procedurën

e konfiskimit të pasurisë, shohim se të drejtat e të pandehurit janë garantuara dhe se nuk ka frikë për ata të cilët kanë fituar të hyra me aktivitetet e ligjshme.

Në të vertetë, nuk bëhet fjalë këtu se prokurori vetëm me pohim, barrën e të provuarit e kalon në të akuzuarin, por prokurori në mënyrë të argumentuar duhet të paraqes dëshmitë si pjesë e kërkesës për konfiskimin e pasurisë, ndërsa i akuzuari ka mundësi që të hedh poshtë pohimin e prokurorit dhe të bashkangjes prova me të cilat kundërshtimin e tij do ta argumentojë.

- Zbatimi i masës së konfiskimit të pasurisë, nuk e cenon supozimin e pafajsisë së të akuzuarit, e as ndalesën e zbatimit retroaktiv të ligjit, në parim. Por duhet nënvizuar faktin se ligji për konfiskimin e zgjeruar të pasurisë, kur thekson se pasuria që mund t'i nënshtrohet konfiskimit është gjithë ajo që është fituar pas luftës, lënë mundësin për keqpërdorime. Është e nevojshme që në rast të rishikimit të legjislacionit, ky afat të jetë më i shkurtë.
- Për të pasur sukses dhe ngritur shkalla e konfiskimit të pasurisë së fituar me veprë penale, hetimi duhet të jetë mirë i organizuar dhe i pajisur me kuadër kompetent. Në këtë drejtim, duhet të parashihet me ligj që, hetimi në këtë fushë të bëhet nga polica gjyqësore e cila do të jetë e përbërë vetëm nga juristët, me specializime në fushën e financave.
- Konfiskimi i përkohshëm (sequestrimi) është etapë e detyrueshme e procedurës i cili përveç tjerash, ka për qëllim pengimin e të akuzuarit që ta tjetërsojë pasurinë e fituar në mënyrë kriminale, ndërsa sipas gjendjes ekzistuese në praktikë, me mënyrën sipas të cilës zbatohet, nuk është paraqitur se qelësi i ekzistimit të saj është konfiskimi i përhershëm. Kjo etapë e procedurës në praktikë zgjatë shumë, me çka i kontribuon zvarritjes së panevojshme të procedurës, duke krijuar edhe shpenzime të panevojshme. Në këtë drejtim, me ligj do të duhej përcaktuar një afat ligjor i arsyeshëm, dhe jo të varet nga përfshirja në aktin akuzues e më pas të pritët epilogu lidhur me fajësin apo jo, të të pandehurit.
- Administrimi me pasurinë e konfiskuar për shkaqe procedurale nuk arrin objektivat e duhura. Duhet të intensifikohet dhënja me qera e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, sepse nga njëra anë do të mbushej arka e shtetit nga të hyrat e tyre, nga ana tjetër nuk do humb kot vlera e tyre, madje duke krijuar shpenzime të panevojshme për mirëmbajtje. Për më tepër, nëse duhet të kthehen pasuritë e sekuestruara për shkak të vërtetimit të legjitimitetit të tyre, atëherë shtetit do bie barrë me e vogël për kompenzim.

II. Rekomandime

Sa më sipër dhe në kuadër të përfundimeve të nxjerra, dalin natyrshëm edhe rekomandime më konkrete të cilat mund të përmbliidhen me sa vijon:

1. Nevojën e rritjes së nivelit të vetëdijes profesionale dhe humane të organeve që marrin pjesë në luftën kundër krimit të organizuar dhe veprave tjera penale me qëllime përfitimi, nepërmjet edukimit sistematik, si domosdoshmëri e përparimit të masave për luftimin e krimit dhe konfiskimin e pasurive të paligjshme;
2. Gjyqësori duhet të fokusohet edhe në shqiptimin e dënimeve plotësuese të konfiskimit, e jo vetëm të dënimeve kryesore.
3. Kodi i procedurës penale në nenet 268-273, të ndryshohet për të përcaktuar një afat ligjor limitues për procedurën e konfiskimit të përkohshëm të pasurisë, që të mos zvarritet procedura e konfiskimit të përhershëm të pasurisë së paligjshme, pasi që është e varur nëse ajo pasuri përfshihet në aktakuzë dhe i pandehuri të shpallet fajtor.
4. Ligji nr. 04/L-140 për kompetenca të zgjeruara të konfiskimit të pasurisë së përfituar me vepër penale, të ndryshohet neni 2 duke e përcaktuar se për cilat vepra penale mund të zbatohen dispozitat ligjore të këtij ligji.
5. Ligji nr. 04/L-140 për kompetenca të zgjeruara të konfiskimit të pasurisë së përfituar me vepër penale, të ndryshohet neni 6 ku përcakton si kriter që pasuritë pas vitit 1999 t'i nënshtrohen kërkesës për konfiskim, ashtu që të përcaktohet afat më i shkurt kohor, kjo nga njëra anë do t'i bënte më efikase organet e ndjekjes, e në anën tjetër do të krijon siguri juridike për qytetarët.
6. Të intensifikohen përpjekjet e shtetit të Kosovës për antarësim në mekanizma ndërkombëtarë dhe të bëhet palë në shumë konventa ndërkombëtare në fushën e të drejtës penale dhe të drejtës penale ndërkombëtare në përgjithësi dhe konfiskimit të dobisë pasurore në veçanti.

Është e kuptueshme që të gjitha këto përfundime dhe rekomandime janë në fakt, një mënyrë për të ndihmuar sado pak teorisë juridike, pastaj organeve legjislative dhe atyre të zbatimit të ligjit, që tentojnë të jenë në luftë të përhershme me të keqen, në funksion të vendosjes së sundimit të ligjit në Kosovë.

Kjo nuk është një luftë e thjeshtë dhe as e lehtë për të siguruar rezultat e sidomos për Kosovën, e cila nuk është pjesë e mekanizmave dhe nuk është palë në instrumentet më të

rëndësishme ndërkombëtare, edhe pse synimi i shtetit të Kosovës është anëtarësimi në strukturat e BE-së dhe OKB-së.

L I T E R A T U R A

I. BURIMET PARËSORE:

Kode, ligje, dhe konventa.

1. Kushtetua e Republikës së Kosovës, 2008.
2. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2012.
3. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, 2012.
4. Kodi i drejtësisë për të mitur, i Republikës së Kosovës, 2010.
5. Ligji Nr. 04/L-140, për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale, i Republikës së Kosovës, 2013.
6. Ligji Nr. 03/L-141, për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, i Republikës së Kosovës, 2009.
7. Ligji Nr. 05/L-096, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, i Republikës së Kosovës, 2016.
8. Ligji Nr. 03/L-196, për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, i Republikës së Kosovës, 2010.
9. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, 2005.
10. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, 2005.
11. Ligji Nr. 9284, për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, i Republikës së Shqipërisë, 2004.
12. Ligji Nr. 10192, për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, i Republikës së Shqipërisë, 2009.
13. Ligji Nr. 157, për masat kundër financimit të terrorizmit, i Republikës së Shqipërisë, 2013.
14. Ligj Nr.10193, për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale, i Republikës së Shqipërisë, 2009.
15. Ligj Nr.8722, për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope, 2000.
16. Ligji Nr. 9920, për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, 2008.
17. Ligji Nr. 8610, për parandalimin e pastrimit të parave, i Republikës së Shqipërisë, 2000.
18. Ligji Nr. 8750, për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope, i Republikës së Shqipërisë, 2001.

19. Ligji Nr. 9086, për disa shtesa dhe ndryshime të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, 2003.
20. Ligji Nr. 9271, për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7975, dt.26.07.1995, Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope, i Republikës së Shqipërisë, 2004.
21. Ligji Nr. 9917, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i Republikës së Shqipërisë, 2008.
22. Ligji Nr.8619, për parandalimin e pastrimit të parave, i Republikës së Shqipërisë, 2000.
23. Ligji Nr. 70, për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10192, dt. 3.12.2009, për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, 2017.
24. Udhëzim Nr.15, për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit në sistemin doganor, në Republikën e Shqipërisë, 2009.
25. Kodi Penal i Republikës së Kroacisë, 2012.
26. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kroacisë, 2013.
27. Ligji nr.145/2010, për procedurën e konfiskimit të dobisë pasurore të realizuar me veprë penale dhe kundërvajtje, i Republikës së Kroacisë, 2010.
28. Ligji nr. 70/12, për administrimin e pasurisë shtetore, i Republikës së Kroacisë, 2102.
29. Ligji Penal i Republikës së Sllovenisë, 2008.
30. Ligji i Procedurës Penale të Republikës të Sllovenisë, 2007.
31. Ligji për Procedurën Tatimore i Republikës të Sllovenisë, 2011.
32. Ligji për Shërbimin Tatimor i Republikës të Sllovenisë, 2007.
33. Ligji penal i Bosnjës dhe Hecegovinës, 2003.
34. Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligji penal i Bosnjës dhe Hecegovinës, 2010.
35. Ligji nr.10/12, për konfiskimin e pasurisë të fituar me kryerjen e veprës penale, për Republikën Serpska, 2012.
36. Kodi Penal i Republikës së Serbisë, 2009.
37. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Serbisë, 2014.
38. Ligji për konfiskimin e pasurisë që rrjedh nga vepra penale, i Republikës së Serbisë, 2008.
39. Ligji Italian Rognoni - La Torre, 1982.
40. Kodi Penal i Republikës së Italisë, 2016.

41. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Italisë, 2011/2012.
42. Ligji Italian Antimafia, 2017.
43. Kodi Penal i Republikës së Sllovakisë, 2005.
44. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Sllovakisë, 2005.
45. Ligji për dëshmimin e prejardhjes së pasurisë i Republikës së Sllovakisë, 2005.
46. Ligji i Drejtësisë Penale i Republikës së Irlandës, 2011.
47. Ligji Penal i Republikës së Irlandës 1997, i ndryshuar 2016.
48. Ligji i Procedurës Penale i Republikës së Irlandës, 2010, i ndryshuar 2017.
49. Ligji për dobinë pasurore të fituar me vepër penale i Republikës së Irlandës, 1996 i amendamentuar 2005.
50. Ligji i Procedurës Penale i Anglisë, 2000.
51. Ligji për dobinë pasurore të fituar me vepër penale i Anglisë, 2002.
52. Ligji për policin dhe krimin e organizuar i Anglisë, 2005.
53. Ligjin për krime të rënda i Anglisë, 2007.
54. Kodi Penal i Republikës së Francës, 2005.
55. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Francës, 2006.
56. Ligji nr. 2010-767 për sekustrim dhe konfiskim i Republikës së Francës, 2010.
57. Kodi Penal i Republikës së Gjermanisë, 1998 i amendamentuar 2009.
58. Kodi Penal i Republikës së Bullgarisë, 1968 i amendamentuar 2017.
59. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë veriore, 2009 i amendamentuar 2018.
60. Kodi Penal i Republikës së Suedisë, 1962 i amendamentuar 1999.
61. Kodi Penal i Republikës së Belgjikës, 2016.
62. Dokumentet dhe rekomandimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së “Për korrupsionin”, Dokumenti C/CN.15.2001.3. f. 27, 2 prill 2001.
63. Konventa e Këshillit të Evropës “Për shpëlarjen e parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga veprimtaria kriminale”, Strasburg, 2003.
64. Konventa e OKB-së kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, Vjenë, 1998.
65. Konventa e Vjenës e OKB-së “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”, 15 nëntor 2000 .
66. Konventa e OKB-së mbi drogat narkotike e ndryshuar nga protokolli i vitit 1971, për ndryshimin e konventës së vetme mbi drogat narkotike të vitit, 1961.
67. Konventa e Këshillit të Europës “Mbi pastrimin, kërkimin, marrjen dhe konfiskimin e produkteve të rrjedhura nga krimet”, Strasburg, 1990.

68. Konventa Ndërkombëtare për luftimin e financimit të terrorizmit, New York, 1999.
69. Konventa penalo-juridike e Këshillit të Europës për korrupsionin, Strasburg, 1999.
70. Konventa Ndërkombëtare për luftimin e financimit të terrorizmit, New York, 1999.
71. Konventa penalo-juridike e Këshillit të Europës për korrupsionin, Strasburg, 1999.
72. Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar transnacional dhe protokollet plotësuese, Palermo, 2000
73. Konventa e OKB-së kundër korrupsionit, New York, 2003.
74. Konventa Europiane “Per ekstradimin” nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më, 19.05.1998, hyrja në fuqi më 17.08.1998;
75. Konventa Europiane “Për ndihmën e ndërsjellte juridike ne fushën penale, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, më 19.05.1998, ratifikuar më 04.04.2000, hyrja në fuqi 03.07.2000.
76. Konventa Europiane “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale”, nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, më 04.04.2000, hyrja në fuqi më 05.07.2000;
77. Konventa Europiane “Për transferimin e personave të dënuar” nënshkruar më 19.05.1998, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, më 04.04.2000, hyrja në fuqi 01.08.2000;
78. Konventa “Për pastrimin, kërkimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të krimit” nënshkruar më 04.04.2000, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, më 31.10.2001, hyrja në fuqi 01.02.2002;
79. Konventa për legjislacionin penal mbi Korrupsionin nënshkruar më 27.01.1999, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, më 19.07.2001, hyrja në fuqi 01.07.2002;
80. Konventa Europiane për Vlefshmërinë e Vendimeve Gjyqësore të Huaja, nënshkruar më 08.06.2000, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, më 22.10.2003, hyrja në fuqi 23.01.2004;
81. Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikimit të Paligjshëm të Substancave Narkotike dhe Psikotrope – ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, më 27.07.2001
82. Marrëveshje dypalëshe mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë “Mbi transferimin e personave të dënuar”;
83. Marrëveshje dypalëshe mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë “Për ekstradimin” dhe “Për ndihmën e ndërsjellte juridike në çështjet penale”;
84. Marrëveshje dypalëshe midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës “Për ekstradimin”;

85. Memorandum mirëkuptimi për bashkëpunimin mes Zyrave të Prokurorive të Përgjithshme të Kroacisë dhe Shqipërisë në luftën kundër krimit ndërkufitar dhe pastrimit të produkteve të këtij lloj krimi ;
86. Memorandum Mirëkuptimi mes Zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Maqedonisë dhe asaj të Maqedonisë, të Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Bosnjës dhe Hercegovinës, asaj të Kroacisë, të Zyrës së Prokurorit Publik të Serbisë dhe të Kryeprokurorit të Malit të Zi për Bashkëpunim Rajonal kundër Krimit të Organizuar, nënshkruar në Shkup më 30.03.2005.
87. Memorandum mirëkuptimi për Bashkëpunimin mes Zyrave të Prokurorive të Përgjithshme të Maqedonisë dhe Shqipërisë në luftën kundër krimit ndërkufitar, trafikimit të qenieve njerëzore dhe emigracionit të paligjshëm.
88. Memorandum mirëkuptimi për bashkëpunimin mes Zyrave të Prokurorive të Përgjithshme të Shqipërisë dhe Malit të Zi në luftën kundër krimit të organizuar.
89. Amendamenti nr. 4 në marrëveshjen për asistencë në mes të SHBA-ve dhe Republikës së Kosovës (publikuar më 19.09.2012) .
90. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Suedisë për bashkëpunim në zbatimin e ligjit për parandalimin dhe luftimin e krimeve të rënda (publikuar më 03.09.2012).
91. Marrëveshje në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane mbi transferimin e personave të dënuar (publikuar më 05.06.2012).
92. Marrëveshje në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Kroacisë për ndihmë të ndërsjellë ligjore në çështjet penale.
93. Marrëveshje në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës Zvicerane mbi transferimin e personave të dënuar.
94. Ratifikimi i marrëveshjes për transferimin e personave të dënuar, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.
95. Ratifikimi i marrëveshjes mbi ekstradimin, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.
96. Ratifikimi i marrëveshjes mbi ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë.
97. Ratifikimi i marrëveshjes mbi ekstradimin, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

98. Ratifikimi i marrëveshjes mbi ndihmën e ndërsjellë ligjore në çështjet penale, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonië.
99. Ratifikimi i marrëveshjes ndërkombëtare për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë (publikuar më 06.06.2011).
100. Vendimi i KBE nr 2001/500 JHA, kornizues për pastrimin e parave, identifikimin, përcjelljen, ngrirjen, konfiskimin e mjeteve dhe të hyrave nga vepra penale, 2001.
101. Vendimi i KBE nr. 2003/577 JHA, kornizues për zbatimin e urdhëresave për ngrirje të pasurisë ose të dëshmive, 2003.
102. Vendimi i KBE, nr. 2004/757/JHA, kornizues për vendosjen e dispozitave minimale për elementët thelbësorë të veprave penale dhe të dënimeve në fushën e trafikimit të paligjshëm të mjete narkotike, 2004.
103. Vendimi i KBE, nr. 2003/212/JHA, kornizues për konfiskimin e përhershëm të të hyrave, mjeteve dhe pasurive të ndërlidhura me kriminalitetin, 2003.
104. Vendimi i KBE, nr. 2006/783/JHA, kornizues për zbatimin e parimit të pranimit reciprok të urdhërit për konfiskim të përhershëm, 2006.
105. Direktiva nr. 2012/0036, për ngrirjen dhe konfiskimin e përhershëm të të hyrave të fituara me vepër penale në Bashkimin European, 2014.
106. Urdhëri European i Hetimeve, 2017.

II. BURIMET DYTËSORE:

a) **Libra dhe monografi:**

1. Albrecht, J. Hans, "The Money Trail, Developments in Criminal Law, and Research Needs: An Introduction", *Eur.JCr, Cr.L & Cr.J*, 1997.
2. Alessandri, Alberto, *Confisca nel diritto penale*, Digesto delle Discipline Penalistiche III, UTET, Torino, 1998.
3. Alldridge, Peter, *Money Laundering Law- Forfeiture, Confiscation, Civil Recovery, Criminal Laundering and Taxation of the Proceeds of Crime*. Hart Publishing Oxford&Portland, Oregon, 2003.
4. Andrew Sanders and Richard Young, "Criminal Justice" the 2 edition, London, 2000.
5. Aubert, Maurice., "Quelques aspects de la port.e du secret bancaire en droit penal interne et dans l'entraide judiciaire internationale", 1984.
6. Aubert, Maurice, Beguin, Pierre Andre, Bernasconi, Paulo, Graziano-Von Burg, J., Schwob, Renate and Treuillaud, Raphael, *Le secret bancaire suisse. Droit priv., p.nal, administratif, Fiscal, proc.dure, entraide et conventions internationales*, Berne, 1995.
7. Bassiouni, M. Cherif. and Gualtieri, S. David., "International and National Responses to the Globalization of Money Laundering", in *Responding to Money Laundering*, 1997.
8. Bergin, T. Jeffrey., "Piercing the Secret Bank Account For Criminal Prosecutions: An Evaluation of United States's Extra-territorial Discovery Techniques and the Mutual Assistance Treaty", *Ariz.JInt'l & Comp.L*, 1990.
9. Black, F. Stephen., "United States Transnational Discovery: The Rise and Fall of the Hague Evidence Convention", 1991.
10. Blakesley, L. Christopher and Lagodny, Otto, "Finding Harmony Amidst Disagreement Over Extradition, Jurisdiction, The Role of Human Rights, and Issues of Extraterritoriality Under International Criminal Law", 1991.
11. Blakesley, C. L., "Extra-territorial Jurisdiction", in *International Criminal Law, Volume II: Procedure*, Bassiouni, M. C., New York: Transnational Publishers, Inc., 1986.
12. Blumenson, Eric and Nilsen, Eva, "Policing for Profit: The Drug War's Hidden Economic Agenda", *University of Chicago Law Review*, 1998.
13. Bollmann, Hans, "Switzerland", *International Bank Secrecy*, 1992.

14. Born, Gary. and Westin, David., *International Civil Litigation in the United States Courts*, Deventer: Kluwer Law and Taxation Publishers, 1992.
15. Brown, Alastair, "Money Laundering: A European and U.K. Perspective", *JIBL* 1997.
16. Candler, J. Linda, "Tracing and Recovering Proceeds of Crime in Fraud Cases: A Comparison of US and UK Legislation", *The International Lawyer*, 1997.
17. Civici, Adrian, *Kriza Financiare apo Globale*, Tiranë, 2010.
18. Christopher L. Blakesley *Terrorism, Drugs, International Law, and the Protection of Human Liberty. A Comparative Study in International Law, Its Nature, Role, and Impact in Matters of Terrorism, Drug Trafficking, War, and Extradition*, New York: Transnational Publishers, Inc., 1992.
19. Dickson, Anne, "Taking Dealers to the Cleaners", *NLJ*, 1991.
20. Drage, John, "Countering Money Laundering: The Response of the Financial Sector", in *Money Laundering*, The David Hume Institute, Edinburgh University Press, 1993.
21. Elezi, Ismet, "E drejta penale e Republikës së Shqipërisë", Tiranë, 2002.
22. Elezi, Ismet, "E drejta Penale Pjesa e Posaçme", Tiranë 2005.
23. Elezi, Ismet, dhe Hysi, V., "Politika Penale", PEGI, Tiranë, 2006.
24. Elezi, Ismet, Kacupi Skënder dhe Haxhia Maksim, *Komentari i Kodit Penal (pjesa e përgjithshme)* Tiranë 2009 (azhornuar e plotësuar me shtesat dhe ndryshimet e bëra me reformat ligjore të viteve 2001, 2003, 2004, 2008 si edhe me praktikën gjyqësore).
25. Elezi, Ismet, *Mendimi Juridik Shqiptar*, Tiranë 1999.
26. Elezi, Ismet, *Zhvillim historik i legjislacionit Penal në Shqipëri* Tiranë 1997.
27. Ethan A. Nadelmann, *Unlaundering Dirty Money Abroad: US Foreign Policy and Financial Secrecy Jurisdictions*, *Inter-American LR*, 1986.
28. Fedders, J. M., "Policing Internationalised US Capital Markets: Methods to Obtain Evidence Abroad", *International Law*, 1984.
29. Freiberg, Arie, "Confiscating the Literary Proceeds of Crime", *Crim.LR*, 1992.
30. Fried, J. David., "Rationalising Criminal Forfeiture", *JCr.L & Crim.* (1988).
31. Gane, C. and Mackarel, M., "The Admissibility of Evidence Obtained from Abroad into Criminal Proceedings - The Interpretation of Mutual Legal Assistance Treaties and Use of Evidence Irregularly Obtained", *Eur.JCr., Cr.L & Cr.J* (1996).
32. Gashi, Rexhep, "Krimi i organizuar", Prishtinë, 2011.

33. Gilmore, C. William, *Dirty Money. The Evolution of Money Laundering Counter-Measures*, 2004.
34. Gleason, Paul and Gottseling, Glen, “Financial Units Intelligence an overview”, Washington, 2004.
35. Govedarica, Milimir, *Oduzimanje imovine stecene izvršenjem krivičnog dela preventivni – represivni aspekt*, Banja Luka, 2013.
36. Golobinek, Robert, *Hetimet financiare dhe konfiskimi i pasurisë së fituar me vepra penale, doracak për pjestarët e policisë dhe gjyqësorit*, Këshilli i Europës, Strazburg, 2006.
37. Gjonça, Luan dhe Gjonça Genc, *Kriminologjia (tekst mësimor)*, Tiranë, 2009.
38. Gjonça, Luan, *Korrupsioni, veprat penale përbërëse, krimi i organizuar*, Tiranë, 2005.
39. Hajdari, Azem, “Kriminaliteti i të miturve në Kosovë 2001-2003”, Prishtinë, 2004.
40. Hajdari, Azem, “Sistemi i drejtësisë për të mitur”, Prishtinë, 2011.
41. Hajdari, Azem, “Bazat e sistemit gjyqësor”, Prishtinë, 2013.
42. Hajdari, Azem, “Efikasiteti procedural dhe të drejtat e njeriut në procedurë penale”, Prishtinë, 2011.
43. Hajdari, Azem, “Shkathtësitë e praktikës gjyqësore”, Prishtinë, 2013.
44. Hajdari, Azem, “Veprat penale me natyrë korrupsioni me një vështrim të posaçëm në Kosovë”, Prishtinë, 2003.
45. Hajdari, Azem, “Kriminaliteti i organizuar”, Prishtinë, 2006.
46. Halili, Ragip, “Kriminologjia”, Kosovë, 2010.
47. Halili, Ragip, *Kriminologjia*, Prishtinë, 2011.
48. Halili, Ragip, *Penologjia*, Prishtinë, 2010.
49. Halili, Ragip, *Viktimologjia*, Prishtinë, 2011.
50. Harmon, J. D., “United States Money Laundering Laws: International Implications”, *NYUJInt'l L& Comp.L*, 1988.
51. Haynes, Andrew, “Money Laundering and Changes in International Banking Regulation”, *JIBL* (1993).
52. Haynes, Andrew, “Financial Services Law Guide”, London, 2014.
53. Hauck, Pierre and Peterke, Sven, “International law and transnational organized crime”, Oxford, 2016.
54. Hinterseer, Kris, *Criminal Finance, the political economy of money laundering in a comparative legal context*, Hague, 2002.

55. Hysi, Vasilika, “Kriminologjia”, Tiranë, 2006.
56. Islami, H., Hoxha A., Panda I., “Procedura Penale”, Botimet Morava, Tiranë 2010.
57. Ivcevic-Karas E. Utvrdjivanje imovinske koristi stecene kaznenim djelom primenom bruto ili neto nacela s obzirom na pravnu prirodu mere (prosirenog) oduzimanja imovinske koristi, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu, Zagreb, vol. 17, broj 1/2010)
58. ISSR (Kosovo Internal Security Sector Review), 2006.
59. Jason-Lloyd, Leonard, “ The Law on Money Laundering, Statutes and Comentary, 1997.
60. Jelec, Nihada dhe Osmanovic, Aida, Drçar-Murko, Propisi o Odozimanje Imovine Stečene Krivičnim Djelom I Upravljanju Tom Imovinom, Sarajevë, 2012.
61. Joutsen, Matti, “The European Union and cooperation in Criminal Matters: The Search for balance, nr. 25, Helsinski, 2006
62. Kaldor, Mary, “New and Old Wars: Organized Violence in a Global Era” 3rd Edition, Cambridge, 2012.
63. Kambovski, Vlado, “E drejta Penale në Maqedoni”, Shkup, 2007
64. Karajkov, Risto, Democracy in Macedonia: Fist Fights, Threats to Women, and Journalist Battering, in *Newropeans Magazine*, October 5th, 2007.
65. Latifi, Vesel, “Kriminalistika” Prishtinë 2011.
66. Levasseur, George; Chavanne, Albert; Montreuil, Jean; Bouloc, Bernard, Droit pénal general et procédure pénale, Sirey editions, 1999
67. Los, Maria “Post Communist fear of crime and the commercialization of security”, in *Theoretical Criminology*, Vol. 6, No. 2, 2002.
68. Los, Maria (2003) ‘Crime in Transition: The post-Communists state, markets and crime’, in *Crime, Law and Social Change*, [Volume 40, Numbers 2-3 / October, 2003](#)
69. Los, Maria (2005) ‘Reshaping of Elites and the Privatization of Security: The Case of Poland’, in *The Journal of Power Institutions in Post-Soviet Societies*, Issue 2 - 2005 - Reflections on Policing in Post-Communist Europe.
70. Mecalla, Naim, “Aspekte juridike dhe kriminologjike të pastrimit të parave”, Tiranë, 2017.
71. Muca, Shefqet, “E Drejta Penale- Pjesa e Përgjithshme” Tiranë, 2007.
72. Murati, Rexhep, Rishikimi i procedurës penale për shkak të fakteve dhe provave të reja, Prishtinë, 2006.

73. Nadelmann, Ethan, "Negotiations in Criminal Law Assistance Treaties", *Am.J.Comp.L.* (1985).
74. OECD (2005) DAC Guidelines and Reference Series, *Security System Reform and Governance*.
75. OECD (2007) *DAC Handbook on Security System Reform: Supporting security and justice*.
76. Peacock, Alan, *The Political Economy of Economic freedom*, Lyme, 1997.
77. Pavišić, Berislav, *Osnovni krivični zakon Republike Hrvatske (bilješke, literatura, sudska praksa, prilog)*, MUP RH, Zagreb, 1993.
78. Sahiti, Ejup dhe Murati, Rexhep, *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2013.
79. Sahiti, Ejup, *Dëshmia e dëshmitarit si provë në procedurë penale*, Prishtinë, 1993.
80. Sahiti, Ejup, *Psikologjia Gjyqësore*, Prishtinë, 2007.
81. Sajo, Andras (1998) 'How the rule of law can facilitate the spread of sleaze: Corruption, Clientelism, and the Future of the Constitutional State in Eastern Europe', in *Eastern European Constitutional Review*, Vol.7, No.2 7 Spring 1998.
82. Salihu, Ismet, "E Drejta Nderkombëtare Penale" LEOPRINT Prishtinë, 2005.
83. Salihu, Ismet, "E Drejta Penale Pjesa e Përgjithshme" Prishtinë, 2008.
84. Salihu, Ismet, "E Drejta Penale" Pjesa e Posaçme Prishtinë, 2009.
85. Savona, U. Ernesto and Riccardi, Michele, "From Illegal Markts to Legimative Businesses the Portofolio of Organised Crime in Europe" Milan, 2015.
86. Strazzari, Francesco "The Decade Horribilis. Organized Violence and Organized Crime along Balkan Peripheries: 1991-2001", in *Mediterranean Politics*, June 2007.
87. Strazzari, Francesco (2008) 'L'Oeuvre au Noir : The Shadow Economy of Kosovo's Independence', in *International Peacekeeping*, Volume [15](#), Issue [2](#) April 2008 .
88. Gjecovi, Shtjefan, *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Tiranë 1993.
89. Pieth, Mark, "The Prevention of Money Laundering: A Comparative Analysis", *Eur. J Cr., Cr.L & Cr.J* (1998).
90. Theodore S. Greenberg, Linda M. Samuel, Wingate Grant, Larissa Gray: *Stolen asset recovery: a good practices guide for non-conviction based asset for feature*, International Bank for Reconstruction and Development /The World Bank, Washington 2009.
91. Wiviano, Frank, "The Empire of Crime" Bruksel 1995.
92. Ukaj, Bajram, "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë" Prishtinë, 2006

93. Vula, Veton, *Kriminaliteti i Organizuar*, Prishtinë, 2013.
94. Dr. Elezi Ela “Efektiviteti i legjislacionit dhe sistemit të drejtësisë penale kundër kriminalitetit në procesin e integritet evropian”. Tiranë, 2013.
95. Zlataric, Bogdan, dhe Damaška, Mirijan, *Rjecnik krivicnog prava i postupka. (Fjalori i drejtës penale dhe i procedures)*, Zagreb, 1996.

b) Revista shkencore

1. E drejta-law, Revistë për çështje juridike dhe shoqërore, nr.1/2012, Elezi, E. “Legjislacioni penal shqiptar dhe efektiviteti i tij në luftën kundër kriminalitetit”.
2. E drejta-law, Revistë për çështje juridike dhe shoqërore, nr.1-4/2009, Gashi, R., “Kontributi i Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Republikën e Kosovës”.
3. E drejta-law, Revistë për çështje juridike dhe shoqërore, nr. 2-4/2005, Demolli, H., “Format dhe masat e luftimit të krimit të organizuar”.
4. E drejta-law, Revistë për çështje juridike dhe shoqërore, nr.1-2/2008, Demolli, H., “Disa karakteristika të kriminalitetit në Kosovën e pasluftës”.
5. Tribunë Juridike, nr. 46/2004, Salihu, I, “Kodi Penal i Kosovës – Akt me Rëndësi Historike, Juridike, Politike dhe Shtetërore”.
6. Tribunë Juridike, nr. 56/2005, Kokona, Sh. “Teoritë mbi Krimin dhe Kriminelët”.
7. Jeta Juridike, nr.2, Anastasi, A. “Mekanizmat e demshperblimit të viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore dhe rëndësia e forcimit të tyre”, Tiranë, 2009.
8. Tribunë Juridike, nr. 46/2004, Mëneri, S. “Mbi Kriteret Bazë të Korrupsionit”.
9. Tribunë Juridike, nr. 52/2005, Hysa, H. “Të drejtat e të dënuarve dhe mbrojtja e tyre”.
10. Tribunë Juridike, nr. 68/2007, Manja, U. “Fillimi i çështjes penale, veprim procedural me rëndësi për hetimin”.
11. Tribunë Juridike, nr.68/2007, Veliqoti, L, “ Rreth pyetjes së të pandehurit”.
12. Tribunë Juridike, nr. 63/2006, Ligor, H. “Për të vertetën në procesin penal”.
13. Tribunë Juridike, nr. 63/2006, Myftari, E. “Kriminalistika dhe Interneti”.
14. Tribunë Juridike, nr.64/2007, Ibi. S. “Për provat në procesin penal”.
15. Tribunë Juridike, nr.72/2007, Brahimllari G. “Kallzimi penal dhe deklarimi në fazën e hetimeve paraprake”.
16. Tribunë Juridike, nr.72/2008, Kokona, Sh. “Parime të Përgjegjësisë Kriminale”.
17. Tribunë Juridike, nr.70/2008, Balla, R. “Mbrojtja e dëshmitarit në procesin penal”.

18. Tribunë Juridike, nr.71/2008, Brahimllari, G. “Vendimi penal i huaj dhe parimi “ne bis in idem”.
19. Tribunë Juridike, nr. 63/2006, Ligor, H. “Për të vertetën në proçesin penal”.
20. Tribunë Juridike, nr. 68/2007, Manja, U. “Fillimi i çështjes penale, veprim procedural me rëndësi për hetimin”.
21. Jeta Juridike, nr.1, Llaci, M. “Probleme të provokimit në blerjen e stimuluar të lëndëve narkotike”, Tiranë, 2009
22. Tribunë Juridike, nr. 46/2004, Nushi, S. “Mbrojtja me Avokat e Personit gjatë Kohës së Shoqërimit, Ndalimit ose Arrestimit në Flagrancë”.
23. Tribunë Juridike, nr.55/2005, Luli, K. “Mbrojtja e Dëshmitarëve dhe e Bashkëpunëtorit të Drejtësisë”.

c) Burimet e Informacionit në web faqe:

1. <http://www.un.org/Docs/sc/committees/AfghanTemplate.htm>
2. http://www.fatf-gafi.org/NCCT_en.htm
3. <http://www.ustreas.gov/terrorism.html>
4. <http://europa.eu.int/eur-lex/en/index.html>.
5. http://www.fatf-gafi.org/TerFinance_en.htm
6. http://www.fatf-gafi.org/40Recs_en.htm
7. <http://untreaty.un.org/English/Terrorism.asp>.
8. <http://www.un.org/terrorism/sc.htm>.
9. <http://www.secicenter.org/m105/Home>.
10. <http://www.seepag.org/>.
11. <http://www.spai-rslo.org/en/>.
12. <http://www.marri-rc.org/>.
13. <http://www.sepca-bg.org/activities/news/>.
14. http://www.kosovo.undp.org/repository/docs/ISSR_report_eng_ver2.pdf
15. <http://www.newropeans-magazine.org/content/view/7022/281/>
16. <http://www.oecd.org/dataoecd/43/25/38406485.pdf>
17. <http://www.oecd.org/dataoecd/8/39/31785288.pdf>
18. <https://www.imolin.org/pdf/imolin/UNres03e.pdf>
19. https://www.unafei.or.jp/publications/pdf/RS_No83/No83_08VE_Weld3.pdf

20. <https://scholarlycommons.law.case.edu/cgi/viewcontent.cgi?referer=https://www.google.com/&httpsredir=1&article=1569&context=jil>
21. https://www.unodc.org/documents/organized-crime/Publications/Mutual_Legal_Assistance_Ebook_E.pdf
22. <http://www.bundesjustizamt.de>.
23. <http://www.scribd.com>.
24. <http://www.md-ks.org/>.
25. <http://www.legifrance.gouv.fr>.
26. <http://www.whitehousedrugpolicy.gov/publications/factsht/crime/index.html>.
27. http://www.newssafety.org/index.php?option=com_content&view=article&id=12194:progress-in-mexico-drug-war-is-drenched-in-blood&catid=345:mexico-security&Itemid=100298
28. <http://www.guardian.co.uk/global/2009/dec/13/drug-money-banks-saved-un-cfief-claims>
29. http://www.pp.gov.al/web/raporti_pp_2016_07_03_2017_1160.pdf
30. <https://rm.coe.int/16806ed4d4>
31. <https://www.pravo.unizg.hr/hljkkp>
32. <http://hjp.srce.hr/>
33. www.uradni-list.si/
34. <https://www.parlament.ba/Publication/Read/3952?title=propisi-o-oduzimanju-imovine-stecene-krivicnim-djelom-i-upravljanju-tom-imovinom-&pageId=0>
35. https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_bosnia_and_herzegovina.pdf
36. http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2009/PDF-2009/181-2009.pdf
37. <http://www.mpravde.gov.rs>
38. www.parlament.gov.rs
39. <http://www.coe.int/en/web/belgrade/project-on-criminal-assets-recovery-in-serbia>
40. www.agenziademanio.it/index.php.htm
41. <http://hjp.srce.hr/>
42. http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/default_en.asp
43. <http://www.altrodiritto.unifi.it/ricerche/law-ways/tancredi/cap1.htm1>
44. <http://www.giurdanella.it/2013/05/22/codice-antimafia-testo-aggiornatoalla-legge-stab/1>
45. www.agenziademanio.it/index.php.htm

46. <http://policehumanrightsresources.org/wp-content/uploads/2016/08/Criminal-Procedure-Code-No.-301-2005.pdf>.
47. http://www.minv.sk/swift_data/source/policia/finpol/vyroc_spravy/SVK4_MER_MONEYVAL-2011-21_en.pdf
48. www.irishstatutebook.ie/
49. https://www.iap-association.org/getattachment/e45fd52f-da76-469c-8a4d-0e13c43c4981/9ERC_Gary_Balch.pdf.aspx
50. <https://www.brightlinelaw.co.uk/news/when-criminal-property-is-not-criminal.html>
51. http://www.cairn-int.info/abstract-E_RIDP_841_0217--cr.htm
52. [https://uk.practicallaw.thomsonreuters.com/2-519-9872?transitionType=Default&contextData=\(sc.Default\)&firstPage=true&bhcp=1](https://uk.practicallaw.thomsonreuters.com/2-519-9872?transitionType=Default&contextData=(sc.Default)&firstPage=true&bhcp=1)
53. <http://www.legislationline.org/documents/section/criminal-codes/country/30>
54. http://www.justice.gouv.fr/art_pix/rapport_ARMSCA_anglais_2011.pdf
55. <http://www.justice.gouv.fr/justice-penale-11330/agrasc-12207/>
56. <https://www.net-iris.fr/veille-juridique/dossier/22348/la-loi-loppsi-ii-pour-renforcer-la-securite-interieure.php>
57. <http://telegraf.al/ekonomi/naim-mecalla-pasojat-e-pastrimit-te-parave>
58. http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/UN_Guide.pdf.
59. <http://hudoc.echr.coe.int>
60. <http://www.naropa.edu/faculty/johndavis/prm2/survey1.html>

d) Raporte

1. Raport i OSBE mbi vlerësimin e zbatimit të politikave Anti-trafikim për vitin 2009.
2. Raportet Vjetore të vitit 2010, 2011, 2012 dhe 2013 të Departamentit Amerikan të Shtetit.
3. Raporti Vjetor i vitit 2009, 2010, 2011 dhe 2012 i Prokurorisë së Përgjithshme, Tiranë, 2009.
4. Raporti Vjetor i Sektorit të Luftës Kundër Drogës Ministria e Brendshme 2011 dhe 2012.
5. Raporti i “Amnesty International” për matjen e korrupsionit në Shqipëri, Tiranë, 2009.
6. Raporti i Departamentit të Shtetit për Trafikimin e Qenieve njerëzore për vitin 2010, 2011 dhe 2012.

7. Raporti i Departamentit të Shtetit për Trafikimin e Drogave për vitin 2010, 2011 dhe 2012.
8. Raporti i Komisionit European për vitin 2005 dhe “Albania 2009 progress Report”.
9. Raporte periodike të CEPEJ (Komisionit European për Eficencën në Drejtësi).
10. Analizë vjetore të punës për vitin 2009, 2010 dhe 2011 nga Gjykata e Krimeve të Rënda.
11. US Department of Justice DEA 1991.
12. SEESAC 2005, Report: *SALW and Private Security Companies in the South Eastern Europe: A cause or effect of insecurity.*
13. Raporti i Komisionit European për vitet 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013.

e) Strategji nacionale

1. Strategjia dhe Plani i Veprimit Kombëtar i Republikës së Kosovës për Kontrollin dhe Grumbullimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta.
2. Strategjia nacionale kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe plani i veprimit 2011-2014.
3. Strategjia Shtetërore dhe plani i veprimit e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit.
4. Strategjia Kombëtare dhe plani i veprimit e Republikës së Kosovës për Migracion.
5. Strategjia Shtetërore dhe Plani i Veprimit e Republikës së Kosovës Kundër Krimit të Organizuar.
6. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit e Republikës së Kosovës Kundër Drogave.
7. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit e Republikës së Kosovës Kundër Terrorizmit.
8. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.